



INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT  
INSTITUCIJA OMBUDSMANA  
OMBUDSPERSON INSTITUTION

# RAPORTI VJETOR 2025 NR. 25





Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit · Institucija Ombudsmana · Ombudsperson Institution



# **RAPORTI VJETOR**

# **2025**

## **NR. 25**

Prishtinë, 2026

# Përmbajtja

<b>Fjala e Avokatit të Popullit</b>	<b>8</b>
<b>Mandati i Avokatit të Popullit</b>	<b>11</b>
<b>Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve</b>	<b>13</b>
<b>Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të parashtruara te Avokati i Popullit</b>	<b>23</b>
<b>Mbrojtja e te drejtave te njeriut nga Avokati i Popullit</b>	<b>30</b>
<b>Të drejtat themelore</b>	<b>30</b>
Dinjiteti i Njeriut	30
E Drejta për Jetën	31
E Drejta e Integritetit Personal	32
Liria e Lëvizjes	33
Mbrojtja e Pronës	34
E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	36
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	38
Aktivitetet e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës lidhur me Dhomat e Specializuara të Kosovës gjatë vitit 2025	41
<b>Çështje të tjera të trajtuara nga Avokati i Popullit lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë</b>	<b>45</b>
E Drejta për Mjete Juridike	48
E Drejta e Privatësisë	48
E Drejta e Martesës dhe Familjes	50
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	51
Liria e Shprehjes	52
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	53
Liria e Medieve	54
Liria e Tubimit	56
Liria e Asociimit	56
Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	57
<b>Avokati i Popullit në rolin e tij si mekanizëm i barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi</b>	<b>60</b>
Gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminimin në Kosovë	61
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi	61
Barazia Gjinore	72
Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre	75
Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	78
Të Drejtat e Fëmijës	80
E Drejta për Arsimin	87
Liria e Artit dhe e Shkencës	90
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	91
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	92
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	95

<b>Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës</b>	<b>100</b>
<b>Të drejtat e personave në kuptim të “drejtësisë tranzicionale”</b>	<b>110</b>
<b>Të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë</b>	<b>112</b>
<b>Shërbimet digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe Të Drejtat e Njeriut</b>	<b>112</b>
<b>Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese</b>	<b>114</b>
<b>Promovimi i drejtave dhe lirive themelore të njeriut</b>	<b>116</b>
<b>Bashkëpunimi ndërkombëtar</b>	<b>130</b>
<b>Komunikimi me publikun dhe mediat</b>	<b>141</b>
<b>Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut</b>	<b>142</b>
<b>Buxheti i IAP-së</b>	<b>146</b>





# Fjala e Avokatit të Popullit

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Paraqitja e Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës përbën një moment të veçantë solemn, që tejkalon dimensionin formal të përmbushjes së një detyrimi kushtetues. Ky akt përfaqëson një nga mekanizmat më të rëndësishëm të ushtrimit të kontrollit demokratik dhe të balancës ndërmjet pushteteve, duke reflektuar përgjegjësinë e shtetit për të garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai njëkohësisht përbën një moment të llogaridhënies publike, por edhe një thirrje për veprim institucional, për reflektim dhe për avancimin e standardeve demokratike në vend.

Institucioni i Avokatit të Popullit këtë vit shënon një jubile të rëndësishëm – 25-vjetorin e themelimit të tij, që përbën një moment domethënës, duke simbolizuar një çerekshkulli përkushtim për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë dhe qeverisjes së mirë në Republikën e Kosovës. I themeluar në periudhën pas luftës, në një kohë kur institucionet demokratike të vendit ishin ende në proces ndërtimi dhe konsolidimi, ky institucion qëndroi i palëkundur në mbrojtjen e sundimit të ligjit, në forcimin e llogaridhënies institucionale dhe në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore për çdo qytetar.

Përgjatë këtyre 25 vjetëve, Institucioni i Avokatit të Popullit është konsoliduar si një nga shtyllat kryesore të rendit demokratik dhe juridik të vendit. Nëpërmjet veprimtarisë së tij të vazhdueshme, ai ka fituar besimin e qytetarëve dhe ka ndërtuar një reputacion të qëndrueshëm edhe në rrejetet ndërkombëtare të institucioneve homologe. Ky institucion ka qenë dhe mbetet një zë i pavarur në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve, veçanërisht në rastet kur ato cenohen nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve publike.

Raporti që paraqitet para jush është rezultat i një pune të përkushtuar të stafit të institucionit, i cili gjatë gjithë vitit ka dëgjuar, hetuar dhe analizuar shqetësimet e qytetarëve. Në thelb, ky raport përfaqëson zërin e qytetarëve: zërin e atyre që përballen me padrejtësi, me vonesa në drejtësi, me mungesë të shërbimeve publike apo me trajtim të pabarabartë nga institucionet. Ai paraqet një pasqyrë reale të nivelit të demokracisë, të sundimit të ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Prandaj, shqyrtimi i këtij raporti nga Kuvendi ka një rëndësi të veçantë. Ai duhet të trajtohet jo si një akt formal, por si një instrument i rëndësishëm i kontrollit demokratik dhe i llogaridhënies institucionale të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës. Për këtë arsye, raporti duhet të shqyrtohet në mënyrë konstruktive dhe kritike, duke kontribuar në ngritjen e nivelit të debatit parlamentar për çështjet e të drejtave të njeriut dhe duke shmangur përdorimin e tij për qëllime politike që mund të cenojnë pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në këtë drejtim, mbetet shqetësues fakti se ky raport i paraqitet Kuvendit, ndërkohë që dy raportet paraprake për vitet 2023 dhe 2024 nuk janë shqyrtuar ende. Një situatë e tillë dobëson funksionin e këtij mekanizmi të rëndësishëm të llogaridhënies dhe dërgon një mesazh jo të mirë për rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Viti për të cilin raportohet u karakterizua nga dinamika të theksuara të zhvillimeve, përfshirë proceset zgjedhore dhe vonesat në konstituimin e institucioneve, të cilat patën ndikim në funksionimin e mekanizmave të kontrollit demokratik dhe në efikasitetin e vendimmarrjes publike. Megjithatë, pavarësisht këtyre rrethanave sfiduese, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar ta ushtronte mandatin e tij me profesionalizëm dhe paanshmëri, duke siguruar vazhdimësi në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke reaguuar në mënyrë të qëndrueshme ndaj shkeljeve të konstatuara.

Gjatë periudhës raportuese u pranuan 1736 ankesa, të cilat adresojnë një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me të drejtat themelore, përfshirë të drejtën për mjete juridike efektive, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtat në punë, mbrojtjen e pronës dhe barazinë para ligjit. Analiza e këtyre ankesave ofroi një pasqyrë të qartë të sfidave me të cilat përballen qytetarët, duke theksuar nevojën për përmirësime të mëtejshme në funksionimin e administratës publike dhe në zbatimin e ligjit.

Përmbajtja e këtij raporti reflekton një qasje të balancuar, duke evidentuar njëkohësisht progresin e arritur dhe sfidat e mbetura. Ai përfaqëson zërin autentik të qytetarëve, veçanërisht të atyre që

përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre, për shkak të mangësive institucionale, vonesave procedurale apo mungesës së shërbimeve adekuate.

Raporti trajton gjithashtu çështje me rëndësi të veçantë për cilësinë e jetës së qytetarëve, përfshirë mbrojtjen e mjedisit, ku ndotja e ajrit dhe menaxhimi i dobët i burimeve natyrore vazhdojnë të paraqesin sfida serioze. Po ashtu, raporti evidenton problematika në fushën e planifikimit urban, ndërtimit dhe infrastrukturës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe kategorive të ndjeshme, përfshirë personat e privuar nga liria, personat me çrregullime mendore, pensionistët dhe komunitetet joshumicë. Raporti evidentoi përpjekjet e Institucionit për t'i adresuar nevojat e këtyre grupeve dhe për të promovuar trajtim të barabartë dhe me dinjitet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Rritja e numrit të ankesave nga komunitetet joshumicë dëshmoi për besimin në rritje ndaj Institucionit dhe rolin e tij si garantues i barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në fushën e lirisë së shprehjes dhe mediave, raporti nënvizoi rëndësinë e sigurimit të një ambienti të sigurt dhe të lirë për gazetarët, si dhe nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional për mbrojtjen e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdoi të luante një rol aktiv në promovimin e të drejtave ekonomike dhe sociale, duke adresuar çështje që lidhen me pensionet, asistencën sociale, rritjen e tarifave të shërbimeve publike etj. Në këtë drejtim, u dhanë rekomandime konkrete për përmirësimin e politikave publike dhe për rritjen e transparencës dhe drejtësisë në vendimmarrje.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, shqetësime të mëdha lidhen me dhunën në shkollë, mungesën e mbështetjes institucionale për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, peshën e rëndë të çantave shkollore dhe mungesën e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat vazhdojnë të jenë probleme që kërkojnë ndërhyrje urgjente institucionale.

Raporti adreson gjendjen e pensionistëve dhe të personave të moshuar, mungesën e një sistemi funksional të sigurimeve shëndetësore dhe pensionale, mungesën e shërbimeve për shëndetin mendor, si dhe vështirësitë ekonomike, që e bëjnë jetën e kësaj kategorie të qytetarëve veçanërisht të vështirë.

Raporti evidenton shqetësime serioze lidhur me funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, veçanërisht mungesën e transparencës, të llogaridhënies dhe të mbikëqyrjes demokratike, pavarësisht faktit se ato janë themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, theksohet domosdoshmëria e respektimit të garancive procedurale dhe standardeve që Kosova zbaton në sistemin e saj gjyqësor, në përputhje me parimet e një procesi të rregullt dhe të drejtë, siç janë barazia e armëve, e drejta për mbrojtje efektive, transparenca e procedurave dhe qasja e barabartë për të gjitha palët. Shqetësimet e ngritura në raport, përfshirë kufizimet e llogaridhënies dhe transparencës, kohëzgjatjen e paraburgimit dhe përdorimin e provave të siguruar nga vende me qasje armiqësore, paraqesin dilema serioze mbi përmbushjen e këtyre standardeve dhe ndikojnë në besimin e publikut në drejtësi. Për rrjedhojë, është thelbësore që funksionimi i këtyre dhomave të harmonizohet plotësisht me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për një gjykim të drejtë, duke garantuar integritet procedural, paanshmëri dhe llogaridhënie të plotë institucionale.

Një shqetësim i vazhdueshëm mbetet fakti se në shumë fusha kritike nuk ka zbatim të plotë të ligjeve në fuqi. Ligji për Sigurimet Shëndetësore ende nuk ka filluar të zbatohet në praktikë, Ligji për Pensionet zbatohet vetëm pjesërisht, ndërsa pagat në sektorin publik shpesh nuk përcillen në përputhje me legjislacionin aktual. Ndonëse Republika e Kosovës ka krijuar mekanizma të avancuar ligjorë dhe institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, efektiviteti i tyre mbetet i kufizuar pa një angazhim të shtuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe forcimin e mekanizmave të zbatimit. Është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të fokusohen jo vetëm në miratimin e ligjeve, por edhe në garantimin e zbatimit të tyre të plotë, duke siguruar që qytetarët të përfitojnë në praktikë nga e drejta e tyre për shëndet, pensione dhe të drejtat e tjera themelore.

Të nderuar deputetë,

Të drejtat e njeriut nuk janë thjesht një standard juridik apo një obligim institucional, por janë themeli mbi të cilin ndërtohet besimi i qytetarëve në shtetin e tyre.

Prandaj, Avokati i Popullit u bën thirrje të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin masa konkrete për adresimin e këtyre shqetësimeve dhe për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë të mbetet një zë i pavarur dhe i fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ju faleminderit!

# Mandati i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i paraparë me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, bazuar në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, është institucion i pavarur në aspektin funksional, organizativ dhe buxhetor. Aspekti më i rëndësishëm i pavarësisë së Avokatit të Popullit është përcaktimi kushtetues që ai nuk pranon udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë organ apo institucion tjetër në Republikën e Kosovës. Kompetenca kryesore kushtetuese e Avokatit të Popullit është mbikëqyrja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Këtë mbikëqyrje dhe mbrojtje, Avokati i Popullit fillimisht e ushtron duke kërkuar informacione nga çdo autoritet që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, informacione që autoritetet kanë detyrim t'i ofrojnë sipas përcaktimeve kushtetuese.

Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, ushtron disa kompetenca/mandate, përkatësisht: (I) Mandati për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; (II) Mandati si Organ i Barazisë; dhe (III) Mandati si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Avokati i Popullit gjithashtu është palë e autorizuar për referimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese<sup>1</sup>.

Një kompetencë e rëndësishme e punës së Avokatit të Popullit është që, bazuar në hetimet e tij, në rastet kur konstatohen shkelje të të drejtave të njeriut, përpilohen raporte me gjetjet përkatëse dhe autoriteteve u drejtohen rekomandimet dhe propozohen masa konkrete.

Po ashtu, një tjetër aspekt i rëndësishëm i Avokatit të Popullit është fakti që për gjetjet e tij në fushën e shkeljeve të të drejtave të njeriut paraqet Raport Vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mund të paraqesë edhe raporte të veçanta.

Është detyrë dhe përgjegjësi e autoriteteve publike që t'i respektojnë dhe zbatojnë

rekomandimet e Avokatit të Popullit, si një matës i respektimit të sundimit të ligjit dhe funksionimit të demokracisë në vendin tonë.

## Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut kundër veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë hetimin e rasteve të paraqitura nga ankuesit, hetimin sipas detyrës zyrtare të shkeljeve të mundshme, kontestimin e akteve të administratës për mbrojtjen e interesit publik, dhënien e rekomandimeve të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, dhënien e opinioneve në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), dhënien e rekomandimeve për rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, udhëheqjen e procedurës së ndërmjetësimit dhe të pajtimit, dhënien e asistencës viktimeve të diskriminimit, dhënien e rekomandimeve për institucionet publike për zbatimin e detyrimeve në fushën e ndalimit të diskriminimit dhe të barazisë, si dhe referimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në mekanizma të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë monitorimin e rasteve gjyqësore ku palët kanë statusin e viktimeve të pretenduar të shkeljes së të drejtave të njeriut, ose kur sipas detyrës zyrtare konsiderohet se mund të ketë shkelje sistematike të të drejtave të njeriut; detyrimin e autoriteteve publike për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit; monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit; mbikëqyrjen e standardit të hartimit të legjislacionit për sa u përket përcaktimeve të të drejtave të njeriut dhe përputhshmërisë me Kushtetutën; monitorimin e zbatimit të ligjeve që kanë për fokus të drejtat e njeriut, si dhe mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 2.

## Roli i Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ka një rol të rëndësishëm në promovimin e të drejtave të njeriut, rol të cilin e ushtron nëpërmjet mekanizmit të ngritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe të institucioneve publike për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore. Këtë e realizon nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe ligjëratave, publikimit të opinioneve dhe broshurave që paraqesin qëndrimin e Avokatit të Popullit për çështje të caktuara, deklaratave për zbatim të masave të caktuara, organizimit të ditëve të hapura për të drejtat e njeriut, organizimit të konferencave dhe tryezave tematike, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me partnerë socialë, shkëmbimit të vizitave me institucione homologe, paraqitjes në media të opinioneve të Avokatit të Popullit, si dhe mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## Roli i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Avokati i Popullit ushtron mandatin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, përmes vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigrantëve dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, ai jep rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve dhe të akteve të tjera me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare në parandalimin e torturës. MKP-ja bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë, vendorë dhe me mekanizmat e tjerë që përcaktohen me ligj të veçantë nëfushën e parandalimit të torturës.

## Roli i Avokatit të Popullit si mekanizëm i barazisë

Avokati i Popullit ushtron mandatin e tij si mekanizëm i barazisë për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit. Një mandat të tillë, Avokati i Popullit e realizon përmes mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, hetimit të rasteve të diskriminimit, promovimit të praktikave të mira të barazisë, informimit të publikut për rastet e diskriminimit, trajtimit të rasteve që lidhen me diskriminimin gjinor, si dhe bashkëpunimit me partnerë socialë dhe me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

# Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve

Nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025, në Institucionin e Avokatit të Popullit, në zyrën qendrore në Prishtinë dhe në zyrat rajonale në Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Gjakovë dhe Graçanicë, janë parashtruar 1736 ankesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, përfshirë pohime ankimore për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga autoritetet publike, si dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike.

Nga analizimi i këtyre ankesave, sipas kategorive kushtetuese të të drejtave dhe lirive të njeriut, vërehet se numri më i madh i tyre lidhet me: të drejtën për mjete juridike, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit, mbrojtjen e pronës, barazinë para ligjit, të drejtat e të akuzuarit, ndalimin e torturës dhe trajtimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të drejtat e fëmijës etj.

Në paraqitjet tabelore të mëposhtme janë dhënë shënime më të detajuara për numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar, shqyrtuara dhe të vendosura për pranueshmërinë ose papranueshmërinë për hetim, rastet e hapura për hetim me vetiniciativë të Avokatit të Popullit, përkatësinë etnike dhe gjinore të ankuesve, autoritetet publike përgjegjëse ndaj të cilave janë parashtruar ankesat, numrin e rasteve të përfunduara/mbyllura, numrin e raporteve dhe rekomandimeve të publikuara ndaj autoriteteve publike, si dhe shkallën e zbatuar të këtyre rekomandimeve nga autoritetet përkatëse.

**Tabela 1.** Ankesat e paraqitura te Avokati i Popullit në vitin 2025

<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura</b>	<b>1736</b>
<b>Përkatësia etnike e ankuesve</b>	
Shqiptarë	1411
Serbë	207
Boshnjakë	29
Ashkalinj	23
Turq	19
Romë	11
Goranë	9
Egjiptianë	8
Tjetër	19
<b>Ankesat e paraqitura, të ndara sipas zyrave të Avokatit të Popullit</b>	
Zyra Qendrore-Prishtinë	953
Zyra Rajonale-Pejë	152
Zyra Rajonale-Gjilan	144
Zyra Rajonale-Prizren	142
Zyra Rajonale-Ferizaj	94
Zyra Rajonale-Gjakovë	90
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Veriut	70
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Jugut	59

Zyra Rajonale-Graçanicë	32
<b>Përkatësia gjinore e ankuesve bazuar në ankesat e paraqitura</b>	
Meshkuj	1158
Femra	578
Autoritetet publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	
Ministritë/Administrata	703
Gjykatat	363
Komunat	261
Policia	124
Prokuroritë publike	73
Ndërmarrjet publike	70
Persona privat	60
Kompani private	40
Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike	36
Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)	19
Autoritetet e huaja	19
Agjancia Kosovare e Privatizimit	18
Kuvendi i Republikës së Kosovës	15
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	12
Përmbarues privatë	12
Të tjera	143

**Tabela 2.** Numri i ankesave të paraqitura, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një ankesë mund të përfshijë disa të drejta e liri)

KRK 32 - E Drejta për Mjete Juridike	553
KRK 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	305
KRK 51 - Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	202
KRK 49 - E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	189
KRK 46 - Mbrojtja e Pronës	139
KRK 24 - Barazia para Ligjit	122
KRK 30 - Të Drejtat e të Akuzuarit	98
KRK 27 - Ndalimi i Torturës	95
KRK 50 - Të Drejtat e Fëmijës	88
KRK 47 - E Drejta për Arsimin	39
KRK 35 - Liria e Lëvizjes	35
KRK 29 - E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	25
KRK 23 - Dinjiteti i Njeriut	24
KRK 37 - E Drejta e Martesës dhe Familjes	21
KRK 52 - Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	13
KRK 41 - E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	13

KRK 25 - E Drejta për Jetën	10
KRK 54 - Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	9
KRK 36 - E Drejta e Privatësisë	7
KRK 45 - Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	6
KRK 26 - Integriteti Personal	5
KRK 40 - Liria e Shprehjes	2
KRK 48 - Liria e Artit dhe e Shkencës	2
KRK 55 - Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore	2
KRK 38 - Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	2
KRK 43 - Liria e Tubimit	1
KRK 39 - Konfesionet Fetare	1
KRK 33 - Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale	1

**Tabela 3.** Numri i ankesave të paraqitura, sipas Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) - një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	1471
03. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	148
10. Pabarazitë e Reduktuara	53
08. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	35
17. Partneritetet për Qëllimet	24
04. Arsim Cilësor	19
06. Uji i Pastër dhe Kanalizimi	9
09. Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura	9
07. Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	8
05. Barazia Gjinore	4
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	4
12. Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm	3
13. Veprimi Klimatik	1

**Tabela 4.** Ankesat e vendosura si të papranueshme

Numri i ankesave të papranueshme	1108
<b>Ankesat e papranueshme, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	374
S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	308
Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	194
Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	178
Mosinteresim, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	38
E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	9
Ankesë anonime – Neni 21, pika 1.3.3	5
Keqpërdorim i së drejtës së ankesës – Neni 21, pika 1.3.4	1
Shënim zyrtar	1

**Tabela 5.** Ankesat në pritje për shqyrtim

Numri i ankesave në pritje për shqyrtim	4
---	---

**Tabela 6.** Ankesat e vendosura si të pranueshme për hetim

Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim	624
Numri i rasteve të hetuara me iniciativë të Avokatit të Popullit (Ex officio)	41
<b>Ankesat e hapura për hetim, sipas përkatësisë etnike të ankuesve</b>	
Shqiptarë	411
Serbë	165
Boshnjakë	17
Ashkalinj	6
Goranë	6
Romë	6
Turq	5
Egjiptianë	3
Tjetër	5
<b>Përkatësia gjinore e ankuesve, bazuar në ankesat e hetuara</b>	
Meshkuj	362
Femra	262
<b>Autoritetet publike ndaj të cilave janë hapur hetime sipas ankesave (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</b>	
Ministritë/Administrata	318
Gjykatat	141
Komunat	121
Policia	36
Prokuroritë	23
Ndërmarrjet publike	19
Zyra e Rregullatorit për Energji	13
Kuvendi i Republikës së Kosovës	10
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	10
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	8
Kompania Kosovare për Distribim me Energji Elektrike	7
Të tjera	53

**Tabela 7.** Numri i ankesave të hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një ankesë mund të përfshijë disa të drejta e liri)

KRK 32 - E Drejta për Mjete Juridike	199
KRK 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	128
KRK 24 - Barazia para Ligjit	94
KRK 49 - E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	73
KRK 50 - Të Drejtat e Fëmijës	68
KRK 46 - Mbrojtja e Pronës	51
KRK 51 - Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	39
KRK 27 - Ndalimi i Torturës	29
KRK 47 - E Drejta për Arsimin	29
KRK 23 - Dinjiteti i Njeriut	12
KRK 30 - Të Drejtat e të Akuzuarit	11
KRK 52 - Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	11
KRK 35 - Liria e Lëvizjes	10
KRK 37 - E Drejta e Martesës dhe Familjes	10
KRK 45 - Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	9
KRK 25 - E Drejta për Jetën	4
KRK 54 - Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	4
KRK 26 - Integriteti Personal	2
KRK 29 - E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	2
KRK 38 - Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	2
KRK 41 - E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	2
KRK 48 - Liria e Artit dhe e Shkencës	2
KRK 55 - Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore	2
KRK 33 - Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale	1
KRK 36 - E Drejta e Privatësisë	1
KRK 42 - Liria e Medieve	1

**Tabela 8.** Numri i ankesave të hetuara, sipas OZhQ-së (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	551
03. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	44
10. Pabarazitë e Reduktuara	25
08. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	15
04. Arsim Cilësor	11
17. Partneritetet për Qëllimet	10
09. Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura	5
07. Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	4
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	2
05. Barazia Gjinore	1

**Tabela 9.** Numri i rasteve ex officio, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një rast mund të përfshijë disa të drejta e liri)

E Drejta për Mjete Juridike	11
Ndalimi i Torturës	9
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	5
E Drejta për Jetën	4
Mbrojtja e Pronës	4
Barazia para Ligjit	3
Të Drejtat e të Akuzuarit	3
Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	3
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	3
Të Drejtat e Fëmijës	3
Dinjiteti i Njeriut	2
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	2
Liria e Lëvizjes	1
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	1
Liria e Medieve	1
E Drejta për Arsimin	1
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	1

**Tabela 10.** Numri i rasteve ex officio, sipas OZhQ-së (një rast mund të përfshijë disa OZhQ)

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	32
3. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	8
4. Arsim Cilësor	1
8. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	1

**Tabela 11.** Ankesat e vendosura me përfundim të hetimeve (përfshijnë ankesat e vitit 2025 dhe viteve paraprake)

Numri i përgjithshëm i ankesave të përfunduara/mbyllura	694
<b>Ankesat e përfunduara/mbyllura, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
I zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5	264
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	187
I mbyllur me raport, kur konstatohen shkelje të të D.Nj. - Neni 24, pika 3	111
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	46
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	35
I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	31
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	12
Shënim zyrtar	8

**Tabela 12.** Raportet me rekomandime dhe Letrat me rekomandime

Raporte për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	44
Raporte për rastet hetimore me iniciativë të AP-së, Ex officio	7
Raportet e MKP-së	6
Letra me rekomandime për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	8
Rekomandime në raportet dhe letrat me rekomandime	683

**Tabela 13.** Statusi i rekomandimeve

Rekomandime të zbatuara	131
Rekomandime pjesërisht të zbatuara	30
Rekomandime të pazbatuara	19
Rekomandime në pritje për zbatim	503
Totali	683

**Tabela 14.** Krahasimi i përqindjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit të adresuara gjatë vitit 2024, gjendja sipas raportimit të periudhës më 31 dhjetor 2024 dhe përditësimi më 31 dhjetor 2025

Rekomandimet 2024	Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve më 31 dhjetor 2024	Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve më 31 dhjetor 2025
Rekomandime të zbatuara	37 - 21%	53 - 30%
Rekomandime pjesërisht të zbatuara	7 - 4%	9 - 5%
Rekomandime në pritje për zbatim	119 - 68%	98 - 56%
Rekomandime të pazbatuara	13 - 7%	16 - 9%
Totali i rekomandimeve	176	176

**Tabela 15.** Statusi i rekomandimeve sipas nivelit institucional – 2025

Niveli insitucional	Gjithsej rekomandime	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara	Në pritje për zbatim
Niveli Qendror	107	25	19	5	58
Niveli Lokal	546	100	11	9	426
Gjyqësori/Prokuroria	30	6	0	5	19
Totali	683	131	30	19	503

**Tabela 16.** Kërkesa, komente dhe opinione të paraqitura pranë institucioneve

Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese	1
Komente drejtuar Gjykatës Kushtetuese	1
Opinione drejtuar autoriteteve të tjera	6
Kërkesë për masë të përkohshme drejtuar autoriteteve të tjera	1
Amicus Curiae	2

**Tabela 17.** Ankesat e pranuar dhe të hetuara nga Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Numri i ankesave të paraqitura	149
Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim	118
Numri i ankesave të papranueshme	31
Numri i rasteve hetimore me vetiniciativë ex officio	6

**Tabela 18.** Zbatueshmëria e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike përgjegjëse

Autoriteti përgjegjës	Rekomandime të implementuara	Rekomandime pjesërisht të implementuara	Rekomandime të paimplementuara	Në pritje për implementim
Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0	0	0	3
Ministria e Shëndetësisë	4	1	0	15
Ministria e Drejtësisë	0	0	0	9
Ministria e Punëve të Brendshme	13	10	3	16
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	4	7	0	0
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0	0	1	8
Policia e Kosovës	0	1	0	0
Dogana e Kosovës	0	0	0	2
Agjencia e Statistikave të Kosovës	2	0	0	0
Inspektorati Shëndetësor	0	0	0	1


Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës	0	0	0	1
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	1	0	1	1
Banka Qendrore e Kosovës	1	0	0	2
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	0	0	0	5
Gjykata e Apelit	1	0	1	3
Gjykata Themelore në Prishtinë	4	0	4	8
Gjykata Themelore në Mitrovicë	1	0	0	3
Komuna e Prishtinës	4	3	1	12
Komuna e Prizrenit	5	0	0	9
Komuna e Pejës	0	0	0	14
Komuna e Skenderajt	0	0	0	14
Komuna e Drenasit	3	0	0	10
Komuna e Mitrovicës Jurgore	6	0	0	8
Komuna e Gjilanit	7	1	0	5
Komuna e Fushë Kosovës	0	0	0	14
Komuna e Deçanit	10	0	0	4
Komuna e Ferizajt	2	0	0	13
Komuna e Gjakovës	0	0	2	13
Komuna e Podujevës	3	1	0	10
Komuna e Vushtrrisë	0	0	0	14
Komuna e Malishevës	0	0	0	15
Komuna e Vitisë	3	1	0	10
Komuna e Graçanicës	2	0	3	12
Komuna e Hanit të Elezit	6	0	0	8
Komuna e Istogut	0	0	0	14
Komuna e Kaçanikut	3	1	0	10
Komuna e Klinës	3	0	0	12
Komuna e Rahovecit	0	0	0	14

Komuna e Kamenicës	0	0	0	14
Komuna e Lipjanit	0	0	0	14
Komuna e Obiliqit	5	1	0	8
Komuna e Klllokotit	4	0	1	9
Komuna e Shtimes	6	0	0	8
Komuna e Suharekës	5	1	0	8
Komuna e Junikut	3	0	0	10
Komuna e Mitrovicës Veriore	0	0	0	15
Komuna e Dragashit	0	0	0	14
Komuna e Novobërdës	0	0	1	13
Komuna e Ranillugit	1	1	0	12
Komuna e Zveçanit	3	1	0	10
Komuna e Leposaviçit	0	0	1	14
Komuna e Zubin Potokut	0	0	0	14
Komuna e Parteshit	6	0	0	8
Komuna e Mamushës	0	0	0	14
Komuna e Shtërpcës	8	0	0	6
KRM "Pastrimi"	1	0	0	0
ShFMU "Elena Gjika"	1	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>131</b>	<b>30</b>	<b>19</b>	<b>503</b>


# Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të parashtruara te Avokati i Popullit

1 janar 2025 - 31 dhjetor 2025


**Figura 1.** Paraqitja e ankesave të qytetarëve të shqyrtuara/vendosura nga Avokati i Populli




**Figura 2.** Përqindja e ankesave sipas përkatësisë etnike të qytetarëve




**Figura 3.** Përkatësia gjinore e ankuesve bazuar në ankesat e paraqitura




**Figura 4.** Autoritetet publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat




**Figura 5.** Ankesat e paraqitura, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore




**Figura 6.** Numri i ankesave të paraqitura, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)




**Figura 7.** Ankesat e hapura për hetim, sipas përkatësisë etnike të ankuesve




**Figura 8.** Autoritetet publike ndaj të cilave janë hapur hetime sipas ankesave




**Figura 9.** Përqindja e ankesave të hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Lirit Themelore




**Figura 10.** Përqindja e ankesave të hetuara, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)




**Figura 11.** Përqindja e ankesave të hetuara Ex officio, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore




**Figura 12.** Përqindja e rasteve ex officio, sipas OZhQ (një rast mund të përfshijë disa OZhQ)




**Figura 13.** Rastet e vendosura me përfundim/mbyllje të hetimeve (përfshijnë rastet e vitit 2025 dhe viteve paraqake)




**Figura 14.** Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike përgjegjëse, të publikuara gjatë vitit 2025



**Figura 15.** Përqindja e ankesave të hetuara dhe të papranueshme nga Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve



**Figura 16.** Ankesat e paraqitura gjatë vitit 2025, në zyrën qendrore dhe në zyrat rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit



# Mbrojtja e të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit

# Mbrojtja e te drejtave te njeriut nga Avokati i Popullit

## Të drejtat themelore

### Dinjiteti i Njeriut

Dinjiteti i njeriut përbën vlerë themelore mbi të cilën ndërtohet rendi kushtetues dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Ai është i paraparë në mënyrë eksplicite në nenin 23 të Kushtetutës, ku theksohet se dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Interpretimi kushtetues i dinjitetit të njeriut në Republikën e Kosovës është i pandashëm nga praktika e GjEDNj-së, e cila ka theksuar vazhdimisht se respektimi i dinjitetit njerëzor përbën thelbin e KEDNj-së. Avokati i Popullit vë në theks se GjEDNj-ja ka zhvilluar standarde, sipas të cilave shtetet kanë jo vetëm detyrimin të përmbahen nga cenimi i dinjitetit të njeriut, por edhe detyrime pozitive për të ndërmarrë masa efektive mbrojtëse, veçanërisht ndaj personave në situata të cenueshme.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 24 ankesa me pretendime për shkelje të dinjitetit të njeriut, prej të cilave 10 janë proceduar për hetime të mëtejme, ndërsa 14 janë shpallur të papranueshme. Ndërsa Avokati i Popullit ka filluar hetimin sipas detyrës zyrtare në dy raste.

Rastet e paraqitura për IAP, ku pretendohet shkelje e dinjitetit njerëzor, ndër të tjera, janë: një ankesë për gjuhë fyese dhe degraduese të përdorur ndaj ankuesve në një institucion publik;<sup>2</sup> raportim për ngacim seksual dhe mosmarrje të masave nga punëdhënësi;<sup>3</sup> ankesë për ndërprerjen e pagesës së pensionit për persona të verbër, por e cila është zgjidhur

nga autoriteti dhe rasti është mbyllur nga IAP-ja;<sup>4</sup> pretendim për trajtim denigrues nga policia;<sup>5</sup> pretendime për cenimin e dinjitetit të njeriut; për diskriminim gjinor; për cenimin e së drejtës nga marrëdhënia e punës;<sup>6</sup> pretendim për kërcënim nga fqinjët dhe mosmarrje e masave nga policia;<sup>7</sup> pretendime për mosintervenim nga Policia, pavarësisht ankesave për sulme psikike dhe fizike ndaj parashtruesit.<sup>8</sup> Raste të tjera të paraqitura me pretendime për shkelje të dinjitetit të njeriut janë raste ku pretendohet për bullizëm, ankesa për ushtrim padie ndaj personave privatë, ankesë për mosfurnizim me ujë të pijes, pretendime për shtrim të paligjshëm në psikiatri dhe trajtim degradues, ankesë për kompensim të ulët si viktimë e veprave penale etj.

Në rastin ex officio R/370/2025, Avokati i Popullit ka filluar hetimet lidhur me pretendimet se një grua me aftësi të kufizuar është dhunuar dhe ka ngelur shtatzëne. Ky rast është raportuar nga mediat. Avokati i Popullit ka filluar hetimet dhe ka kontaktuar me organet kompetente, të cilat janë duke zhvilluar hetimet lidhur me rastin. Për Avokatin e Popullit është tejet shqetësues fakti që ky akt është kryer ndaj një gruaje me aftësi të kufizuar, e cila bën pjesë në një kategori të cenueshme, duke rezultuar me shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor, e duke prekur në të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore e poshtëruese, në të drejtën për integritet trupor dhe mosdiskriminim. Hetimet në këtë rast nuk kanë përfunduar ende dhe Avokati i Popullit është duke i ndjekur zhvillimet e procedurave të organeve kompetente.

Nga hetimi i rastit R.nr.1501/2025, sipas ankesës së një qytetari kundër ShSKUK-së, është vërejtur se si mungesë e hapësirave për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim të personave me çrregullim mendor që kanë kryer vepër penale dhe u është shqiptuar kjo masë nga gjykata, nuk trajtohen nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike për shkak të mungesës së vendeve. Gjithashtu është vërejtur se në mungesë të hapësirave, këto raste dërgohen në mbajtje në qendrat e paraburgimit. Situata e tillë nënkupton trajtim të padinjitetshëm për këta persona dhe paraqet dështim të autoriteteve përgjegjëse për t'i përmbushur detyrimet ligjore për trajtimin e rasteve të tilla. Nga përgjigjja që mori Avokati i Popullit nga Instituti i Psikiatrisë

2 Rasti R/1733/2025.

3 Rasti R/1688/2025.

4 Rasti R/1525/2025.

5 Rasti R/1240/2025.

6 Rasti R/1159/2025.

7 Rasti R/1147/2025.

8 Rasti R/562/2025.

Forenzike, theksohet se posedojnë vetëm 12 shtretër për këtë kategori të personave, ndërsa në anën tjetër nuk ka hapësirë për trajtimin e femrave. Kjo situatë është tregues i mungesës së masave të përshtatshme për personat, ndaj të cilëve është caktuar kjo masë me vendim të gjykatës, nuk ka kontroll të zbatimit të saj nga gjykata, e në anën tjetër kjo për Avokatin e Popullit paraqet shkelje të vazhdueshme të dinjitetit të këtyre personave dhe të të drejtave dhe lirive të tyre në raport me detyrimin e shtetit që këta persona të marrin trajtimin dhe shërbimet shëndetësore të nevojshme.

## E Drejta për Jetën

E drejta për jetën përbën themelin e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut. Pa garantimin e kësaj të drejte, ushtrimi i të drejtave të tjera bëhet i pamundur. Në Republikën e Kosovës, e drejta për jetën është e garantuar qartë në Kushtetutë, në legjislacionin vendor dhe mbështetet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

E drejta për jetën nënkupton mbrojtjen e individit nga çdo formë e privimit arbitrar të jetës. Ajo nuk përfshin vetëm ndalimin e vrasjes, por edhe detyrimin e shtetit për të ndërmarrë masa aktive për mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Kjo përfshin mbrojtjen nga dhuna, trajtimi çnjerëzor, tortura, neglizhenca institucionale dhe rreziqet që mund ta rrezikojnë jetën e njeriut. E drejta për jetën konsiderohet e drejtë absolute, e cila nuk mund të pezullohet as në gjendje të jashtëzakonshme.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për jetën dhe shprehimisht përcakton se secili individ gëzon këtë të drejtë, ndërsa dënimi me vdekje është i ndaluar.<sup>9</sup> Po ashtu, kjo e drejtë garantohet edhe me instrumente ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara,<sup>10</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,<sup>11</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,<sup>12</sup> të cilat janë pjesë e sistemit juridik dhe kushtetues në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike në Republikën e

Kosovës.<sup>13</sup> Aktet e lartpërmendura përcaktojnë obligimin e shteteve palë që ta garantojnë këtë të drejtë me ligj dhe që askush nën juridiksionin e tyre të mos privohet nga jeta në mënyrë arbitrare.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 10 ankesa me pretendimin për shkeljen e kësaj të drejte, prej të cilave 4 janë hapur për hetime të mëtejme, ndërsa 6 janë shpallur të papranueshme. Gjatë vitit raportues janë hapur edhe 4 raste për hetim sipas detyrës zyrtare.

Rasti i parë ka të bëjë me rrëmbimin e një qytetari të Kosovës, të nacionalitetit serb, i cili u plagos dhe u rrëmbye nga xhandarmëria serbe dhe u dërgua në Serbi. Sipas informatave nga mediat, rrëmbimi kishte ndodhur brenda territorit të Republikës së Kosovës. Rrethanat në të cilat kishte ndodhur ky rast ishin të paqarta, ndërsa kishte informacione se personi i rrëmbyer ishte keqtrajtuar. Në bazë të këtyre informatave, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Zyra Ndërlidhëse e Kosovës në Serbi që të interesohet për marrjen e informatave lidhur me fatin e tij, gjendjen shëndetësore dhe mënyrën e trajtimit. Nga Zyra Ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi, Avokati i Popullit është njoftuar se i njëjti ishte i hospitalizuar në repartin intensiv, ndërsa për kërkesën për informim të detajuar mbi gjendjen e tij dhe për mundësimin e vizitës nga diplomatët e Zyrës Ndërlidhëse është marrë përgjigje negative. Nga informatat e ofruara, Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se, përkundër përpjekjeve të autoriteteve të Republikës së Kosovës, nuk është arritur të sigurohet monitorimi i këtij rasti.<sup>14</sup>

Rasti i dytë është hapur për hetim bazuar në informatat e siguruar nga mediat, të cilat kishin raportuar për një ngjarje të ndodhur në Lipjan, kur gjatë arrestimit të një qytetari që ishte duke prishur rendin dhe qetësinë publike, ai kishte ndërruar jetë. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 00:15, më 7 korrik 2025, kur policia kishte pranuar informatën se një person, i cili dyshohej se ishte nën ndikim të alkoolit, po sulmonte automjete dhe kalimtarë në rrugën “Haradin Bajrami” në Lipjan. Gjatë vendosjes

9 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25.

10 Kombet e Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 3.

11 Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 2.

12 Kombet e Bashkuara, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 6.

13 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

14 1661/2025.

nën kontroll dhe arrestimit, personi ndaj të cilit po ndërmerreshin veprimet ka ndërruar jetë. E gjithë situata është regjistruar me video nga kalimtarët. Rasti ka ngjallur debat publik, duke qenë se vdekja ka ndodhur gjatë arrestimit dhe pamjet janë publikuar në media dhe rrjete sociale. Avokati i Popullit ka deklaruar se duhet të ndërmerren veprime urgjente hetimore për zbardhjen profesionale të të gjitha detajeve të rastit, për të përcaktuar shkaqet e vdekjes, proporcionalitetin e përdorimit të forcës, nëse është ofruar ndihma mjekësore në kohë dhe rrethanat e tjera përkatëse. Avokati i Popullit është duke i vazhduar hetimet dhe është në pritje të raporteve nga autoritetet kompetente.<sup>15</sup>

Rasti i tretë është hapur për hetim bazuar në informatat e siguruar nga mediat për vdekjen e një personi të arrestuar në Qendrën e Ndalimit në Stacionin Policor në Suharekë, i cili, sipas raportimeve të Policisë, ishte vetëvarur në qeli. Sipas informatave të siguruar, autoritetet përgjegjëse kanë përfunduar hetimet dhe kanë marrë masa ndaj zyrtarëve policorë që kanë qenë kujdestarë në natën kritike<sup>16</sup> Avokati i Popullit është duke vazhduar hetimet për të vlerësuar përmbushjen e detyrimeve të autoriteteve përgjegjëse për marrjen e masave që garantojnë sigurinë e jetës së personave të arrestuar dhe të ndaluar, në përputhje me legjislacionin vendor dhe me garancitë procedurale që rrjedhin nga neni 2 i KEDNj-së.

Rasti i katërt është hapur për hetim bazuar në njoftimin nga Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve se një person ka kryer vetëvarje në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë. Në komunikim të vazhdueshëm me autoritetet relevante dhe pas pranimit të raportit të Komisionit Hetimor, është vërejtur se janë zbatuar Procedurat Standarde të Veprimit dhe normat etike e profesionale që nga pranimi i personit në qendër, si dhe është konkluduar se nuk ka pasur vonesë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë, të gjitha dokumentet e nevojshme u janë përcjellë organeve kompetente për hetimin e rastit.<sup>17</sup>

Avokati i Popullit, më 17 prill 2025, ka publikuar Raport me Rekomandime për një rast të ndodhur në vitin 2024, kur një 21-vjeçar ishte vrarë nga ish-bashkëshorti i saj, ndërkohë që ajo ndodhej në Qendrën për Punë Sociale në

Ferizaj<sup>18</sup> Rasti ka ndodhur më 12 prill 2024, kur e ndjera E. C., në ditën kritike, kishte dërguar fëmijën e saj të mitur për t'u takuar me babanë në ndërtesën e QPS-së në Ferizaj. Ish-bashkëshorti kishte qëlluar me armë zjarri duke e vrarë E.C. dhe duke plagosur vëllain e saj të mitur D. C. Raporti ka konstatuar se, pavarësisht masave të ndërmarra, autoritetet shtetërore nuk kanë arritur t'i ndërmerrnin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar jetën e qytetares, e cila si pasojë e mungesës së masave adekuate të sigurisë është vrarë nga ish-bashkëshorti i saj. Autoriteteve u janë adresuar rekomandime për masa parandaluese në raste të tilla.

Përkundër faktit se Republika e Kosovës ka bërë hapa seriozë në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, mbeten ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse lidhur me obligimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e së drejtës për jetë, çështje kjo e cila do të trajtohet më detajisht në vijim.

## E Drejta e Integritetit Personal

E drejta për respektim dhe pacenueshmëri të integritetit fizik dhe psikik të çdo personi përbën thelbin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

E drejta e integritetit personal është e drejtë e garantuar me nenin 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, integritetin fizik dhe psikik të një personi e interpreton nëpërmjet nenit 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare). Në frymën e Kushtetutës, e drejta e integritetit personal në vendin tonë rregullohet edhe me një numër ligjesh.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej pesë ankesa individuale me pretendime për shkeljen e së drejtës në integritet personal. Pas shqyrtimit fillestar të këtyre ankesave, dy ankesa kanë përmbushur kriteret ligjore të pranueshmërisë. Njëra nga ankesat ka të bëjë me rastin e një ankueseje, e cila pretendon se i është nënshtruar trajtimit të pavullnetshëm psikiatrik në Klinikën Psikiatrike.

15 850/2025.

16 840/2025.

17 1224/2025.

18 <https://oik-rks.org/2025/04/17/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-563-2024-lidhur-me-detyrimet-pozitive-per-ndermarrjen-e-masave-preventive-ne-qendrat-per-pune-sociale-per-mbrojtjen-e-integritetit-fizik-gjegjesisht-per-t/>

Të dy këto raste janë në trajtim e sipër dhe për to ende nuk është nxjerrë një vendim përfundimtar.

Ndërsa tri ankesa nuk i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë dhe janë shpallur të papranueshme për shkak të mungesës së kushteve të përcaktuara me ligj, si më poshtë:

- Dy janë shpallur të papranueshme, sepse nga shënimet e paraqitura dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të rrethanave të përshkruara në ankesa, ka rezultuar se çështjet e parashtuara nuk janë në kompetencën e Avokatit të Popullit.
- Një ankesë është shpallur e papranueshme meqenëse nga dëshmitë e paraqitura dhe rrethanat e përshkruara ka rezultuar se ankuesi nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion.

Përgjithësisht, kjo e drejtë zbatohet dhe respektohet nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Megjithatë, vazhdon të jenë shqetësues<sup>19</sup> pranimi i personave për trajtimin e pavullnetshëm në Repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) pa vendim gjykatë. Edhe pse MKP-ja ka rekomanduar vazhdimisht zgjidhjen e këtij problemi, kjo çështje ende mbetet e pazgjidhur. Gjithashtu, Avokati i Popullit nga vizitat e realizuara në UKIP ka vërejtur se nuk ka evidenca me të cilat dëshmohet se personave për trajtim të pavullnetshëm u ofrohet shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t'i shpjegohen me shkrim brenda 48 orëve arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.

Shikuar nga kjo perspektivë, ekipi i MKP-së ka vërejtur se në UKIP, edhe në departamentet psikiatrike në kuadër të spitaleve të përgjithshme regionale në nivel vendi, në të shumtën e rasteve personave të hospitalizuar me probleme të shëndetit mendor nuk u jepet

mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit. E njëjta situatë ishte konstatuar edhe në Raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015<sup>20</sup> dhe 2020,<sup>21</sup> ku theksohet:

*“Pranimi i një personi në një institucion psikiatrik mbi baza të pavullnetshme, qoftë në kontekstin e një procesi gjyqësorë civil apo penal, nuk duhet të përjashtojë marrjen e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo shmangie nga ky parim duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.”*

## Liria e Lëvizjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e çdo personi për liri të lëvizjes, si brenda territorit të shtetit, ashtu edhe jashtë kufijve të tij (nenin 35). Kjo e drejtë u garantohej në mënyrë të barabartë të gjithë banorëve, pa pengesa apo ndërhyrje të kundërligjshme. Ndërkaq, hyrja dhe qëndrimi i shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Kosovës rregullohet me ligj të veçantë (neni 35, paragrafi 5).

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 36 ankesa që kanë të bëjnë me të drejtën e lirisë së lëvizjes. Nga to, 26 ankesa janë shpallur të papranueshme, ndërsa për 10 të tjera<sup>22</sup> janë zhvilluar hetimet në bazë të pretendimit të ankuesve.

Ankesat e shpallura të papranueshme janë si në vijim:

- Pesëmbëdhjetë (15) ankesa janë shpallur të papranueshme bazuar në nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ku nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi.
- Shtatë (7) ankesa janë shpallur të

19 <https://oik-rks.org/2023/10/04/raport-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-te-qendres-klinike-universitare-te-kosoves-urgjenca-dhe-kujdesi-intensiv-psikiatrik/>

20 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

21 Shih raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

22 R/202/2025; R/435/2025; R/770/2025; R/790/2025; R/1171/2025; R/1179/2025; R/1235/2025; R/1262/2025; R/1289/2025; R/1634/2025.

papranueshme bazuar në nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ku nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se çështja e shtruar nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

- Tri (3) ankesa janë shpallur të papranueshme bazuar në nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ku nga shënimet e paraqitura dhe rrethanat e rastit ka rezultuar se nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.
- Një (1) ankesë është shpallur e papranueshme bazuar në nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.4, ku nga shënimet e paraqitura dhe rrethanat e rastit ka rezultuar se ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës.

Nga dhjetë (10) rastet e hapura për hetim, në dy kanë përfunduar hetimet në pajtim me 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ku nga hetimi i rastit ka rezultuar se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi.

Rastet e hapura për hetim kanë të bëjnë kryesisht me procedurat për njohjen ose fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, si dhe me pajisjen me dokumentacionin përkatës. Ankuesit pretendojnë se refuzimi i kërkesave për lejeqëndrimi është bazuar në mospërputhje të të dhënave personale, ndërkohë që ankesat e ushtruara nuk janë shqyrtuar brenda afateve ligjore nga organet e shkallës së dytë. Në disa raste, ankuesit theksojnë se janë njoftuar për refuzim pa arsyetim të plotë ligjor, pa sqarim të bazës juridike të vendimit dhe pa udhëzim për mjetet juridike, gjë që ka prodhuar pasoja serioze praktike, veçanërisht në ushtrimin e lirisë së lëvizjes. Një pjesë e ankesave lidhen edhe me vështirësi që kanë dalë si pasojë e mospërputhjeve në dokumentacion dhe mungesës së informatave të qarta nga institucionet kompetente. Hetimet për këto raste janë duke vazhduar.

Avokati i Popullit vlerëson se, megjithëse liria e lëvizjes nuk është një e drejtë absolute dhe mund të kufizohet për arsye të përcaktuara me ligj, zbatimi i këtyre kufizimeve në praktikë duhej të shoqërohet me vendimmarrje të qartë, të arsyetuar dhe të bazuar në kritere të

domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, duke u siguruar që kufizimet e vendosura në praktikë të mos e cenojnë thelbin e kësaj të drejte.

## Mbrojtja e Pronës

E drejta e pronës është e drejtë e mbrojtur me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues pranoi 139 ankesa, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e pronës. Nga këto ankesa u hapën për hetim 51 raste.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit pati në fokus çështje që ndërlidhen me mbrojtjen e pronës, përkatësisht çështje lidhur me:

- shpronësimin e pronave të paluajtshme dhe mosrealizimin e kompensimit për shpronësim;
- rrënimin e objekteve pa leje dhe procedurat standarde ligjore lidhur me çështje të tilla;
- mbrojtjen e pronës në procedurat gjyqësore.

Lidhur me çështjet e shpronësimit të pronës së paluajtshme dhe mosrealizimit të kompensimit për shpronësimin, Avokati i Popullit hapi hetime sipas detyrës zyrtare lidhur me rastin e banorëve të lagjes “Bregu i Diellit” në Prishtinë dhe problemet pronësore me të cilat u përballën ata. Në këtë rast, Avokati i Popullit vërejti se pronat e banorëve të kësaj lagjeje u shpronësuan gjatë vitit 1985, mirëpo asnjëherë nuk u ekzekutua kompensimi për shpronësimin dhe banorët asnjëherë nuk u zhvendosën nga pronat të cilat u shpronësuan në vitet e nëntëdhjeta. Rasti është në fazën e zhvillimit të hetimeve.

Lidhur me çështjen e rrënimin të objekteve pa leje dhe procedurat standarde ligjore për çështje të tilla, Avokati i Popullit shqyrtoi ankesat e banorëve të fshatit Leshak, të cilët u paralajmëruan nga kryetari i Komunës, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, se do të rrënoheshin 12 shtëpi pa leje në zonën afër stacionit policor në Leshak. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, me qëllim të informimit më të detajuar për rastin, më 10 korrik 2025 doli në terren dhe takoi pronarët e këtyre shtëpive, nga të cilët u informua për situatën dhe gjendjen e tyre të rëndë, si dhe

për nevojën që t'u garantohet respektimi i procedurave të përcaktuara ligjore. Avokati i Popullit më pas u takua edhe me kryetarin e Komunës së Leposaviqit, z. Lulzim Hetemi, nga i cili kërkoi që të respektohen procedurat e përcaktuara ligjore, duke pasur parasysh interesin e të dy palëve dhe me qëllim të mbrojtjes së ligjshmërisë, por edhe të mbrojtjes së interesit të banorëve, për aq sa është e mundur.

Lidhur me çështjen e mbrojtjes së pronës në procedurat gjyqësore, Avokati i Popullit edhe gjatë këtij viti raportues vazhdoi të pranonte ankesa për zvarritjen e procedurave gjyqësore që kanë të bëjnë me çështje të pronës dhe pengim të posedimit, si dhe publikoi një numër të konsiderueshëm raportesh me rekomandime, me të cilat u rekomandoi gjykatave të Republikës së Kosovës që të veprojnë brenda afateve të arsyeshme me qëllim të vendosjes për çështjet që kanë në shqyrtim.

### **Legalizimi i pronave**

Avokati i Popullit, nga hetimet e ankesave të pranuar dhe shqetësimeve të ngritura nga qytetarët dhe shoqëria civile, konstatoi se sfidat për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, ashtu siç parashihet në Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, tashmë cenon të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se një numri të madh qytetarësh, pronarë të objekteve të ndërtuara pa leje të Kategorisë I dhe njësive të banimit në objekte të Kategorisë II, duke mos arritur të regjistrojnë pronësinë e tyre për shkak të mungesës së legalizimit në regjistrat kadastrorë, u mohohen të drejtat themelore që lidhen me pronën, si e drejta për të përfutur nga shitja, trashëgimia apo përdorimi i saj si garanci bankare, ndërsa në situata të veçanta prona mbetet e ekspozuar ndaj pasigurisë juridike dhe rrezikut të rrënimit.

Avokati i Popullit, me qëllim të analizimit të situatës dhe sfidave në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje në vend, në lidhje me rastin e iniciuar sipas detyrës zyrtare, iu drejtua nëpërmjet pyetësorëve me pyetje relevante nga Ligji Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe 38 komunave të Republikës së Kosovës, nga të cilat mori përgjigje prej 20 komunave. Mbi bazën e informatave të pranuar rezultoi se shumica e komunave nuk morën masa konkrete për zgjidhjen me

efikasitet të çështjes së trajtimit të kërkesave për legalizim. Procesi vazhdon të përcillet me sfida në shumë komuna; nuk u investua në ngritjen e kapaciteteve, procesi menaxhohet kryesisht nga Drejtoria e Urbanizmit dhe nuk ka sektorë të veçantë për menaxhimin e tij. Vetëm një numër i vogël komunash kanë të përcaktuar zyrtarë kompetentë ose kanë ndarë detyra shtesë për trajtimin e këtyre rasteve. Si pasojë e mospërfundimit të procesit të legalizimit, përfshirë edhe rastet në listën e pritjes për legalizim, një numër i madh pronash mbetën pa u regjistruar në regjistrin e ndërtimeve në kadastrë, si hap përfundimtar i legalizimit dhe formalizimit të së drejtës pronësore.

Po ashtu, çështje me ndikim serioz në të drejtën e pronës dhe sigurinë juridike të qytetarëve vazhdon të paraqesë mospërbushja e obligimit të MMPHI-së për zgjidhjen e çështjes së Listës së Pritjes, që rrjedh nga neni 4 i Ligjit Nr. 08/L-184 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, sipas të cilit MMPHI-së iu përcaktua një afat i ri, brenda të cilit duhej të propozonte, jo më vonë se 31 dhjetor 2024, programe të hollësishme për Qeverinë për mënyrën e trajtimit të ndërtimeve në Listën e Pritjes.

Në këtë drejtim, sfida më vete paraqet neni 7 i Ligjit Nr. 06/L-024, i cili përcakton përgjegjësitë për aplikimin dhe mbulimin e kostove të legalizimit të ndërtimeve pa leje me shumë njësi banimi. Sipas këtij neni, investitori i ndërtimit pa leje mban përgjegjësinë kryesore për të iniciuar procesin e legalizimit të objektit shumëbanesor. Në mungesë të dispozitave detyruese, në disa raste investitorët e këtyre ndërtimeve nuk paraqitën kërkesë për legalizim për shkak të kostove të larta të procesit, ndërsa në raste të tjera investitorët (persona fizikë apo juridikë) falimentuan ose e shuan aktivitetin e biznesit.

Në rast se investitori nuk vepron, një ose më shumë pronarë të njësive në objekt mund të paraqesin kërkesë për legalizim në emër të tyre. Në këto raste, kostot e legalizimit ndahen proporcionalisht mes të gjithë pronarëve, bazuar në madhësinë e njësive të tyre në ndërtesë. Pronarët që paguajnë këto kosto kanë të drejtë të ndërmarrin veprime ligjore kundër atyre që refuzojnë të kontribuojnë, për të rikuperuar shpenzimet e tyre. Po ashtu, ata mund të kërkojnë kompensim nga investitori, duke përfshirë dëmet dhe shpenzimet ligjore të lidhura me procesin. Avokati i Popullit paraqet

skepticizëm lidhur me efektivitetin e kësaj të drejte të paraparë me dispozitat ligjore për ndarjen e shpenzimeve, duke marrë parasysh se në këto objekte ka shumë njësi të pabanuara dhe persona që jetojnë jashtë vendit, të cilëve nuk u dihet vendqëndrimi. Ndërkaq, tejkjatja e procedurave gjyqësore dhe njohja e së drejtës nëpërmjet tyre paraqet çështje më vete dhe mjet juridik joefikas.

Po ashtu, në këtë drejtim, Avokati i Popullit vërejtji pengesa të rëndësishme në zbatimin e nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Një nga problematikat kryesore lidhet me dispozitat e nenit 14, paragrafi 2, të ligjit, i cili përcaktonte: *“Aplikuesi dorëzon në komunën ku ndodhet ndërtimi formularin e aplikimit dhe të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara, siç parashihet në aktin nënligjor të miratuar nga Ministria [...]”*, si dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2021 për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje të Kategorisë I dhe II, i nxjerrë nga MMPHI-ja. Sipas nenit 6, paragrafi 1, të këtij udhëzimi, parashihet që aplikacioni për legalizimin e ndërtimeve të kategorisë II duhet të përfshijë, ndër të tjera, edhe: *“Dëshminë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën që kërkohet për regjistrim në kadastër dhe në Regjistrin e të Drejtave Pronësore mbi Pasurinë e Paluajtshme (RDPP)”*.

Duhet theksuar se kërkesat e lartpërmendura të Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ krijojnë një pengesë të pakapërcyeshme për zbatimin e nenit 7 të ligjit, i cili u jep pronarëve të njësive të banimit në ndërtesat pa leje të drejtën për të aplikuar për legalizim, pasi ata nuk janë në gjendje të paraqesin dëshmi mbi të drejtën pronësore apo të shfrytëzimit të parcelës ku është ndërtuar objekti. Këto dokumente mund të sigurohen vetëm nga investitori ose nga pronari juridik i parcelës mbi të cilën është ngritur ndërtesa shumëbanesore. Si rrjedhojë, mungesa e këtyre dokumenteve e bën të pamundur zbatimin praktik të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-024, duke i lënë pronarët e njësive të banimit pa një zgjidhje efektive ligjore për legalizimin e pronave të tyre. Andaj, mund të konkludohet se edhe kjo pengesë ligjore ka ndikim të drejtpërdrejtë në kufizimin e së drejtës së pronës së qytetarëve në këtë situatë.

23 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

24 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 5.

25 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike, neni 9.

## E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë

E drejta e lirisë dhe sigurisë është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe njihet gjerësisht në të drejtën kushtetuese<sup>23</sup> dhe ndërkombëtare, si në KEDNJ<sup>24</sup> dhe KNDCP.<sup>25</sup> Askush nuk mund të privohet nga liria në mënyrë arbitrare (ndalim, arrestim, burgim). Kufizimi i lirisë mund të lejohet vetëm kur parashihet me ligj: për shkak të kryerjes së veprës penale, ndalim për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, ndalim për të parandaluar kryerjen e ndonjë veprë penale, ndalim i personave me sëmundje mendore (në përputhje me ligjin), si dhe ndalim për çështje migracioni (sipas ligjit).

Në momentin kur dikush ndalohet, duhet të njoftohet menjëherë për arsyet e ndalimit dhe të paraqitet para një gjykate. Në rast se tejkalohej koha e paraparë për ndalim (48 orë), personi ka të drejtë të kundërshtojë ligjshmërinë e ndalimit, si dhe të kërkojë dëmshpërbim në rast ndalimi të paligjshëm. Kjo e drejtë e siguron qytetarin nga arbitrariteti i shtetit dhe garanton që autoritetet duhet të veprojnë vetëm brenda ligjit dhe duke respektuar dinjitetin njerëzor.

Roli i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës është thelbësor në mbikëqyrjen e respektimit të së drejtës për liri dhe siguri, në përputhje me ligjin dhe me respektimin e dinjitetit njerëzor, veçanërisht për personat e privuar nga liria. Kjo e drejtë rrezikohet më shumë kur një person ndalohet apo arrestohet, mbahet në paraburgim apo ndodhet në institucione të mbyllura (burgje, stacione policore, institucione psikiatrike, qendra migracioni).

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit, në rolin e MKP-së, ka vizituar 15 stacione policore, ka realizuar 27 vizita në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, 16 vizita në institucionet psikiatrike, si dhe 5 vizita në vendet ku mbahen azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt.

Gjatë vizitave janë vlerësuar kushtet e mbajtjes, higjiena, ushqimi dhe kujdesi shëndetësor. Gjithashtu është vlerësuar edhe respektimi i tri garancive ligjore: njoftimi i familjes, qasja në avokat dhe qasja në mjek. Në përgjithësi është vërejtur se këto garanci janë respektuar. Personat e ndaluar janë njoftuar për arsyet e ndalimit (deri në 6 orë në stacion policor) ose 48 orë në qendër të mbajtjes.

Gjatë vizitave është vërejtur se shumica e stacioneve policore nuk kanë një hapësirë të ndarë për mbajtjen e personave deri në 6 orë, por ata kryesisht mbahen në zyrat e policëve hetues. Po ashtu, është gjetur se ka stacione policore të cilat nuk mbajnë regjistra për ndalimin e personave deri në 6 orë. Të gjeturat i janë përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, si dhe është njoftuar komandanti i stacionit të vizituar. Janë adresuar 32 rekomandime për policinë.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar 25 ankesa me pretendim se është shkelur e drejta e lirisë dhe sigurisë, prej të cilave 23 ankesa janë shpallur të papranueshme, ndërsa 2 janë hapur për hetim. Pas hetimit, të dy rastet janë mbyllur,<sup>26</sup> pasi nuk janë gjetur shkelje. Ankesat kryesisht kanë qenë kundër vendimeve për ndalim prej 48 orësh, vazhdim të paraburgimit, kundër vendimeve të gjykatave (pasi pala ndihet e pafajshme), bastisjeve të shpeshta në qendrat korrektuese, mosefikasitetit të policisë etj. Në të gjitha situatat, palët janë udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmarrin.

Avokati i Popullit, me raportet e publikuara, ua ka rikujtuar autoriteteve obligimin e shtetit për të garantuar sigurinë e personave të cilët janë të privuar nga liria, qofshin edhe ndalime afatshkurtra (deri në 6 orë), duke siguruar hapësirë të përshtatshme, ndriçim e ventilim, qasje në tualet dhe ujë të pijshëm, si dhe siguri fizike e shëndetësore. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se edhe ndalimet e shkurtra kërkojnë kushte minimale humane. Nëse këto kushte nuk plotësohen, shteti mban përgjegjësi kushtetuese dhe ndërkombëtare, pasi përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit gjatë periudhës raportuese ka mbajtur një punëtori me pjesëmarrës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë, ku, duke u nisur nga problematikat e shfaqura në praktikë, ka diskutuar mes tjerash edhe: (i) kriteret e caktimit të masës së paraburgimit; dhe (ii) trajtimin e personave me çrregullime mendore, me fokus trajtimin e pavullnetshëm dhe trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri.

Për sa u përket kriterëve të paraburgimit, duke u referuar në statistikat relevante, Avokati

i Popullit ka vërejtur se masa e paraburgimit është masë e cila përdoret shpesh si masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë. Rrjedhimisht, për të siguruar që e drejta e njeriut në liri nuk po cenohet, autoritetet publike duhet t'i kenë parasysh standardet ndërkombëtare me rastin e shqiptimit të paraburgimit. Si i tillë, paraburgimi duhet të shqiptohet si masë e fundit dhe duhet të plotësohen kriteret, si: (i) së pari duhet të ekzistojë "dyshimi i bazuar" që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale; (ii) qëllimi i privimit nga liria në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale dhe, për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm për ta siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse; (iii) privimi nga liria apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj.

Në diskutim e sipër me institucionet relevante dolën këto konkluzione:

- Rritja e mbikëqyrjes nga Gjykata e Apelit dhe kontrolli nga Gjykata Supreme i vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit, duke dhënë qëndrime parimore që garantojnë respektimin e parimit që paraburgimi duhet të jetë masa e fundit, e domosdoshme dhe proporcionale.
- Gjykatat të vendosin në përputhje me ligjin për kërkesat për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit, duke i dhënë përparësi së drejtës së të pandehurit në procedurë dhe mbikëqyrjes së masës së paraburgimit si përgjegjësi e gjykatës, sidomos në rastet e vazhdim të paraburgimit, kur duhet të vlerësohen me kujdes të gjitha rrethanat dhe të merret parasysh rreziku që paraburgimi të përdoret si trysni që i pandehuri të pranojë fajësinë (të intensifikohen trajnimet për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë lidhur me mbikëqyrjen e paraburgimit, si dhe të diskutohet në drejtim të plotësimit të KPPK-së për procedurat lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së kësaj mase).
- Monitorimi elektronik të aplikohet edhe në procedurën e monitorimit të arrestit shtëpiak; kjo duhet të përcaktohet qartë në legjislacion dhe në procedurat për caktimin e masave.

26 A.nr. 51/2025 kunder Policisë në Prizren; A.nr. 510/2025 kundër Gjykatës Themelore në Prizren.

- Vendimet për caktimin e masës së paraburgimit të jenë në përputhje me KPPK-në, sidomos në drejtim të dhënies së një arsytimi të plotë dhe të individualizuar; të shmangen arsyetimet me parafrazim të normës dhe të fakteve të parëndësishme që shpesh përshkruhen në arsytetime.
- Marrja e masave nga autoritetet përgjegjëse që vendimet e gjykatave dhe të prokurorëve të mos jenë të ndikuara nga opinionet publike, presionet politike dhe presionet e natyrave të tjera.
- Gjykatat duhet të marrin masa që paraburgimi në asnjë rrethanë të mos përdoret si mjet presioni për pranimin e fajësisë.

Për sa i përket trajtimit të personave me çrregullime mendore, me fokus trajtimin e pavullnetshëm dhe trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, Avokati i Popullit, duke u nisur nga fakti që shëndeti mendor është bazë për shëndetin e njeriut në përgjithësi, vë në theks se nevojitet angazhim shtesë për sfidat me të cilat po ballafaqohen institucionet në trajtimin e personave me probleme mendore. Në rastin konkret, për sa u përket masave mbrojtëse, Avokati i Popullit thekson se ka mungesë qartësie në lidhje me dispozitat ligjore që rregullojnë vendosjen e pavullnetshme dhe trajtimin e pavullnetshëm të pacientëve në institucionet psikiatrike. Është veçanërisht shqetësuese që, në praktikë, gjykatat duhet të jenë më ekspeditive në çështjet e rivlerësimit në rastet e pacientëve të pranuar pa vullnetin e tyre. Kjo është reflektuar edhe në Raportin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) ose (CPT).

Problem i identifikuar në praktikë është zbatimi i garancive që përcaktohen me Ligjin për Procedurën Jokontestimore, në raport me ndalimin e pavullnetshëm, propozimin për caktimin e përfaqësuesit ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të garantuara me ligj. Kjo vërehet sidomos me propozimin e caktimit të përfaqësuesit ligjor nga radhët e avokatëve për mbrojtjen e interesave të pacientit, siç përcaktohet me Ligjin për Shëndet Mendor (LShM), neni 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.3, si dhe neni 85 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Në diskutim e sipër me institucionet relevante dolën këto konkluzione:

- Të forcohet kompetenca mbikëqyrëse e gjykatave në raport me masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe rastet e shëndetit mendor të trajtohen me prioritet.
- Gjykata merr përsipër që, gjatë ndryshimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, të bashkëpunojë me ekspertët në Institutin e Psikiatrisë Forenzike dhe Klinikën e Psikiatrisë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë të sigurojnë rritjen e kapaciteteve të institucioneve për trajtimin e personave me çrregullime mendore, me qëllim zgjidhjen e problemit të vendosjes në këto institucione për shkak të mungesës së hapësirave, ngase kapacitetet e pamjaftueshme në vazhdimësi paraqesin problem në rastet kur caktohen këto masa.
- Ministria e Shëndetësisë duhet t'i ndërtojë kapacitetet për trajtim psiko-social, trajtim dhe rehabilitim të personave në varësi nga substancat narkotike dhe të tjera.
- Harmonizimi i dispozitave ligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor dhe të Ligjit për Procedurat Kontestimore.

## E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm është garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së [E drejta për një proces të rregullt]. Kjo e drejtë përmban në vete shumë elemente të rëndësishme, duke filluar nga gjykimi i drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, kërkesa për gjykatë të pavarur dhe të paanshme, barazia e armëve, e drejta për t'u dëgjuar, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, që gjykimi të jetë publik, që vendimi të jetë i arsyetuar, prezumimi i pafajësisë (në çështje penale) etj.

Avokati i Popullit, në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit, nuk ndërhyjnë në procedura dhe vendimmarrje gjyqësore. Megjithatë, ka mandat të japë rekomandime të përgjithshme për sistemin gjyqësor, të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore

që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe, po ashtu, ka kompetencë të veçantë në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore.

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit, gjatë periudhës së raportimit, ka pranuar 305 ankesa nga qytetarët që lidhen me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Nga këto, 128 ankesa janë hapur për hetim, të cilat përfshijnë pohime për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme nga gjykatat, ndërsa 177 ankesa janë vlerësuar të papranueshme për hetim për shkak se: janë jashtë juridiksionit (36 ankesa); nuk ka pasur shkelje apo keqadministrim (56 ankesa); kërkesa ka qenë jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit (8 ankesa); janë në shfrytëzim të mjeteve juridike (64 ankesa) ose për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike (13 ankesa).<sup>27</sup>

Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese, ka mbajtur një punëtori me pjesëmarrës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë. Në këtë punëtori, për sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë dhe të

paanshëm, u trajtuan këto çështje: (i) e drejta në gjykim brenda një kohe të arsyeshme; (ii) e drejta e të akuzuarit në mbrojtje; dhe (iii) pranimi i fajësisë në procedurë penale.

- *Për sa i përket gjykimit në kohë të arsyeshme*

Ashtu si në vitet paraprake, dominojnë ankesat për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Nga 128 ankesa të hapura, Avokati i Popullit ka nisur hetimet dhe ka kërkuar informata nga gjykatat e instancave të ndryshme në lidhje me veprimet që janë ndërmarrë nga to. Nga përgjigjet që pranuan nga gjykatat e ndryshme të Kosovës, Avokati i Popullit ka vërejtur se gjyqësori i Kosovës ballafaqohet me një numër shumë të madh rastesh të pazgjidhura dhe se ato janë duke u trajtuar sipas Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Lidhur me këtë pikë, Avokati i Popullit vë në theks faktin se edhe në Raportin statistikor të gjashtëmujorit të parë për vitin 2025, i publikuar nga KGJK-ja,<sup>28</sup> rezulton se gjatë pjesës së parë të vitit 2025, në punë kanë qenë 338.634 lëndë gjyqësore, çka dëshmon që ka ngarkesë të konsiderueshme në gjykata.

#### Gjendja e lëndëve:

	Gjykata	Numri i lëndëve që gjykatat kanë pasur në punë gjatë periudhës raportuese	Nga numri i përgjithshëm i lëndëve:		Numri i lëndëve që gjykatat kanë zgjidhur gjatë periudhës raportuese	Numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese
			Numri i lëndëve të trashëguara si të pazgjidhura nga periudha raportuese	Numri i lëndëve të pranuar në punë gjatë periudhës raportuese		
1	Gjykata Supreme	1510	383	1127	1063	447
2	Dhoma Posaçme	11824	11254	570	1383	10441
3	Gjykatat e Apelit	44571	25519	19052	11846	32725
4	Gjykata Komerciale	12526	9423	3103	2954	9572
5	Gjykata Themelore	268203	217439	50764	63780	204423
	<b>Gjithsej</b>	<b>338634</b>	<b>264018</b>	<b>74616</b>	<b>81026</b>	<b>257608</b>

27 Ligji Nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit, neni 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3.1 dhe 1.3.2, si dhe neni 22, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1; 1.2; 1.3 dhe 1.4.

28 Shih Raportin Statistikor të Gjykatave, tabelën statistikore në faqen 5, e qasshme në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/78700\\_KGJK\\_RAPORTI\\_PERGJITHSHEM\\_GJASHTEMUJORI\\_II\\_2025.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/78700_KGJK_RAPORTI_PERGJITHSHEM_GJASHTEMUJORI_II_2025.pdf)

Si rezultat i hetimeve, Avokati i Popullit ka publikuar 30 raporte me rekomandime në lidhje me zvarritjen e procedurave gjyqësore. Avokati i Popullit ka gjetur se:

- ankuesve nga gjyqësori u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;
- është gjetur se ankuesve u është shkelur e drejta për mjete efektive juridike, të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;
- si dhe u është shkelur e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit problematikën e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore e ka trajtuar edhe me Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë, në punëtorinë e mbajtur me datë 10–11 maj 2025, nga e cila punëtori dolën konkluzionet në vijim:

- Nevoja për komunikim, koordinim dhe ndërveprim institucional me qëllim të arritjes së standardit për një gjykim të drejtë, sa i përket afatit të arsyeshëm;
- Përfshirja dhe roli efektiv i sistemit të drejtësisë në grupet punuese për hartimin e legjislacionit, me qëllim që ligjet e aprovuara të kenë zbatim të plotë në praktikë; kjo do t'i ndihmonte hartuesit e legjislacionit t'i evitonin gabimet eventuale që mund të paraqisnin problem për zbatim;
- Rritja e efikasitetit të qeverisë dhe të organeve të tjera në zbatim të ligjit, vendimeve gjyqësore, zbatimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe rritjen e efikasitetit në realizimin e të drejtave ligjore në procedurat jashtëgjyqësore – administrative – me qëllim të shmangies së situatave të mbingarkimit (siç janë rasti i kontratës kolektive, pensionet në shumë baza, Ligji i Pagave lidhur me pagesën në bazë të stazhit etj.);

- Procedura e hartimit të Projektligjit për Realizimin e së Drejtës për Gjykim Brenda një Afati të Arsyeshëm Kohor duhet t'i përfshijë dy komponentë të rëndësishëm: 1. Organi që do të vendosë për këto raste duhet të jetë jashtëgjyqësor; 2. Procedura nuk duhet të krijojë situatë të përsëritjes së gjykimit të zvarritjeve;
- Vazhdimi i reformës në drejtësi me fokus në rritjen e efikasitetit të gjyqësorit dhe të prokurorisë, përmirësimin e infrastrukturës, avancimin e digjitalizimit dhe të sistemit elektronik, riorganizimin e sistemit të gjykatave, mbikëqyrjen e punës së gjyqtarëve përmes vlerësimit dhe procedurave disiplinore;
- Nevoja për rritjen e kapaciteteve profesionale të avokatëve dhe të përfaqësuesve ligjorë, mbikëqyrja e punës së tyre nga komisionet përkatëse të Odës së Avokatëve, si faktor i rëndësishëm që ndikon në mbarëvajtjen e procedurave gjyqësore;
- Lehtësimi i komunikimit dhe i pajisjes me shkresa, prova dhe materiale të tjera në procedurë të hetimit dhe në atë gjyqësore mes palëve, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, mundësimin të mbrojtjes efektive dhe përfaqësimit të denjë në procedurë gjyqësore, duke përfshirë edhe komunikimin përmes e-mailit, formës elektronike të dërgimit të shkresave dhe mundësisë për qasje për të gjitha palët në procedurë që të pajisen me materialet e regjistruara të seancave. Është konstatuar se është shumë e rëndësishme që mbrojtjes t'i lejohet qasje në sistemin SMIL;
- Efekti “ping-pong” duhet të evitohet në rastet kur shkaktohet nga neglizhenca dhe joprofesionalizmi, gjithmonë duke pasur kujdes që evitimi i kësaj dukurie në asnjë rrethanë nuk mund ta cenojë standardin e gjykimit të drejtë;
- Gjykatat detyrohen ta aktivizojnë kontrollin kushtetues incidental të dispozitave ligjore, sa herë që gjatë shqyrtimit të një çështjeje konstatojnë se një dispozitë e aplikueshme mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën. Përdorimi i kontrollit incidental është thelbësor për parandalimin e grumbullimit të padive që lidhen me shkelje të mundshme të të drejtave dhe lirive themelore që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të tilla.

## Aktivitetet e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës lidhur me Dhomat e Specializuara të Kosovës gjatë vitit 2025

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë themeluar me Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Me këtë ligj është rregulluar funksionimi, organizimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (DhSK). Procesi gjyqësor në DhSK ka filluar në prill 2023 dhe aktualisht është në fazën përfundimtare të procesit të parë në rastin e Thaçit dhe të të tjerët.

Në nëntor të vitit 2021, Avokati i Popullit vizitoi DhSK-në, ku u takua me kryetaren e këtij institucioni dhe me bashkëpunëtorët e saj, si dhe vizitoi të paraburgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Lidhur me këtë vizitë, Avokati i Popullit e njoftoi Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet Raportit Vjetor për vitin 2021.<sup>29</sup>

### Takimi me kryetaren e DhSK-së

Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, më 13 maj 2025 priti në takim, me kërkesë të saj, kryetaren e Dhomave të Specializuara të Kosovës, znj. Ekaterina Trendafilova. Në këtë takim u ngritën një sërë çështjesh lidhur me punën e Dhomave të Specializuara, duke u bazuar edhe në shqetësimet e ngritura nga palët.

Në këtë rast, Avokati i Popullit theksoi shqetësimin e tij lidhur me mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së DhSK-së, si dhe ngriti çështjen nëse në këtë gjykatë po garantohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm, sipas standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me të drejtat e të akuzuarit në procedurë, të cilat janë të përcaktuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit theksoi rëndësinë e respektimit të parimit të barazisë së armëve në raport me provat dhe mënyrën se si janë siguruar ato, në veçanti duke iu referuar provave të siguruar nga Republika e Serbisë, duke pasur parasysh se Serbia është një shtet

që ka qëndrime armiqësore ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesë e së cilës ishin të akuzuarit. Në këtë kontekst, ai ngriti çështjen e mënyrës, rrugës dhe procedurave nëpërmjet të cilave janë siguruar këto prova, besueshmërisë së tyre, si dhe mundësisë që ato të jenë komprometuar para paraqitjes në gjykatë. Po ashtu, ai theksoi rëndësinë që mbrojtjes t'i mundësohet kundërshtimi efektiv i këtyre provave, përfshirë edhe sigurimin e informatave nga palët që i kanë siguruar ato.

Avokati i Popullit theksoi rëndësinë e respektimit të së drejtës për mjet efektiv juridik. Mënyra se si funksionon gjykata, ku të gjitha nivelet e saj janë të konsoliduara në një strukturë të vetme, lë vend për dyshime lidhur me pavarësinë e niveleve gjyqësore që veprojnë brenda saj. Një organizim i tillë nuk është në frymën e standardeve ndërkombëtare që garantojnë një gjykim të drejtë, në veçanti në raport me shkallëshmërinë e procedurës, e cila ndërlidhet drejtpërdrejt me të drejtën për mjet efektiv juridik.

Avokati i Popullit gjithashtu theksoi se mbetet shqetësuese që brenda kësaj strukture është e vendosur edhe Dhoma Kushtetuese, duke krijuar dilema lidhur me ndarjen e pushteteve, marrë parasysh se Dhoma Kushtetuese nuk ushtron funksionin e gjykatave të rregullta, por ka karakter vlerësimi të kushtetutshmërisë, vendimeve dhe akteve të tjera, si dhe të kontrollit të respektimit të të drejtave të njeriut në përputhje me standardet ndërkombëtare që janë pjesë e legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, më shqetësuese e bën fakti se Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara është pjesë e kësaj strukture, gjë që është në kundërshtim me Parimet e Parisit, të cilat përcaktojnë se Avokati i Popullit duhet të jetë një institucion i pavarur, i themeluar me ligj ose Kushtetutë, i zgjedhur në mënyrë transparente dhe që ushtron mandatin e tij në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga asnjë autoritet, gjë që, në rastin e Dhomave të Specializuara, nuk duket se i plotëson këto standarde.

Avokati i Popullit theksoi rëndësinë e së drejtës së privatësisë së të paraburgosurve, duke ngritur si shqetësim përgjimin e bisedave dhe vizitave në paraburgim dhe konsideroi se, përkundër faktit që këto mund të jenë të lejuara me ligj, ato cenojnë parimin e privatësisë,

29 Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit 2021, faqe 169, linku <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/>

jetës familjare, si dhe mbrojtjen efektive, nëse përgjimet ndodhin edhe në raport me ekipin mbrojtës të të akuzuarve.

Avokati i Popullit ngriti shqetësimin lidhur me vazhdimin e paraburgimit të të paraburgosurve, edhe kur kanë pushuar rrethanat për të cilat ishte caktuar paraburgimi. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vërejtë se Zyra e Prokurorit të Specializuar përdorte vazhdimisht të njëjtat argumente për vazhdimin e paraburgimit, edhe kur këto rrethana kishin pushuar së ekzistuari, si p.sh. dyshimi për ndikim të dëshmitarët, edhe pas përfundimit të procedurës së intervistimit të tyre. Kjo kohëzgjatje dhe mosndryshimi i masave me masa të tjera alternative krijon përshtypjen se Gjykata nuk u beson institucioneve të Republikës së Kosovës që ato mund të garantojnë një proces të rregullt dhe të papenguar.

## Vizita në Dhomat e Specializuara në Hagë

Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, së bashku me bashkëpunëtorë, nga 12 deri më 15 nëntor 2025 vizituan Dhomat e Specializuara në Hagë dhe ndoqën nga afër zhvillimet e procedurave gjyqësore pranë këtyre dhomave.

Kjo vizitë ishte rezultat i kërkesës paraprake të parashtruar më 15 shtator 2025 nga Avokati i Popullit, drejtuar Dhomave të Specializuara, me qëllim që t'i mundësohej përcjellja e seancave publike, takimi me kryetaren e DhSK-së, vizita te të paraburgosurit, si dhe inspektimi i hapësirave ku qëndrojnë të paraburgosurit. Lidhur me këtë çështje, DhSK-ja ktheu përgjigje dhe e njoftoi Avokatin e Popullit për mundësinë e përcjelljes së seancave të planifikuara më 12 dhe 13 nëntor 2025, takimin me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, si dhe takimin me të paraburgosurit. Mirëpo, lidhur me kërkesën për t'i vizituar hapësirat ku qëndrojnë të paraburgosurit, DhSK-ja nuk dha asnjë përgjigje, duke ia pamundësuar Avokatiit të Popullit ta realizonte vizitën në këto vende. Ndërsa takimi me kryetaren e DhSK-së nuk u realizua, me arsyetimin se në kohën kur planifikohej vizita, kryetarja nuk ndodhej në Hagë.

Vonesa për realizimin e kësaj vizite, nga data e parashtrimit të kërkesës, lidhej me refuzimin e të paraburgosurve që vizita të konsiderohej private, duke kërkuar që e njëjta të trajtohej si vizitë zyrtare e Avokatiit të Popullit.

Avokati i Popullit gjithashtu kërkoi takim edhe me Avokatin e Popullit të DhSK-së, por ky i fundit ktheu përgjigje se mund të realizohej vetëm një takim virtual nëpërmjet "Zoom"-it, duke nënkuptuar se takimi fizik në Hagë nuk ishte i mundur. Në këtë mënyrë, takimi i planifikuar me Avokatin e Popullit të DhSK-së nuk u realizua.

Gjatë kësaj vizite, Avokati i Popullit, së bashku me bashkëpunëtorë, veproi sipas agjendës në vijim:

- Më 12 dhe 13 nëntor, Avokati i Popullit përcolli seancat gjyqësore, ku dëshmuar z. Christopher Hill dhe Michael Durkee, dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja e të akuzuarve.
- Më 13 nëntor, Avokati i Popullit me bashkëpunëtorë takoi përfaqësuesit e mbrojtjes së z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Jakup Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi.
- Më 14 nëntor, Avokati i Popullit me bashkëpunëtorë realizoi takim me Zyrën e Regjistrimit në DhSK.
- Më 15 nëntor, Avokati i Popullit realizoi takim individual me të paraburgosurit z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Jakup Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi.

### Të gjeturat gjatë vizitës

Gjatë realizimit të kësaj vizite, Avokati i Popullit ngriti dilema lidhur me respektimin në DhSK të garancive të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të përcaktuara në KEDNj dhe në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson:

- DhSK-ja nuk monitorohet nga asnjë institucion apo organizatë ndërkombëtare dhe nuk i raporton për punën e saj asnjë institucioni në Republikën e Kosovës. Si rezultat i kësaj, shfaqet një mungesë totale e transparencës ndaj popullit të Republikës së Kosovës.
- Juridiksioni i DhSK-së është i paqartë dhe nuk kuptohet saktë se cilën bazë normative apo praktikë ndërkombëtare zbaton ajo në rastet e gjyqimit, si dhe nëse po respektohet parimi "Nullum crimen, nulla poena sine lege".

- Është e paqartë nëse struktura organizative e DhSK-së është në përputhje me standardet ndërkombëtare për një tribunal. Ky konstatim rrjedh nga fakti se të gjitha shkallët e gjykatës, si dhe Gjykata Kushtetuese dhe Avokati i Popullit, janë të vendosura brenda të njëjtit institucion, gjë që vë në dyshim funksionin e tyre të pavarur dhe të paanshëm lidhur me çështjet në gjykim, si dhe efikasitetin e mjetit juridik, gjykimin e drejtë dhe të paanshëm.
- Mbetet e paqartë nëse DhSK-ja, gjatë hartimit të rregulloreve të saj, ka respektuar plotësisht obligimet e deleguara me ligj, apo ka tejkaluar autorizimet ligjore, duke përcaktuar autorizime që mund të ndikojnë në ndarjen e pushteteve, si dhe duke ndryshuar procedurat dhe praktikën me të cilat gjykatat procedojnë çështjet penale në Republikën e Kosovës.
- Veprimet e DhSK-së, duke pranuar në administrim prova nga Republika e Serbisë ose literaturë (botime individuale të të akuzuarve), vënë në dyshim besueshmërinë dhe arritjen e një pragu minimal të besueshmërisë së provave në proces.
- Ekzistojnë dilema nëse, në rastet e gjykimit, po zbatohet standardi lidhur me barazinë e palëve në procedurë, duke pasur parasysh se përgatitja e aktakuzës ka zgjatur pesë vjet, ndërsa mbrojtjes i është dhënë vetëm dy muaj kohë.
- Ekzistojnë dilema lidhur me respektimin e jetës private dhe familjare të të paraburgosurve, pasi realizimi i vizitave nën vëzhgimin e kamerave dhe në prani të oficerëve korrektues ngre dyshime nëse veprimet e tilla të DhSK-së janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për jetën private dhe familjare.
- Është vërejtur ndërhyrje dhe mosrespektim i pozicionit të të pandehurit në procedurë penale. Ky konstatim rrjedh nga fakti se z. Thaçit iu konfiskua laptopi, të cilin ai e përdorte për përgatitjen e argumenteve mbrojtëse në procedurën që po zhvillohej kundër tij.
- Mbetet shumë e paqartë mënyra e financimit të DhSK-së nga jashtë dhe mungesa e transparencës në këtë drejtim. Kjo mungesë transparence ngre dilema nëse përmbushet standardi që gjykata të jetë e paanshme dhe të veprojë brenda kornizës së juridiksionit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me amendamentin kushtetues, si dhe me Ligjin për Dhomat e Specializuara.
- Vërehet se Avokati i Popullit i DhSK-së nuk publikoi asnjë raport për vizitat në burg, nuk dihet kujt i raporton dhe mënyra se si u zgjodh ishte në kundërshtim me standardet e zgjedhjes së ombudsmanëve, si dhe me funksionin e Ombudsmanit. Nga këto rrethana mbetet shumë e paqartë nëse Avokati i Popullit i DhSK-së është funksional dhe nëse po e realizon mandatin e vet.

## Përfundim

Nga të gjitha këto që u theksuan më sipër, Avokati i Popullit ngre shqetësime serioze nëse në DhSK po zbatohen standardet ndërkombëtare, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga gjykatat në Republikën e Kosovës, të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe që kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Avokati i Popullit gjithashtu ngre shqetësime lidhur me zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Avokati i Popullit konsideron se është shumë e rëndësishme të angazhohet një institut i të drejtave të njeriut ose një grup ekspertësh të pavarur ndërkombëtarë, të specializuar në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare, të cilët do të fokusohen në monitorimin e hollësishëm të të gjitha veprimeve të DhSK-së, nga fillimi i procedurës e deri në kohën aktuale, me fokus në respektimin e standardeve ndërkombëtare që lidhen me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, si dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Gjithashtu, të hartohet një raport i detajuar që do t'u dorëzohet DhSK-së, institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

**Çështje të tjera  
të trajtuara nga  
Avokati i Popullit  
lidhur me të drejtën  
për gjykim të drejtë**

# Çështje të tjera të trajtuara nga Avokati i Popullit lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë

Siç u potencua më lart, Avokati i Popullit, përmes ngritjes së shqetësimeve në takimin e përbashkët me aktorët relevantë, përveç temës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka trajtuar edhe të drejtat e akuzuarit në mbrojtje dhe pranimin e fajësisë në procedurë penale.

Për sa i përket (ii) Së drejtës së të akuzuarit në mbrojtje, Avokati i Popullit, në Opinionin e tij A.nr 230/2023 lidhur me të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur me ndihmën e mbrojtësit, ka theksuar se sipas Kushtetutës, të akuzuarit i lejohet të komunikojë lirisht me mbrojtësin e tij. Në këtë Opinion, Avokati i Popullit ka ofruar edhe praktikën më të zgjeruar të GjEDNj-së, që përcakton standardet lidhur me këtë aspekt. Avokati i Popullit ka theksuar gjithashtu se policia, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të kenë kujdes në zbatimin e procedurave gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit, në mënyrë që të respektojnë në përpikëri të drejtat kushtetuese dhe ligjore, standardet ndërkombëtare dhe praktikën e GjEDNj-së, që lidhen me të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur nëpërmjet mbrojtësit, si dhe për të komunikuar lirshëm me të. Lidhur me këtë çështje, në takimin me aktorët relevantë dolën këto konkluzione:

- Nxjerrja e një qëndrimi juridik nga Gjykata Supreme, lidhur me të drejtën e të pandehurit për konsultim me mbrojtësin e tij në të gjitha fazat e procedurës hetimore, para dhe gjatë gjithë procedurës gjyqësore, në respektim të normës kushtetuese dhe të qëndrimeve të Avokatit të Popullit të shprehura në Opinionin Nr. 230/2023, duke pasur parasysh se kjo e drejtë nuk mund të kufizohet;
- Hartimi i një udhëzuesi nga KPK-ja apo nga kryeprokurorët, për procedurat

e marrjes në pyetje të të akuzuarit, ku do të përfshihet edhe e drejta e të akuzuarit për mbrojtje; e njëjta vlen edhe për policinë, e cila duhet ta zbatojë PSV-në;

- Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet të trajtojë stafin për të përmirësuar sjelljen e tyre në raport me respektimin e së drejtës së të pandehurit për të komunikuar me mbrojtësin e tij lirshëm, në hapësira të përshtatshme dhe pa prezencën e personave të tjerë (të pranishmit iu referuan shumë rasteve kur zyrtarët korrektues qëndrojnë prezentë dhe nuk pranojnë të largohen në situatat kur i pandehuri konsultohet me mbrojtësin e tij);
- Të merren masa nga autoritetet përgjegjëse që të mos lejohet përgjimi dhe regjistrimi i fshehtë i bisedave dhe komunikimeve mes të pandehurit dhe mbrojtësit;
- Ofrimi me kohë i qasjes së mbrojtjes në shkresa gjatë hetimit, në polici, prokurori dhe gjykatë, duke iu dorëzuar të gjitha shkresat dhe provat siç përcakton KPPK-ja (ka raste kur policia ia dorëzon të pandehurit ose mbrojtësit të tij vetëm faqen e parë të deklaratës së dhënë në polici);
- Të merren masa nga Policia dhe Prokuroria që deklarata e të pandehurit të mos merret pa praninë e mbrojtësit, duke shmangur praktikën ku avokatët ftohen vetëm për ta nënshkruar deklaratën. Një veprim i tillë të sigurohet gjithmonë në rastet kur kemi mbrojtje të detyruar, ndërsa kur nuk parashihet mbrojtja e detyruar, nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij për mbrojtje;
- Oda e Avokatëve të sigurojë që avokatët të mos nënshkruajnë procesverbalet e marrjes në pyetje nëse nuk kanë qenë prezentë që nga fillimi i procedurës.

Lidhur me arritjen e pranimin e fajësisë në procedurë penale dhe arritjen e një marrëveshjeje për një gjë të tillë, Avokati i Popullit konsideron se ky mekanizëm është një mundësi ligjore që i lejon të pandehurit të pranojë fajin dhe, në këtë mënyrë, të marrë një dënim më të ulët. Kjo rrit efikasitetin e gjykatave, por rregullat procedurale janë esenciale për të shmangur shkeljet e së drejtës për gjykim

të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ, dhe të elaboruara nga vendimet e GjEDNJ-së. Çdo vendim për pranimin e marrëveshjes së fajësisë duhet të shoqërohet nga kushtet:

- Marrëveshja duhet të pranohet me dijeni të plotë të fakteve dhe pasojave juridike, në mënyrë vërtet vullnetare;
- Përmbajtja e marrëveshjes dhe mënyra e arritjes së saj mes palëve duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit të mjaftueshëm gjyqësor.

Nga diskutimet me aktorët relevantë dolën këto konkluzione:

- Të rishikohet Kodi i Procedurës Penale për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke përfshirë vendimmarrjen e gjykatës për pranimin ose refuzimin e marrëveshjes, pa tejkalar dënimin e dakorduar. Gjithashtu, duke përcaktuar edhe limitet e lejuara të sanksionit penal që ndikon në ndërtimin e standardeve që garantojnë konsistencë në procedurën penale mbi parimin e parashikueshmërisë;
- Të hartohet një udhëzues uniform për prokurorët për t'i inkurajuar palët në arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke përcaktuar hapat dhe procedurat që duhen ndjekur nga prokuroria;
- Të ndërmerren masa konkrete nga KPK-ja dhe KGjK-ja për të parandaluar presionin mbi të pandehurit për pranimin e fajësisë, nëpërmjet paragjyqimit të fajësisë me rastin e njoftimit që i bëhet të pandehurit për të drejtat që i ka në procedurë dhe në rastet e caktimit të paraburgimit;
- Oda e Avokatëve të Kosovës t'i paraqesë të gjitha rastet kur konstaton se gjyqtarët ose prokurorët institutin e pranimit të fajësisë e përdorin si presion ndaj të pandehurit/akuzuarit;
- Akademia e Drejtësisë të mbajë trajnime të vazhdueshme për prokurorë dhe gjyqtarë, lidhur me procedurat për negociimin e pranimit të fajësisë, duke vendosur praktikatat më të mira dhe

duke i rritur kapacitetet profesionale të trajnerëve;

- Oda e Avokatëve të Kosovës, KPK-ja dhe KGjK-ja të ndërmarrin masa me qëllim të parandalimit të trajtimit të pabarabartë të të pandehurve dhe të palëve në procedurë mbi bazat e mbrojtura (gjinore, etnike, racore, orientimit seksual dhe bazave të tjera), të përcaktuara në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

### **Sfidat lidhur me respektimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm**

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, për Avokatin e Popullit mbetet shqetësuese që në sistemin tonë të brendshëm ende nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes së cilit ankuesit do të mund të ankohen për zvarritje të procedurës, për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.

Lidhur me respektimin e kësaj të drejte, Avokati i Popullit, edhe vite më parë, ka publikuar raport,<sup>30</sup> me të cilin i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës ndërmarrjen e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Edhe pse Ministria e Drejtësisë ka përgatitur Projektligjin për realizimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, i cili projektligj, me 10 qershor 2024, është publikuar në Platformën e konsultimit publik,<sup>31</sup> megjithatë ende nuk është aprovuar, dhe rrjedhimisht qytetarët vazhdojnë edhe më tej të mos kenë në dispozicion një mekanizëm ligjor për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit në rastet e zvarritjeve gjyqësore.

Shqetësuese për Avokatin e Popullit janë deklaratat dhe gjuha që po përdoret në raport me gjyqësorin nga përfaqësues të qeverisë, deputetë të Kuvendit, grupe të ndryshme të interesit, OJQ dhe mediat. Kjo qasje cenon pavarësinë e gjyqësorit dhe ka si pasojë rënien e besimit të qytetarëve në drejtësi.

30 Raport me Rekomandime Ex-officio nr.129/2018, <https://oik-rks.org/2018/03/29/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1292018/>

31 <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42476>

Avokati i Popullit thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore duhet të vlerësohet në kontekstin e rrethanave të secilës çështje të parashtruar në gjykatë. Problemi i kohëzgjatjes në shqyrtimin e lëndëve gjyqësore dhe efikasitetit të zgjidhjes së tyre nuk duhet të trajtohet vetëm në nivel ligjor dhe politikash, por kërkon ndërmarrjen e veprimeve praktike dhe efektive për të përshpejtuar procesin e shqyrtimit dhe marrjen e vendimeve përkatëse, në mënyrë që e drejta për gjykim të drejtë edhe të paanshëm të mos jetë veç e karakterit formal, por të jetë e zbatueshme në praktikë.

Avokati i Popullit në vazhdimësi ka tërhequr vëmendjen se në situatën e krijuar, në raport me numrin e madh të rasteve dhe mbingarkesës që kanë gjykatat me raste gjyqësore, ka ndikuar edhe performanca e administratës shtetërore, moszbatimi i ligjit me rastin e marrjes së vendimeve administrative dhe mosrespektimi i parimeve të miradministrimit. Përveç kësaj, në këtë situatë ka ndikuar edhe mungesa e vullnetit politik e institucional për të ndërmarrë masa konkrete administrative në zbatim të ligjit dhe akteve të tjera të përgjithshme administrative. Në këtë rast janë përmendur rastet siç është kontrata e përgjithshme kolektive e punës dhe obligimet që dalin nga kjo kontratë dhe kontratat sektoriale, mosamandamentimi i ligjeve që mundësojnë realizimin e të drejtave, siç janë pensionet e shumëfishta mbi baza të ndryshme ligjore, paga e 13 te sektorët që ligji ua njeh këtë të drejtë (rasti i Policisë) dhe situatat e tjera të ngjashme. Të gjitha këto, përveç që kanë shkaktuar numër të madh të rasteve të së njëjtës natyrë në gjykatë, duke mbingarkuar gjyqësorin me lëndë, kanë shkaktuar edhe dëm të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit.

Për rrjedhojë, Avokati i Popullit ka vërejtur se, edhe përkundër masave që ka ndërmarrë KGJK, duke vepruar sipas Planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi,<sup>32</sup> situata nuk është përmirësuar për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen për të gjitha autoritetet e Republikës së Kosovës për nevojën e komunikimit dhe bashkëveprimin ndërinstitucional me qëllim të vazhdimit të reformës në drejtësi, që siguron rritje të efikasitetit të gjyqësorit, ruajtjen e pavarësisë nga ndikimi dhe ndërhyrjet, rrit transparencën

dhe garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të paanshëm gjyqësor edhe në aspektin e kohëzgjatjes, si një nga bazat mbi të cilat është ndërtuar sistemi ynë demokratik dhe mbi vlerat kushtetuese që garantojnë të drejtat e njeriut.

## Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve i jep disa kompetenca Avokatit të Popullit, ndër të cilat edhe: kompetencën për t'ia dërguar autoritetit kompetent ankesën e pranuar ndaj një gjyqtari ose prokurori; kompetencën për t'i kërkuar Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës fillimin e procedurës disiplinore; dhe kompetencën për të ushtruar ankesë te Gjykata Supreme, në rastet e përcaktuara me ligj.

Duke u bazuar në kompetencat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues, i ka pranuar 13 ankesa nga qytetarët, prej të cilave 7 ankesa i ka proceduar si raste për hetim, ndërsa 6 ankesa i ka refuzuar si të papranueshme, meqenëse nuk i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë në pajtim me Ligjin e Avokatit të Popullit dhe me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve.

Vlen të theksohet se Avokati i Popullit, në të gjitha rastet kur ka përcjellë ankesat te autoritetet kompetente për fillim të procedurës disiplinore, i ka pranuar vendimet e autoriteteve brenda afatit të paraparë me ligj dhe i ka njoftuar ankuesit për vendimet që ka pranuar.

32 [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK\\_Plani\\_strategjik\\_per\\_permiresimin\\_qasjes\\_ne\\_drejttesi\\_2022\\_2025\\_lidhur\\_me\\_efikasitetin\\_dhe\\_prioritizimin\\_lendeve\\_brenda\\_sistemit\\_gjyqesor.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK_Plani_strategjik_per_permiresimin_qasjes_ne_drejttesi_2022_2025_lidhur_me_efikasitetin_dhe_prioritizimin_lendeve_brenda_sistemit_gjyqesor.pdf)

## E Drejta për Mjete Juridike

E drejta për mjete juridike përbën një nga garancitë themelore të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në një shtet të së drejtës. Kjo e drejtë u mundëson individëve të kundërshtojnë vendimet e autoriteteve publike që cenojnë interesat dhe të drejtat e tyre, duke siguruar mbikëqyrjen dhe kontrollin gjyqësor dhe administrativ mbi veprimtarinë e administratës publike.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kjo e drejtë është e garantuar me nenin<sup>32</sup>, i cili parasheh: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat dhe interesat e saj/tij në mënyrë e përcaktuar me ligj*”.<sup>33</sup> Kjo dispozitë kushtetuese plotësohet nga neni 54,<sup>34</sup> i cili garanton mbrojtje gjyqësore në rastet e shkeljes apo mohimit të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, si dhe të drejtën për mjete juridike efektive. E drejta për mjete juridike garantohet edhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila obligon shtetet që qytetarëve t’u sigurohen mjete juridike efektive dhe që gjykatat dhe organet administrative të respektojnë afatet ligjore. Zgjidhja e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme është një element thelbësor për krijimin e sigurisë juridike, për forcimin e sundimit të ligjit dhe për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Përveç garancive kushtetuese, e drejta për mjete juridike është e rregulluar edhe me legjislacionin vendor.<sup>35</sup> Legjislacioni penal, civil dhe administrativ u ofron qytetarëve mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që cenojnë të drejtat dhe interesat e tyre, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara me ligj.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej 553 ankesa për shkelje të së drejtës për mjete juridike, kryesisht për shkak të mosdhënies së përgjigjes brenda afateve ligjore nga organet administrative. Nga këto ankesa, 199 ankesa janë hapur për hetim, ndërsa ankesat e tjera janë shpallur të papranueshme për arsye të ndryshme, përfshirë ankesa jashtë juridiksionit, ankesa pas afatit ligjor, ankesa anonime, ankesa për mungesë shkeljeje ligjore

ose keqadministrimi, ankesa për mungesë interesi nga ankuesit, ankesa ku ankuesit kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike, dhe ankesa për mosshfrytëzim të mjeteve juridike. Po ashtu, 11 raste ex officio janë hapur me iniciativë të vetë Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit vlerëson se edhe pse kjo e drejtë në vendin tonë është e garantuar dhe mirërregulluar në aspektin ligjor, vetë fakti i pranimit të një numri të madh të ankesave nga qytetarët është indikacion se kjo e drejtë nuk po respektohet plotësisht. Po ashtu, vërehet neglizhencë e autoriteteve për t’u kthyer përgjigje qytetarëve në kërkesat e tyre.

Numri më i madh i ankesave të cilat janë shpallur të papranueshme nga Avokati i Popullit ka të bëjë me kërkesa për hartim të mjeteve juridike, si ankesa, kërkesa, padi apo mjete të tjera juridike, si dhe kërkesa për përfaqësimin e ankuesve në kontestet pranë institucioneve kompetente. Të gjitha këto janë jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Avokatit të Popullit.

## E Drejta e Privatësisë

Në rrethanat aktuale shoqërore, ku zhvillimi i teknologjisë, administrata digjitale dhe përdorimi në rritje i inteligjencës artificiale po ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën e ushtrimit të funksioneve publike, respektimi dhe mbrojtja e së drejtës për privatësi paraqesin një element thelbësor për ruajtjen e besimit publik, si dhe për garantimin e dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë kontekst, zhvillimi dhe aplikimi i sistemeve të inteligjencës artificiale në sektorin publik ofron mundësi për rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, por njëkohësisht kërkon një qasje të përgjegjshme, të bazuar në parime etike, transparencë dhe vlerësim të rreziqeve, me qëllim të parandalimit të cenimit të privatësisë dhe të drejtave të tjera themelore.

Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rregullon parimet, qëllimet dhe kushtet e përpunimit të të dhënave personale, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave, duke paraparë masa përgjegjësie dhe sanksione për shkelje të dispozitave ligjore përkatëse.

33 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

34 Po aty, neni 54.

35 Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat, neni 7, paragrafi 3; Ligji nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 176.

E drejta për privatësi përfshin respektimin e jetës private dhe familjare, paprekshmërinë e banesës, si dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të komunikimeve të tjera. Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 36), i cili përcakton se mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe përdorimi i të dhënave personale rregullohen me ligj.

E drejta për privatësi mbrohet gjithashtu edhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në përputhje me nenin 8, paragrafi 1 të Konventës, çdo person ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe, në pajtim me nenin 8, paragrafi 2 të Konventës, mund t'i nënshtrohet kufizimeve të caktuara, për aq sa ato janë të parashikuara me ligj, ndjekin një qëllim legjitim dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, përfshirë rastet që lidhen me mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Lidhur me të drejtën e privatësisë dhe pretendimeve për shkelje të kësaj të drejte, Avokati i Popullit gjatë vitit 2025 ka pranuar gjashtë ankesa. Nga to, një rast është hetuar, ndërsa pesë janë shpallur të papranueshme, të paraqitura në vijim:

- Një rast është shpallur i papranueshëm sipas nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ku nga shënimet e paraqitura dhe rrethanat e rastit ka rezultuar se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur dhe nuk ka pasur kurrfarë keqadministrimi.
- Katër ankesa janë shpallur të papranueshme sipas nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, ku nga shënimet e paraqitura dhe rrethanat e rastit ka rezultuar se çështja e shtruar nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

Ndërsa, për sa i përket ankesës së hapur për hetim, hetimi ka përfunduar në përputhje me kërkesën e ankuesit dhe është mbyllur sipas nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.

Përkundër numrit jo të madh të ankesave të pranuar në IAP, rezulton se ka një nevojë për informim të shtuar të qytetarëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përdorimin korrekt të mjeteve

juridike për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale.

Mbrojtja e së drejtës për privatësi dhe siguria e të dhënave personale mbeten elemente themelore për garantimin e dinjitetit dhe lirive individuale. Megjithëse korniza ligjore dhe institucionale është dukshëm më e zhvilluar, sfidat në mbrojtjen e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale kanë marrë një dimension më kompleks në rrethanat aktuale shoqërore. Kuadri kushtetues dhe ligjor ofron garanci dhe mekanizma mbrojtës, por zbatimi efektiv i tyre është i domosdoshëm për parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara dhe respektimin e të drejtave të individëve, ndërsa çdo kufizim duhet të jetë i ligjshëm, i justifikuar dhe proporcional.

Avokati i Popullit, nga analiza e informacionit të mbledhur lidhur me rastin Ex officio nr. 438/2024 mbi ndikimin e teknologjive të Inteligjencës Artificiale (në vijim: IA) në të drejtat e njeriut, vlerëson se mungesa e rregullimit me dispozita normative të përdorimit të IA-së lë të hapur mundësinë e kërcënimit të së drejtës për një jetë private të qytetarëve, duke pasur parasysh që sistemet e inteligjencës artificiale mund të përdoren për të mbledhur dhe analizuar të dhëna personale, si të dhëna biometrike, vendndodhjen dhe aktivitete online. Algoritmet e IA-së që përpunojnë të dhëna personale mund të jenë të ndjeshme për sa i përket sigurisë, për shkak të rrezikut të ekspozimit të informacionit personal të individëve dhe përdorimit të të dhënave personale jashtë qëllimit kryesor për të cilin janë mbledhur ato.

Rreziku për kufizimin e së drejtës në fjalë ekziston në rastet kur individët nuk informohen për mënyrën se si përdoren të dhënat e tyre nga sistemet e IA-së dhe nuk mund të japin pëlqimin përkatës, duke u pamundësuar zotërimi i kontrollit mbi to.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen për rrezikun potencial dhe mundësinë e ndërhyrjes në jetën familjare dhe private të individëve në rastet e përdorimit të teknologjive të mbikëqyrjes dhe monitorimit në hapësirat private të banimit.

## E Drejta e Martesës dhe Familjes

Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtën e martesës dhe familjes dhe, në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.<sup>36</sup> Më tej, Kushtetuta përcakton se martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.<sup>37</sup> Gjithashtu, Kushtetuta garanton se familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.<sup>38</sup>

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 21 ankesa që lidhen me të drejtat e martesës dhe familjes. Prej këtyre, 11 janë shpallur të papranueshme për arsye se çështjet që trajtonin ishin jashtë juridiksionit të këtij institucioni, nuk kishte shkelje të të drejtave të njeriut, ose ankuesit kishin mundësi t'i shfrytëzonin mjetet e tjera juridike. Nga 10 ankesa që janë pranuar për hetim, 1 rast është mbyllur, për të cilin është vërtetuar se nuk ka pasur shkelje apo keqadministrim nga autoritetet publike. Raste të tjera janë ende në proces hetimi.

Bazuar në analizën e rasteve të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ankesat kryesore kanë të bëjnë me çështje familjare dhe administrative, përfshirë: realizimin e kontaktit personal ndërmjet prindit dhe fëmijës;<sup>39</sup> pajisjen me dokumente personale dhe rregullimin e statusit juridik në Kosovë;<sup>40</sup> refuzimin e dhënies së pëlqimit nga Qendra për Punë Sociale për pajisjen e fëmijëve me pasaportë dhe udhëtimin e tyre jashtë vendit;<sup>41</sup> zvarritjen e procedurave në gjykatë lidhur me dhënien e pëlqimit për pasaportë;<sup>42</sup> monitorimin në rastet e heqjes të së drejtës prindërore;<sup>43</sup> çështje të shkurorëzimit, besimit të fëmijëve, caktimit të alimentacionit dhe masave të sigurisë<sup>44</sup>;

zvarritjen e procedurave gjyqësore për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi bazën e kontributit të përbashkët martesor;<sup>45</sup> si dhe pretendime për trajtim joadekuat gjatë realizimit të kontaktit me fëmijën.<sup>46</sup> Në kontekstin e së drejtës së martesës dhe familjes, pas hetimeve të rasteve gjatë vitit raportues, janë evidentuar probleme të vazhdueshme lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore dhe administrative, vështirësitë në realizimin e kontaktit prind-fëmijë, si dhe mungesën e koordinimit dhe efikasitetit institucional, veçanërisht në dhënien e pëlqimeve për pajisjen e fëmijëve me dokumente personale dhe në garantimin e interesit më të mirë të fëmijës.

Në raportin e vitit të kaluar, Avokati i Popullit kishte vlerësuar pozitivisht miratimin e Ligjit nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, si një hap të rëndësishëm drejt reformimit të sistemit të shërbimeve sociale në Kosovë. Ky ligj synon rregullimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë, si dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të institucioneve publike dhe private që ofrojnë këto shërbime.<sup>47</sup> Ligji vendos theks të veçantë në zhvillimin e shërbimeve familjare dhe atyre me bazë në komunitet, zgjerimin e formave të mbrojtjes sociale, si dhe avancimin e strehimit familjar për të rinjtë pas moshës 18-vjeçare. Po ashtu, ai krijon mundësinë për zbatimin e modelit të “jetesës së pavarur të mbikëqyrrur”, e cila, pas një rivlerësimi të nevojave individuale, mund të vazhdojë deri në moshën 26-vjeçare.<sup>48</sup>

Në këtë raport, Avokati i Popullit vijon të vlerësojë zbatimin praktik të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe ndikimin e tij në përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare. Megjithatë, një nga indikatorët kyç të zbatimit të këtij ligji, përkatësisht miratimi i akteve nënligjore përkatëse, ende nuk është

36 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 1.

37 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 2.

38 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 3.

39 R.nr. 242/2025; R.nr. 1406/2025.

40 R.nr. 730/2025; R.nr. 740/2025; R.nr. 741/2025; R.nr. 742/2025; R.nr. 743/2025; R.nr. 744/2025; R.nr. 781/2025; R.nr. 781/2025; R.nr. 799/2025.

41 R.nr. 24/2025.

42 R.nr. 783/2025.

43 R.nr. 45/2025.

44 R.nr. 223/2025.

45 R.nr.550/2025.

46 R.nr.682/2025.

47 Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111>

48 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 28.

përmbushur në tërësi. Në veçanti, mungon miratimi i akteve nënligjore që rregullojnë organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Kujdes Ditor dhe Qendrave për Pranim,<sup>49</sup> gjë që po ndikon drejtpërdrejt në funksionalizimin e këtyre shërbimeve. Mosmiratimi i plotë i këtyre akteve nënligjore vazhdon të pengojë zbatimin efektiv të ligjit, ndërkohë që janë miratuar vetëm gjashtë akte nënligjore në funksion të zbatimit të tij.<sup>50</sup>

Për më tepër, më 5 maj 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit publikoi Raportin ex officio nr. 662/2024 mbi përgjegjësinë e shtetit në garantimin e shëndetit mendor të fëmijëve,<sup>51</sup> në të cilin ritheksohet se, ndonëse Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare ka hyrë në fuqi në vitin 2024, aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij vazhdojnë të mungojnë. Në mënyrë të veçantë, theksohet nevoja për miratimin e akteve nënligjore që operacionalizojnë nenin 61 (Qendrat e Kujdesit Ditor) dhe nenin 62 (Qendrat e Pritjes), të cilat janë të rëndësishme edhe për ofrimin e mbështetjes në fushën e shëndetit mendor.

Raporti evidenton gjithashtu qasje të kufizuara të fëmijëve në shërbime të specializuara të shëndetit mendor në kujdesin shëndetësor parësor dhe sekondar. Sipas Ligjit për Shëndetin Mendor, këto shërbime në nivelin e mesëm ofrohen vetëm në spitalet rajonale, nëpërmjet departamenteve psikiatrike, të cilat, përveç atij në Gjakovë, nuk kanë njësi të veçanta për fëmijë dhe nuk ofrojnë shërbime nga psikiatër të specializuar për fëmijë. Për më tepër, kapacitetet e kufizuara profesionale në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve nuk përputhen me kërkesën në rritje për vlerësim dhe trajtim, gjë që pamundëson edhe ofrimin e shërbimeve të psikoterapisë nga psikologët klinikë, veçanërisht për shkak të numrit të pamjaftueshëm të profesionistëve në raport me nevojat ekzistuese.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se Projekt Kodi Civil, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2021, gjatë vitit 2022 nuk arriti t'i siguronte votat e nevojshme për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Megjithëse Qeveria e Republikës së Kosovës e kishte paraparë në Programin Legjislativ për vitin 2023 ridërgimin e Projekt Kodit Civil për shqyrtim dhe miratim, një veprim i tillë nuk u realizua. Për më tepër, funksionimi i kufizuar dhe periudhat e mosfunksionimit efektiv të Kuvendit për më shumë se një vit kanë ndikuar drejtpërdrejt në vonesën e procedimit dhe miratimit të Projekt Kodit Civil.

Avokati i Popullit e shpreh shqetësimin e tij lidhur me këtë zvarritje të tejzgjatur dhe thekson nevojën për përshejtimin e procedimit të Projekt Kodit Civil nga ana e Qeverisë, si dhe për trajtimin me prioritet nga ana e Kuvendit. Miratimi i këtij Kodi mbetet një hap i domosdoshëm drejt forcimit të sigurisë juridike, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe konsolidimit të rendit juridik në vend.

## Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë në Republikën e Kosovës është e garantuar me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka trajtuar gjithsej dy raste që lidhen me respektimin e të drejtave dhe lirive fetare, të cilat përfshinin ankesa të paraqitura nga qytetarët, si dhe një rast të iniciuar sipas detyrës zyrtare (ex officio). Këto raste kanë reflektuar problematika të ndryshme, përfshirë çështjen e statusit të parregulluar juridik të bashkësive fetare, qasjen dhe përdorimin e objekteve fetare, ushtrimin e lirive fetare në institucionet arsimore, si dhe pretendime për trajtim diskriminues mbi bazë fetare nga autoritetet publike.

E drejta e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë rregullohet me Ligjin nr.02/L-31 për Liritë Fetare, i cili nuk ofron një rregullim gjithëpërfshirës të statusit juridik të bashkësive fetare, pasi nuk përmban dispozita që rregullojnë regjistrimin e tyre, fitimin e personalitetit juridik, si dhe çështjet pronësore dhe financiare.

49 Shih nenet 61 dhe 62 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

50 Rregullorja nr.13/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim rezidencial; Rregullorja nr. 09/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim familjar; Rregullorja nr.10/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për adoptim; Rregullorja nr.08/2024 për organizimin dhe funksionimin e këshillit profesional për shërbime sociale dhe familjare; Udhëzimi administrativ nr. 14/2024 për kriteret dhe mënyrën për licencimin e punonjësit profesional për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare; Udhëzimi administrativ nr. 03/2025 për strehimin rezidencial.

51 <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-6662-2024-pergjegjesia-e-shtetit-ne-raport-me-shendetin-mendor-te-femijeve/>

Si rrjedhojë, ekziston një boshllëk ligjor që krijon vështirësi praktike në ushtrimin e lirive fetare.

Iniciativat për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit kanë vazhduar për më shumë se një dekadë. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar disa projektligje, përfshirë Projektligjin nr. 07/L-037, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2023, por që deri në fund të periudhës raportuese nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Mosmiratimi i këtij ligji vazhdon të paraqesë një problem sistematik që ndikon negativisht në realizimin e plotë të lirisë së besimit fetar për të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në Kosovë.

Avokati i Popullit, në vazhdimësi dhe në mënyrë të përsëritur, ka theksuar nevojën për miratimin e një kornize të re ligjore gjithëpërfshirëse, e cila do të siguronte trajtim të barabartë të bashkësive fetare para ligjit dhe do të garantonte ushtrimin efektiv të lirive fetare, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Bazuar në informatat e pranuar gjatë këtij viti, Avokati i Popullit është njoftuar për rastet e dy nxënësve që ishin përjashtuar nga procesi mësimor për shkak të mbajtjes së shamisë. Avokati i Popullit ka ndërmarrë veprime dhe u ka tërhequr vëmendjen autoriteteve duke ritheksuar detyrimin e tyre që çdo veprim dhe vendim që ka të bëjë me të drejtat e fëmijës të zbatohet duke pasur parasysh parimin e interesit më të mirë të fëmijëve.

Kushtetuta përcakton: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërrmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”*<sup>52</sup>

Ndërsa Konventa për të Drejtat e Fëmijës<sup>53</sup> përcakton: *“Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.”*

## Liria e Shprehjes

Liria e shprehjes në Republikën e Kosovës garantohet me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili siguron të drejtën për shprehje të lirë, pranimin dhe shpërndarjen e informacioneve dhe ideve pa ndërhyrje, ndërsa kufizimet e kësaj të drejte lejohen vetëm kur janë të parashikuara me ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike. Ky standard kushtetues është në përputhje të plotë me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, zbatohet drejtpërdrejt në rendin juridik të Republikës së Kosovës.

Në këtë kuadër, ushtrimi i kësaj të drejte konkretizohet dhe rregullohet më tej nëpërmjet Ligjit Nr. 08/L-289 për Qasje në Dokumente Publike, Ligjit Nr. 08/L-164 për Komisionin e Pavarur për Media, Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, si dhe Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat parashikojnë kufizime vetëm kur ato janë të parashikuara me ligj, të domosdoshme dhe proporcionale për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe interesit shoqëror. Në këtë mënyrë vendoset balanca e nevojshme ndërmjet lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve, interesit shoqëror, rendit publik dhe privatësisë.

Megjithatë, kjo e drejtë mund t'i nënshtrohet kufizimeve vetëm kur ato janë të parashikuara me ligj, të domosdoshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Kufizimet ndaj lirisë së shprehjes konsiderohen të arsyetuara vetëm në rastet kur shprehjet nxisin ose justifikojnë urrejtjen, dhunën apo diskriminimin, ose kur ato cenojnë sigurinë publike, rendin kushtetues, dinjitetin e individit dhe të drejtat e grupeve të cënueshme. Një vlerësim i tillë duhet të bëhet gjithmonë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke marrë parasysh kontekstin, qëllimin, ndikimin dhe rrezikun real që buron nga përmbajtja e shprehur.

Standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 10), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (nenet 19 dhe 20), si dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat

52 Neni 50, paragrafi 4.

53 Neni 3, paragrafi 1.

e Njeriut (Feret kundër Belgjikës, Aplikacioni nr. 15615/07,<sup>54</sup> Jersild kundër Danimarkës, Aplikacioni nr. 15890/89<sup>55</sup>) vendosin detyrime të qarta për shtetin që të garantojë mbrojtjen efektive të lirisë së shprehjes, duke siguruar njëkohësisht parandalimin dhe adresimin e gjuhës së urrejtjes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të të tjerëve, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej dy ankesa që lidhen me lirinë e shprehjes. Njëra ankesë është shpallur e papranueshme për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike, ndërsa ankesa tjetër është shpallur e papranueshme pasi nga shënimet e paraqitura dhe rrethanat e rastit ka rezultuar se çështja nuk bie në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji.

Megjithëse numri i ankesave është i vogël, kjo nuk e ka penguar Avokatin e Popullit të monitorojë respektimin e lirisë së shprehjes në vend dhe gjuhën e përdorur në diskursin publik. Mediat tradicionale dhe portalet informative janë burime kryesore të informacionit dhe instrumente të rëndësishme për ushtrimin e lirisë së shprehjes, ndërsa platformat e rrjeteve sociale, të cilat lejojnë komunikim interaktiv, ofrojnë mundësi të gjerë për komunikim.

Mungesa e një rregullimi ligjor të qartë për përdorimin e platformave sociale vazhdon të paraqesë sfida në lidhje me tejkalimin e kufijve të lirisë së shprehjes, sigurinë dhe besueshmërinë e informacionit, identifikimin e përgjegjësive për përmbajtjen e shpërndarë, si dhe përdorimin e gjuhës degraduese dhe të urrejtjes.

Direktivat e BE dhe instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e lirisë së shprehjes theksojnë nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje institucionale, si dhe për ndërgjegjësim të shtuar publik mbi përdorimin e përgjegjshëm të lirisë së shprehjes, me qëllim të ruajtjes së integritetit të informacionit dhe respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të individëve.

Lidhur me gjuhën e përdorur në diskursin publik, Avokati i Popullit më 5 dhjetor 2025, përmes një reagimi publik ka shprehur shqetësim të thellë

për përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe diskriminuese në kohën e fushatës zgjedhore. Sipas Avokatit të Popullit, gjuha e tillë cenon integritetin personal, moral dhe profesional, ushqen gjuhën e urrejtjes dhe minon progresin e arritur në Kosovë, duke keqpërdorur lirinë e shprehjes dhe fuqinë politike. Avokati i Popullit ka bërë thirrje për pjekuri politike dhe përgjegjësi institucionale, duke promovuar një gjuhë të matur, korrekte dhe tolerante, veçanërisht në periudha të ndjeshme.<sup>56</sup>

Avokati i Popullit, edhe nëpërmjet këtij raporti vjetor, e thekson rëndësinë e përgjegjësive institucionale, pjekurisë politike dhe promovimit të një komunikimi të matur, etik dhe tolerante, si dhe nevojën për ndërgjegjësim publik dhe ndërhyrje institucionale për ruajtjen e integritetit të informacionit dhe respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të individëve.

## E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike

Qasja në dokumente publike, përveç se është një e drejtë themelore, përbën një mekanizëm thelbësor për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, duke mundësuar informimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në çështje me interes publik. Kjo e drejtë kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e sundimit të ligjit dhe në rritjen e besimit të publikut ndaj administratës publike.

Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë (neni 41) dhe me instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 19), Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 10) dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 19), të cilat përcaktojnë standarde për transparencën dhe lirinë e informimit.

Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP - neni 1) përcakton të drejtën e çdo personi, pa diskriminim, për të pasur qasje në dokumente publike që janë krijuar, pranuar, administruar apo kontrolluar nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik. Ky ligj parashton parimin e qasjes së lirë

54 Shih në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22002-1407%22%5D%7D>

55 Shih në <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57891%22%5D%7D>

56 <https://oik-rks.org/2025/12/05/reagim-i-avokatit-te-popullit-per-gjuhen-ne-diskursin-publik/>

në dokumente publike, duke lejuar kufizime vetëm në raste të veçanta dhe të arsyetuara, si mbrojtja e sigurisë kombëtare, zhvillimi i hetimeve penale apo mbrojtja e të dhënave personale, si dhe rregullon procedurat e rishqyrtimit dhe ankimit administrativ.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 21 të LQDP-së, ofron mbështetje për qytetarët në realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, duke vepruar në bazë të Kushtetutës, Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe legjislacionit përkatës. Çdo person ka të drejtë t'i drejtohet Avokatit të Popullit me kërkesë ose ankesë, në rastet kur konsideron se i është cenuar ndonjë e drejtë e garantuar me legjislacionin për qasje në dokumente publike.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar 13 (trembëdhjetë) ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike. Dy nga këto ankesa janë hapur për hetim, ndërsa 11 (njëmbëdhjetë) janë shpallur të papranueshme.

Nga 11 ankesat e shpallura të papranueshme, gjashtë (6) janë shpallur në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pasi nuk është konstatuar shkelje e të drejtave të njeriut apo keqadministrim; katër (4) në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, pasi procedurat janë ende në zhvillim në organet kompetente; dhe një (1) në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike.

Ndërsa, për sa u përket rasteve të hapura për hetim, në një rast hetimet kanë përfunduar në bazë të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.<sup>57</sup> Kurse në tjetrin hetimet janë duke u zhvilluar.<sup>58</sup>

Nga të dhënat e rasteve të regjistruara në IAP, vërehet se një pjesë e konsiderueshme e rasteve të adresuara lidhen me aspekte procedurale dhe me mungesën e shterimit të mjeteve juridike, duke reflektuar nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve, por edhe për përmirësimin e praktikës administrative të institucioneve publike në zbatimin e legjislacionit për qasje në dokumente publike.

57 R.nr. 738/2025

58 R.nr.880/2025

59 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42, paragrafi 1

60 <https://kpm-ks.org/Page/138>

## Liria e Medieve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 42 të saj, garanton lirinë dhe pluralizmin medial.<sup>59</sup> Në po këtë nen, ndalohet censura dhe pengimi i shpërndarjes së informacionit apo ideve nëpërmjet mediave. Mirëpo, gjithashtu, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj-së, legjitimohet ndërhyrja e shtetit në rastet kur kjo bëhet për parandalimin e nxitjes së dhunës në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Burimet e gazetarëve mbrohen me Ligjin nr. 04/L-147 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë. Ekzistojnë edhe ligje të tjera që përmbajnë dispozita të hollësishtme për zbatimin e garancive kushtetuese, si Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për të Drejtat e Autorit, si dhe vetërregullimi i mediave përmes Kodit të Etikës, i cili synon përgjegjësinë më të madhe në gazetari.

Në Kosovë ekziston një pluralizëm i gjerë i mediave, përfshirë mediat që publikojnë në gjuhë të ndryshme të komuniteteve joshumicë. Sipas Komisionit të Pavarur të Mediave,<sup>60</sup> organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, në Kosovë ekzistojnë 19 televizione: një televizion publik (i cili transmeton në të gjitha gjuhët e komuniteteve), 13 TV stacione në gjuhën shqipe, 4 TV stacione në gjuhën serbe dhe 83 radiostacione të licencuara. Mbetet i paqartë numri i saktë i portaleve që operojnë në vend, për shkak të sfidave në transparencën e pronësisë së mediave dhe çështjeve të tjera si qëndrueshmëria financiare.

Për vitin raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar një rast sipas detyrës zyrtare, pas shqetësimeve të ngritura publikisht nga komuniteti i gazetarëve në lidhje me mosakreditimin e disa mediave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për përcjelljen e procesit zgjedhor për zgjedhjet lokale më 12 tetor 2025. Avokati i Popullit reagoi publikisht duke theksuar rëndësinë dhe rolin kyç të medias dhe pluralizmit medial në informimin e opinionit publik dhe transparencën

e procesit zgjedhor.<sup>61</sup> Pas disa ditësh, KQZ-ja njoftoi për akreditimin e mediave vendore dhe ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve, media të cilat nuk ishin akredituar paraprakisht.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka raportuar për 69 raste të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe organizatave mediale.<sup>62</sup> Dy raste janë regjistruar si ankesa të gazetarëve dhe kameramanëve për shkak të largimit nga puna dhe i kanë paditur punëdhënësit për mosrespektim të Ligjit të Punës. Po ashtu, gjatë vitit 2025 janë raportuar dy sulme ndaj mediave, ku janë sulmuar hapësirat e shtëpive mediale duke shkaktuar dëme materiale. Një numër i rasteve përfshin reagimet e AGK-së për gjuhën e përdorur nga zyrtarët publikë, respektivisht nga figura të larta të partisë në pushtet, ndaj mediave dhe gazetarëve.

Në një rast të tillë, Avokati i Popullit ka reaguar ndaj cilësimeve fyese dhe të vrazhda nga ana e njërit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj gazetarëve, përderisa kryenin punën e tyre, si dhe ndaj kualifikimeve akuzuese dhe denigruese ndaj AGK-së. Avokati i Popullit theksoi se deklaratat e tilla tejkalojnë kufijtë e arsyeshëm të sjelljes dhe etikës së personave publik që mbartin përgjegjësi institucionale<sup>63</sup>.

Reporterët pa Kufij (RSF) raportuan për përkeqësim të lirisë së medias në Kosovë për vitin 2025, duke e renditur Kosovën në vendin e 99-të në botë<sup>64</sup>. Ky ishte viti i dytë radhazi që Kosova shënon rënie, pasi në vitin 2024 ra nga vendi i 56-të në atë të 75-të. Sipas Reporterëve pa Kufij, qëllimi i Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit është të krahasojë nivelin e lirisë që gëzojnë gazetarët dhe mediat në 180 shtete. Raporti thekson se mediat arrijnë t'i mbajnë politikanët përgjegjës, por gazetarët vazhdojnë të jenë shënjestra të sulmeve politike.

Raporti po ashtu vlerëson se Komisioni i Pavarur i Medias (KPM) është një rregullator joefektiv i medias, i cili *“iu nënshtrua një reforme legjislative kontroverze që rrezikon të pengojë më tej pavarësinë e tij”*. Që nga janari 2025, KPM-ja mbeti pa kuorum të nevojshëm dhe numri i anëtarëve u zvogëlua në vetëm dy, duke pamundësuar vendimmarrjen, përfshirë

gjatë fushatës zgjedhore. Në anën tjetër, Bordi i Ankesave i KPM-së mbetet pa kuorum që nga nëntori 2023.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit organizoi një takim me gazetarë dhe redaktorë, me të cilët diskutoi për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi për gjendjen e lirisë së mediave në vend, sfidat dhe problemet me të cilat përballen gazetarët, renditja negative e Kosovës në indeksin e Reporterëve pa Kufij, mbrojtja ligjore e gazetarëve, mbrojtja e të dhënave personale dhe sfidat në trupat vetërregulluese të mediave.<sup>65</sup>

Avokati i Popullit tha se liria e mediave dhe liria e shprehjes hyjnë në katalogun e të drejtave të njeriut dhe janë baza të themelit të demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ai theksoi se raporti i RSF-së për vitin 2025 për gjendjen e mediave në Kosovë ka ngritur alarm dhe se duhen marrë masa për të garantuar pacenueshmërinë e mediave.

Avokati i Popullit tha se raporti në fjalë ka theksuar se ndërhyrja politike në media dhe siguria e gazetarëve ishin në nivelin më kritik dhe se qasja e qeverisë së atëhershme ndaj raportimeve të tilla ka qenë përpjekje për relativizim të realitetit. Qeveria nuk e trajtoi raportin në mënyrë racionale, por e paraqiti si një tendencë për ta paraqitur keq Kosovën dhe adresoi fajet tek ata që raportuan te kjo organizatë.

Pjesëmarrësit theksuan se sulmet e vazhdueshme dhe fushatat denigruese ndaj gazetarëve dhe mediave nga ana e qeverisë kanë qenë arsyt kryesore për rënie e Kosovës në këtë raport. Një ndër çështjet që u diskutua ishte Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili nuk kaloi në Gjykatën Kushtetuese, dhe u theksua se ndryshimet duhen bërë me pjesëmarrje të gjerë të publikut dhe profesionistëve të fushës.

Në këtë takim u konstatua se është me rëndësi të ketë një dialog të mirëfilltë me qeverinë e ardhshme dhe institucionet e tjera respektive në lidhje me lirinë e mediave dhe sigurinë

61 <https://oik-rks.org/2025/10/10/reagim-i-avokatit-te-popullit-lidhur-me-vendimarrjen-e-kqz-se-per-te-mosakredituar-nje-numer-mediash-per-te-percjelle-zgjedhjet-lokale-2/>

62 <https://www.agk-ks.org/rastet-kerko/?keywords=&city=&ngakush=&gjinia=&year=2025&llojiimedias=&llojiincidentit=&ppublik=&gjyqesor=&pligjor=&search=1>

63 <https://oik-rks.org/2025/12/05/reagim-i-avokatit-te-popullit-per-gjuhen-ne-diskursin-publik/>

64 <https://rsf.org/en/index>

65 <https://oik-rks.org/2025/07/01/avokati-i-popullit-diskutoi-me-gazetare-per-lirine-e-mediave/>

e gazetarëve, veçanërisht për çështjen e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve që lidhen me punën e mediave. U kërkua më shumë efikasitet nga ana e sistemit të drejtësisë dhe sigurisë në lidhje me rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, si dhe për përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët.

Për sa i përket transmetuesit publik - RTK-së, ai vazhdon të funksionojë me ligj të vjetër, marrë parasysh se Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës ka hyrë në fuqi më 12 prill 2012 dhe periudha tranzitore trevjeçare ka përfunduar më 2015. Mungesa e ligjit të ri po shkakton probleme të mëdha brenda transmetuesit publik, veçanërisht mungesën e financimit të plotë dhe të qëndrueshëm, çështje pronësie dhe të tjera. Gjatë vitit 2025, situata financiare në transmetuesin publik u vështirësua edhe më tej si pasojë e moskonstitutimit të Kuvendit të Kosovës, si themelues i RTK-së dhe, rrjedhimisht, për shkak të mungesës së miratimit të buxhetit, RTK-ja nuk ishte në gjendje të funksiononte si duhej. Avokati i Popullit ka reaguar për këtë çështje<sup>66</sup> dhe i ka kërkuar Qeverisë në detyrë që të gjejë mënyra të përkohshme për ekzekutimin e pagave për punëtorët e transmetuesit publik.

## Liria e Tubimit

Liria e tubimit është e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe gurthemeli i saj. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e tubimit paqësor. Më tej, Kushtetuta përcakton se secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse kjo është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.<sup>67</sup> Kjo e drejtë po ashtu garantohet edhe me instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat i obligojnë shtetet të lehtësojnë dhe të mos pengojnë tubimet, siç janë protestat, marshimet etj., dhe lejojnë vetëm kufizime të domosdoshme, të bazuara në ligj, proporcionale dhe që nuk shkelin thelbin e së drejtës së garantuar.<sup>68</sup>

66 <https://oik-rks.org/2025/07/25/komunikate-per-shtyp-deklarata-e-avokatit-te-popullit-ne-lidhje-me-radiotelevizionin-e-kosoves/>

67 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 43.

68 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike, neni 21.

69 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 44, paragrafi 1.

70 Po aty, neni 44, paragrafi 3.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar tri ankesa lidhur me pretendimet për shkelje të lirisë së tubimit paqësor. Pas vlerësimit preliminar të ankesave në fjalë, nuk janë konstatuar shkelje të kësaj të drejte.

## Liria e Asociimit

Liria e asociimit është e drejtë themelore, e cila është esenciale për funksionimin e demokracisë dhe kusht për gëzimin e të drejtave të tjera themelore. Kjo e drejtë gëzon mbrojtje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat janë pjesë e sistemit juridik të Kosovës, siç janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton këtë të drejtë themelore dhe përcakton se liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate<sup>69</sup>. Po ashtu, sipas Kushtetutës, kjo e drejtë, në raste të caktuara, mund të kufizohet me vendim të gjykatës kompetente. Kushtetuta shprehimisht përcakton: *“Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.”*<sup>70</sup>

Përveçqë është e garantuar me Kushtetutë, liria e asociimit rregullohet me Ligjin nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë dhe me Ligjin nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues, nuk ka marrë ndonjë ankesë me pretendim për cenim të kësaj të drejte, gjë që tregon se kjo e drejtë, në përgjithësi, respektohet dhe nuk ka pasur ndonjë rast serioz të cenimit të saj në vendin tonë.

## Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si një nga të drejtat themelore të njeriut, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,<sup>71</sup> si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Të drejtat zgjedhore dhe e drejta e përfaqësimit janë të lidhura ngushtë me demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ofrojnë një kornizë të rëndësishme për sigurimin e këtyre të drejtave, ndërsa implementimi dhe mbikëqyrja e tyre janë po aq të rëndësishme për të arritur një demokraci funksionale dhe gjithëpërfshirëse. Të drejtat zgjedhore janë element thelbësor i demokracisë, duke ia garantuar mundësinë secilit të shprehë mendimin e tij dhe të kontribuojë në proceset vendimmarrëse.

Viti 2025 mund të karakterizohet si vit i zgjedhjeve në vend, duke pasur parasysh që brenda vitit janë organizuar dy procese të zgjedhjeve të përgjithshme, zgjedhjet e datës 9 shkurt dhe ato të datës 28 dhjetor 2025, si dhe dy procese të zgjedhjeve lokale, ato të datës 12 tetor dhe raundi i dytë i tyre më 9 nëntor 2025. Të katër proceset janë zhvilluar me ton të qetë dhe demokratik, duke u mundësuar qytetarëve pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe kredibile në zgjedhje.

Zhvillim pozitiv në vitin 2025, i cili ndikoi në avancimin e proceseve zgjedhore në drejtim të promovimit të përfshirjes demokratike, sigurimit të barazisë politike dhe rritjes së legjitimitetit të procesit zgjedhor, ishte edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili u ofroi qytetarëve që jetojnë jashtë vendit forma të zgjeruara të votimit. Reforma thjeshtoi regjistrimin duke lehtësuar kërkesat për dokumentacion dhe duke vendosur një proces të arritshëm dhe efikas online.<sup>72</sup> Edhe pse, sipas KQZ-së, në zgjedhjet e datës 9 shkurt 2025 pjesëmarrja e votuesve jashtë Kosovës ka arritur 75%, megjithatë janë regjistruar raste të problemeve teknike, si mospranimi i materialit zgjedhor<sup>73</sup> apo mospranimi i tij me kohë.

71 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45.

72 [https://www.idea.int/sites/default/files/2025-09/global-state-of-democracy-2025-democracy-on-the-move\\_0.pdf](https://www.idea.int/sites/default/files/2025-09/global-state-of-democracy-2025-democracy-on-the-move_0.pdf),

73 R.nr. 1653/2025.

Nga vlerësimi i përbërjes së listave të kandidatëve të partive politike konfirmohet shqetësimi i ngritur nga Avokati i Popullit lidhur me përfaqësimin gjinor të kandidatëve, ngase edhe kësaj radhe përfaqësimi i grave në listat zgjedhore ka mbetur në kuotat minimale. Sipas raportimeve nga KQZ-ja, vetëm 33% e pjesëmarrësve në listat zgjedhore kanë qenë gra.

Duke e vlerësuar lart mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore si tregues të respektimit të parimeve të demokracisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet një strukture të koordinuar të ekipeve monitoruese të përbëra nga stafi i institucionit, monitoroi katër proceset zgjedhore në vend. Monitorimi u realizua nga stafi i IAP-së, të cilët mbuluan vëzhgimin në qendrat e votimit nëpër komuna, si dhe në qendrat e votimit në institucione specifike (si qendrat e paraburgimit, burgjet, qendrat shëndetësore etj.). Procesi i votimit u monitorua nga hapja e qendrave të votimit deri në mbylljen e tyre, me qëllim që të vlerësohej pjesëmarrja e papenguar e qytetarëve në procesin e votimit, nëse po respektohej fshehtësia e votës, nëse ishte krijuar hapësirë e përshtatshme për votim për personat me aftësi të kufizuara etj.

Avokati i Popullit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, ka monitoruar mbarëvajtjen e zgjedhjeve nga aspektet në vijim:

- nëse procesi i votimit ka filluar me kohë;
- nëse ka pasur raste që kanë cenuar rrjedhën normale të votimit;
- nëse qendrat e votimit kanë pasur qasshmëri infrastrukturore, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara;
- identifikimin e votuesve në regjistrin e votuesve në vendvotime;
- nëse janë respektuar rregullat e vendosjes së kamerave në vendvotime;
- mbarëvajtja e procesit të vëzhgimit nga vëzhguesit;
- nëse ka pasur parregullsi në procesin e votimit;
- nëse është respektuar ruajtja e fshehtësisë së votës dhe ruajtja e vullnetit elektoral të votuesve;
- nëse janë respektuar të drejtat e votimit të personave me nevoja të veçanta;

- *mbarëvajtja e procesit zgjedhor në qendrat e ndalimit, të paraburgimit, në burgjet, spitalet dhe shtëpitë e të moshuarve etj.*

Edhe pse përgjithësisht vlerësohet se është respektuar e drejta e votës dhe fshehtësia e saj, si dhe vullneti politik i votuesve, megjithatë ekipet e IAP-së kanë hasur në disa parregullsi në një numër të vogël të qendrave të votimit.<sup>74</sup>

Nga monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme të datës 9 shkurt 2025, Avokati i Popullit vlerësoi se, në përgjithësi, procesi zgjedhor u zhvillua në mënyrë të qetë dhe demokratike, edhe pse nga ekipet vëzhguese të IAP-së u evidentuan disa parregullsi dhe mangësi që ndikuan në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe krijuan vështirësi në realizimin e së drejtës së votës. Lëshimet e evidentuara ishin: mosunifikimi i praktikave të votimit me asistencë; mungesa e fletëvotimeve në Braille; mungesa e tavolinave ndihmëse; mungesa e materialeve informuese nga KQZ-ja; mungesa e shenjave orientuese dhe e shënimit të numrave të qendrave të votimit në hyrje të tyre; moshurimi i qasjes së papenguar në qendra për persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara; mungesa e trajnimeve të mjaftueshme për stafin e angazhuar të KQZ-së në zgjedhje, si dhe standarde jo të unifikuara të vendosjes së kamerave vëzhguese.

Avokati i Popullit, më 11 prill 2025, ka publikuar Opinionin Ex Officio nr. 295/2025,<sup>75</sup> ku ka vlerësuar se zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025, janë zhvilluar në një ambient të qetë dhe demokratik, ku përgjithësisht janë respektuar të

drejtat zgjedhore dhe vullneti politik i qytetarëve të vendit. Në Opinion theksohet se KQZ-ja dhe institucionet tjera përkatëse, përfshirë ato të sigurisë, kanë ndërmarrë masa të duhura për të siguruar që procesi zgjedhor të zhvillohet në mënyrë të qetë, demokratike dhe të sigurt. Megjithatë, Opinioni paraqet edhe nevojën për fuqizimin e kapaciteteve të personelit të KQZ-së të angazhuar në terren. Po ashtu, Opinioni sjell në vëmendje nevojën për angazhim dhe kujdes të shtuar në garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës për qytetarët me aftësi të kufizuara, si dhe për unifikimin e praktikave në zbatimin e rregullave dhe procedurave zgjedhore të përcaktuara me ligj dhe me rregulloret zgjedhore në lidhje me realizimin e zgjedhjeve, realizimin e së drejtës së votës me asistencë, të së drejtës së votës për qytetarët me nevoja të veçanta, si dhe asistimin nga ekipet mobile.

Avokati i Popullit ka monitoruar, përmes 19 ekipeve, zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025,<sup>76</sup> nëpërmjet 23 ekipeve ka monitoruar raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë komunash, të mbajtura më 9 nëntor 2025,<sup>77</sup> si dhe nëpërmjet 19 ekipeve ka monitoruar procesin e Zgjedhjeve Qendrore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025.<sup>78</sup>

Në përgjithësi, në bazë të gjetjeve nga vëzhgimi i të tri proceseve zgjedhore në terren, nga ekipet e akredituara të IAP-së u vërejt se, edhe pse proceset zgjedhore u zhvilluan përgjithësisht në mënyrë të qetë dhe demokratike, gjatë tyre u evidentuan mangësi të përsëritura strukturore, organizative dhe procedurale që ndikuan në ushtrimin efektiv të së drejtës së votës, të cilat

74 IAP-ja, më 9 shkurt 2025, ka monitoruar qendrat e votimit në komunat në vijim: Prishtinë, Graçanicë, Lipjan, Pejë, Istog, Gjakovë, Deçan, Junik, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Vushtri, Prizren, Malishevë, Klinë, Drenas dhe Skënderaj, Suharekë, Mamushë, Rahovec, Ferizaj, Shtërpcë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Viti, Klokot, Partesh Ranillug, Shtime, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, Novobërdë, Kamenicë, Podujevë, Zveçan, Leposaviç, Zubin Potok.

75 <https://oik-rks.org/2025/04/14/opinion-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-295-2025-lidhur-me-monitorimin-e-mbarevajtjes-se-zgjedhjeve-te-pergjithshme-ne-republiken-e-kosoves-te-mbajtura-me-9-shkurt-2025/>

76 IAP-ja, më 12 tetor 2025, ka monitoruar qendrat e votimit në komunat në vijim: Prishtinë, Gjilan, Viti, Klokot, Partesh, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Gjakovë, Deçan, Junik, Pejë, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Prizren, Dragash, Istog, Skenderaj, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Vushtri, Zubin Potok, Leposaviç, Zveçan, Kamenicë, Novobërdë, Shtime, Lipjan, Graçanicë, Shtërpcë, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Ferizaj. Vëzhgimi u përqendrua gjithashtu në fshatrat e këtyre komunave. Po ashtu, u mbuluan edhe qendra specifike të votimit, si: Burgu i Sigurisë së Lartë, Burgu i Dubravës, Burgu i Smerkonicës, qendrat e paraburgimit në Pejë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë dhe Lipjan, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Shtëpia e të Moshuarve në Prishtinë, Qendra për Rehabilitim në Shtime, Qendra Korrektuese në Dubravë, Qendra Korrektuese në Lipjan, Qendra e Shëndetit Mendor, Spitali Rajonal në Pejë, Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë etj.

77 IAP-ja, më 9 nëntor 2025, ka monitoruar qendrat e votimit në komunat si në vijim: Prishtinë, Prizren, Dragash, Fushë Kosovë, Obiliq, Gjakovë, Junik, Viti, Klokot, Gjilan, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Vushtri, Pejë, Rahovec, Suharekë dhe Mamushë. Vëzhgimi u përqendrua gjithashtu në fshatrat e këtyre komunave dhe përfshiu qendrat specifike të votimit, si: Burgu i Dubravës, Burgu i Sigurisë së Lartë, Burgu i Smerkonicës, Burgu i Mitrovicës, qendrat e paraburgimit në Prishtinë dhe Lipjan, Qendra për Rehabilitim në Shtime dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).

78 IAP-ja, më 28 dhjetor 2025, ka monitoruar qendrat e votimit në komunat në vijim: Prishtinë, Gjakovë, Deçan, Pejë, Klinë, Vushtri, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Zubin Potok, Leposaviç, Zveçan, Gjilan, Viti, Klokot, Partesh, Novobërdë, Kamenicë, Ranillug, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Prizren, Dragash, Ferizaj, Shtërpcë, Kaçanik, Hani i Elezit, Graçanicë, Janjevë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Istog. Përveç qendrave të zakonshme të votimit, IAP-ja i kushtoi

në vijim pasqyrohen të përmbledhura:

- Qasje e kufizuar fizike për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, si pasojë e vendotimeve të vendosura në kate të larta pa ashensor dhe në objekte shkollore të vjetra.
- Mungesa ose vendosja jo e duhur e tavolinave ndihmëse/orientuese, që shkaktoi konfuzion te votuesit, radhë dhe vonesa në disa qendra votimi.
- Mungesa e materialeve zgjedhore në raste të izoluar, përfshirë mungesën e formularëve për votim dhe mungesën ose shpërndarjen jo të njëtrajtshme të fletëvotimeve në alfabetin Braille.
- Vonesa në hapjen e disa qendrave të votimit për shkak të mungesës së komisionerëve, problemeve teknike dhe moszëvendësimit të tyre me kohë nga autoritetet zgjedhore.
- Probleme serioze lidhur me votimin me asistencë, për shkak të zbatimit jo të njëtrajtshëm të rregullave, kërkesës për dëshmi mjekësore dhe përjashtimit të personave analfabetë dhe të moshuar.
- Zhvendosje të qendrave të votimit për votues të caktuar, përfshirë transferime në komuna të tjera pa lidhje reale banimi, duke shkaktuar konfuzion dhe pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës.
- Rrezikim i fshehtësisë së votës në disa institucione korrektuese, për shkak të përdorimit të zarfeve që përmbanin të dhëna identifikuese ose numra rendorë të lidhur me votuesin.
- Pamundësim i realizimit të së drejtës së votimit në disa institucione shëndetësore dhe sociale nga ekipet mobile, për shkak të mungesës së kërkesës paraprake ose të stafit për asistencë.
- Mungesë e punëtorëve teknikë dhe e stafit mbështetës në disa qendra votimi, si dhe raste kur disa prej tyre ishin angazhuar pa kompensim financiar.
- Mangësi infrastrukturore dhe teknike në disa qendra votimi, përfshirë mungesën e ngrohjes, ndërprerjet e shkurtra të energjisë elektrike dhe mungesën e shënjitimit identifikues.

Avokati i Popullit do të publikojë raport me rekomandime lidhur me të gjeturat nga monitorimi i këtyre proceseve zgjedhore.

---

vëmendje të veçantë votimit të grupeve të cënueshme, duke përfshirë institucionet korrektuese dhe të paraburgimit: Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, Qendra e Paraburgimit në Pejë, Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë, Burgu i Dubravës, Burgu i Smrekonicës dhe institucionet e tjera të paraburgimit dhe burgjet në zona të ndryshme, si dhe institucionet shëndetësore dhe sociale, përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Qendrën për Rehabilitim Psikiatrik dhe Shtëpitë për Përkujdesje të të Moshuarve.

**Avokati i Popullit  
në rolin e tij si  
mekanizëm i barazisë  
dhe mbrojtjes nga  
diskriminimi**

# Avokati i Popullit në rolin e tij si mekanizëm i barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit më tej specifikohen me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim mbi bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin. Ndërsa, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor.

Ligji për Avokatin e Popullit është ligj organik dhe procedurat lidhur me trajtimin e rasteve, duke përfshirë këtu edhe rastet e diskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me Ligjin për Barazi Gjinore, zbatohen në përputhje me procedurat e specifikuara në Ligjin për Avokatin e Popullit.

## Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD) përcakton kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e këtij ligji. Neni 9, paragrafi 2.12, i LMD-së i kërkon Avokatit të Popullit të paraqesë një raport të paktën çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për

zbatimin e këtij ligji. Më 10 dhjetor 2025, Avokati i Popullit ka dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës Raportin Vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2024.

Sikurse edhe në Raportin Vjetor për Zbatimin e LMD-së për vitin 2023, edhe Raporti i vitit 2024 ka shpërfaqur mangësitë dhe defektet në strukturën institucionale që pamundësojnë mbikëqyrjen sistematike të zbatimit të këtij ligji. Një nga mangësitë kryesore të identifikuara është mungesa e një sistemi të organizuar për mbledhjen e të dhënave mbi rastet e diskriminimit. Me Raportin për vitin 2024, Avokati i Popullit rekomandoi që institucionet të krijojnë një sistem të qëndrueshëm për mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas bazave dhe formave kryesore të diskriminimit, gjë që do të mundësonte monitorim më efektiv nga Avokati i Popullit. Raporti theksoi nevojën për përfundimin e emërimeve të zyrtarëve dhe funksionalizimin e njësive për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna brenda 12 muajve të ardhshëm. Gjithashtu, është rekomanduar që personeli i institucioneve të trajnohet për mbledhjen e të dhënave, në mënyrë që të mundësohet mbikëqyrja e zbatimit të LMD-së.

Nga të dhënat dhe informacionet e Avokatit të Popullit rezulton se asnjë nga këto rekomandime nuk është zbatuar, megjithëse këto rekomandime janë përsëritur në të dy raportet e Avokatit të Popullit për zbatimin e LMD-së, të publikuara deri më tani.

Ndërsa, drafti i ri i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është pjesë e Agjendës Legjislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## Gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminimin në Kosovë

Avokati i Popullit, në dy raportet për zbatimin e LMD-së për dy vite radhazi, ka konstatuar mungesë të të dhënave lidhur me rastet e diskriminimit në nivel vendi. Duke u nisur nga rrethana të tilla, Avokati i Popullit bazohet në ankesat e pranuar dhe të hetuara, si dhe në raportet dhe opinionet e publikuara nga vetë institucioni lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin. Të dhënat dhe të gjeturat e Avokatit të Popullit mund të mos pasqyrojnë

gjendjen reale në vend, duke pasur parasysh mungesën e të dhënave nga autoritetet përkatëse dhe faktin se, në praktikë, mund të ketë edhe më shumë raste të diskriminimit se sa gjetjet e Avokatit të Popullit, të përmbledhura në këtë raport.

Numri i përgjithshëm i ankesave të evidentuara në Departamentin për Mbrojtje nga Diskriminimi me pretendime për diskriminim është 27 raste të hapura për hetim.

Gjatë periudhës raportuese janë hapur 4 raste sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Natyra e ankesave që Avokati i Popullit i ka pranuar me pretendime për diskriminim ka të bëjë me çështje, si: barazia para ligjit, e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, pagat dhe beneficinet e të punësuarve, ndërprerja e marrëdhënies së punës, përfshirë ndërprerjen e kontratës së punës gjatë pushimit të lehonisë, si dhe çështje që lidhen me pensionet për të gjitha kategoritë.

Bazat e pretenduara të diskriminimit janë: aftësia e kufizuar, mosha, përkatësia etnike, statusi social, gjinia, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, përkatësia politike dhe baza të tjera të mbrojtura me nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Gjatë vitit raportues janë publikuar 7 raporte me rekomandime, bazuar në ankesat e pranuar ose të hapura sipas detyrës zyrtare, me konstatime për shkelje të të drejtave të njeriut, trajtim të pabarabartë dhe diskriminim.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka publikuar katër opinione për autoritetet publike dhe dy opinione *amicus curiae* në cilësinë e mikut të gjykatës.

### **Aktet normative që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit**

Baraziadhemosdiskriminimijanëdyngaparimet themelore që përbëjnë vlera kushtetuese në Republikën e Kosovës. Këto parime përshkojnë çdo segment të jetës shoqërore dhe përbëjnë bazamentin e sistemeve juridike bashkëkohore. Mbështetja e legjislacionit vendor mbi këto parime është kërkesë thelbësore për çdo shtet, me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të standardeve në respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Në këtë drejtim, edhe legjislacioni i Republikës së Kosovës, veçanërisht ai primar, përmban

dispozita imperative që mishërojnë parimin e mosdiskriminimit.

Megjithëse parimi i mosdiskriminimit është pjesë qenësore e legjislacionit në Republikën e Kosovës, Avokati i Popullit ka hasur në akte normative që bien ndesh me këtë parim.

Gjatë hetimit të rasteve individuale dhe hetimeve sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit ka konstatuar shkelje të këtij parimi në akte të përgjithshme normative në dy raste: në Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe në Rregulloren e Brendshme nr. 11/2024 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së.

### *Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti*

Më 24 nëntor 2025, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime lidhur me njohjen e së drejtës në dy pensione mbi dy baza të ndryshme ligjore (pensione të dyfishta),<sup>79</sup> të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Raporti ka vënë në pah se e drejta për pension sipas Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti përbën të drejtë pronësore, edhe në rastet kur përfituesi merr një pension ose kompensim tjetër mbi një bazë tjetër ligjore.

Aktgjykimi A.nr.280/17, i datës 4 shkurt 2020, me të cilin një qytetari i është njohur e drejta në pensione mbi dy baza të ndryshme – pensioni kontributpagues i moshës dhe pensioni i invalidit civil të luftës – ndonëse është vendim gjyqësor individual, ka efekt *erga omnes*, pasi prek të drejtat dhe interesat e një numri të madh qytetarësh dhe krijon precedent për raste të njëjta ose të ngjashme. Megjithatë, MFPT-ja ka vazhduar të refuzojë kërkesat e qytetarëve, duke u mbështetur në interpretime të ngushta ligjore dhe duke mos reflektuar qëndrimin e gjyqësorit.

Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore duhet të

<sup>79</sup> <https://oik-rks.org/2025/11/25/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-614-2024-lidhur-me-njohjen-e-se-drejtës-ne-dy-pensione-mbi-dy-baza-ligjore-te-ndryshme-pensione-te-dyfishta/>

interpretohen në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Jurisprudenca e GjEDNj-së ka efekt *erga omnes*, duke kërkuar nga shtetet jo vetëm kompensim individual, por edhe masa institucionale dhe sistematike për korrigjimin e shkeljeve.

Kjo qasje është konfirmuar në raste si *Ošruš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, ku vendimi për diskriminim në arsim ka çuar në reforma gjithëpërfshirëse kombëtare, si dhe në rastin *Grudić kundër Serbisë*, ku GjEDNj-ja ka konstatuar shkelje të së drejtës së pronës për shkak të mospagimit të pensioneve dhe ka kërkuar ndryshim të përgjithshëm të praktikave shtetërore për shkak të numrit të madh të personave të prekur.

Në analogji me këto raste, Aktgjykimi A.nr.280/17 në Kosovë duhet të shërbejë si bazë për rishikim institucional dhe reformim të qasjes së MFPT-së ndaj kërkesave për përfitime pensionale. MFPT-ja ka obligim të harmonizojë politikat dhe vendimmarrjen me vendimet gjyqësore, veçanërisht kur ato korrigjojnë interpretime të gabuara të ligjit dhe prekin një numër të madh qytetarësh.

Trajtimi i vazhdueshëm i rasteve të ngjashme ndryshe nga rasti i vendosur me aktgjykim ka shkelur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, ka cenuar sigurinë juridike dhe ka kontribuar në mbingarkesën e sistemit gjyqësor, pasi qytetarët janë udhëzuar të ndjekin rrugën gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre.

Sipas Avokatit të Popullit, MFPT-ja dhe Qeveria nuk kanë ndërmarrë nismë për analizë apo plan konkret për zgjidhjen e kësaj problematike, pavarësisht ekzistencës së shumë skemave dhe ligjeve pensionale në Kosovë, të cilat shpesh nuk kanë qenë të harmonizuara ndërmjet vete.

*Rregullorja e Brendshme nr. 11/2024 e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pranimin e drejtorit të sekretariatit të KQZ-së*

Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar që gjatë hartimit dhe miratimit të akteve të brendshme ligjore të sigurohet përputhshmëria e tyre me parimin

e mosdiskriminimit dhe të shmanget vendosja e kriterëve që mund të çojnë në trajtim të pabarabartë të individëve ose grupeve në të ardhmen.<sup>80</sup>

Avokati i Popullit ka shqyrtuar dy ankesa individuale kundër KQZ-së, të cilat kanë pasur të bëjnë me konkursin e datës 24 qershor 2024 për pozitën e drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së, ku është pretenduar se kriteret e konkursit kanë qenë diskriminuese. Kriteri kontestues ka pasur të bëjë me njohjen e detyrueshme të gjuhës angleze në nivelin B2, të dëshmuar ekskluzivisht me certifikata TOEFL ose IELTS, duke përjashtuar forma të tjera të vlefshme të dëshmimit të njohjes së gjuhës angleze. Ky kusht ka qenë i përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, të Rregullores së Brendshme nr. 11/2024 të KQZ-së për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së.

Me qëllim të vlerësimit të arsyeshmërisë dhe proporcionalitetit të këtij kriteri obligues dhe kufizimit të paraparë në nenin kontestues, Avokati i Popullit ka kërkuar shpjegime nga KQZ-ja, e cila e ka arsyetuar kushtin me nevojën për komunikim ndërkombëtar dhe ruajtjen e standardeve të larta profesionale.

Gjatë hetimit, neni kontestues i rregullores është shfuqizuar plotësisht nga KQZ-ja me Vendimin nr. 01/981-2025, të datës 13.5.2025. Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit e ka përfunduar hetimin me raport, pasi kriteri, gjatë kohës që ka qenë në fuqi, ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë.

Avokati i Popullit ka konstatuar se aktet nënligjore, siç janë rregulloret e brendshme, duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Ai ka vlerësuar se, ndonëse kërkesa për njohjen e gjuhës angleze në nivelin B2 ka qenë legjitime, kufizimi i dëshmimit vetëm në dy certifikata specifike ka qenë joproporcional, pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë. Kushti i veçantë, i përcaktuar me Rregulloren nr. 11/2024, nuk ka pasur mbështetje në Kushtetutë, në Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe as në Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërsa një kriter i tillë diskriminues nuk mund të vendoset me asnjë akt normativ.

80 <https://oik-rks.org/2025/11/25/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-637-2024-dhe-r-nr-725-2024-lidhur-me-ndryshimin-e-rregullores-se-brendshme-nr-11-2024-per-pranimin-e-drejtorit-te-sekretariatit-te-kqz-se/>

## **Praktikat e përgjithshme që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit**

Megjithëse ekziston një konsensus se korniza ligjore në Republikën e Kosovës është e avancuar në kuptimin e mbrojtës së të drejtave të njeriut dhe fushës së mosdiskriminimit, Avokati i Popullit gjatë hetimit të rasteve has në situata kur ligjet zbatohen në mënyrë të gabueshme apo nuk zbatohen fare, praktika këto që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë.

### **Diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar**

Personat me aftësi të kufizuara kanë vazhduar të përballen me vështirësi në qasjen në shërbime shëndetësore, arsim, punësim dhe në pjesëmarrje në jetën publike.

Avokati i Popullit, në vazhdimësi, përmes rekomandimeve drejtuar autoriteteve shtetërore, ka adresuar çështje që kanë pasur të bëjnë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Disa prej këtyre rekomandimeve, si ai për rivlerësimin mjekësor të aftësisë së kufizuar për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kanë çuar në ndryshimin e rregullativës që ka qenë në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në vitin 2023, me vendim unanim, ka vendosur që listës së marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës t'i shtohet edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Kjo Konventë ka përcaktuar respektin për dinjitetin e natyrshëm dhe autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhje personale dhe pavarësinë e personave me aftësi të kufizuara; respektimin e parimit të mosdiskriminimit; pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri; respektin për ndryshimin dhe pranimin e tyre si pjesë e diversitetit njerëzor; respektin për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara; si dhe respektin për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre. Me miratimin e kësaj Konvente, Republika e Kosovës do të merrte përsipër detyrime

specifike pozitive, ndër të tjera, për ndërmarrjen e masave të nevojshme legjislative dhe masave të tjera institucionale, duke krijuar mekanizma në funksion të zbatimit të plotë të saj.

Megjithë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, kjo Konventë ende nuk është miratuar nga Kuvendi.

*Mosofrimi i trajtimit të përshtatshëm shëndetësor stomatologjik dhe diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar*

Avokati i Popullit, më 13 janar 2025, ka publikuar Raportin me Rekomandime nr. 649/2024<sup>81</sup> i cili trajton ankesën e një qytetareje me aftësi të kufizuar, të përfaqësuar nga babai i saj, e paraqitur kundër Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK), për shkak të mosofrimit të trajtimit të përshtatshëm shëndetësor stomatologjik dhe diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar. Raporti identifikon shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe thekson detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe legjislacionin në fuqi nga fusha e shëndetësisë.

Gjatë hetimeve, Avokati i Popullit ka konstatuar se ankueses nuk i është ofruar trajtimi adekuat stomatologjik në QKSUK, duke ia shkelur të drejtën për kujdes dhe mbrojtje të barabartë shëndetësore të garantuar me nenin 51 të Kushtetutës së Kosovës. Mosofrimi i trajtimit sipas nevojave dhe karakteristikave të veçanta të saj është vlerësuar si diskriminim mbi bazën e gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe me nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Raporti thekson se rasti i ankueses shpërfaq edhe një problem më të gjerë sistematik, pasi persona të tjerë me aftësi të kufizuar apo me veçori specifike shëndetësore mund të gjenden në situata të ngjashme, ku për shkak të vështirësive në ekzaminim dhe mungesës së vlerësimit paraprak adekuat, ata referohen vetëm për ndërhyrje të kufizuara stomatologjike, si nxjerrja e dhëmbëve me anestezion të përgjithshëm, pa u shqyrtuar alternativa të tjera trajtimi.

<sup>81</sup> <https://oik-rks.org/2025/01/13/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-649-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shteterore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi-dhe-me-legjislacionin-ne-fuqi-p/>

Po ashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se personeli shëndetësor në QKSUK nuk ka njohuri dhe qartësi të mjaftueshme lidhur me trajtimin e personave me aftësi të kufizuar dhe me veçori specifike shëndetësore, gjë që ka çuar në moszbatimin e Udhërrëfyesit Klinik nr. 28 për Përdorimin e Sedacionit Inhalator me Azot Oksidul (N<sub>2</sub>O/O<sub>2</sub>) në Praktikën Stomatologjike. Të gjitha këto kanë shtyrë që ankuesja të kërkojë trajtim stomatologjik jashtë vendit, me shpenzime të veta.

Në përfundim, Avokati i Popullit ka rekomanduar që Ministria e Shëndetësisë të nxjerrë udhëzime të posaçme për institucionet shëndetësore publike për përshtatjen e procedurave diagnostikuese dhe trajtuese sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuar dhe të krijojë mekanizma për kompensimin e shpenzimeve për trajtime stomatologjike që nuk ofrohen në vend; Inspektorati Shëndetësor të monitorojë zbatimin e standardeve ligjore dhe profesionale; ndërsa QKSUK-ja të zbatojë në mënyrë të plotë Udhërrëfyesin Klinik nr. 28 në rastet e diagnostikimit dhe trajtimit të këtyre kategorive të pacientëve.

#### *Reduktimi i tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personave të verbër*

Më 11 prill 2025, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime lidhur me të drejtën për reduktimin e tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe për personat e verbër.<sup>82</sup>

Avokati i Popullit ka gjetur se *Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm të energjisë elektrike*, i miratuar nga Qeveria në shtator të vitit 2023, përcakton subvencionim për faturat e energjisë elektrike për konsumatorët e cenueshëm, të ardhurat mesatare mujore të të cilëve janë nën 150 euro për anëtar të familjes. Ndërsa, Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (neni 14) përcakton se përfituesit nga ky ligj gëzojnë reduktim të tarifave të konsumit të energjisë elektrike, dhe Ligji Nr.04/L-092 për Personat e Verbër (neni 14, paragrafi 1) përcakton se të gjithë personat e verbër gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike. Avokati i Popullit vlerëson se me miratimin e këtij programi anashkalohet

zbatimi i këtyre dispozitave ligjore, për faktin se personat paraplegjikë, tetraplegjikë dhe personat e verbër nuk përfitojnë nga këto ligje që specifikisht rregullojnë të drejtat dhe përfitimet e këtyre personave për shkak të kushteve të vendosura mbi bazën e të ardhurave familjare. Avokati i Popullit ka vlerësuar se këto të drejta duhet të realizohen bazuar në statusin ligjor të përfituesve dhe jo në të ardhurat e familjes.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit lidhur me këtë rast i janë dërguar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve duke i rekomanduar nxjerrjen e një udhëzimi administrativ për kriteret për reduktim në tarifa të konsumit të energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, si dhe nxjerrjen e një udhëzimi administrativ për kriteret për reduktim në tarifa të konsumit të energjisë elektrike për personat e verbër, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr.04/L-092 për Personat e Verbër.

#### **E drejta e votës për personat që pjesërisht u është hequr zotësia e veprimit**

Më 12 dhjetor 2025, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime lidhur me një rast të mohimit të së drejtës për të votuar për një qytetare me Sindromën Down, së cilës, me vendim gjyqësor, pjesërisht i është hequr zotësia e veprimit dhe është vendosur nën kujdestari. Rrjedhimisht, ky Raport ka trajtuar të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset politike, përkatësisht të drejtën e votës së qytetarëve të cilëve, me vendim gjyqësor, u është hequr pjesërisht zotësia për të vepruar dhe që janë vendosur nën kujdestari.<sup>83</sup> Avokati i Popullit ka vlerësuar se heqja e zotësisë së veprimit dhe vendosja e personave nën kujdestari nuk ka nënkuptuar automatikisht edhe heqje të së drejtës për të votuar, nëse vendimi gjyqësor me të cilin është hequr zotësia e veprimit këtë nuk e ka përcaktuar shprehimisht.

Në këtë raport është konstatuar se privimi në mënyrë automatike nga e drejta për të votuar i personave të cilëve u është hequr zotësia e veprimit dhe janë nën kujdestari, pa i pasur parasysh rrethanat individuale të secilit person, nuk ka justifikuar kufizimin e së drejtës zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

82 <https://oik-rks.org/2025/04/14/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-94-2024-lidhur-me-mohimin-e-te-drejtës-ne-reduktimin-e-tarifave-te-energjisë-elektrike-per-personat-paraplegjik-tetraplegjik-dhe-personat-e-verbër/>

83 <https://oik-rks.org/2025/12/15/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-226-2025-lidhur-me-mohimin-e-te-drejtës-se-votës/>

Për këto arsye, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që të ndryshojë Rregulloren Zgjedhore nr. 03/2024, në mënyrë që e drejta e votës të mos kufizohet, përveç rasteve kur ajo është hequr shprehimisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit është vënë në dijeni se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka nxjerrë për diskutim publik Draft-Rregulloren për regjistrin e personave të cilëve u hiqet zotësia e veprimit, regjistrin e personave të cilëve u hiqet e drejta prindërore, si dhe regjistrin e adoptimit. Avokati i Popullit e konsideron këtë dokument të rëndësishëm, meqenëse neni 5 i kësaj rregulloreje përcakton përmbajtjen e regjistrit të personave të cilëve u është hequr zotësia e veprimit, duke i klasifikuar ata në dy kategori: personat të cilëve u është hequr zotësia e veprimit plotësisht dhe ata të cilëve u është hequr pjesërisht. Kjo ndarje do t'i mundësonte KQZ-së përdorimin e saktë të këtyre të dhënave gjatë përpilimit të listave të votuesve.

Nga hetimi i këtij rasti, Avokati i Popullit ka konstatuar se një ndarje e tillë nuk ka ekzistuar deri më tani. Kjo është vërtetuar edhe nga përgjigjja që kemi pranuar nga KGJK-ja, në të cilën është theksuar se, sipas nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjykata kompetente ka qenë e obliguar t'ia dorëzojë KQZ-së të dhënat për personat të cilëve u është hequr zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna janë dorëzuar në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga KQZ-ja.

Në këtë kuadër, KGJK-ja ka sqaruar se të dhënat që i janë përcjellë KQZ-së kanë përfshirë vetëm informacionin se personit i është hequr zotësia e veprimit, si dhe numrin e vendimit përkatës dhe disa të dhëna të përgjithshme procedurale. Secila gjykatë i ka proceduar këto të dhëna në bazë të evidencave të saj, ndërsa KGJK-ja i ka përcjellë ato në KQZ pa shtuar apo ndryshuar përmbajtjen e tyre. Sipas KGJK-së, duke u bazuar në dispozitat e nenit 8 të ligjit në fjalë dhe në kërkesat e KQZ-së, informacioni i kërkuar është kufizuar vetëm në konstatimin nëse personit i është hequr zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, të dhënat e ofruara nuk kanë përfshirë detaje lidhur me të drejtat specifike që i janë hequr personit, as përmbajtjen e plotë apo të detajuar të vendimit gjyqësor.

Megjithatë, Avokati i Popullit është vënë në dijeni se ankuesja, pavarësisht faktit se ndaj saj është marrë vendim për heqjen e zotësisë së veprimit, ka ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet e fundit të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

### **Mungesa e ofrimit të arsimit cilësor për personat e shurdhër**

Avokati i Popullit, duke u bazuar në informatat e pranuar nga Forumi i Shoqërisë Civile, ka hapur për hetim çështjen e arsimit për personat e shurdhër. Sipas informatave të pranuar, thuhet se personat e shurdhër që përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë nuk zotërojnë shkathtësi bazike të shkrim-leximit, megjithëse diplomat e tyre rezultojnë me nota të larta.

Avokati i Popullit ka nisur hetimet për të vlerësuar nëse mungesa e arsimit cilësor për personat e shurdhër përbën diskriminim, nëse MASHTI ka vendosur kurrikula dhe masa të përshtatshme për përgatitjen arsimore të këtyre personave dhe për aftësimin e tyre për tregun e punës në Kosovë, si dhe nëse stafi arsimor është i kualifikuar për t'u përgjigjur nevojave të tyre specifike në procesin mësimor.

Deri më tani është konstatuar se ekziston mungesë e kapaciteteve profesionale (defektologë, logopedë, punëtorë socialë etj.), si dhe mungesë në ndjekjen e kurseve të gjuhës së shenjave nga mësimdhënësit. Sipas informatave, shumica prej tyre kanë vetëm nivelin A1, ndërsa shumë pak mësimdhënës kanë ndjekur nivelin C.

Gjetjet nga ky hetim, Avokati i Popullit do t'i publikojë dhe do t'ua adresojë autoriteteve përkatëse gjatë vitit 2026.

## Diskriminimi mbi bazën e moshës

Avokati i Popullit ka vazhduar të trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin mbi bazën e moshës. Nga gjetjet e Avokatit të Popullit rezulton se diskriminimi mbi bazën e moshës shpesh ndërlihet edhe me baza të tjera të mbrojtura, gjë që rezulton me diskriminim të shumëfishtë, sepse, përveç diskriminimit për shkak të moshës, diskriminimi ndodh edhe mbi ndonjërin nga bazat e tjera të mbrojtura me nenin 1 të LMD-së

## Diskriminimi mbi bazën e moshës në konkursin e shpallur nga Dogana e Kosovës

Më 6 maj 2025, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime lidhur me bazën ligjore për përcaktimin e kriterit të moshës për aplikim në konkurs në Doganën e Kosovës. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Doganës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me caktimin e kriterit të moshës për pozitën specifike në Doganën e Kosovës dhe nëse këto kriterie bazohen në Kodin nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave.<sup>84</sup>

Konkursi për pozitën e oficerit doganor është shpallur në një kohë kur as ligji i vjetër dhe as ligji i ri doganor nuk parashihnin kufizime moshe për punësim në Doganën e Kosovës. Kriteri kontestues i konkursit për oficer doganor ishte që kandidatët të jenë nën 30 vjeç. Vendosja e një kriteri të tillë nuk mbështetet në legjislacionin primar dhe as në një akt nënligjor të vlefshëm, të publikuar dhe të qasshëm për publikun. Akti administrativ në të cilin Dogana mbështet këtë kriter rezulton i paqartë për sa i përket statusit juridik dhe nuk garanton siguri juridike.

Kufizimi i qasjes në punësim mbi bazën e moshës përbën ndërhyrje në të drejtën për trajtim të barabartë dhe mund të justifikohet vetëm nëse ekziston një qëllim legjitim dhe proporcional, i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punës. Në këtë rast, arsyetimet e ofruara nga Dogana, si ulja e moshës mesatare të stafit apo supozime të përgjithshme për aftësitë e kandidatëve mbi 30 vjeç, nuk i përmbushin këto kriterie dhe mbështeten në paragjykime, jo në analiza objektive.

Standardet kushtetuese, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe praktika evropiane tregojnë se dallimet në trajtim mbi bazë të moshës lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme

dhe të arsyetuara mirë. Në mungesë të një baze ligjore të qartë, të një qëllimi legjitim dhe të proporcionalitetit, kriteri i moshës në këtë konkurs përbën diskriminim të drejtpërdrejtë.

Si rrjedhojë, Avokati i Popullit vlerëson se Dogana e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit dhe të barazisë para ligjit, ndërkaq i ka rekomanduar heqjen e kriterit të moshës nga aktet përkatëse, si dhe publikimin e rregullt të tyre.

Më 12 qershor 2025, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga Dogana e Kosovës, nëpërmjet së cilës është njoftuar se janë në proces të hartimit të një udhëzimi të ri administrativ, bazuar në Kodin e ri Doganor, duke përfshirë harmonizimin me standardet më të larta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe, në të njëjtën kohë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e Avokatit të Popullit.

## Diskriminimi në punë

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash që lidhen me pretendime për diskriminim në marrëdhëniet e punës. Këto ankesa kanë përfshirë trajtim të pabarabartë në punësim, kushte pune, avancim profesional dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës, duke evidentuar nevojën për masa më efektive institucionale për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit në punë.

## *Mendimi amicus curiae lidhur me transferimin e vendit të punës në KOSTT*

Më 25 nëntor 2025, Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë me mendim juridik lidhur me rastin e një ankueseje, punonjëse e KOSTT-it, lidhur me vendimin për ulje në pozitë. Avokati i Popullit, pas hetimit të ankesës, ka vlerësuar se vendimi i KOSTT-it për transferimin e ankuses në një pozitë më të ulët pune përbën degradim të paligjshëm. Ky vendim nuk është mbështetur në ndonjë procedurë disiplinore, nuk është shoqëruar me arsyetim ligjor të paraparë për masa ndëshkuese dhe nuk buron nga ndonjë detyrim i drejtpërdrejtë i aktgjykimit gjyqësor në të cilin KOSTT-i është mbështetur, madje duke kërkuar edhe opinion ligjor të jashtëm, përkundër faktit se Zyra Ligjore e KOSTT-it ka këshilluar që aktgjykimi nuk mund të zbatohet në rastin e ankuses.

84 <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-231-2024-r-nr-234-2024-dhe-r-nr-244-2024-lidhur-me-bazen-ligjore-per-percaktimin-e-kriterit-te-moshes-per-aplikim-ne-konkurs-ne-doganen-e-kosoves/>

Avokati i Popullit vëren se aktgjykimi i Gjykatës Themelore, mbi të cilin KOSTT-i e ka bazuar veprimet e tij, nuk ka trajtuar në themel marrëdhënien e punës së ankueses dhe as nuk ka urdhëruar uljen e saj në pozitë. Rikthimi në fuqi i vendimeve administrative të mëhershme, të cilat kishin qenë të anuluar dhe të përfunduara, cenon parimin e sigurisë juridike dhe krijon pasiguri në marrëdhëniet e punës.

Po ashtu, mosshqyrtimi i ankesave të ankueses dhe trajtimi i pabarabartë i saj, krahasuar me një punonjës tjetër, për të cilin janë ndërmarrë veprime të posaçme dhe janë kërkuar opinione ligjore të jashtme, paraqet shkelje të së drejtës për mjete juridike dhe krijon dyshim të bazuar për trajtim diskriminues. Për këto arsye, Avokati i Popullit konsideron se veprimet e KOSTT-it janë në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit dhe të trajtimit të barabartë në marrëdhëniet e punës.

*Opinion amicus curiae lidhur me anulimin e konkursit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë*

Më 26 nëntor 2025, Avokati i Popullit ka paraqitur një mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me një rast të mosdhënies së kontratës së punës dhe anulimit të një konkursi publik për pozitën e drejtorit të përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Në bazë të kompetencave ligjore, Avokati i Popullit pranoi një ankesë lidhur me moslidhjen e kontratës së punës për pozitën e drejtorit të përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore, pavarësisht se ankuesja ishte shpallur kandidat e suksesshme pas përfundimit të procedurave të rregullta të rekrutimit. Fillimi i marrëdhënies së punës ishte pezulluar nga Ministria e Drejtësisë për shkak të një procedure disiplinore dhe më pas për shkak të fillimit të një procesi hetimor penal ndaj ankueses.

Nga shqyrtimi i rastit rezulton se procedura disiplinore ndaj ankueses kishte përfunduar me vendim përfundimtar pa konstatuar shkelje, ndërsa edhe kallëzimi penal ishte hedhur poshtë nga prokuroria. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë nuk kishte zbatuar vendimin për përzgjedhjen e ankueses dhe më vonë kishte anuluar konkursin për pozitën përkatëse, pa dhënë arsytim ligjor. Ankuesja ka paraqitur

padi për anulimin e njoftimit për anulimin e konkursit dhe për realizimin e së drejtës së saj për emërim.

Gjatë hetimit të ankesës nga Avokati i Popullit u ngritën gjithashtu shqetësime lidhur me mungesën e komunikimit institucional, përkatësisht faktin se Prokuroria nuk e ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë për epilogun e kallëzimit penal të paraqitur nga kjo ministri, duke kontribuar kështu në zvarritjen e kësaj çështjeje.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se gjykata, gjatë vendosjes në këtë çështje, duhet ta ketë parasysh parimin e ligjshmërisë, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për trajtim të drejtë dhe të paanshëm. Vendimet për mosdhënien e kontratës dhe për anulimin e konkursit duhet të shqyrtohen në dritën e faktit se ndaj ankueses nuk ka pasur shkelje disiplinore dhe se procedura penale ka përfunduar pa pasoja juridike për të.

*Opinion për Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me të drejtat e të punësuarve tek operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime për institucionet publike*

Më 5 dhjetor 2025, Avokati i Popullit ka publikuar një Opinion lidhur me të drejtat e punëtorëve të punësuar tek operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime për institucionet publike.<sup>85</sup> Avokati i Popullit, në bazë të kompetencave ligjore, hapi rast sipas detyrës zyrtare lidhur me dyshimet për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me Ligjin e Punës ndaj punëtorëve të angazhuara në shërbime të mirëmbajtjes dhe pastrimit në institucione publike. Rasti u hap pas njoftimeve të punëtorëve që kishin hyrë në grevë, të cilat ngritën shqetësime për paga të ulëta, mospagim të punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave, pamundësi për shfrytëzim të pushimit mjekësor, si dhe mospagim të kontributeve pensionale.

Gjatë hetimit, Avokati i Popullit zhvilloi takime me punëtorët për t'i dëgjuar drejtpërdrejt shqetësimet e tyre dhe kërkoi informacione nga autoritetet përkatëse lidhur me veprimet e ndërmarra ndaj operatorëve ekonomikë të kontraktuar. Nga të dhënat e siguruara rezultoi se Inspektorati i Punës kishte kryer inspektime dhe kishte konstatuar shkelje të dispozitave të

85 [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/12/KPD-1866-2025-OPINION-I-AVOKATIT-TE-POPULLIT-ne-lidhje-me-te-drejtat-e-te-punesuarve-tek-Operatoret-Ekonomike-qe-ofrojne-sherbime-per-institucionet-publike-1\\_compressed.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/12/KPD-1866-2025-OPINION-I-AVOKATIT-TE-POPULLIT-ne-lidhje-me-te-drejtat-e-te-punesuarve-tek-Operatoret-Ekonomike-qe-ofrojne-sherbime-per-institucionet-publike-1_compressed.pdf)

Ligjit të Punës, për të cilat ishin shqiptuar masa ndëshkimore dhe ishin iniciuar procedura kundërvajtëse ndaj operatorit ekonomik.

Avokati i Popullit konstatoi se punëtorët kishin qenë në marrëdhënie pune për më shumë se dhjetë (10) vjet, duke kryer të njëjtat detyra edhe pas ndërrimit të punëdhënësve përmes kontratave të prokurimit publik. Në këtë kontekst, kontratat e tyre konsiderohen kontrata me afat të pacaktuar, ndërsa mosvazhdimi i tyre përbën ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës, veçanërisht pasi ndërprerja ndodhi pas ushtrimit të së drejtës për grevë.

Në vlerësimin e tij, Avokati i Popullit theksoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të pjesëmarrjes në grevë bie ndesh me Ligjin për Grevat dhe përbën shkelje të drejtpërdrejtë të së drejtës së punës dhe të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e punëtorëve. Po ashtu, u vlerësua se autoritetet publike kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për respektimin e të drejtave të punëtorëve nga operatorët ekonomikë që kontraktojnë, përfshirë detyrimin për të mos e vazhduar bashkëpunimin me subjekte që janë verifikuar si shkelës të legjislacionit të punës.

Avokati i Popullit ngriti gjithashtu shqetësime lidhur me aspektin gjinor, duke vënë në pah se punëtorët e prekura ishin gra, çka tregon rrezikun e diskriminimit strukturor dhe nevojën për përfshirjen e kriterëve të barazisë gjinore në procedurat e prokurimit publik. Në përfundim, u theksua domosdoshmëria që autoritetet publike t'i forcojnë mekanizmat e mbikëqyrjes, të përfshijnë kriterë të detyrueshme për respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe t'i parandalojnë praktikën që dëmtojnë interesin publik dhe parimet e shtetit të së drejtës.

*Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi*

Më 30 shtator 2024, Avokati i Popullit pranoi një ankesë kundër Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime në lëndën Anatomia, në Fakultetin e Mjekësisë, për vitin akademik 2024/25.<sup>86</sup> Ankuesi pretendonte se të drejtat e tij për ushtrim të profesionit ishin cenuar, se procedura ishte jotransparente dhe se

ishite trajtuar në mënyrë të pabarabartë. Ai ishte shpallur fillimisht i suksesshëm, por më pas Komisioni i Ankesave e riktheu rastin për rishqyrtim, duke argumentuar se kishte shkelje të rregullores dhe Statutit të Universitetit, me pretendimin se ekzistonte konflikt interesi për shkak të lidhjes familjare të ankuesit, nëna e të cilit punon në fakultet. Ankuesi theksoi se nëna punon në një departament tjetër dhe nuk ka pasur rol në procesin e përzgjedhjes, duke argumentuar se nuk ekzistonte konflikt real.

Avokati i Popullit analizoi rastin në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve për mbrojtjen nga diskriminimi, duke vërejtur se garancia e barazisë para ligjit dhe e qasjes së barabartë në punësim nuk lejon trajtim preferencial ose penalizues për lidhje familjare pa konflikt të vërtetuar. Ai theksoi se Universiteti duhet të sigurojë transparencë të plotë dhe mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët në konkurset publike, duke shmangur interpretime të gabuara të rregulloreve që çojnë në diskriminim.

Në përfundim, Avokati i Popullit konstatoi se eliminimi i ankuesit për shkak të lidhjes familjare në një departament tjetër ishte i pabazuar dhe përbente trajtim të pabarabartë dhe diskriminues. Universiteti është i detyruar të respektojë ligjet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të sigurojë që të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të barabartë, në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjore.

Avokati i Popullit është vënë në dijeni se edhe Gjykata Supreme, më 10 dhjetor 2025, ka nxjerrë Aktgjykimin P.A.nr.29/2025, lidhur me një rast të ngjashëm, me ç'rast ka shpallur të paligjshëm dhe ka shfuqizuar nenin 153, paragrafët 3 dhe 4, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores nr. 2/54 për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin e Prishtinës.

Gjykata konstatoi se këto dispozita vendosnin ndalesa absolute pa vlerësim konkret të konfliktit të interesit, duke shkelur parimet kushtetuese të barazisë, meritokracisë dhe ndalimit të diskriminimit. Ajo vlerësoi se masat ishin joproporcionale dhe në kundërshtim me ligjet për arsimin e lartë dhe parandalimin e konfliktit të interesit, pasi përjashtonin kandidatët vetëm për shkak të lidhjeve familjare.

86 Linku i dokumentit

Gjykata theksoi se lidhja familjare nuk përbën automatikisht nepotizëm dhe se dispozitat e kontestuara cenonin të drejtën për konkurrim të barabartë dhe ushtrim të funksioneve akademike sipas meritës.

*Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet ligjore përkatëse, sipas ankesës së B. Z. kundër Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe Inspektoriatit Policor*

Avokati i Popullit ka publikuar Opinionin R.176/2024<sup>87</sup> pas shqyrtimit të ankesës së një zyrtari policor, i cili ka pretenduar shkelje të së drejtës për ushtrimin e profesionit në mënyrë të pavarur, të drejtë dhe pa pengesa nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe Inspektoriatit Policor të Kosovës (IPK). Ankuesi ka pohuar se, që nga viti 2016, ndaj tij janë ndërmarrë veprime të padrejta përmes inicimit të hetimeve dhe ngritjes së aktakuzave, të cilat kanë përfunduar me lirimin e tij nga ndjekja penale.

Sipas ankuesit, këto veprime lidhen me ngjarjen e 12 dhjetorit 2023, kur ai, si mbikëqyrës i patrullave policore, urdhëroi vendosjen e një pike kontrolli në Gjilan, ku u ndalua një automjet i drejtuar nga një prokuror për shkelje në trafik. Pas shqiptimit të gjobës, prokurori reagoi në mënyrë arrogante dhe paralajmëroi ankesë ndaj zyrtarëve policorë. Ankuesi kërkoi nisjen e procedurës disiplinore ndaj prokurorit, e cila u refuzua pa u njoftuar zyrtarisht. Në anën tjetër, u paraqit kallëzim penal ndaj zyrtarëve policorë dhe vetë ankuesit, si dhe IPK-ja rekomandoi transferimin e përkohshëm të ankuesit në Stacionin Policor (SP) në Prishtinë.

Avokati i Popullit ka konstatuar se veprimet e Prokurorisë dhe të IPK-së përbëjnë cenim të parimit të ligjshmërisë, mosrespektim të procedurave të parapara, dështim të mekanizmave për vlerësim etik dhe shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, duke theksuar se këto veprime kanë ndikuar drejtpërdrejt në ushtrimin e profesionit të ankuesit dhe në besimin e qytetarëve në funksionimin e drejtë të institucioneve publike.

## Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike

Avokati i Popullit vlerëson se, pavarësisht arritjeve të shënuara ndër vite, komunitetet joshumicë në Kosovë vazhdojnë të përballen me forma të ndryshme të diskriminimit në shërbime publike, punësim, arsim dhe përfaqësim institucional. Kjo situatë dëshmon se nevojiten përpjekje të vazhdueshme dhe masa më efektive për të garantuar barazi të plotë dhe mbrojtje të të drejtave të tyre.

*Raporti me Rekomandime lidhur me dështimin e institucioneve publike për përbushje të kuotës për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.*

Më 4 mars 2025, Avokati i Popullit publikoi Raportin me Rekomandime drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me shkeljet e parimeve të miradministrimit në procedurat e rekrutimit dhe dështimin e institucioneve publike për të përbushur kuotën ligjore për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.<sup>88</sup>

Për sa u përket shkeljeve të parimeve të miradministrimit lidhur me zhvillimin e një procedure rekrutimi nga KQZ-ja për pozita jopermanente, të shpallura në kuadër të organizimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ankesa kishte të bënte me mosnjoftimin e kandidatit për rezultatin e aplikimit, pavarësisht se ai kishte marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe ishte ftuar në intervistë. Ankuesi pretendonte se ishte diskriminuar për shkak të përkatësisë së tij etnike nga radhët e komuniteteve joshumicë. Nga veprimet hetimore rezultoi se KQZ-ja nuk kishte njoftuar zyrtarisht asnjë nga kandidatët e pasuksesshëm për rezultatin e konkursit, duke u arsyetuar me natyrën urgjente të procesit zgjedhor dhe numrin e madh të aplikuesve. Kjo praktikë ishte ndjekur në mënyrë të përgjithshme dhe jo vetëm ndaj ankuesit.

Megjithatë, Avokati i Popullit vlerëson se mosnjoftimi i kandidatëve për rezultatin e aplikimit përbën keqadministrim dhe cenon parimet e transparencës, të administratës së hapur dhe të informimit të palëve në procedurat

87 <https://oik-rks.org/2025/11/04/opinion-i-avokatit-te-popullit-r-nr-176-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shteterore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-ligjore-perkatese/>

88 <https://oik-rks.org/2025/03/05/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-702-2022-lidhur-me-shkeljet-e-parimeve-te-miradministrimit-me-rastin-e-shpalljes-se-konkurseve-dhe-deshmitit-te-institucioneve-publike-ne-permbushjen-e-kuotes-per/>

administrative. Kjo praktikë ka pamundësuar ushtrimin e mjeteve të brendshme ankimore dhe ka krijuar pasiguri juridike për kandidatët pjesëmarrës në procedurë.

Në këtë kontekst, është konstatuar se KQZ-ja ka vepruar në kundërshtim me parimet e miradministrimit dhe me rregullat e veta të brendshme, të cilat kërkojnë që të njoftohen individualisht kandidatët gjatë fazave të vlerësimit dhe në përmbyllje të konkursit. Megjithatë nuk është konstatuar trajtim i pabarabartë apo diskriminim individual, praktika e ndjekur në tërësi është vlerësuar si e papranueshme nga këndvështrimi i miradministrimit.

Për sa i përket mosrealizimit të kuotës së përfaqësimit etnik në institucionet publike, Avokati i Popullit ka zgjeruar shqyrtimin edhe në aspektin e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në institucionet publike në nivel qendror. Në këtë kuadër janë kërkuar informata zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e kuotës së përfaqësimit etnik dhe me të dhënat statistikore mbi përbërjen e shërbimit civil.

Nga përgjigjja që kemi pranuar rezulton se kuota e përfaqësimit prej 10% për komunitetet joshumicë trajtohet si objektiv i përgjithshëm në nivel të administratës qendrore dhe jo domosdoshmërisht si obligim individual për secilin institucion veç e veç. Gjithashtu, është theksuar se institucionet publike kanë mundësi të ndërmarrin masa afirmative, përfshirë shpalljen e konkurseve të veçanta për komunitetet e nënpërfaqësuar.

Të dhënat statistikore të ofruara, të cilat i referohen vitit 2022, tregojnë një përfaqësim të ulët të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil dhe mungesë të plotë të të dhënave për disa komunitete, si romët, ashkalinjtë, egjiptianët, kroatët dhe malazezët. Këto mangësi tregojnë se nuk ekziston një sistem i përditësuar dhe gjithëpërfshirës i monitorimit të përfaqësimit etnik në institucionet publike.

Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e të dhënave të sakta, të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse e vështirëson vlerësimin real të gjendjes së përfaqësimit të komuniteteve joshumicë dhe tregon rrezik për mosrealizimin efektiv të obligimeve kushtetuese dhe ligjore në këtë fushë. Për këtë arsye, është theksuar

nevoja për masa konkrete institucionale, monitorim të vazhdueshëm dhe përdorim aktiv të mekanizmave afirmativë për të arritur përfaqësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës në sektorin publik.

## Diskriminimi në bazë të gjuhës

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e të drejtës për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, e garantuar me Kushtetutë dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, sipas të cilit gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare të barabarta. Kjo e drejtë përfshin përdorimin e gjuhës në jetën publike, para institucioneve shtetërore, në arsim, administratë dhe në sektorë me interes publik.

Më 26 nëntor 2025, Avokati i Popullit ka publikuar një Raport ex officio lidhur me mosrespektimin e të drejtave gjuhësore nga bankat komerciale në Kosovë.<sup>89</sup> Raporti evidenton mungesën e dokumentacionit dhe shërbimeve në gjuhën serbe, si dhe mungesën e stafit që e flet këtë gjuhë, duke krijuar pengesa për klientët serbishtfolës dhe duke i ekspozuar ata ndaj trajtimit të pabarabartë.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se këto praktika përbëjnë diskriminim, pasi bankat, si ofrues shërbimesh me interes publik, janë të obliguara të respektojnë barazinë gjuhësore. Si përfundim, është rekomanduar që Banka Qendrore e Kosovës të vendosë dhe monitorojë udhëzime të qarta për ofrimin e shërbimeve bankare në të dyja gjuhët zyrtare, në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.

Më 31 dhjetor 2025, BQK-ja u përgjigj në rekomandimet e Avokatit të Popullit, duke konfirmuar se, në përputhje me mandatin e saj ligjor, përmes rolit të saj si rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar, do të kontribuojë në mënyrë konstruktive në përmirësimin e situatës në këtë sektor. Në këtë kuptim, do t'u lëshohet bankave komerciale një letër këshilluese, në të cilën do të paraqiten gjetjet e raportit të Avokatit të Popullit dhe do të kërkohet respektimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë, me qëllim promovimin e praktikave të mira dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

89 <https://oik-rks.org/2026/01/15/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-152-2023-ne-lidhje-me-perdorimin-e-gjuheve-zyrtare-ne-bankat-komerciale-ne-kosove/>

## Pezullimi të pagesës së shtesës për fëmijë

Avokati i Popullit, në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore dhe duke marrë parasysh një numër të madh ankesash të pranuar nga qytetarët që kryesisht i përkasin komunitetit serb, kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), për shkak të pezullimit të pagesës së shtesës për fëmijë, filloi një hetim ex officio.<sup>90</sup>

Më 9 shtator 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Vendimin nr. 55 për zbatimin e Masës 3.5, që parasheh subvencionimin e familjeve me fëmijë nga mosha 0 deri në 16 vjeç, duke përcaktuar qartë procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, pa paraparë proces verifikimi shtesë. Ankuesit kanë përfituar nga shtesat për fëmijë nga shtatori 2021 deri në dhjetor 2024. Gjatë periudhës gusht–dhjetor 2024, Departamenti i Skemave Sociale (DSS) i MFPT-së ka kërkuar dokumentacion shtesë për verifikim dhe njëkohësisht ka pezulluar pagesat, pa nxjerrë vendime individuale apo pa dhënë sqarime të qarta.

Pavarësisht se ankuesit vepruan sipas udhëzimeve dhe dorëzuan dokumentacionin e kërkuar, pagesat mbetën të pezulluara. Disa ankues u njoftuan se dokumentacioni i dorëzuar nuk ishte i vlefshëm, pa u specifikuar arsyt, dhe u obliguan të paraqiteshin fizikisht në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në Prishtinë për verifikimin e vendbanimit me praninë e të gjithë anëtarëve të familjes. Kjo kërkesë ka krijuar vështirësi të konsiderueshme për familjet, veçanërisht për shkak të distancës dhe kushteve financiare.

Në kuadër të hetimit, Avokati i Popullit zhvilloi takim me përfaqësuesit e DSS-së, të cilët konfirmuan se procesi i verifikimit kishte filluar në shtator 2024 dhe se pezullimi i pagesave ishte i përkohshëm, por shoqërohej me vonesa për shkak të mungesës së stafit. Është pranuar se dokumentet e lëshuara nga institucionet arsimore dhe shëndetësore që nuk funksionojnë në kuadër të sistemeve zyrtare të Republikës së Kosovës nuk njihen, çka ka ndikuar kryesisht te përfituesit nga komunitetet joshumicë, veçanërisht komuniteti serb.

Avokati i Popullit ka konstatuar se ndryshimet e Vendimit nr. 55 të datës 31 tetor 2024, me të cilat është paraparë procesi i verifikimit, nuk janë publikuar zyrtarisht dhe nuk përcaktojnë qartë

dokumentacionin dhe procedurat përkatëse. Për më tepër, nuk është ofruar bazë ligjore për përfshirjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në këtë proces dhe as kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të dërguar për verifikim.

Si rezultat, Avokati i Popullit ka vlerësuar se veprimet e MFPT-së dhe DSS-së cenojnë parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe ndalimit të arbitraritetit, si dhe kanë prodhuar efekte diskriminuese ndaj fëmijëve të komuniteteve joshumicë, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Kërkesa për paraqitje fizike në Prishtinë përbën barrë joproporcionale dhe nuk merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Avokati i Popullit ka rekomanduar publikimin e menjëhershëm dhe transparent të të gjitha akteve dhe udhëzimeve për verifikim, sigurimin e procedurave të qarta dhe të qasshme për qytetarët, nxjerrjen e vendimeve individuale të arsyetuara dhe realizimin e pagesave retroaktive për të gjithë përfituesit, përfshirë periudhën e pezullimit dhe përfitimet shtesë të parapara.

## Barazia Gjinore

Kushtetuta përcakton: *“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”* Ndërsa Ligji për Barazi Gjinore e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë, me kompetencë për trajtimin e rasteve që lidhen me diskriminimin në baza gjinore.

### Barazia gjinore në të drejtën në punë

Avokati i Popullit rikujton se gjatë vitit të kaluar ka publikuar Raportin Ex officio nr. 535/2019, lidhur me zbatimin e masave të veçanta të parapara me nenin 6 (Masat e veçanta) të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, nga organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe nga institucionet e tjera publike në Republikën e Kosovës.

Ky raport ka evidentuar përfaqësim të

90 <https://oik-rks.org/2025/05/29/leter-rekomandim-ex-officio-nr-68-2025/>

pabarabartë gjinor në tri nivele kryesore të hierarkisë institucionale: niveli i lartë drejtues, niveli i mesëm drejtues dhe stafi mbështetës. Për një vlerësim të ri të përfaqësimit gjinor dhe për matjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ky raport, do të ishte i nevojshëm një hetim i ri, duke u bazuar në të njëjtën metodologji.

Deri në realizimin e një hetimi të tillë, dhe duke marrë parasysh se në një periudhë më të shkurtër se dy vjet nuk mund të priten ndryshime thelbësore, Avokati i Popullit mban qëndrimin se gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në institucionet publike.

Diskriminimi gjinor në vendin e punës shfaqet në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe ngacmimin seksual. Aktualisht, Avokati i Popullit është duke trajtuar një rast me pretendime për ngacmim seksual në vendin e punës. Edhe pse ngacmimi seksual përbën vepër penale, roli i Avokatit të Popullit konsiston në vlerësimin nëse punëdhënësi ka miratuar dhe zbatuar kode dhe procedura të qasshme për parandalimin dhe adresimin e ngacmimit seksual në vendin e punës.

## Barazia gjinore në të drejtën në pronë dhe trashëgimi

Bazuar në të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të reflektuara në Raportin Vjetor për vitin 2024, rezulton se nga gjithsej 628,764 prona të regjistruara, 20.23% janë regjistruar në emër të femrave. Kjo përbën një rritje krahasuar me vitin paraprak, kur kjo përqindje ishte 19.79%.

Megjithëse vërehet një trend i vazhdueshëm i rritjes së regjistrimit të pronave në emër të femrave, ky trend mbetet i ngadalshëm. Avokati i Popullit thekson se e drejta në pronë dhe trashëgimi është e garantuar me Kushtetutë dhe legjislacionin përkatës. Megjithatë, realizimi i plotë i saj kërkon ndryshim të mendësisë shoqërore, veçanërisht kur bëhet fjalë për barazinë në trashëgimi dhe pronë, që fillon brenda familjes.

Sfidat kryesore që pengojnë gëzimin e plotë të të drejtave pronësore nga gratë përfshijnë: ndikimin e së drejtës zakonore, normat kulturore diskriminuese, informalitetin, mungesën e informimit për të drejtat në trashëgimi,

mosnjoftimin e të gjithë trashëgimtarëve për procedurat e trashëgimisë, heqjen dorë nga prona për t'i ruajtur marrëdhëniet familjare, si dhe zvarritjet e procedurave gjyqësore lidhur me çështjet pronësore.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar një kërkesë për këshilla juridike nga një ankuese lidhur me ndarjen e trashëgimisë së bashkëshortit të saj të ndjerë, e cila shërben si rast ilustrues dhe nuk është i vetmi i këtij lloji.

Sipas ankueses, bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë gjatë vitit të kaluar, pas së cilës ajo dhe fëmijët e saj u larguan nga familja ku kishin jetuar në bashkësi me vëllezërit e bashkëshortit të ndjerë. Për pasojë, ankuesja kërkoi strehim nga Komuna e Gjakovës, e cila i subvencionoi shpenzimet e strehimit. Ajo sqaroi se prona në fshatin ku kishte jetuar deri një vit më parë ishte regjistruar në emër të vjehrrit të saj, i cili kishte ndërruar jetë vite më parë. Ajo shprehu shqetësim se kërkesa e saj për përfitim nga një thirrje publike e Komunës për subvencionim financiar për ndërtim ose renovim banesash mund të refuzohet, me arsyetimin se prona ende figuron në librat kadastrorë në emër të vjehrrit.

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit informuan ankuesen lidhur me radhët e trashëgimisë, ndarjen e bashkësisë familjare sipas legjislacionit në fuqi, si dhe mundësinë e shfrytëzimit të ndihmës juridike falas.

### Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje

Avokati i Popullit vlerëson se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe me lansimin e sistemit të hallkave për mbikëqyrje elektronike, Kosova ka ndërmarrë veprime të shumta për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Këto vlerësime Avokati i Popullit i bazon në faktin se, megjithëse nuk ka rol aktiv sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me dhunën në familje dhe nuk ka hasur në ndonjë rast për të cilin do të mund të inicionte hetime sipas detyrës zyrtare. Roli i Avokatit të Popullit për sa i përket dhunës mbi baza gjinore konsiston në mbikëqyrjen e autoriteteve për zbatimin e

detyrimeve pozitive që ato kanë për marrjen e masave të përshtatshme për mbrojtjen e së drejtës për jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe koordinimin e këtyre masave sipas legjislacionit dhe procedurave standarde të veprimit.

Megjithatë, dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna mbi baza gjinore vazhdojnë të jenë të përhapura, shpesh edhe në forma të dhunës psikologjike, seksuale dhe ekonomike, të cilat shpesh mbeten të paraportuara.

Sipas të dhënave që Avokati i Popullit ka siguruar nga Policia e Kosovës, rastet e dhunës në familje mbeten të larta. Gjatë vitit 2024 u raportuan 2547 raste, ndërsa gjatë vitit 2025 u raportuan 2509 raste.

Për sa u përket rasteve të ngacmimeve seksuale, sipas nenit 183 të Kodit Penal, gjatë vitit 2024 u raportuan 102 raste, ndërsa gjatë vitit 2025 u raportuan 64 raste.

### **Viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës**

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit nuk ka marrë ankesa nga viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës. Megjithatë, Avokati i Popullit rikujton se gjatë vitit 2024 është publikuar një raport mbi respektimin e të drejtave të njeriut gjatë njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, si dhe mbi pengesat në realizimin e beneficioneve të garantuara me legjislacionin në fuqi. Ky raport u dorëzua te autoritetet kompetente për shqyrtim dhe ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ka vlerësuar se Rregullorja Nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës përmban zbrazëtira ligjore që shkaktojnë pasiguri juridike dhe paqartësi në procedurë. Mungon përcaktimi i qartë i afateve kohore për zhvillimin e procedurës administrative dhe nxjerrjen e vendimeve, gjë që ka krijuar konfuzion ndërmjet afateve të parashikuara në rregullore dhe atyre të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Terminologjia e përdorur për mjetet juridike, përfshirë termat “ankesë” dhe “kërkesë për rishqyrtim”, është gjithashtu e paqartë dhe në kundërshtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Avokati i Popullit ka ngritur shqetësime serioze lidhur me mënyrën e trajtimit të viktimave gjatë intervistimit, duke theksuar nevojën për respektimin e plotë të konfidencialitetit, shmangien e ritraumatizimit dhe sigurimin e kushteve infrastrukturore adekuate. Është vlerësuar e domosdoshme që ambientet e intervistimit të jenë të qasshme për të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, dhe që oraret të organizohen në mënyrë që të shmanget ballafaqimi i viktimave me njëra-tjetrën.

Raporti evidenton vonesa në pajisjen e viktimave me kartela identifikuese, sipas nenit 37 të rregullores përkatëse, si dhe mungesën e dispozitave specifike për ofrimin e mbështetjes psiko-sociale, e cila është thelbësore për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre të qëndrueshëm në shoqëri.

Në përfundim, Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime konkrete për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me qëllim sigurimin e respektimit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Lidhur me rekomandimet e Avokatit të Popullit, kryetarja e komisionit përkatës ka dhënë një përgjigje gojore duke deklaruar se ato janë marrë parasysht. Megjithatë, nuk është pranuar asnjë përgjigje zyrtare me shkrim nga autoritetet kompetente lidhur me veprimet konkrete të ndërmarra.

Edhe pse gjatë vitit raportues nuk janë paraqitur ankesa zyrtare, Avokati i Popullit vlerëson se viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës vazhdojnë të kërkojnë drejtësi dhe presin që kërkesat e tyre të trajtohen me seriozitet dhe të mos injorohen nga Komisioni Qeveritar përkatës.

### **Të drejtat e personave LGBTIQ+**

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë lidhur me shkeljen e të drejtave të personave LGBTIQ+, e cila u hap për hetim për shkak të gjuhës së përdorur gjatë fushatës zgjedhore nga “Koalicioni për Familjen” ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti. Avokati i Popullit ka vendosur ta mbyllë rastin duke marrë parasysht faktin se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) kishte marrë vendim për këtë çështje. Rasti ishte trajtuar gjithashtu

edhe nga Gjykata Supreme. Në raport me çështjet e ngritura në këtë ankesë, Avokati i Popullit ka dhënë qëndrimet dhe opinionet e tij në Raportin ex officio nr. 146/2021, lidhur me gjuhën në diskursin publik dhe detyrimet e shtetit për garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.<sup>91</sup>Gjithashtu, çështjet e ngritura janë trajtuar edhe në Opinionin Ligjor R. nr. 175/2024 në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), për Gjykatën Themelore në Prishtinë, lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+, lidhur me Padinë C. nr. 2993/2024, të paraqitur më 1 mars 2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka vazhduar hetimin e një rasti të hapur në vitin 2024, të paraqitur nga “Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore” (CSGD), në emër të personit N.N. (me kod mbrojtës të viktimës të caktuar me vendim gjykate “Fabian”). Rasti kishte të bënte me kërkesën për monitorimin e seancave gjyqësore lidhur me lëndën PKR. nr.112/2024. Nga gjithsej gjashtë (6) seanca të mbajtura, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë monitoruar pesë (5) prej tyre.

Në seancën e datës 13 janar 2025, u shpall aktgjykimi, me të cilin të akuzuarit u shpallën fajtorë për veprat penale për të cilat ishin akuzuar. Edhe pse nuk u vërtetua se veprat penale ishin kryer për motive të urrejtjes, është vlerësuar e rëndësishme monitorimi i procesit, duke pasur parasysh se personat e përfshirë i përkisnin komunitetit LGBTIQ+. Sipas të dhënave të ofruara nga Policia e Kosovës, gjatë vitit 2025 janë raportuar tri raste të veprave penale ndaj komunitetit LGBTIQ+.

## Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përveç Kapitullit II, i cili garanton të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të saj, në Kapitullin III specifikisht rregullon Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në vend. Sipas Kushtetutës, Konventa Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare zbatohet drejtpërdrejt dhe ka prioritet ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, qëllimi i të cilit është promovimi i të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës, dhe njëherësh obligon shtetin për ndërmarrjen e masave të veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta.

Pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese, komunitetet joshumicë ende hasin pengesa të shumta në ushtrimin e të drejtave të tyre. Këto pengesa reflektohen në zbatimin joadekuat të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, te rastet e diskriminimit, si dhe mundësitë e pamjaftueshme për punësim, ndërsa problemet që lidhen me marrjen e dokumenteve personale dhe realizimin e së drejtës për mbështetje ekonomike dhe sociale janë ende të pranishme.

Në këtë kuptim, është e nevojshme të përmirësohen më tej mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë me qëllim inkurajimin e integritit të tyre të plotë në shoqëri. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të dialogut dhe sigurimit të një mjedisi stimulues për të gjitha komunitetet.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka

91 <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/>

pranuar 331 ankesa të paraqitura nga anëtarët e komuniteteve joshumicë.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit organizoi një sërë takimesh në komunat Graçanicë, Rahovec, Klinë, Dragash, Mamushë, Letnicë, Shtërpcë, Prizren, Reçan, Ferizaj, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Stanishor, Leposaviq dhe Leshak.

Në këto takime morën pjesë përfaqësues të organeve komunale, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarë nga komunitetet joshumicë. Takimet u organizuan me qëllim të bashkëbisedimit me qytetarët e këtyre komuniteteve dhe si mundësi për t'i paraqitur shqetësimet, sfidat dhe kërkesat e tyre. Gjithashtu, pjesëmarrësit u informuan rreth rekomandimeve të Avokatit të Popullit, zbatimit të tyre nga autoritetet publike, si dhe procedurës për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave që qytetarët ia paraqesin Avokatit të Popullit.

Gjatë këtyre takimeve u identifikuan një numër problemesh me të cilat përballen qytetarët në jetën e tyre të përditshme, siç janë çështjet e mosrespektimit të të drejtave gjuhësore në procedurat administrative dhe gjyqësore, vonesat në sigurimin e përkthimeve të vendimeve gjyqësore, komunikimi i vështirë me vetëqeverisjet lokale në rajonet ku jetojnë anëtarët e komuniteteve joshumicë, sfidat në realizimin e së drejtës për kujdes shëndetësor, problemet me të cilat përballen në fushën e arsimit etj.

Avokati i Popullit publikoi Raport me rekomandime A.nr.702/2022,<sup>92</sup> në lidhje me shkëlqen e parimeve të miradministrimit gjatë shpalljes së konkursit dhe dështimin e institucioneve publike për të përmbushur kuotën e punësimit të anëtarëve të komuniteteve joshumicë, dhe e dorëzoi këtë raport te palët përgjegjëse. Nga përgjigja që pranuan nga Ministria e Punëve të Brendshme, Avokati i Popullit është informuar se, me kërkesë të Zyrës së Kryeministrit, më 26 janar 2024 u është dërguar një kërkesë të gjitha ministrive për të hapur të paktën 10 vende të reja pune për anëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar, dhe se MPB-ja tashmë ka shpallur një konkurs, ndërsa ministritë e tjera pritën ta bëjnë këtë pasi të përfundojë procesi i ristrukturimit.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në

periudhën nga janari deri në fund të nëntorit 2025, u regjistruan pesë (5) raste të iniciuara sipas nenit 141 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili i referohet nxitjes së përçarjes dhe intolerancës.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 48 ankesa nga qytetarët, kryesisht nga veriu i Kosovës, por edhe nga rajone të tjera, kryesisht nga anëtarë të komunitetit serb, që kanë të bëjnë me çështjet e rregullimit të gjendjes civile, regjistrimit të vendbanimit dhe paraqitjes së kërkesës për lëshimin e një karte të përkohshme identiteti. Avokati i Popullit vëren se, edhe përkundër ekzistimit të bazës ligjore dhe procedurave për rregullimin e çështjeve të ngritura në këto ankesa, ka pasur hezitim të qytetarëve për të vepruar sipas rregullativës së paraparë.

Ende ekziston një çështje e hapur në lidhje me kriteret dhe llojin e dokumentacionit që konsiderohet i pranueshëm si provë e qëndrimit afatgjatë dhe të vazhdueshëm në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht në komunat veriore. Në këtë kontekst, nga ankesat rezulton se personat e përfshirë në këtë çështje nuk kanë pasur mundësinë të merrnin dokumentacion alternativ. Bazuar në atë që i tha më sipër, statusi i qëndrimit të këtyre personave mbetet i pazgjigdhur, gjë që sjell një shkallë të caktuar pasigurie ligjore në lidhje me statusin e tyre të mëtejshëm.

Situata e lartpërmendur nuk i referohet ekskluzivisht çështjeve të gjendjes civile dhe shtetësisë, por ka implikime më të gjera për ushtrimin e të drejtave të tjera, duke përfshirë lirinë e lëvizjes, të drejtën për punë, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Në të njëjtën kohë, ajo ndikon në përmbushjen e detyrimeve që këta qytetarë kanë ndaj shtetit. Avokati i Popullit e ka theksuar këtë çështje në raportet e tij të mëparshme, ndërsa rastet në fjalë janë ende në proces dhe Avokati i Popullit, brenda mandatit të tij, vazhdon të monitorojë zhvillimin e mëtejshëm të situatës.

Të drejtat pronësore vazhdojnë të jenë një çështje komplekse, veçanërisht duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore për t'u vendosur brenda një afati të arsyeshëm.

Gjatë vitit 2025, një numër i konsiderueshëm

92 <https://oik-rks.org/2025/03/05/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-702-2022-lidhur-me-shkeljet-e-parimeve-te-miradministrimit-me-rastin-e-shpalljes-se-konkurseve-dhe-deshimit-te-institucioneve-publike-ne-permbushjen-e-kuotes-per/>

prindërisht të fëmijëve që tashmë e kanë ushtruar të drejtën për shtesë për fëmijë, si dhe prindër që kanë aplikuar për realizimin e kësaj të drejte sociale për herë të parë, iu drejtuan Avokatit të Popullit, duke paraqitur ankesa në lidhje me pezullimin e pagesës së shtesës për fëmijë. Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit ka konstatuar se ndryshimet e Vendimit nr. 55, të datës 31 tetor 2024, me të cilat është paraparë procesi i verifikimit, nuk janë publikuar zyrtarisht dhe nuk përcaktojnë qartë dokumentacionin dhe procedurat përkatëse.

Për më tepër, nuk është ofruar bazë ligjore për përfshirjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në këtë proces dhe as kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të dërguar për verifikim.

Avokati i Popullit konstatoi se Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve veprimi në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe ndalimit të arbitraritetit, sepse futi kushte dhe verifikime shtesë që nuk ishin përcaktuar qartë ose nuk ishin shpallur publikisht. Prandaj, Avokati i Popullit lëshoi rekomandime për transparencën e procedurës, marrjen e vendimeve individuale dhe pagesën retroaktive të fondeve të pezulluara.

Avokati i Popullit vlerëson se, si në të gjitha vitet e mëparshme, ende ka dallime në sistemin arsimor në Kosovë. Sistemi arsimor administrohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake, dhe jashtë sistemit arsimor, arsimi ende kryhet në gjuhën serbe për komunitetin serb, pjesërisht edhe për anëtarët e komunitetit boshnjak (në veri të Kosovës), për një pjesë të caktuar të anëtarëve të komunitetit goran dhe kryesisht anëtarët e komunitetit rom. Avokati i Popullit përsërit edhe këtë vit se, si pasojë e kësaj, studentët që përfundojnë arsimin e tyre në sistemin paralel nuk mund të vazhdojnë arsimin e tyre në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, sepse këto diploma nuk njihen.

Gjatë vitit 2025, Agjencia e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë e Kosovës përsëri nuk e akreditoi Departamentin e Studimeve Ballkanike, për studimet e gjuhës shqipe dhe serbe, në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, si i vetmi institucion shtetëror i arsimit të lartë në Kosovë, dhe për këtë arsye nuk mundi të pranonte studentë të rinj në vitin akademik 2024/25.

Edhe në këtë vit, janë evidentuar probleme për furnizimin me kohë me tekste mësimore për nxënësit që vijnë në mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake, për shkak të çmimeve të teksteve shkollore në këto dy gjuhë, pasi doli që tekstet shkollore në gjuhët turke dhe boshnjake janë më të shtrenjta se tekstet shkollore në gjuhën shqipe.

Në lidhje me çështjen e mësipërme, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa dhe në përgjigjen që ka marrë nga MASHTI është siguruar se kjo çështje është zgjidhur, ashtu që në përgjigjen e datës 22 tetor 2025, MASHTI ka sqaruar se janë pajtuar për zbritje çmimi dhe shtëpitë botuese janë deklaruar se tekstet janë në dispozicion.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa lidhur me pamundësinë e qytetarëve të komunitetit serb për të aplikuar për subvencionim të teksteve shkollore për fëmijët që ndjekin arsimin në gjuhën serbe. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit nisi një hetim ex officio dhe iu drejtua MASHTI-t për sqarime dhe informata të nevojshme. Në përgjigjen e kësaj ministrie, të datës 15 prill 2025, Avokati i Popullit u njoftua se subvencionimi është në dispozicion për të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin sipas kurrikulës së Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit mori ankesa në lidhje me të drejtat gjuhësore, megjithëse kjo fushë është përgjegjësi kryesore e Zyrës së Komisionarit për Gjuhët. Mosemërimi i Komisionarit dhe mungesa e një konkursi publik, së bashku me procesin e zgjatur zgjedhor, kërcënuan seriozisht mbikëqyrjen institucionale mbi zbatimin e legjisllacionit në fushën e të drejtave gjuhësore.

Avokati i Popullit, në vitin 2025, gjithashtu përcaktoi se ende ka mangësi serioze në cilësinë dhe konsistencën e përkthimit të akteve ligjore, veçanërisht nga gjuha shqipe në gjuhën serbe. Pavarësisht njoftimit në vitin 2024 të themelimit të Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor në Zyrën e Kryeministrit, ky detyrim nuk u përmbush deri në fund të periudhës raportuese, gjë që la përgjegjësinë e nevojshme institucionale për të garantuar siguri ligjore dhe zbatim të barabartë të legjisllacionit për të gjithë qytetarët.

Në lidhje me respektimin e të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit vazhdoi bashkëpunimin me

Zyrën e Komisionarit për Gjuhët me qëllim koordinimin dhe promovimin më të mirë të të drejtave gjuhësore, si dhe bashkëpunimin me qëllim zgjidhjen më të shpejtë të ankesave të paraqitura. Një projekt i përbashkët u zbatua në koordinim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Projekti i referohet monitorimit të pajtueshmërisë me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në komuna dhe gjykata të caktuara në Republikën e Kosovës.

Pas kësaj, Ministria e Administrimit të Vetëqeverisjes Lokale, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët në Kabinetin e Kryeministrit, si dhe me Institucionin e Avokatit të Popullit, me mbështetjen e Këshillit të Evropës/Zyrës në Prishtinë, nëpërmjet projektit "Promovimi i kohezionit social përmes forcimit të të drejtave të komuniteteve dhe përdorimit të gjuhëve", organizoi shtatë takime të tjera rajonale me përfaqësues të të gjitha komunave të Kosovës. Qëllimi i këtyre takimeve ishte të diskutoheshin sfidat me të cilat përballemi gjatë procesit të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, në aspektin e rolit të anëtarëve të rrjetit të politikave gjuhësore, publikimit të dokumenteve në gjuhët zyrtare në faqen zyrtare të internetit të komunës, koeficienteve të përkthyesve në komuna, tabelave brenda dhe jashtë institucioneve publike, në rrugë dhe sheshe, si dhe koordinimit të brendshëm.

## Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

### Arsimi

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit nuk ka marrë ndonjë ankesë lidhur me braktisjen e gjerë të shkollimit të obligueshëm nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në përgjithësi, mbi bazën e informatave nga vetë komunitetet dhe aktivistët e tyre, edhe ndonjë braktisje e shkollimit ka pasuar me ndërhyrjen e menaxhmentit të shkollës përkatëse për kthimin e nxënësve në banka shkollore. Kryesisht, në disa raste, arsyet e braktisjes së shkollimit janë po të njëjta sikurse në periudhat e kaluara raportuese. Ende një pjesë e prindërve shprehin mungesë të perspektivës për fëmijët e tyre, një tregues shqetësues në shoqëri. Disa të tjerë theksojnë se detyrohen që fëmijët e tyre të punojnë në tregun joformal, por ka të tillë që pohojnë se nuk kanë mjete financiare për t'i shkolluar fëmijët e tyre, çka në realitet nuk mund të jetë arsyetim, duke marrë parasysh

se, veçanërisht, shkollimi i obligueshëm nuk ka ndonjë kosto të lartë financiare.

Në këtë vit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka dhënë rreth 500 bursa për nxënës të shkollave të mesme të larta të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, kjo ministri ka publikuar vendimin për ndarjen e bursave për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për vitin akademik 2024/2025. Këtë vit, përfitues të kësaj skeme janë gjithsej 49 studentë.

### Të drejtat pronësore

Pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese, qasja e kufizuar në informacion, kostot e larta të shërbimeve ligjore dhe procedurat e ndërlikuara të regjistrimit shpesh i lënë këto komunitete pa i rregulluar çështjet e regjistrimit të pronave. Kjo situatë i la ata në një gjendje pasigurie dhe cenueshmërie ligjore në ushtrimin e të drejtave pronësore. Shumë nga këto familje e kanë blerë pronën përmes marrëveshjeve joformale, të cilat nuk janë regjistruar kurrë në regjistrin kadastral. Kjo ka çuar në mosmarrëveshje dhe pamundësi për t'i realizuar të drejtat e lidhura me pronën, si trashëgimia dhe mbrojtja ligjore.

Shumica e pretendimeve ankimore të ankesave të parashtruara te Avokati i Popullit për të drejtat pronësore, kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave gjyqësore. Avokati i Popullit ka trajtuar raste të kësaj natyre që i ka konsideruar të ndjeshme. Në një nga ankesat e hetuara, sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi E. P., me numër të rastit A.nr.551/2023, Avokati i Popullit ka konstatuar cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor, meqë procedura gjyqësore nuk ka përfunduar për më shumë se 20 vjet. Çështjet e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore janë shqetësime për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Megjithatë, ky shqetësim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian mund të ketë ndikim më të madh, për shkak se informaliteti në të drejtat pronësore, mungesa e regjistrimeve formale dhe çështjet pronësore të pazgjidhura janë më të shprehura.

Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishëm rolin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, si dhe ndërmjetësimin në realizimin e të drejtave pronësore të komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Avokati i Popullit, gjatë diskutimeve me pjesëtarët e këtyre komuniteteve, nxori konstatimin se këto komunitete nuk kanë informata të mjaftueshme për sa i përket ndërmjetësimit,

si një mekanizëm efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve, në përputhje me parimet e ndërmjetësimit.

Megjithatë, gjatë vitit 2025, shoqëria civile që merret me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë aktive në mbajtjen e fushatave informuese në këtë fushë.

### **Punësimi**

Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime A.nr.702/2022,<sup>93</sup> lidhur me shkeljet e parimeve të miradministrimit me rastin e shpalljes së konkurseve dhe dështimit të institucioneve publike në përmbushjen e kuotës për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.<sup>94</sup> Raporti konstaton se të dhënat statistikore të ofruara nga MPB-ja për komunitetet e tjera janë në dispozicion, por për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka të dhëna.

Me këtë raport, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Ministria e Punëve të Brendshme të veprojnë në pajtim me Rregulloren 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e cila, sipas nenit 13, par. 4, përcakton: “Institucionet publike me qëllim të plotësimit të kuotës si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nën përfaqësuar, si dhe t’i mbajë të përditësuar të dhënat statistikore për numrin e të punësuarve të komuniteteve joshumicë në Kosovë, në institucione publike në nivel qendror”. Gjithashtu, ka kërkuar që në kuadër të të dhënave statistikore të përfshihen edhe komunitetet e tjera joshumicë, si: romët, ashkalinjtë, egjiptianët, kroatët dhe malazezët.

Pas reagimit të Avokatit të Popullit, MPB-ja dhe KQZ-ja kanë filluar të ndërmarrin veprime korrigjuese, përfshirë përmirësimin e procedurave të njoftimit të kandidatëve dhe hapjen e konkurseve të dedikuara për komunitetet e nënpërfaqësuar.

### **Të dhënat statistikore të ankesave të parashtruara në IAP**

Avokati i Popullit gjatë vitit 2025 ka pranuar 11 ankesa nga komuniteti rom, prej të cilave 6 janë hapur për hetim; 23 ankesa nga komuniteti ashkali, prej të cilave 6 janë hapur për hetim; si dhe 8 ankesa nga komuniteti egjiptian, prej

të cilave 3 janë hapur për hetim. Të dhënat statistikore më të detajuara të ankesave, sipas përkatësisë etnike, janë elaboruar në pjesën përkatëse të paraqitjes së të dhënave statistikore në këtë raport.

Problemet më të shpeshta të paraqitura në ankesat e parashtruara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë të bëjnë me: çështje pronësore, përfshirë lejet ndërtimore dhe vërtetimin e pronësisë; njohjen e gjuhës rome në përdorim zyrtar në komuna; pretendime për cenim të të drejtave në marrëdhënie pune; trajtim të padinjitetshëm mjekësor; si dhe zvarritje të procedurave gjyqësore në konteste civile.

### **Pjesëmarrja në aktivitete**

Gjatë vitit 2025, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit morën pjesë në aktivitete të shumta, kryesisht të organizuara nga organizata të shoqërisë civile që merren me çështjet e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ndër këto aktivitete përfshihen: punësoria treditore për hartimin e planit të punës së Grupit Teknik për zbatimin e rekomandimeve të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; pjesëmarrja online në tryezën me temë “Organet e barazisë në mundësimin e qasjes së barabartë të romëve në edukim”, e organizuar nga EQUINET; pjesëmarrja në Tryezën e Rrumbullakët Kombëtare me temë “Sfidat e të drejtave pronësore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë”; tryeza “Gjendja e të drejtave të komuniteteve në Kosovë – diskutim i përbashkët”, e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit; si dhe Punësoria dyditore për gjithëpërfshirjen në punësim, e organizuar nga OJQ-ja “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” në Gjilan.

93 <https://oik-rks.org/2025/03/05/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-702-2022-lidhur-me-shkeljet-e-parimeve-te-miradministrimit-me-rastin-e-shpalljes-se-konkurseve-dhe-deshhtimit-te-institucioneve-publike-ne-permbushjen-e-kuotes-per/>

94 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/03/organized-1-1.pdf>

# Të Drejtat e Fëmijës

Të drejtat e fëmijës janë pjesë e pandashme e të drejtave të njeriut. Përveç të drejtave të përgjithshme që u takojnë njësoj si të rriturve, fëmijët gëzojnë edhe të drejta të veçanta, të cilat burojnë nga nevojat e tyre specifike, si grup i veçantë shoqëror. Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes të nevojshëm për mirëqenien e tyre. Po ashtu, Kushtetuta e ngarkon shtetin me detyrimin ligjor për t'i respektuar, mbrojtur dhe zbatuar këto të drejta, nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF).<sup>95</sup>

Si pasojë e mosformimit të institucioneve pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, nuk u shënuar asnjë avancim në legjisllacionin e ri në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Edhe gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin për mosnxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, të cilat rregullojnë organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Kujdes Ditor dhe Qendrave për Pranim,<sup>96</sup> duke qenë se vonesat në miratimin e këtyre akteve e pengojnë zbatimin e plotë të ligjit. Në aspektin e zhvillimit të politikave në nivel vendi, procesi i hartimit të Draft-Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve 2026–2031 përbën një avancim të rëndësishëm, dhe IAP-ja mirëpret finalizimin e këtij dokumenti strategjik.

Avokati i Popullit vlerëson se edhe gjatë këtij viti fëmijët vazhdojnë të përballen me pengesa në ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre. Këto pengesa shfaqen pothuajse në të gjitha aspektet e jetës së fëmijëve, me theks të veçantë në realizimin e së drejtës për arsim, në proceset gjyqësore dhe administrative, në mbrojtjen nga dhuna, si dhe në qasjen në shërbime shëndetësore dhe sociale.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 149 ankesa lidhur me të drejtat e fëmijës, kryesisht të parashtruara nga prindërit e fëmijëve, ndërsa 6 raste janë hetuar sipas detyrës zyrtare. Për sa i përket gjinisë së

ankuesve, 32 ankesa janë iniciuar nga burra dhe 79 nga gra. Institucionet kundër të cilave janë paraqitur ankesat përfshijnë: 32 kundër komunave; 11 kundër gjykatave, kryesisht për zvarritje të procedurave gjyqësore dhe kërkesa për monitorim të proceseve gjyqësore; 72 kundër ministrive dhe administratës; 5 kundër policisë; 4 kundër prokurorive; si dhe 7 ankesa të natyrave të tjera. Nga ky numër, 31 ankesa janë shpallur të papranueshme, pasi çështjet kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk kanë përbërë shkelje të të drejtave të njeriut, ose ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë apo kanë qenë duke i shfrytëzuar mjetet juridike. Nga ankesat e pranuar, 118 janë hapur për hetim dhe shtjellohen më detajisht përgjatë raportit. Gjatë këtij viti, IAP-ja u ka adresuar 529 rekomandime autoriteteve publike përkatëse lidhur me të drejtat e fëmijës dhe u ka dërguar 69 letra rikujtuuese për mospërgjigje dhe moszbatim të rekomandimeve.

Ankesat e paraqitura nga individët	149
Rastet e hapura për hetim sipas ankesave të paraqitura nga individët	118
Ankesat e papranuara	31
Rastet e hapura për hetim sipas detyrës zyrtare	6
Gjithsej	155

Gjithashtu, Avokati i Popullit është në proces të përditësimit dhe rifunksionalizimit të platformës promovuese “Njih të Drejtat e Tua”, e cila ka për qëllim informimin e të rinjve kosovarë për të drejtat e tyre dhe për institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre të drejtave, duke ofruar përshtatje të të drejtave dhe të legjisllacionit në një gjuhë miqësore për fëmijët dhe të përshtatshme për moshën e tyre.

## E drejta e fëmijës për arsim

Shkeljet e pretenduara lidhur me realizimin e së drejtës në arsim përbëjnë një numër të konsiderueshëm të rasteve të raportuara tek Avokati i Popullit. Rastet lidhur me të drejtën për arsim, të cilat janë hetuar, duke përfshirë edhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: mungesën e ngrohjes në shkollë,<sup>97</sup>

95 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

96 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenët 61 dhe 62.

97 Rasti 1399/2025.

mungesën e transportit për në shkollë,<sup>98</sup> dhunën në shkolla,<sup>99</sup> mungesën e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm,<sup>100</sup> subvencionimin e teksteve shkollore në gjuhën turke dhe boshnjake,<sup>101</sup> procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore,<sup>102</sup> braktisjen e shkollës,<sup>103</sup> përjashtimin nga shkolla,<sup>104</sup> dëmtimin e objekteve fizike të shkollës,<sup>105</sup> mungesën e asistentit mbështetës për fëmijë me aftësi të kufizuara,<sup>106</sup> diskriminimin,<sup>107</sup> dhe procesin e përzgjedhjes së fëmijës në kopsht publik.<sup>108</sup> Po ashtu, në këtë drejtim Avokati i Popullit ka publikuar 4 raporte ex-officio dhe 5 letra me rekomandime, të cilat trajtojnë dimensionet kyçe të së drejtës për arsim, përfshirë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve në shkolla, qasjen e barabartë në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, kushtet fizike të mësimi, si dhe obligimet institucionale lidhur me transportin dhe mbështetjen me asistentë mësimi. Këto veprime kishin për qëllim t'i evidentonin mangësitë sistematike dhe përgjegjësitë institucionale, për t'i përmirësuar kushtet e arsimit, parandaluar diskriminimin dhe garantuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët në Kosovë. Për sa i përket promovimit të të drejtave të fëmijëve, IAP-ja edhe gjatë këtij viti zhvilloi fushata informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në 29 shkolla në 16 komuna (Ferizaj, Shtërpçë, Shtime, Gjilan, Viti, Kamenicë, Malishevë, Rahovec, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Prishtinë dhe Podujevë).

Mbi bazën e hetimeve të ankesave të pranuar dhe hetimeve sipas detyrës zyrtare, gjatë vitit 2025 janë trajtuar tema të rëndësishme që lidhen me të drejtat e fëmijës, për të cilat do të flitet në vijim.

## **Ndërlidhja mes së drejtës për arsim dhe së drejtës së fëmijës për shëndet**

Në *Raportin me rekomandime ex officio nr. 479/2023, lidhur me ndikimin e peshës së çantave tek fëmijët e shkollave fillore (cikli 1–5) dhe funksionalizimin e dollapëve në shkolla*,<sup>109</sup> Avokati i Popullit ka konstatuar shkelje të të drejtave të fëmijës, duke u bazuar në ndërlidhjen ndërmjet së drejtës për arsim dhe së drejtës së fëmijës për shëndet. Raporti ka vlerësuar se organizimi i procesit arsimor, në rastet kur cenon shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, ndikon drejtpërdrejt në realizimin e së drejtës për arsim cilësor. Në këtë kontekst, raporti mbështetet në nenin 3 të KDF-së, i cili imponon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese në të gjitha vendimmarrjet, si dhe në nenin 24, i cili garanton të drejtën e fëmijës për gjendjen më të mirë të mundshme shëndetësore. Gjetjet e raportit tregojnë se pesha e çantave shkollore, e cila arrin nga 5 deri në 6 kg për nxënësit e ciklit fillor, shkakton lodhje, raskapitje dhe potencialisht mund të shkaktojë dëmtime të shtyllës kurrizore, duke ndikuar negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Bazuar edhe në hulumtimet e institucioneve arsimore dhe shëndetësore mbi mbingarkesën kurrikulare, raporti konstaton se kjo gjendje përbën pengesë për përmbushjen e së drejtës për arsim cilësor. Si zgjidhje, Avokati i Popullit ka paraparë dy veprime: (i) që Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për trajnimin e mësimdhënësve në zbatim efikas të planprogramit gjatë orëve mësimore, për reduktimin e detyrave të shtëpisë dhe për rishikimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve gjatë orëve të edukatës fizike; si dhe (ii) u ka rekomanduar të gjitha komunave që të vazhdojnë me funksionalizimin e dollapëve në shkolla dhe me koordinimin institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, si masa të

98 Rasti 416/2025.

99 Rastet 1702/2025, 1469/2025, 780/2025, 520/2025 dhe 182/2025.

100 Rastet 1399/2025, 1323/2025, 1261/2025 dhe 1255/2025.

101 Rasti 1178/2025.

102 Rasti 1124/2025.

103 Rasti 1370/2025.

104 Rasti 494/2025.

105 Rasti 1267/2025.

106 Rasti 1238/2025, 292/2025 dhe 1396/2025.

107 Rasti 422/2025.

108 Rasti 942/2025.

109 <https://oik-rks.org/2025/05/13/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-479-2023-lidhur-me-ndikimin-e-peshes-se-cantave-tek-femijet-e-shkollave-fillore-cikli-1-5-funksionalizimin-e-dollapeve-ne-shkolla/>

domosdoshme për garantimin e një mjedisi arsimor që promovon shëndetin dhe zhvillimin e plotë të fëmijëve.

### **Arsimi gjithëpërfshirës dhe aftësia e kufizuar**

Në muajin gusht, Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë kundër Komunës së Malishevës për dështim në sigurimin e transportit për një fëmijë me aftësi të kufizuara drejt Qendrës Burimore, ku ai ndjek procesin mësimor. Kjo ankesë është mbështetur në mënyrë aktive nga Grupi i fëmijëve “Respect Our Rights” (ROR), si një zë i fuqishëm avokues – nga vetë fëmijët për fëmijët. Pas zhvillimit të hetimeve, IAP-ja publikoi *Letrën me Rekomandime R. nr. 1126/2025*, në të cilën konstatoi se Komuna e Malishevës ka shkelur të drejtat e fëmijës me aftësi të kufizuara, duke dështuar t’ia siguronte transportin e nevojshëm nga vendbanimi i tij deri në Qendrën Burimore dhe anasjelltas. Avokati i Popullit ka ritheksuar se, përveç obligimeve kushtetuese dhe atyre që rrjedhin nga KDF-ja, neni 40 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar garanton parimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe obligon institucionet kompetente të ofrojnë mbështetje adekuate, në përputhje me nevojat individuale të fëmijës. Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton sigurimin e qasjes në arsim cilësor për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes apo aftësive të tyre, duke përbushur në mënyrë efektive nevojat e ndryshme dhe duke garantuar pjesëmarrjen e tyre në një mjedis të përbashkët mësimor. Në funksion të zbatimit të këtyre dispozitave, neni 17 (2) i Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2024 për Qendrat Burimore përcakton qartë obligimin e komunave për sigurimin e transportit për nxënësit në shkollat speciale të Qendrave Burimore, përfshirë edhe nxënësit konviktorë. Rrjedhimisht, IAP-ja i rekomandoi Komunës së Malishevës që t’ia sigurojë fëmijës së ankueses transportin e nevojshëm, në përputhje me nevojat e tij individuale dhe me detyrimet ligjore në fuqi.

### **Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla**

Lidhur me dhunën ndaj fëmijëve, përfshirë edhe sigurinë në shkolla, Avokati i Popullit ka

zhvilluar hetime për 13 raste, prej të cilave 10 janë iniciuar sipas ankesave të prindërve dhe 3 sipas detyrës zyrtare. Rastet kanë të bëjnë me dhunë psikike dhe/ose fizike ndaj nxënësve nga mësimdhënësit,<sup>110</sup> dhunë fizike dhe psikike nga bashkëmohatarët,<sup>111</sup> ngacmim seksual ndaj nxënësve,<sup>112</sup> dhunë nga zyrtar policor ndaj nxënësit; si dhe qasje efektive në drejtësi në rastet e dhunës seksuale dhe fizike.<sup>113</sup>

Rastet e paraqitura nga prindërit kryesisht kanë të bëjnë me dhunën e ushtruar nga bashkëmohatarët dhe nga mësimdhënësit ndaj fëmijëve. Në rastin e parë ex officio, Avokati i Popullit ka nisur hetimet bazuar në informatat e publikuara në portalin “Nacionale.com”, në shkrimin me titull “12-vjeçari problematik në Shtime, institucionet s’kanë zgjidhje”. Sipas këtij portali, në rrjete sociale ka qarkulluar një video shqetësuese, ku shfaqet një i mitur duke goditur rëndë një të mitur tjetër.<sup>114</sup> Në rastin e dytë, në muajin shkurt, IAP-ja ka hapur hetim ex officio bazuar në informatat nga portali “Veriu.info”, në shkrimin me titull “Skandal në shkollën ‘Abdullah Shabani’ në Mitrovicë – nëna denoncon dhunën ndaj djalit të saj”. Sipas raportimit, fëmija ka qenë viktimë e dhunës së vazhdueshme nga disa bashkëmohatarë, të cilët e kanë kërcënuar, ofenduar dhe sulmuar fizikisht në mënyrë të përsëritur.<sup>115</sup> Këto raste janë trajtuar dhe përfshirë në *Raportin ex officio nr. 661/2024, i cili përmban rekomandime lidhur me përgjegjësitë e institucioneve në raport me dhunën në shkolla*.<sup>116</sup>

Në *Raportin ex officio nr. 661/2024 për përgjegjësinë e institucioneve në raport me dhunën në shkolla*, Avokati i Popullit, për të analizuar gjendjen, ka përfshirë: (i) studime të realizuara nga autorë të ndryshëm, Instituti Pedagogjik, UNDP-ja etj.; (ii) statistika të nxjerra nga MASHTI dhe Policia e Kosovës; si dhe (iii) fokus-grupe me prindër, mësimdhënësit dhe nxënës, duke përfshirë edhe konsultimin e gjetjeve me grupin e fëmijëve ROR.

Avokati i Popullit ka konstatuar se dhuna ndaj nxënësve në shkollat e Kosovës është e pranishme dhe ushtrohet si nga bashkëmohatarët, ashtu edhe nga

110 Rastet 182/2025, 780/2025, 1702/2025.

111 Rastet 445/2025, 494/2025, 1469/2025, ex officio 56/2025 dhe ex officio 137/2025.

112 Rasti ex officio 1663/2025.

113 Rastet 752/2025, 1387/2025 dhe 852/2025.

114 <https://nacionale.com/video/12-vjecari-problematik-ne-shtime-institucionet-skane-zgjidhje-pamje-te-renda>

115 <https://veriu.info/skandal-ne-shkollen-abdullah-shabani-ne-mitrovice-nena-dennoncon-dhunen-ndaj-djalit-te-saj/>

116 <https://oik-rks.org/2025/05/29/raportin-e-avokatit-te-popullit-ex-officio-661-2024-pergjegjesia-e-institucioneve-ne-raport-me-dhunen-ne-shkolla/>

mësimdhënësit, duke ndikuar negativisht në mirëqenien fizike dhe mendore të fëmijëve, si dhe në cilësinë e procesit arsimor. Sipas të dhënave nga MASHTI, të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), nga viti 2014 deri më 2024 (për 10 vjet), shkollat kanë raportuar 272 raste të dhunës në shkolla, ndërsa të dhënat nga Policia e Kosovës për të njëjtën periudhë janë 5652 raste. Në anën tjetër, sipas gjetjeve të studimeve, 77% e nxënësve kanë raportuar se kanë përjetuar të paktën një formë dhune gjatë muajit të fundit. Një mospërputhje kaq e madhe ndërmjet statistikave zyrtare dhe deklarimeve të nxënësve tregon seriozitetin e situatës dhe kërkon angazhim urgjent institucional, fillimisht për raportimin e saktë të rasteve dhe më pas për ndërmarrjen e masave konkrete. Shifra të larta të dhunës në shkolla kanë rezultuar edhe nga anketa “Zërat e Rinj”, ku një nga gjetjet kryesore tregon se 78% e fëmijëve raportojnë se bullizmi është shumë ose mesatarisht pranishëm në shkollën e tyre.<sup>117</sup>

Pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore që e ndalon dhunën dhe ndëshkimin fizik, autoritetet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë masa të mjaftueshme për mbrojtjen efektive të fëmijëve, ndërsa zbatimi dhe monitorimi i politikave dhe protokolleve ekzistuese mbeten të pamjaftueshme. Mësimdhënësit përballen me vështirësi në menaxhimin e disiplinës dhe kanë nevojë për trajnim në metoda alternative, ndërkohë që nxënësit dhe prindërit raportojnë mungesë sigurie në ambientet shkollorë, deri në ndryshimin e shkollës për shkak të dhunës së përsëritur. Sistemi aktual i raportimit të dhunës vlerësohet si joefikas, duke penguar adresimin e rasteve dhe llogaridhënien institucionale, çka thekson nevojën urgjente për ndërhyrje të koordinuara, forcim të mekanizmave të raportimit, monitorim rigoroz dhe zbatim të plotë të kornizës ligjore në fuqi.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar MASHTI-t që t'i forcojë mekanizmat e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes për institucionet e arsimit parauniversitar, duke siguruar zbatimin e Rregullores nr. 21/2013 për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla. Ministria duhet të vlerësojë në mënyrë sistematike shkollën e shfaqjes së dhunës, të hartojë një strategji gjithëpërfshirëse multisektoriale të shoqëruar me plan veprimi konkret, si dhe të garantojë raportim të rregullt dhe të besueshëm nga institucionet arsimore.

Po ashtu, është rekomanduar rishikimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ nr. 26/2013, me qëllim sigurimin e pranisë së psikologëve në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar. Ndërsa komunave u është rekomanduar që të përmirësojnë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në institucionet e arsimit parauniversitar, të forcojnë monitorimin në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta dhe të sigurojnë zbatimin e legjislacionit për parandalimin e dhunës në shkolla. Gjithashtu, është rekomanduar rritja e bashkëpunimit të Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) me Policinë e Kosovës, shërbimet sociale dhe shëndetësore, si dhe komunitetin; organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit dhe stafin profesional për menaxhimin e rasteve të dhunës; si dhe zhvillimi i hulumtimeve mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve, me fokus në parandalimin dhe eliminimin e dhunës në ambientet shkollorë.

Avokati i Popullit vlerëson se përdorimi i dhunës në shkolla mbetet një ndër shqetësimet më serioze në fushën e të drejtave të fëmijës në Kosovë. Raporti i publikuar më 28 maj 2025 evidenton se, pavarësisht ekzistencës së kornizës ligjore që ndalon çdo formë dhune, masat për zbatimin efektiv të saj kanë qenë të pamjaftueshme. Dhuna, si ndërmjet bashkëmoshatarëve, ashtu edhe nga mësimdhënësit, cenon sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike të fëmijëve dhe dëmton procesin arsimor.

Për këtë arsye, Avokati i Popullit u bën thirrje autoriteteve përgjegjëse që të zbatojnë pa vonesë rekomandimet e dhëna në raport, me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurt dhe mbrojtës për të gjithë nxënësit.

Avokati i Popullit ka vazhduar në mënyrë aktive me veprimtaritë promovuese dhe ndërgjegjësuere, duke filluar me fushata informuese në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, në 29 shkolla në 16 komuna. Qëllimi i këtij aktiviteti është që t'i njoftojë nxënësit dhe mësimdhënësit me rolin, mandatin dhe kompetencat e IAP-së. Po ashtu, Avokati i Popullit ka mbajtur takime me përfaqësues të grupeve të ndryshme të fëmijëve që avokojnë për të drejtat e fëmijëve, për të dëgjuar perspektivën e tyre lidhur me çështjet që i prekin drejtpërdrejt në shkolla dhe në komunitet, përfshirë dhunën në shkolla.

117 Save the Children, Zërat e Rinj, 2024, i qasshëm në: <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/Zerat-e-Rinj-2024.pdf>

Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në Konferencën e 29-të vjetore të organizuar në Rumani nga ENOC, e cila ka pasur në fokus të drejtën e fëmijëve për shëndet fizik. Në këtë konferencë janë diskutuar, ndër të tjera: (i) përfshirja e shëndetit në nivel politikash; (ii) promovimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve; (iii) shërbimet e specializuara mjekësore për fëmijë; si dhe (iv) mbrojtja ligjore e fëmijës në kujdesin shëndetësor. Avokati i Popullit thekson se kjo e drejtë është me interes të veçantë për sigurimin e mirëqenies së fëmijëve, duke ngritur, ndër të tjera, problematikat që lidhen me ushqyerjen, aktivitetin fizik, shëndetin mendor dhe abuzimin me substanca (përfshirë alkoolin, cigaret elektronike etj.).

Institucioni i Avokatit të Popullit gjithashtu ka marrë pjesë në Bruksel në një panair për pjesëmarrjen e fëmijëve, ku është trajtuar e drejta e fëmijëve për t'u dëgjuar. Kjo e drejtë nënkupton që fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen dhe të shprehin pikëpamjet e tyre në të gjitha vendimet që i prekin, qoftë në shtëpi, në shkollë apo në çështje të tjera ku ata përfshihen. Fatkeqësisht, siç është theksuar edhe nga takimet me fëmijët dhe nga anketat përkatëse,<sup>118</sup> kjo e drejtë nuk po respektohet nga institucionet publike. Është gjetur se 83% e fëmijëve do të dëshironin të kishin më shumë ndikim, fuqi dhe mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre për çështjet që i shqetësojnë ata dhe bashkëmoshatarët e tyre, ndërsa vetëm 9% e fëmijëve kanë marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të organizuar nga komuna e tyre ose nga qeveria gjatë dy viteve të fundit.

### **Të drejtat e fëmijës në procedurat gjyqësore**

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar 11 ankesa kundër gjykatave, të cilat kryesisht kishin të bënin me mosheqjen e së drejtës prindërore,<sup>119</sup> besimin e kujdestarisë së fëmijëve dhe caktimin e alimentacionit,<sup>120</sup> zvarritjen e procedurave gjyqësore,<sup>121</sup> dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve,<sup>122</sup> si dhe 4 ankesa kundër prokurorive.<sup>123</sup>

118 *Zërat e Rinj, 2024 Shih:* <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/Permbledhje-Ekzekutive-e-Zerave-te-Rinj-2024.pdf>

119 Rasti 45/2025, 242/2025.

120 Rasti 223/2025.

121 Rastet 852/2025, 752/2025, 783/2025 dhe 223/2025.

122 Rastet 1337/2025, 1287/2025 dhe 863/2025 dhe 1492/2025.

123 Rastet 834/2025, 1133/2025, 1206/2025 dhe 14/2025.

124 Rastet 834/2025 dhe 45/2025.

125 Rasti 45/2025.

126 Rasti 223/2025.

127 <https://oik-rks.org/2025/05/29/raportin-e-avokatit-te-popullit-ex-officio-695-2022-lidhur-me-arsimimin-dhe-afesimin->

Gjithashtu, me kërkesë të palëve, Avokati i Popullit ka monitoruar seancat gjyqësore<sup>124</sup> dhe u është drejtuar gjykatave përkatëse me shkresa për t'u informuar për veprimet e ndërmarra në drejtim të respektimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe të së drejtës për mjete juridike.

Ngjashëm me vitet e kaluara, Avokati i Popullit ka trajtuar ankesa të prindërve lidhur me realizimin e të drejtave prindërore, përfshirë të drejtën e kontaktit me fëmijët e tyre. Në një rast, ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër QPS-së dhe gjykatës lidhur me iniciimin e procedurës për heqjen e së drejtës prindërore, ndërkohë që fëmija i saj prej disa vitesh ndodhej në strehimore dhe ishte nën përkujdesjen e QPS-së<sup>125</sup>. Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka monitoruar seancën gjyqësore dhe ka zhvilluar hetime për të vlerësuar nëse veprimet e institucioneve përkatëse ishin në përputhje me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe me garantimin e mjeteve juridike efektive.

Në një rast tjetër, një baba kishte paraqitur ankesë kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore lidhur me besimin e fëmijëve dhe caktimin e alimentacionit<sup>126</sup>. Gjatë trajtimit të këtij rasti, IAP-ja ka ndërmarrë veprime aktive duke kontaktuar vazhdimisht QPS-në, gjykatën dhe ankuesin, deri në konfirmimin se seanca ishte mbajtur dhe se ishte arritur marrëveshje për besimin e fëmijëve dhe për alimentacionin.

### **Fëmijët me aftësi të kufizuara**

Gjatë kësaj periudhe raportuese, lidhur me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për 5 raste të inicuar pas ankesave të prindërve, si dhe ka hartuar *Raportin me rekomandime Ex officio 695/2022 lidhur me arsimimin dhe aftësimin gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara për qasjen në tregun e punës*<sup>127</sup>. Këto ankesa ndërlidhen kryesisht me të drejtën për arsim dhe kishin të bënin

me mungesën e transportit shkollë–shtëpi<sup>128</sup>, të drejtën për asistent për fëmijë me aftësi të kufizuara,<sup>129</sup> orarin për qëndrim në çerdhe<sup>130</sup> dhe regjistrimin në shkollë.<sup>131</sup>

### **Mungesa e asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara**

Ngjashëm me vitet e kaluara, një ndër pengesat kryesore të cilat e vështirësojnë qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim vazhdon të mbetet mungesa e asistentëve për fëmijë. Në mars, prindi ishte ankuar kundër Komunës së Gjilanit për shkak se fëmijës së vet i ishte mohuar regjistrimi në shkollë në mungesë të asistentit mbështetës. Pas hetimeve, fëmija u regjistrua me sukses në shkollë dhe ka filluar mësimin me rregull.<sup>132</sup> Ngjashëm, në tetor, një prind tjetër ka paraqitur ankesë ndaj Komunës së Gjilanit për mospajtimin e një asistenti mbështetës.<sup>133</sup> Prindi i është drejtuar komunës me kërkesë për sigurimin e asistencës për fëmijën me nevoja të veçanta arsimore dhe ofrimin e transportit, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar. Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Gjilan e ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur ta aprovojë pjesërisht, duke miratuar mbështetjen me transport, ndërsa ka refuzuar kërkesën për sigurimin e asistencës mbështetëse për fëmijën me aftësi të kufizuara. Prindi, po ashtu, ka ngritur shqetësimin se gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara është e rënduar për shkak të mungesës së mbështetjes adekuate institucionale. Sipas ankuesit, shpenzimet për trajtime psikologjike, logopedike, ergoterapeutike, dieta të veçanta ushqimore, terapi mjekësore, si dhe për mbështetje nga mësues apo asistentë gjatë ndjekjes së procesit mësimor janë të konsiderueshme dhe të vazhdueshme. Në këto rrethana, prindërit detyrohen t'i sigurojnë vetë këto shërbime, duke i mbuluar shpenzimet nga mjetet personale, çka paraqet një barrë financiare të papërbalueshme për shumicën e familjeve.

Në rastin tjetër, prindi paraqiti ankesë kundër Komunës së Prizrenit lidhur me orarin e qëndrimit të fëmijës në çerdhe. Gjatë hetimeve,

IAP-ja u informua se DKA-ja ishte në proces të angazhimit të një asistenti mbështetës për fëmijën në fjalë. Po ashtu, komuna ngriti shqetësimin për mungesën e madhe të asistentëve, pasi aktualisht e kanë të pamundur t'i plotësojnë të gjitha kërkesat. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se kujdesi i hershëm në fëmijëri është hapi i parë i shkallës së të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijës, e konsideron të domosdoshme që institucionet të krijojnë hapësira dhe kapacitete në mënyrë që fëmijët, pa dallim, të kenë qasje të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte. Duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, KDF-në, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Ligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Avokati i Popullit ka ritheksuar se qasja në institucionet parashkollore e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara, pa diskriminim, është në interesin më të mirë të tyre. Pas veprimeve të IAP-së, ankuesja dhe çerdhja arritën një marrëveshje lidhur me orarin e vijimit dhe ofrimin e mbështetjes nga asistenti për fëmijën e saj.

### **Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve**

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për jetesë, rritje dhe zhvillim në kushte që sigurojnë mirëqenie fizike, emocionale dhe sociale, me qëllim që secili fëmijë të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Institucionet janë të obliguara të ndër marrin masa për mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, duke siguruar zhvillimin, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijët në rrezik.<sup>134</sup> Në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, këtë vit janë paraqitur 59 ankesa nga prindërit kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), lidhur me mospërfitimin nga Programi i Shtesave për Fëmijë.

### **Zbatimi i parimit të interesit më të mirë të fëmijës në procedura administrative që ndikojnë në mirëqenien sociale të tyre**

Në maj, pas 56 ankesave nga qytetarë, kryesisht nga komuniteti serb, Avokati i

[gjithepershires-t%D1%91-personave-me-aftesi-te-kufizuara-p%D1%91r-qasjen-ne-tregun-e-punes/](#)

128 Rasti 1126/2025.

129 Rastet 1396/2025, 1238/2025 dhe 292/2025.

130 Rasti 885/2025.

131 Rasti 292/2025.

132 Rasti 292/2025.

133 Rasti 1396/2025.

134 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 1 (5).

Popullit publikoi Letër me Rekomandime në rastin ex officio nr. 68/2025 kundër MFPT-së për pezullimin e shtesave për fëmijë. Pas hetimeve, Avokati i Popullit konstatoi se procesi i verifikimit të dokumentacionit për të përfituar nga shtesa ishte zhvilluar në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe procedurës administrative. Vendosja e kërkesave shtesë për dokumentacion, të papërcaktuara me vendime të publikuara, si dhe pezullimi masiv i përfitimeve pa vendime individuale të arsyetuara, kishte lënë fëmijët dhe familjet e tyre pa mbrojtje efektive juridike dhe sociale. Rrjedhimisht, këto veprime kanë qenë në kundërshtim me standardet e GjEDNj-së (*D. H. dhe të tjerët kundër Çekisë, 2007*), Kushtetutën dhe KDF-në, duke mos respektuar interesin më të mirë të fëmijës.

Avokati i Popullit ka ritheksuar se interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese në çdo vendim administrativ që prek të drejtat e tij. Në këtë rast, autoritetet kanë dështuar ta zbatonin këtë parim, duke u fokusuar në procedura të paqarta verifikimi dhe jo në mbrojtjen e mirëqenies dhe në të drejtave themelore të fëmijëve. Avokati i Popullit i ka rekomanduar MFPT-së t'i publikojë në të dyja gjuhët zyrtare të gjitha vendimet, udhëzimet dhe kushtet në lidhje me procesin e verifikimit, si dhe të gjenden modalitete të përshtatshme për verifikimin e përmbushjes së kriterëve, duke u dhënë mundësi të gjithë qytetarëve të dëshmojnë përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Po ashtu, të gjithë qytetarëve, të cilëve kjo shtesë u është pezulluar, t'u ofrohen vendime individuale të arsyetuara dhe t'u paguhen në mënyrë retroaktive të gjitha pagesat që kanë mbetur të papaguara.

### **Shëndeti mendor si komponent kyç i së drejtës për shëndet**

Në maj, IAP-ja ka publikuar *Raportin me rekomandime ex officio nr. 662/2024 përgjegjësia e shtetit në raport me shëndetin mendor të fëmijëve*,<sup>135</sup> një nga hulumtimet e para në fushën e shëndetit mendor të fëmijëve në Kosovë. Raporti ofron një analizë gjithëpërfshirëse të legjislacionit dhe politikave relevante, të plotësuar me intervista me akterë kyç për të kuptuar më thellë dhe në mënyrë të strukturuar situatën e shëndetit mendor, problemet, pasojat, ndikimin dhe shërbimet e ofruara për trajtimin e fëmijëve.

Avokati i Popullit ka konstatuar se sistemi

<sup>135</sup> <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/05/organized.pdf>

i shëndetit mendor për fëmijë në Kosovë përballet me mangësi të theksuara ligjore, institucionale dhe profesionale, të cilat pengojnë ofrimin e kujdesit të hershëm, parandalues dhe të specializuar. Mungojnë dispozita ligjore dhe mekanizma sistematikë për identifikimin e hershëm të sfidave të shëndetit mendor te fëmijët, ndërsa shkollat dhe institucionet e kujdesit parësor nuk kanë trajnim të mjaftueshëm për të njohur shenjat e hershme të shqetësimit mendor. Këto intervenime të hershme dhe parandaluese janë të rëndësishme për fëmijët, sepse fëmijëria është periudha kur truri dhe personaliteti zhvillohen më shpejt. Prandaj, mbështetja e hershme ndihmon fëmijën të ndërtojë aftësi të shëndetshme dhe ul rrezikun e problemeve më serioze në të ardhmen.

Problematikë tjetër është qasja në shërbime të specializuara psikologjike, e cila është e kufizuar në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, veçanërisht në nivelin parësor dhe dytësor, ku mungojnë njësi të veçanta për fëmijë, profesionistë të specializuar dhe shërbime të vazhdueshme. Për më tepër, në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adolehentëve, numri i profesionistëve të angazhuar nuk mund të akomodojë kërkesat e pacientëve, duke e vështirësuar ndarjen e përgjegjësive sipas prapavijave profesionale. Kërkesa e madhe për vlerësime psikologjike nga pacientët dhe QPS-të, si dhe numri i ulët i profesionistëve në raport me kërkesat, e bëjnë të pamundur ofrimin e shërbimeve të psikoterapisë nga specialistët e psikologjisë klinike.

Këto mangësi thellohen edhe më tej nga mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Shëndetin Mendor dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe qasjen e fëmijëve në shërbime të shëndetit mendor. Raporti i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë të hartojë dhe zbatojë një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për shëndetin mendor të fëmijëve, duke përfshirë intervenimin e hershëm, kujdesin parandalues dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Ministria duhet të plotësojë kornizën ligjore, të zhvillojë protokolle të standardizuara dhe mekanizma efektivë monitorimi e llogaridhënieje. Po ashtu, propozohet rritja e kapaciteteve profesionale përmes rekrutimit dhe trajnimit të psikiatërve dhe psikologëve klinike, krijimi i ekipeve

të intervenimit në krizë të qasshme 24/7, rritja e kapaciteteve institucionale, si dhe zhvillimi i fushatave të shëndetit publik për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e stigmës. Ndërsa MASHTI-t i rekomandohet që të integrojë shëndetin mendor në kurrikulat shkollore, me qëllim zhvillimin e shkathtësive bazë të nxënësve për mirëqenie mendore dhe kërkim të ndihmës. Gjithashtu, rekomandohet plotësimi dhe ndryshimi i Udhëzimit Administrativ nr. 26/2013 për të siguruar praninë e psikologëve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore parauniversitare. Së fundmi, komunave u rekomandohet që të ngrenë kapacitetet lokale për shëndetin mendor të fëmijëve përmes trajnimit të mësimitdhënësve dhe psikologëve shkollorë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin adekuat të problemeve të shëndetit mendor. Po ashtu, sugjerohet rekrutimi i profesionistëve të shëndetit mendor në shërbimin parësor, krijimi i ekipeve të intervenimit në krizë, të qasshme 24/7, zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale dhe organizimi i fushatave lokale për ndërgjegjësim dhe reduktim të stigmës. Gjithsej, raporti përmban 169 rekomandime, prej të cilave 32 janë zbatuar, ndërsa të tjerat mbesin ende në pritje për zbatim.

## E Drejta për Arsimin

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dhe rregullon të drejtën për arsimim nëpërmjet nenit 47, si e drejtë që ngërthen tri obligime kryesore: (i) ofrimin e arsimit themelor të detyrueshëm dhe pa pagesë, (ii) krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili ofron mundësi të barabarta, si dhe (iii) krijimin e një sistemi arsimor, i cili përmbush nevojat dhe aftësitë themelore e specifike të çdo fëmije.<sup>136</sup> Kjo e drejtë përcaktohet edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNj) dhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).<sup>137</sup>

Në drejtim të mbrojtjes së këtyre të drejtave, në kuadër të aktiviteteve promovuese dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit, edhe gjatë vitit 2025, zhvilloi fushata informuese për nxënësit dhe mësimitdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Për këtë qëllim, u vizituan institucione arsimore parauniversitare dhe u mor pjesë në tryeza të ndryshme.

<sup>136</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47.

<sup>137</sup> Protokoll nr. 1 i KEDNj-së, neni 2, dhe Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 28.

Më 20 nëntor 2025, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Fëmijëve, Avokati i Popullit riafirmoi angazhimin e tij të palëkundur për mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të çdo fëmije, pa dallim. Kjo ditë na kujton se çdo fëmijë, kudo në botë, meriton dashuri, siguri, arsim cilësor dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tij të plotë.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 39 ankesa lidhur me të drejtën për arsim. Nga ky numër, 11 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bënin kanë qenë jashtë juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut ose ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzonte apo kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga ankesat që kemi pranuar prej qytetarëve, 28 janë hapur për hetim të mëtejshëm, ndërsa 1 rast është hapur sipas detyrës zyrtare.

Rastet e paraqitura sipas tabelës:

Ankesat e paraqitura nga individët	39
Rastet e hapura për hetim sipas ankesave të paraqitura nga ankuesit	28
Ankesat e papranueshme	11
Rastet e hapura për hetim sipas detyrës zyrtare	1
Gjithsej	40

Bazuar në analizën e rasteve të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, ankesat kanë të bëjnë me: dhunën ndaj fëmijëve në shkolla; mosregjistrimin e fëmijëve në shkollë; trajtimin diskriminues dhe të pabarabartë nga organet drejtuese të shkollave; mungesën e subvencionimit për tekste dhe materiale shkollore; përjashtimin nga shkolla; mosdhënie e përgjigjeve nga institucionet përkatëse; moslicencimin e të diplomuarve në kolegje private; pretendime për parregullsi në hartimin e pyetjeve në testet me shkrim; mosnostrifikimin e diplomës; mossigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara; mungesën e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake; mohimin e së drejtës për riprovim në shkollën e mesme; problematikën lidhur me shpërndarjen e teksteve mësimore për klasat VI–IX; dallimet strukturore dhe përmbajtjesore

mes versioneve në dy gjuhë zyrtare, si dhe statusin ligjor të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2024 për Qendrat Burimore; mospërfitimim e librave shkollorë falas; kthimin e pjesëshëm të pagesave të kryera në kolegje private dhe garantimin e moshumbjes së viteve apo krediteve të fituara si pasojë e mosakreditimit të programit; mosdhënien e përgjigjeve lidhur me njohjen dhe verifikimin e diplomave në kolegje private; mospranimin e fëmijëve në shkollë; si dhe mungesën e informimit për shtesat për studentë.

Nga gjithsej 29 raste të hapura për hetim, 14 janë mbyllur. Prej tyre, 10 raste janë zgjidhur në përputhje me kërkesat e palëve, për 3 raste është konstatuar se janë në proces të shfrytëzimit të mjeteve juridike, ndërsa 1 rast është mbyllur për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e palës ankuese me Avokatin e Popullit.

Gjatë vitit raportues, lidhur me të drejtën në arsim, Avokati i Popullit ka publikuar 4 raporte me rekomandime,<sup>138</sup> siç janë elaboruar në pjesën e këtij raporti për të drejtat e fëmijës në arsim.

- Më 28 maj 2025, Avokati i Popullit publikoi raportin lidhur me përgjegjësinë e institucioneve në raport me dhunën në shkollë.<sup>139</sup>
- Më 7 prill 2025, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandim, i cili trajton shkeljen e së drejtës së fëmijës për arsimim, si pasojë e mungesës së angazhimit të asistentit mbështetës për një fëmijë me aftësi të kufizuara.<sup>140</sup>
- Më 27 mars 2025, Avokati i Popullit publikoi *Raportin ex officio nr. 479/2023*,<sup>141</sup> i cili trajton ndikimin e peshës së çantave shkollore te nxënësit e ciklit fillor (klasat 1-5) dhe

funksionalizimin e dollapëve në shkollë.

- Më 27 maj 2025, Avokati i Popullit publikoi *Raportin ex officio nr. 676/2022*,<sup>142</sup> i cili trajton gjendjen e arsimimit dhe aftësimin gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara për qasje dhe konkurrim në tregun e punës.

Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka adresuar tek autoritetet përgjegjëse edhe 5 letra me rekomandime.<sup>143</sup> Këto letra me rekomandime janë të paraqitura në vijë:

- Më 30 qershor 2025, Avokati i Popullit publikoi Letrën me rekomandim, lidhur me mosdhënien e përgjigjes nga Komuna e Prishtinës ndaj një ankese të paraqitur nga E.S.<sup>144</sup>
- Më 16 shtator 2025, Avokati i Popullit ia adresoi Komunës së Malishevës Letrën me rekomandim, lidhur me mospërfitimim e transportit për një fëmijë me aftësi të kufizuara nga Malisheva për në Pejë dhe anasjelltas, për ndjekjen e mësimin në Qendrën Burimore “Xheladin Deda”.
- Më 22 prill 2025, Avokati i Popullit publikoi Letrën me rekomandim, e cila trajton shkeljen e së drejtës për arsim për shkak të mungesës së transportit për një fëmijë me aftësi të kufizuara.<sup>145</sup>
- Më 26 mars 2024, Avokati i Popullit publikoi Letrën me rekomandim, lidhur me cenimin e së drejtës për shkollim të fëmijës, mosofrim i transportit për distancë më të gjatë se 4 kilometra.<sup>146</sup>
- Më 21 maj 2025, Avokati i Popullit ia adresoi Letrën me rekomandim Këshillit Drejtues të Shkollës “Elena Gjika” në Prishtinë, lidhur me ligjshmërinë e marrëveshjes së shkollës dhe prindërve të nxënësve të klasave të para dhe të gjashta.

138 R.nr.565/2023; Ex - Officio nr. 695/2022; Ex - Officio nr. 479/2023; Ex - Officio nr.661/2024.

139 <https://oik-rks.org/2025/05/29/raportin-e-avokatit-te-popullit-ex-officio-661-2024-pergjegjesia-e-institucioneve-ne-raport-me-dhunen-ne-shkolla/>

140 <https://oik-rks.org/2025/04/14/raport-i-avokatit-te-popullit-ankesa-nr-565-2023-lidhur-me-cenimin-e-se-drejtës-se-femijes-per-shkollim-mosangazhim-te-asistentit-per-femijen-me-aftesi-te-kufizuara/>

141 <https://oik-rks.org/2025/05/13/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-479-2023-lidhur-me-ndikimin-e-peshes-se-cantave-tek-femijet-e-shkollave-fillor-cikli-1-5-funksionalizimin-e-dollapeve-ne-shkolla/>

142 <https://oik-rks.org/2025/05/29/raportin-e-avokatit-te-popullit-ex-officio-695-2022-lidhur-me-arsimimin-dhe-aftesimin-gjithepershires-t%D1%91-personave-me-aftesi-te-kufizuara-p%D1%91r-qasjen-ne-tregun-e-punes/>

143 R.nr.1103/2024; R.nr. 1052/2024; R.nr. 924/2024; R.nr. 1272/2024; R.nr. 1126/2025

144 <https://oik-rks.org/2025/06/30/leter-rekomandim-i-avokatit-te-popullit-r-nr-1272-2024/>

145 <https://oik-rks.org/2025/04/22/leter-rekomandim-r-nr-1103-2024/>

146 <https://oik-rks.org/2025/03/27/leter-rekomandim-r-nr-1052-2024-lidhur-me-cenimin-e-se-drejtës-per-shkollim-te-femijes-mosofrim-i-transportit-per-distancen-me-te-gjate-se-4-kilometra/>

## Arsimi parauniversitar

Avokati i Popullit ka vërejtur se edhe këtë vit janë paraqitur probleme në të drejtën për arsim në raport me shpërndarjen e teksteve shkollore. Për furnizim me tekste shkollore u kërkua që prindërit të aplikojnë përmes platformës “e-Kosova” dhe më pas t’i marrin mjetet financiare për blerjen e teksteve shkollore. Kjo është përcjellë me probleme të shumta dhe vonesa të panevojshme; shumë prindër kishin vështirësi në aplikim dhe pati vonesa për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore.

Në nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme gjatë vitit 2025, përkundër angazhimit të MASHTI-t për ndërtimin e çerdheve të reja, ende vazhdon të ketë përfshirje të ulët të fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme. Gjatë këtij viti raportues, MASHTI prezantoi Kurrikulën e re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) për fëmijët 0–6 vjeç, e cila paraqet një vizion modern dhe gjithëpërfshirës, e vendos fëmijën në qendër të procesit mësimor dhe mbështetet në filozofinë e të nxënësve nëpërmjet lojës dhe mirëqenies së fëmijës.<sup>147</sup>

Lidhur me arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit, ashtu sikurse edhe në raportet vjetore të viteve të kaluara, shpreh shqetësimin e tij lidhur me mungesën e asistentëve për këta fëmijë. Po ashtu, është shqetësues fakti se transporti sigurohet vetëm për disa fëmijë. Prandaj Avokati i Popullit u ka rekomanduar autoriteteve përgjegjëse marrjen e masave për sigurimin e qasjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirjen e plotë të fëmijëve në arsim.

Mësimdhënia në Republikën e Kosovës zhvillohet në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake. Për sa i përket së drejtës për arsimin të komunitetit serb, shkollat që zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe ende vazhdojnë të punojnë me planprograme të Republikës së Serbisë, pa u miratuar nga MASHTI. Ndërsa, lidhur me përfshirjen e komuniteteve të tjera, Avokati i Popullit e vlerëson pozitivisht vazhdimin e përkrahjes financiare të ofruar për studentët romë, ashkalinj dhe egjiptianë.<sup>148</sup>

## Arsimi universitar

Për sa i përket arsimit universitar, më 14 korrik 2025, pas vlerësimit pozitiv nga ekipi i pavarur i ekspertëve të Asociacionit Evropian

për Sigurimin e Cilësisë (ENQA), Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është regjistruar në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). Si rezultat, diplomat e studentëve kosovarë do të kenë vlefshmëri të garantuar dhe të njohur ndërkombëtarisht, si në kuptimin akademik, ashtu edhe profesional, në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Regjistrimi në EQAR është tregues se diploma vjen nga një program ose institucion që përmbush standardet rigorozë të cilësisë, duke u garantuar studentëve dhe punëdhënësve vlerën e diplomës. Nga ana tjetër, institucionet e arsimit të lartë në vend do të kenë qasje të plotë në programe të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit, mundësi për njohje ndërkombëtare, partneritete, financim, tërheqje studentësh dhe zhvillim të vazhdueshëm.<sup>149</sup> Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se ky është një sukses i arritur me angazhimin e AKA-së, i cili siguron cilësinë e programeve studimore në arsimin universitar.

Gjithashtu, sikurse në vitet paraprake, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ende mbetet sfida zvarritja e miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, prandaj, me qëllim të përfundimit të autonomisë dhe integritetit akademik të institucioneve të arsimit të lartë dhe përmirësimit të cilësisë, Avokati i Popullit, rekomandon që sa më parë të miratohet nga Kuvendi Ligji për Arsimin e Lartë.

Gjithashtu, sikurse në vitet paraprake, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese mbetet sfida zvarritja e miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë. Prandaj, me qëllim të përfundimit të autonomisë dhe integritetit akademik të institucioneve të arsimit të lartë dhe përmirësimit të cilësisë, Avokati i Popullit rekomandon që sa më parë të miratohet nga Kuvendi Ligji për Arsimin e Lartë.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit vëmendje të veçantë i ka kushtuar cilësisë së arsimimit të personave me aftësi të kufizuara në raport me qendrat burimore dhe qendrat profesionale. Për sa i përket cilësisë së arsimit për personat me vështirësi në dëgjim, bazuar në informatat e siguruar në takimet me organizatat e shoqërisë civile, që mbrojnë të drejtat e personave të shurdhër, është kuptuar se personat e shurdhër, edhe pas përfundimit të shkollimit, nuk arrijnë nivelin e duhur të arsimit profesional për të qenë të gatshëm për tregun e

147 Për më shumë informata, shih: [Prezantohet Kurrikula e re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme për moshën 0-6 vjeç – MASHTI](#)

148 [Njoftim – MASHTI](#)

149 [Agjencia e Kosovës për Akreditim regjistrohet në EQAR – Agjencia e Kosovës për Akreditim](#)

punës. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit është duke vazhduar hetimet dhe gjetjet preliminare tregojnë mangësi të shumta, duke filluar nga vetë përgatitja e personelit mësimdhënës në këto qendra.

Avokati i Popullit, edhe në *Raportin ex officio nr. 695/2022*, me të cilin ka trajtuar gjendjen e arsimimit dhe aftësimin gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara për qasje dhe konkurrim në tregun e punës, ka evidentuar pengesa të shumta strukturore dhe institucionale në arsimim dhe aftësim profesional, përfshirë mungesën e programeve gjithëpërfshirëse etj.

## Liria e Artit dhe e Shkencës

Liria e artit dhe e shkencës, si një nga format më specifike të manifestimit të mendimit artistik dhe shkencor, është e garantuar jo vetëm me instrumente ndërkombëtare, por edhe me Kushtetutën dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 48, thekson qartë: “1. *Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar*”. “2. *Liria akademike është e garantuar*”.<sup>150</sup>

Liria e artit dhe e shkencës nënkupton lirinë dhe të drejtën e secilit/es që të marrë pjesë në krijimin e veprave shkencore dhe artistike dhe që si autor/e të gëzojë në mënyrë të patjetërsueshme mbrojtjen e interesave që rrjedhin nga veprat që janë rezultat i krijimtarisë së tij/saj.

Gjithashtu, në kuptim të përmbajtjes së paragrafit 2 të nenit 48 të Kushtetutës, duhet theksuar se me lirinë e krijimtarisë artistike dhe shkencore është ngushtë e lidhur edhe garancia e veçantë kushtetuese e lirisë akademike, do të thotë e autonomisë së universiteteve - institucioneve të shkollimit të lartë shkencor, e që është me rëndësi të veçantë për punën krijuese shkencore dhe artistike të mësimdhënësve universitarë.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare e Festivalit “Mal Fest”, parashtruar kundër Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për mosperkrahje financiare. Ky festival ka rëndësi për promovimin e trashëgimisë kulturore, nxitjen e krijimtarisë artistike dhe forcimin e lidhjes së diasporës me

vendlindjen. Rasti është ende në procedurë hetimore. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë tjetër lidhur me të drejtën e autorit nga një qytetare e komunitetit turk, e cila pretendon se fotografia e vitit 1966, me titull “Vajza e Kosovës (Kosovarja)”, i përket nënës së saj, Q.L. Fotografia, e realizuar në baker ose në formë pikturë, është shitur prej vitesh në Kosovë, ndërsa ankuesja nuk ka mundur ta ushtronte të drejtën e autorit dhe nuk ka përfituar asgjë nga përfitimet financiare që kanë pasur të tjerët. Avokati i Popullit vëren se qytetarët shpesh nuk janë të informuar për të drejtat që u garanton ligji mbi pronësinë intelektuale. Ky fakt nënvizon nevojën që autoritetet të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuese dhe të ofrojnë informim adekuat për të drejtat e autorëve dhe pronës intelektuale.

<sup>150</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

## E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve

E drejta e punës dhe ushtrimi i profesioneve garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>151</sup> dhe është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.<sup>152</sup> Përveç kësaj, kjo e drejtë është e rregulluar dhe mbrohet edhe me ligje bazike që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.<sup>153</sup>

Avokati i Popullit vëren se realizimi i të drejtave të qytetarëve në fushën e marrëdhënies së punës ka një rëndësi të veçantë për statusin e çdo qytetari dhe përbën një indikator të qartë të mënyrës se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve. Garancitë kushtetuese për të drejtën e punës dhe për të drejtën për ushtrimin e profesioneve krijojnë detyrime për institucionet që t'i mbrojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve dhe të sigurojnë respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.

Avokati i Popullit vazhdon të trajtojë marrëdhëniet e punës si një nga problematikat kryesore dhe më të rëndësishme në shqyrtimin e ankesave nga persona që punojnë në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 189 ankesa lidhur me të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesioneve. Këto ankesa trajtonin çështje, si: ndërprerja e marrëdhënies së punës, mosrealizimi i së drejtës në pagë dhe zvogëlimi i saj, sistemimi i padrejtë në vendin e punës, heqja e shtesave, problemet me koeficientin e pagës, si dhe trajtimi joadekuat dhe jo i barabartë ndërmjet pozitave të përcaktuara me ligj. Ankesat ishin nga të punësuarit në sektorin publik dhe privat, disa nga grupe punonjësish<sup>154</sup> dhe përmes sindikatave.<sup>155</sup>

Viti 2025, ashtu sikurse vitet e mëparshme, u karakterizua edhe nga greva në disa sektorë për përmirësimin e kushteve të punës. Përfshihen

punëtorët e kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” në Prishtinë, punëtorët e “Trainkosit” dhe “Infrakosit”, punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës, punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës dhe KOSTT-it, punëtorët e Trafikut Urban në kryeqytet, si dhe sektori privat, si: Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat, punëtorët e sigurimit fizik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, punëtorët e sigurimit fizik të Komunës së Prishtinës dhe punëtorët e Feronikelit, për largim kolektiv nga puna etj.<sup>156</sup> Këto grupe kërkonin përmirësim të kushteve të punës dhe trajtim të barabartë.<sup>157</sup>

Avokati i Popullit konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese vazhdojnë të shfaqen shkelje të së drejtës nga marrëdhënia e punës, si në sektorin publik, e sidomos në atë privat. Këto përfshijnë diskriminim, shkelje të procedurave të punësimit, ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, shkelje lidhur me kohëzgjatjen e orarit të punës, kompensimin për punë jashtë orarit, mohimin e së drejtës për pushim vjetor dhe pushim të lehonisë, si dhe mosrealizimin e së drejtës në pagë<sup>158</sup>.

Avokati i Popullit thekson se Inspektorati i Punës, si mekanizëm parandalues dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, duhet të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha vendet e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, duke mbikëqyrur kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve. Veçanërisht, duhet të veprojë aktivisht për ndalimin e të gjitha formave të diskriminimit. Avokati i Popullit konstaton se mbrojtja gjyqësore lidhur me marrëdhënien e punës nuk është në nivelin e duhur, pasi një procedurë gjyqësore në kontestet e punës zgjat mesatarisht 6 deri në 8 vjet deri në një vendim të plotfuqishëm. Kjo situatë vendos punëtorët në një pozicion të vështirë për realizimin e të drejtave të tyre.

Gjithashtu, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen për mosfunksionimin e Këshillit Ekonomiko-Social, që ka pasoja të vazhdueshme dhe vë në pikëpyetje qëllimin e themelimit të tij.

151 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

152 Po aty, neni 22.

153 Ligji nr. 03/L-212 i Punës; Ligji nr.03/L-145 për Shërbimin Civil; Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë; Ligji nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

154 Rasti: Ex-officio 275/2025, lidhur me uljen e koeficienteve pas caktimit fillestar të një koeficienti më të lartë, ku përfshihen disa institucione publike, të cilët janë ankuar se u është ndryshuar koeficienti dhe pas uljes së koeficientit janë detyruar ta kthenin diferencën e pagës.

155 Komunikatë për shtyp – Deklarata e Avokatit të Popullit në lidhje me Radiotelevizionin e Kosovës, <https://oik-rks.org/2025/07/25/komunikate-per-shtyp-deklarata-e-avokatit-te-popullit-ne-lidhje-me-radiotelevizionin-e-kosoves/>

156 <https://gazetametro.net/largimi-i-mbi-500-punetoreve-sindikata-e-punetoreve-te-feronikelit-situata-alarmante/>

157 <https://gazetabolic.com/punetoret-ne-kosove-edhe-ne-vitin-2025-protestuon-per-paga-me-te-larta/>

158 Rastet: 592, 1235, 1253 dhe 1268/2025, lidhur me diskriminimin në punë kundër Kombinatit Trepça Sh.A.

Dialogu social në Kosovë ka rëndësi të veçantë për realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve, nëpërmjet zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe ose trepalëshe.

Avokati i Popullit vëren se marrëveshjet kolektive të punës janë instrument i rëndësishëm për rregullimin e kushteve të punës dhe të punësimit, si dhe për realizimin e të drejtave nga puna. Dispozitat e kontratës kolektive kanë efekt juridik të përgjithshëm dhe mund të plotësojnë ose zëvendësojnë normat ligjore. Mosarritja e një marrëveshjeje të përgjithshme kolektive, e cila kishte skaduar në vitin 2018, ka ndikuar në përkeqësimin e realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës në sektorin publik dhe privat.

Avokati i Popullit thekson rëndësinë e miratimit të kontratës kolektive të punës, si një instrument kyç që garanton realizimin e të drejtave ligjore, përmirësimin e kushteve të punës dhe zbatimin e të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës.

### **Mbrojtja dhe siguria në punë**

Ligji nr. 03/L-212 për Marrëdhëniet e Punës, në nenin 42, paragrafi 1, përcakton: *“I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.”* Një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm është parakusht themelor për parandalimin e rreziqeve në procesin e punës, me qëllim ruajtjen e jetës, shëndetit dhe dinjitetit të punonjësve.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka përcjellë me shqetësim rastet e aksidenteve në punë, përfshirë ato me fatalitet. Sipas të dhënave zyrtare të Inspektoratit të Punës, janë evidentuar 515 aksidente në vendet e punës, nga të cilat 19 kanë rezultuar me humbje jete.<sup>159</sup> Numri më i madh i aksidenteve dhe lëndimeve është regjistruar në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si ndërtimtaria, prodhimtaria, elektriciteti, shërbimet etj.

Avokati i Popullit vëren mospërputhje në të dhënat statistikore, pasi nuk ekziston një sistem i integruar për mbledhjen e të dhënave nga autoritetet përkatëse. Për shembull, Sindikata e Punëtorëve të Sektorit Privat ka raportuar se

gjatë vitit 2025, 32 persona kanë humbur jetën në vendin e punës dhe janë regjistruar gjithsej 1745 aksidente, duke e konsideruar vitin 2025 si vitin me numrin më të lartë të aksidenteve dhe vdekjeve në vendin e punës. Sektorët kryesorë të raportuar janë ndërtimtaria, prodhimtaria, shërbimet dhe elektriciteti, ku shënohen më shumë fatalitete dhe lëndime.<sup>160</sup> Kjo tregon se besueshmëria e të dhënave mbetet sfiduese dhe e diskutueshme.

Avokati i Popullit thekson se këto shifra bëhen edhe më shqetësuese duke marrë parasysh zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe nivelin e zbatueshmërisë së legjislacionit për marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se, edhe gjatë periudhës raportuese, Kosova vazhdon të përballet me mungesën e sigurimit shëndetësor për qytetarët dhe mosfunksionimin e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, gjë që vë në pikëpyetje përmirësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së sigurisë në punë.

Pavarësisht se mbrojtja dhe siguria në punë janë të garantuara ligjërisht, Avokati i Popullit shqetësohet për mungesën e hetimit të duhur nga Inspektorati i Punës dhe organet hetuese, si dhe për mosndëshkimin e punëdhënësve që nuk i sigurojnë punëtorët dhe ambientet e punës.

## **Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale**

Neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në paragrafin 1 përcakton: *“Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.”* Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.”*

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka pranuar 202 ankesa nga qytetarët në lidhje me cenimin e të drejtave shëndetësore dhe sociale, prej të cilave janë hapur për hetim 39 raste. Përveç kësaj, Avokati i Popullit ka iniciuar edhe 5 raste sipas detyrës zyrtare.

<sup>159</sup> Përgjigje më 26 dhjetor 2025, nga z. Rizah Plakolli, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, në shkresën e dërguar më 23 dhjetor 2025. Të dhënat për vitin 2025 i referohen periudhës janar - nëntor 2025.

<sup>160</sup> Bisedë me kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, z. Jusuf Azemi, më 6 janar 2026. Të dhënat për vitin 2025 i referohen periudhës janar - dhjetor 2025.

Nga fusha sociale, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa të shumta lidhur me çështje të tilla si ndërprerja e pensioneve, ndërprerja e shtesave për fëmijë, vështirësi në aplikimin online përmes platformës “e-Kosova” për shtesat e fëmijëve, vonesa në vlerësimin e gjendjes shëndetësore nga komisionet përkatëse, mosnjohja e të drejtave për pensione të dyfishta, bllokimi i xhirollogarive të pensionistëve nga përmbaruesit privatë, heshtje administrative nga komisionet e shkallës së dytë, mosnjohja e statusit të ish- të dënuarve dhe ish- të përndjekurve politikë, si dhe mosekzekutimi i pagesave nga programi i subvencionimit të energjisë elektrike për konsumatorët e cenueshëm. Po ashtu, janë trajtuar ankesa lidhur me moszbatimin e aktgjykimeve që lidhen me të drejtat e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zvarritje të procedurave gjyqësore për çështjet e pensioneve kontributpaguese.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka hapur raste sipas detyrës zyrtare lidhur me problematikën e banimit social në qendrat kolektive në Komunën e Leposaviqit, për çështje që lidhen me vendimet e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) për rritjen e çmimit të energjisë elektrike<sup>161</sup> dhe për pagesën e faturave të ujit.<sup>162</sup>

Avokati i Popullit ka publikuar dy raporte me rekomandime dhe një opinion ligjor nga fushëveprimi i së drejtës sociale. Raporti R. nr. 94/2024, lidhur me mohimin e së drejtës për reduktimin e tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjikë, tetraplegjikë dhe personat e verbër,<sup>163</sup> konstatoi se kriteret e përcaktuara në programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm i vendosin këta persona në një pozitë të pafavorshme dhe vështirëson pozitën e tyre sociale. Këto kritere nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Kjo për faktin se përfituesit sipas programit janë vetëm familjet me të ardhura të ulëta, ndërsa ligji u garanton të drejtën të gjithëve që kanë status sipas këtij ligji.

Gjatë vitit 2025, ZRRÉ-ja njoftoi për rritjen e tarifave të energjisë elektrike dhe liberalizimin e tregut, vendim që u prit me reagim, debat, kritika dhe protesta, duke shqetësuar qytetarët për rritjen e kostos së jetesës. Lidhur me

këto shqetësime, Avokati i Popullit mbajti takime informuese me Bordin e ZRRÉ-së dhe me organizatat e shoqërisë civile, të cilat kundërshtonin këto vendime, për të siguruar informacion të plotë lidhur me shqetësimet e ngritura. Pas vlerësimit të informatave, Avokati i Popullit publikoi Opinionin R. nr. 538/2025, duke shprehur qëndrimin e tij për efektet negative të rritjes së çmimit të energjisë elektrike nga ZRRÉ-ja, sii dhe efektet negative të krijuara nga kjo rritje, në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve.

Në fushën e pensioneve, Avokati i Popullit ka trajtuar ankesa lidhur me ndërprerjen e pensioneve kur administrata kërkon nga përfituesit të heqin dorë nga një pension, edhe kur u takojnë dy apo më shumë pensione bazuar në ligje të ndryshme. Gjykatat në raste të kontestuara kanë konstatuar shkelje dhe kanë anuluar vendimet e Administratës Pensionale, duke garantuar të drejtat ligjore të ankuesve. Për sqarimin e kësaj çështjeje, më 24 nëntor 2025, Avokati i Popullit publikoi Raportin ex officio nr. 614/2024 për njohjen e së drejtës në dy pensione mbi dy baza ligjore të ndryshme (pensione të dyfishta).<sup>164</sup> Ky raport vë në pah vlerësimin e situatës në raste kur një përfitues i një skeme pensionale e ka fituar atë të drejtë sipas Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, si një e drejtë pronësore, dhe në të njëjtën kohë përfiton një pension apo kompensim tjetër sipas një baze tjetër ligjore.

Një çështje tjetër lidhet me të drejtat e përfituesve të pensioneve dhe detyrimin për t'u paraqitur në Administratën Pensionale për të dëshmuar se janë në jetë. Në raport me këtë çështje, Gjykata Supreme e ka aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit E. Sh., të paraqitur kundër së paditurës - Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – Departamentit të Pensioneve.<sup>165</sup> Është shpallur i paligjshëm dhe është shfuqizuar neni 4, paragraf 2, i Udhëzimit Administrativ nr. 05/2015 (MPMS) për Procedurat e Lajmërimit, Suspendimit nga Pagesa dhe Kthimin e Mjeteve në Rastet e Keqpërdorimit të Pensioneve. Është shpallur i paligjshëm dhe është shfuqizuar neni 5, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, i këtij Udhëzimi. Gjykata Supreme në arsyetim të këtij vendimi ka theksuar se çdo rregullim nënligjor që

161 Shih rastin Ex officio nr.538/2025.

162 Shih rastin Ex officio nr.266/2025.

163 E qasshme në linkun: <https://oik-rks.org/2025/04/14/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-94-2024-lidhur-me-mohimin-e-te-drejtës-ne-reduktimin-e-tarifave-te-energjise-elektrike-per-personat-paralegjik-tetraplegjik-dhe-personat-e-verbër/>

164 E qasshme në linkun: <https://oik-rks.org/2025/11/25/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-614-2024-lidhur-me-njohjen-e-se-drejtës-ne-dy-pensione-mbi-dy-baza-ligjore-te-ndryshme-pensione-te-dyfishta/>

165 E qasshme në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2025/12/17/aprovohet-padia-e-e-sh-shpallen-te-paligjshme-nenet-qe-obligojne-pensionistet-te-lajmerohen-ne-departamentin-e-pensioneve/>

imponon paraqitje të detyrueshëm, afate të reja materiale, suspendim të automatizuar apo pasojë të humbjes së pensioneve për kategori që ligji nuk i ka përfshirë shprehimisht, është i paligjshëm.

Duhet theksuar se vendimi gjyqësor ka krijuar paqartësi nëse janë të liruar të gjithë personat përfitues të skemave pensionale nga ky detyrim. Pas publikimit të Aktgjykimit, Administrata Pensionale doli me sqarim publik, duke bërë të qartë se nga ky detyrim lirohen vetëm disa kategori. Është vlerësim i Avokatit të Popullit se kjo zgjidhje është e pjesshme dhe nuk zgjidh problemin në themel. Çështja kryesore që është diskutuar gjatë viteve për përfituesit e skemave pensionale është privimi nga e drejta që në mënyrë retroaktive të kthehen pensionet të cilat janë ndaluar pas periudhës së mosparaqitjes sipas akteve nënligjore. Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit, më 25 nëntor 2016, kishte publikuar Raportin ex officio nr. 382/2016 në lidhje me cenimin e dinjitetit dhe të së drejtës së pensionistëve për pensione,<sup>166</sup> duke konstatuar se procedurat e paraqitjes dhe suspendimit nga pagesa janë diskriminuese dhe cenojnë dinjitetin e pensionistëve. Prandaj, Avokati i Popullit kishte rekomanduar ndryshimin dhe plotësimin e ligjit me qëllim të rregullimit të plotë dhe të përhershëm të kësaj çështjeje. Megjithatë, rekomandimet nga ky raport nuk janë zbatuar.

Avokati i Popullit vëren se gjatë vitit 2025, Qeveria ka ndërmarrë disa masa për përmirësimin e situatës sociale për grupet e ndjeshme të shoqërisë, duke rritur vlerën e pensioneve bazë për 25%, dhe vendimin për shtesat të njëhershme në dhjetor të vitit 2025 në shumën prej 100 eurosh për të gjithë pensionistët dhe fëmijët. Por, Avokati i Popullit konstaton se, për shkak të inflacionit, masat e ndërmarra kanë pasur ndikim afatshkurtër në përmirësimin e gjendjes sociale-ekonomike për familjet dhe individët përfitues.

Avokati i Popullit ripërsërit faktin se Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vazhdon të mos jetë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, nga ajo që u tha më sipër, vërehet se Republika e Kosovës nuk e ka të rregulluar mjaftueshëm legjislacionin në fushën sociale për disa nga grupet e ndjeshme shoqërore që bazohet në standardet ndërkombëtare dhe

që do ta rregullonte mirëfilli fushën e sigurimit social për qytetarët e saj.

Të drejtat shëndetësore në Kosovë garantojnë përmes ligjeve dhe akteve të tjera juridike, me ç'rast aty përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësi. Por, përkundër kësaj, numri i ankesave të pranuar gjatë vitit 2025 ka treguar se mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave deri më tash janë treguar të pamjaftueshëm dhe, si rrjedhojë, as gjatë këtij viti raportues nuk mund të flasim për një ofrim të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Ndër ankesat e pranuar nga e drejta shëndetësore gjatë vitit raportues janë evidentuar ankesa lidhur me mungesën e barnave të rastet e pacientëve të diagnostifikuar me kancer, vonesa në ekzekutimin e pagesave të vendimeve për subvencione për barna, mosofrimi i ndihmës shëndetësore nga profesionistët shëndetësorë, privim i kundërligjshëm nga liria me trajtim të pavullnetshëm psikiatrik, mungesa e kushteve higjienike dhe ushqimore në disa prej institucioneve shëndetësore të nivelit terciar, mospërfilljen e vendimeve gjyqësore nga institucionet shëndetësore psikiatrike lidhur me zbatimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, mungesa e komunikimit të mirëfilltë mjek-pacient etj.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit i ka hapur dy raste ex officio nga fusha e të drejtave shëndetësore, të cilat kanë trajtuar problematikën e hemodializës për kosovarët në Shqipëri,<sup>167</sup> si dhe janë duke u zhvilluar hetime lidhur me mungesën e sistemit paliativ dhe legjislacionit adekuat që e rregullon këtë fushë.<sup>168</sup>

Në rastin e hemodializës, Avokati i Popullit hapi rast sipas detyrës zyrtare për të zhvilluar hetime, duke u bazuar në raportimet e mediave të shkruara dhe elektronike, të cilat publikuan lajmin se Shqipëria s'i trajton falas kosovarët në hemodializë dhe se Avokati i Popullit në Tiranë ka nisur një hetim.<sup>169</sup> Më tej, mediat thanë se pacientët nga Republika e Shqipërisë i marrin falas shërbimin e hemodializës në institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës, ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të

<sup>166</sup> E qasshme në linkun: [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/old\\_doc/1104-2016\\_382-2016Raport\\_me\\_rekomandime\\_723722.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/old_doc/1104-2016_382-2016Raport_me_rekomandime_723722.pdf)

<sup>167</sup> Shih rastin Ex officio nr.1052/2025.

<sup>168</sup> Shih rastin Ex officio nr.953/2025.

<sup>169</sup> E qasshme në linkun: <https://www.koha.net/arberi/shqiperia-si-trajton-falas-kosovaret-ne-hemodialize-avokati-i-popullit-ne-tirane-nis-hetim>

paguajnë njëqind e pesëdhjetë euro (150) për një seancë hemodialize në Republikën e Shqipërisë.

Pas kësaj, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës i dërgoi shkresë Avokates së Popullit në Republikën e Shqipërisë, nga e cila kërkoi informata për rezultatet e hetimeve dhe epilogun që mori kjo çështje në Institucionin e Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipëri. Avokatja e Popullit e Republikës së Shqipërisë njoftoi se, pasi e kishte hetuar këtë çështje, i kishte nxjerrë dy rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë, duke rekomanduar ndërmarrjen e masave konkrete dhe të menjëhershme lidhur me ofrimin falas të shërbimit të hemodializës për shtetasit e Republikës së Kosovës, me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Më 13 janar 2025, Avokati i Popullit publikoi Raportin nr.649/2024 në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin në fuqi për ofrimin e kujdesit shëndetësor stomatologjik,<sup>170</sup> me ç'rast konstatoi se vajza e ankuesit është viktimë e diskriminimit mbi bazën e gjendjes shëndetësore, si dhe mbi bazën e aftësisë së kufizuar.

Ndërsa, më 5 maj 2025, Avokati i Popullit publikoi Raportin ex officio nr.662/2024 lidhur me përgjegjësinë e shtetit në raport me shëndetin mendor të fëmijëve.<sup>171</sup>

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, më 10 dhjetor 2025, Avokati i Popullit organizoi tryezë diskutimi përkitazi me temën: “Shëndeti mendor i personave të moshuar: Detyrimi i shtetit për përkujdesje, mbrojtje dhe dinjitet dhe roli i Avokatit të Popullit”. Gjatë kësaj tryeze, Avokati i Popullit theksoi se shoqëria kosovare vazhdon të përballet me sfidat dhe probleme për sa i përket shëndetit mendor, e në veçanti të shëndetit të qytetarëve të moshës së tretë. Aty u tha se Raporti Ex officio nr. 601/2023, në lidhje me detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën konstatoi se kufizimi i moshës mbi 65 vjeç për personat me probleme të shëndetit

mendor, si kriter për t'u pranuar në institucionet përkatëse, përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Po ashtu, Avokati i Popullit ka gjetur se mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor sfidon zbatimin e këtij ligji dhe krijon hapësirë për praktika diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor, lidhur me kufizimin e moshës për personat mbi 65 vjeç. Çështjet kryesore që dolën si konkluzion nga ky takim ishin:

Nevoja për finalizimin e Ligjit për Shëndetin Mendor, zbatimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore dhe të SISh-it, përfundimin e Strategjisë për Shëndetin Mendor, ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve geriatrike, hartimin e protokolleve të qarta për trajtimin e personave me çrregullime mendore, rishikimin e procedurave dhe forcimin e garancive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, hartimin e politikave sociale që sigurojnë kosto të përballeshme për familjet etj.

## Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

Mjedisi dhe mbrojtja e tij janë përcaktuar si vlerë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Për më tepër, mbrojtja e mjedisit është renditur si përgjegjësi, ku secili, e në veçanti institucionet, kanë obligim dhe përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit. Kushtetuta garanton qasje në vendimmarrje mjedisore.

Avokati i Popullit, nga monitorimi i gjendjes që lidhet me këtë të drejtë dhe bazuar në ankesat e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, vëren se edhe këtë vit nuk janë ndërmarrë veprime institucionale, të cilat do të shënonin përmirësime të dukshme dhe ndërprerje të veprimeve arbitrare në mjedis, nëpërmjet të cilave do t'u sigurohej qytetarëve mjedis cilësor. Në këtë situatë ndikoi edhe mungesa e konstituimit të institucioneve pas zgjedhjeve nacionale, pasi nuk kishte asnjë zhvillim në drejtim të avancimit të legjislacionit.<sup>172</sup>

Nga analizimi i rasteve të pranuar që kanë të bëjnë me ndotjen e ujërave, tokës dhe ajrit, bezdinë nga zhurma, problemet e ndotjes me mbeturina, problematikat lidhur me planifikimin

170 E qasshme në linkun: <https://oik-rks.org/2025/01/13/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-649-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shtetërore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi-dhe-me-legjislacionin-ne-fuqi-p/>

171 E qasshme në linkun: <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-6662-2024-pergjegjesia-e-shtetit-ne-raport-me-shendetin-mendor-te-femijeve/>

172 Gjashtë projektligje të fushës së mjedisit të miratuara me Vendimin Nr. 03/247, datë 31.1.2025, në Programin e projektligjeve për vitin 2025 – 2027.

hapësinor dhe infrastrukturën ujore,<sup>173</sup> si dhe mosveprimin e autoriteteve në drejtim të problemeve mjedisore,<sup>174</sup> vërehet se, përveç kufizimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, kufizohen edhe të drejta të tjera.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ngre shqetësimin lidhur me situatën e mjedisit dhe kaosin urbanistik në vendet urbane, në veçanti në Komunën e Prishtinës dhe në qendrat e tjera të mëdha, si dhe tendencën e përkeqësimit. Ndotja e ajrit, ndërtimet e larta pa kriter, tejkallimet e etazhitetit, mospërcjellja e balancuar e ndërtimeve me infrastrukturë rrugore dhe ujore, trotualet jashtë standardeve dhe, në shumë raste, mungesa e tyre, mosrespektimi i kriterëve për qasje për personat me aftësi të kufizuara, mosndërmarrja e veprimeve për përmirësimin e transportit publik, përdorimi i lëndëve djegëse alternative dhe zhvillimi i planeve të qëndrueshme të lëvizshmërisë urbane që u përmbahen standardeve mjedisore dhe sociale të BE-së, si dhe keqmenaxhimi i mbeturinave, janë duke kufizuar në thelb të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

Angazhimi i Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen, promovimin dhe monitorimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, përveç se ka ndikuar në rritjen e besimit në publik dhe rritjen e numrit të ankesave, është vlerësuar edhe nga institucionet ndërkombëtare. Raporti i Projektit Rajonal të Këshillit të Evropës për “Të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore” ka konstatuar se Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetmi autoritet, i cili “u referohet më shpesh neneve të KEDNJ-së apo praktikës së GjEDNJ-së në praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë”. Sipas raportit, “Avokati i Popullit duhet

përgëzuar për prirjen e tij më të madhe drejt përdorimit më të gjerë të këtyre standardeve në raportet e tij lidhur me mbrojtjen e lumenjve, menaxhimin e mbetjeve dhe hidrocentralet në Kosovë.”<sup>175</sup>

Bazuar në raportet mujore për gjendjen e ajrit në vend,<sup>176</sup> Avokati i Popullit vëren se cilësia e ajrit është pothuajse e ngjashme nga viti në vit, me tejkallime të dukshme me PM10 dhe PM2.5 në periudhat janar – mars dhe tetor – dhjetor. Edhe pse ajri jokualitativ është bërë realitet që cenon në vazhdimësi shëndetin e qytetarëve,<sup>177</sup> organet kompetente ende nuk kanë treguar ndonjë interesim për hapa konkretë për përmirësimin e gjendjes, edhe pse tejkallimet tashmë janë duke paraqitur kërcënim serioz për shëndetin e qytetarëve. Edhe pse është e dokumentuar që burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit janë përdorimi i linjtit për prodhimin e energjisë,<sup>178</sup> drurit dhe thëngjillit për amvisëri,<sup>179</sup> si dhe mjetet e transportit, shteti ende nuk i ka orientuar investimet në mbrojtje të ajrit. Zëvendësimi i ngrohjes në amvisëri me sistem të kogjenerimit vazhdon me hapa të ngadaltë. Edhe pse situata me shfrytëzimit të transportit shënon përkeqësim nga viti në vit, shteti ende nuk ka ndërmarrë veprime për stimuluese për energji të ripërtërishme, transport të qëndrueshëm, zëvendësimin e veturave të vjetra me të reja,<sup>180</sup> masa efektive për zvogëlimin e ngarkesave në trafik, etj. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit, e vlerëson shqetësuese dhe jotoleruese mos ndërmarrjen e masave ligjore për mbrojtje nga ndotja gjatë së ndërtimeve të objekteve dhe rrugëve.

Avokati i Popullit, në lidhje kundërmimin e mbeturinave me ndikimin e tyre negativ në jetën private të qytetarëve, ka publikuar Raportin me rekomandime R. nr. 1326/2024,<sup>181</sup>

173 [R/995/2024](#), [R/683/2024](#)

174 Përgjegjësia për mjedisin jetësor - janë pranuar 25 ankesa; 13 ankesa të pranueshme për hetime; 12 ankesa të papranueshme.

175 <https://rm.coe.int/baseline-study-human-rights-environment-southeast-europe-march-2025-fi/488028e14>  
<https://rm.coe.int/baseline-study-human-rights-environment-southeast-europe-march-2025-al/48802938b0>  
[https://rm.coe.int/osnovna-s-zakonodavtsvu-politici-i-sudskoj-praksi-u-oblasti-lj/488028e14a\\_tudija-o](https://rm.coe.int/osnovna-s-zakonodavtsvu-politici-i-sudskoj-praksi-u-oblasti-lj/488028e14a_tudija-o)

176 <https://www.ammk-rks.net/al/mjedisi/20/raportet-mujore>

177 - Informatë që pranuan nga IShKP-ja, më 13 janar 2025. Të dhënat paraqesin vetëm numrin e rasteve të reja me sëmundje malinje për vit, që i posedon IShKP-ja. Viti 2020 - 2787 raste; viti 2021 - 3270 raste; viti 2022 - 3110 raste; viti 2023 - 4165 raste; viti 2024 - 3644 raste.

- Raporti i Progresit për Kosovën 2025: “Nuk pati përparim në lidhje me cilësinë e ajrit. Ai vazhdon të paraqesë një rrezik të madh shëndetësor...”

Kosovo progress Report 2025, “There was no progress relating to air quality. It continues to present a major health risk.”

- AMMK, Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2024, Efektet e ndotjes së ajrit në shëndet: “Sëmundjet e frymëmarrjes (bronkit kronik, infeksione të rrugëve të frymëmarrjes), dëmtimet e mushkërive, si dhe rritje të rrezikut për sëmundje të zemrës, goditje në tru dhe disa lloje të kancerit, përfshirë kancerin e mushkërive. Studimet e fundit kanë vënë në dukje se ndotja e ajrit ndikon edhe në zhvillimin neurologjik të fëmijëve, duke u shoqëruar me probleme në përqendrim, kujtesë dhe sjellje.”

178 Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031.

179 Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, rreth 57% e familjeve përdorin drurin si burim ngrohjeje.

180 Informatë që pranuan nga Qendra e Regjistrimit të Veturave.

181 <https://oik-rks.org/2025/07/23/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-1326-2024-ne-lidhje-me-ndikimin-negativ-te-mbeturinave-komunale-ne-jeten-e-qytetareve/>

në të cilin ka konstatuar se ndotja e ajrit nga lirimi i kundërmimit dhe djegia e mbeturinave komunale përbën rrezikshmëri për shëndetin e individëve. Raporti ka theksuar se ndikimi negativ i ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut, përfshirë ndotjen nga mbeturinat, është vërtetuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Gjithashtu ka sjellë në vëmendje se, referuar standardeve ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, jetesa e qytetarëve në një mjedis me nivele të larta të ndotjes së ajrit dhe të mjedisit cenon të drejtat e njeriut për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe përbën cenim të jetës private, familjare dhe të mirëqenies së tyre personale. Duke marrë parasysh ndikimin e ndotjes në shëndetin e njeriut, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen për nevojën e përmirësimit të informimit të publikut nga institucionet publike dhe mediat, në kohë reale, për cilësinë e ajrit, veçanërisht në rastet e tejkalimit të vlerave të lejuara.

Përkundër nevojës për t'iu bashkëngjitur përpjekjeve globale për ndërmarrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e ujërave, vendi vazhdon të përballë me pasoja të thella të degradimit të lumenjve, mungesë të ujit të pijshëm, dëmtim të florës dhe faunës, shkatërrim të burimeve ujore dhe të parqeve kombëtare, mungesë të trajtimit të ujërave dhe mungesë të impianteve përkatëse. Avokati i Popullit konsideron se tashmë ndërhyrjet e pakontrolluara dhe pa kriter, si dhe ndërtimet pranë lumenjve, të kryera gjatë periudhave të gjata kohore, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe shpesh të pariparueshme. Dëmet e shkaktuara nga hidrocentralet janë të dukshme dhe me potencial për të qenë të pariparueshme, edhe pse çështja lidhur me ligjshmërinë e tyre është duke vazhduar. Mjedis të pasigurt dhe jo të shëndetshëm në vend tashmë ka krijuar edhe eksploatimi i pakontrolluar i inerteve (rërës dhe zhavorrit), duke shkaktuar dëme të mëdha në përbërjen e lumenjve dhe regjimin e ujërave, si dhe në florën dhe faunën ujore. Problem më vete, me ndikim në të drejtën për ujë të pijshëm në vend, vazhdon të paraqesë cilësi të ulët e ujërave, e shkaktuar nga shkarkimi i ujërave të patrajtuara. Vërsimet/përmbytjet që tashmë janë duke u

përsëritur nga viti në vit, janë duke krijuar një mjedis jashtëzakonisht të rrezikshëm dhe të përhershëm për jetën dhe sigurinë e qytetarëve. Nga vërsimet e periudhës 17–20 nëntor 2025 u regjistruan dëme në toka bujqësore, prona private etj.

Ndryshimi pa kriter i destinimit të tokave bujqësore, në kundërshtim me Ligjin për Tokën Bujqësore, nuk ka shënuar përmirësim. Ndërsa, sistemi i menaxhimit të mbeturinave nuk ka shënuar asnjë përmirësim. Viti ka shënuar gjendje të njëjtë në deponi, si dhe kriza të menaxhimit të pikave mbledhëse të mbeturinave në mjediset urbane. Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime Rr. nr. 1326/2024, në të cilin konstatoi se ndotja e ajrit, përfshirë ndotjen nga lirimi i kundërmimit të mbeturinave komunale, përbën rrezik për shëndetin e individëve dhe se jetesa e qytetarëve në një mjedis me nivele të larta të ndotjes së ajrit dhe të mjedisit cenon të drejtën e njeriut për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe përbën cenim të jetës private dhe familjare dhe të mirëqenies personale.

Nuk është vërejtur ndonjë ndryshim pozitiv në respektimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe të Ligjit për Ndërtimin. Vazhdon mosrespektimi i kushteve të ndërtimit,<sup>182</sup> në veçanti i atyre që, sipas Avokatit të Popullit, përbëjnë rrezik potencial për jetën e qytetarëve, siç janë kriteret e sigurisë nga zjarri dhe rreziqet e tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor. Në këtë drejtim, duhet theksuar nevoja urgjente për t'i kushtuar vëmendje serioze krijimit të kushteve të përshtatshme për zjarrfikësit dhe përgjegjësit e tjerë në rastet e emergjencave.

Për sa i përket mjedisit ndërtimor, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se, edhe gjatë vitit raportues, një numër i madh i qytetarëve kanë vazhduar të ballafaqohen me kufizimin e së drejtës së pronës, status të paqartë dhe të pasigurt juridik, pamundësinë për fitimin e të drejtave në pronën e paluajtshme, pamundësinë e përdorimit të saj si garanci financiare, si dhe rrezikun që objekti të jetë i ekspozuar ndaj rrënimit, për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve nga autoritetet kompetente për pajisjen me certifikata të përdorimit për shumicën e objekteve të ndërtuara.

<https://oik-rks.org/sr/2025/07/23/izvestaj-ombudsmana-r-br-1326-2024-u-vezi-sa-negativnim-uticajem-komunalnog-otpada-na-privatni-zivot-gradjana/>  
<https://oik-rks.org/en/2025/07/23/report-of-ombudsperson-r-no-1326-2024-on-the-negative-impact-of-municipal-waste-on-the-private-life-of-citizens/>

182 Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Kushtet e Ndërtimit, si: përqindja e sipërfaqes së lejuar për ndërtim brenda parcelës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrare dhe ruajtja e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike; masave për ekuilibër dhe stabilitet; mungesa e hapësirave të emergjencës; vendparkimet; hapësirat e sanitarisë; menaxhimi i mbeturinave ndërtimore; ndriçimi natyror dhe adekuat; ndotja mjedisore; ventilimi dhe zhurma, hapësirat e sanitarisë; kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike; kufizime për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore; masave për eficiencë dhe kursim të energjisë.

Për sa i përket respektimit të tri parimeve mjedisore – qasjes në informata, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi – nuk është vërejtur ndonjë përmirësim. Përkundër garancisë së drejtpërdrejtë të dhënë nga Kushtetuta e vendit lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente publike, si dhe asaj të garantuar me legjislacionin mjedisor, në veçanti me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, i cili ka përcaktuar qartë pamundësinë e kufizimit të qasjes në dokumente që kanë të bëjnë me mjedisin, qasja në informata që lidhen me mjedisin mbetet e vështirësuar. Avokati i Popullit vlerëson se të dhënat e MMPHI-së dhe AMMK-së lidhur me mjedisin, në veçanti ato me interes publik për tejkallimet e ndotjes së ajrit dhe ujit, si dhe dokumentet e rëndësishme me ndikim të lartë mjedisor, siç janë licencat dhe vlerësimet e ndikimit mjedisor etj., rrallë publikohen, mbeten të kufizuara, janë vështirë të qasshme dhe të papërditësuara.<sup>183</sup> Gjatë vitit është vërejtur rënie në informimin e publikut lidhur me çështjet mjedisore dhe vazhdon të mos ketë raporte të përditësuara nga organet kompetente.

Gjithashtu, lidhur me respektimin e procedurave të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, nuk është vërejtur ndonjë përmirësim.

Lidhur me rastet që lidhen me mjedisin, trajtimi i tyre nga prokuroritë dhe gjykatat vazhdon pa ndonjë përmirësim.<sup>184</sup> Me përjashtim të të dhënave që lidhen me nenet e Kodit Penal, gjykatat nuk kanë të dhëna lidhur me rastet e natyrës administrative dhe civile që lidhen me mjedisin, të cilat qartazi do ta sqaronin trajtimin e lëndëve të kësaj natyre brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Respektimi i të drejtave të qytetarëve lidhur me problemet mjedisore po ashtu është duke u cenuar nga procedurat inspektive. Numri i inspektorëve mbetet i ulët, ndërsa niveli i tyre profesional është i zbehtë në krahasim me nevojat dhe gjendjen në terren. Procedurat e ankimimit kundër vendimeve të shkallës së parë të organit inspektiv të nivelit lokal, në organin kolegjal, si dhe procedurat e mëpastajme, nuk garantojnë të drejtën për një mjet juridik efektiv, edhe për faktin se ekziston neglizhencë nga Inspektorati Qendror i Ndërtimit dhe Mjedisit lidhur me ankesat e palëve që kanë të bëjnë me ndërtime të Kategorisë I. Ky inspektorat nuk shqyrton një numër të konsiderueshëm

të ankesave me arsyetimin se kompetencat e tij janë të kufizuara vetëm në objektet e Kategorisë II dhe III. Andaj, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me procedurat në fjalë, të cilat lënë të hapur mundësinë për mosmarrjen e qëndrimeve profesionale nga inspektorati përkatës mjedisor i nivelit qendror, si dhe rrezikun e shkakimit të dëmit të riparueshëm për palën në procedurë.<sup>185</sup>

Mungesa e funksionalizimit të SISH-it pamundëson nxjerrjen e statistikave të qarta lidhur me ndikimin e ndotjes në shëndetin e qytetarëve. Po ashtu, ende vazhdon të mos ketë një hulumtim nga ISHPK-ja lidhur me ndikimin e ajrit të ndotur në shëndetin publik.

Në mungesë të konstituimit të Kuvendit, edhe këtë vit nuk është arritur të miratohet Ligji i ri për Mbrojtje nga Zhurma, i cili do ta vinte nën kontroll mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve nga zhurma dhe bezdia. Po ashtu, Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Ndërtimit, Banimit, Mbrojtjes dhe Sigurisë Bërthamore nuk u arrit të miratohet.

Avokati i Popullit, përgjatë vitit, ka organizuar takime me qytetarë dhe tryeza me organizata të shoqërisë civile, ku kanë marrë pjesë edhe institucione të nivelit lokal dhe qendror. Në këto takime është diskutuar nevoja për rritjen e masave për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me të drejtën mjedisore, nga ana e institucioneve edukative dhe mediave.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile në drejtim të projekteve që lidhen me mjedisin.

183 Botim, Projekti Rajonal i Këshillit të Evropës për "Të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore", financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF)\*Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës gjyqësore për të drejtat e njeriut dhe mjedisin në Evropën Juglindore, mars 2025.

184 Po aty, "në praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë, nuk është gjetur asnjë përdorim i standardeve dhe praktikës së GJEDNJ, me përjashtim të referencave të vogla të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në çështjen e saj të vitit 2009"

185 R.908-2025.

# **Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Trortueës**

# Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 17 parasheh që Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në vijim: MKP). Sipas ligjit, MKP-ja viziton rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në institucionet e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Raporti i MKP-së për vitin 2025 bazohet në të dhënat e mbledhura nga vizitat pa paralajmërim në stacionet e policisë, qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, stacionet e policisë kufitare, institucionet psikiatrike, azilin dhe qendrën e mbajtjes për të huaj, shtëpitë e kujdesit social, si dhe Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” etj.

Raporti ofron një pasqyrë të veprimeve që synojnë parandalimin e torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjëzore ose poshtëruese. Gjatë këtij viti janë realizuar 73 vizita monitoruese, janë publikuar 6 raporte dhe janë dhënë 51 rekomandime.

## Monitorimi i stacioneve policore

Gjatë vitit 2025, MKP-ja vizitoi 15 stacione policore dhe konstatoi se disa ambiente për personat e privuar nga liria nuk i plotësonin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi mbikëqyrja përmes kamerave nuk ishte e instaluar ose kishte dukshmëri të dobët në disa zona, ndërsa sistemi i thirrjes emergjente (zilja) nuk ishte i instaluar në qendrat e ndalimit të stacioneve policore, çka përbën një mangësi serioze në aspektin e sigurisë dhe reagimit të shpejtë në rast nevojë. Gjatë vizitave janë zhvilluar intervista me personat e ndaluar, ku të intervistuarit patën ankesa lidhur me

trajtimin ose mosrespektimin e të drejtave të tyre. Në përgjithësi, respektohen tri të drejtat themelore, përfshirë njoftimin e familjes për arrestim, të drejtën për avokat dhe të drejtën për shërbim mjekësor.

Gjatë vitit raportues janë pranuar 108 ankesa kundër Policisë, nga të cilat 26 janë vlerësuar të pranueshme për hetim. Asnjëra nga këto ankesa nuk lidhej me pretendime për keqtrajtim; shumica kishin të bënin me mospranim në punë pas konkursit, mosavancim ose mosdhënien e përgjigjes nga autoritetet përkatëse, ose çështje të tjera jashtë mandatit të MKP-së. Janë hapur pesë raste sipas detyrës zyrtare për hetimin e rasteve të raportuara në media dhe sigurimin e informacioneve nga burime të tjera për keqtrajtim të qytetarëve nga e zyrtarëve policorë.

Rastet e trajtuara janë si në vijim:

Rasti Ex officio 26/2025 lidhet me pretendimet për sjellje joprofesionale dhe abuzim të autoritetit zyrtar nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës ndaj z. V. Đ., bazuar në informacionin e publikuar në media. Sipas raportimeve mediale, gjatë një kontrolli rutinë të automjeteve në fshatin Soçanicë, Komuna e Leposaviqit, Policia ka nxjerrë V. Đ. nga automjeti dhe e kanë rrahur pa arsye të justifikueshme, në prani të pasagjerit. Avokati i Popullit lidhur me rastin në fjalë ka kontaktuar Inspektoratin e Policor të Kosovës (IPK) për të kërkuar informacione nese është duke u trajtuar ky rast dhe nese është duke u vepruar sipas ligjit. IPK-ja ka njoftuar se janë duke u zhvilluar hetimet dhe se do të na njoftojnë me rezultatin përfundimtar të hetimit.

Rasti Ex officio 841/2025, bazuar në informacionin e publikuar në media, ku theksohet: “Arrestohet polici në Prizren për tejkallim të autorizimeve dhe dhunë ndaj qytetarit”. Avokati i Popullit ka komunikuar me IPK-së, Policinë e Kosovës, ku kanë konstatuar që ka pasur tejkallim të autorizimeve nga zyrtarët policorë dhe rasti është proceduar për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë Themelore në Prizren. Nga informacionet e siguruar rezultoi se janë ndërmarrë veprimet ligjore nga autoritetet përgjegjëse.

Rasti Ex officio 842/2025, bazuar në informatat e publikuara në media, që kanë të bëjnë me veprimet e policisë gjatë arrestimit të një qytetari në Klinë. Avokati i Popullit për këtë rast ka komunikuar me IPK-në, Policinë e Kosovës, ku kanë konstatuar se ka pasur tejkallim të autorizimeve nga zyrtarët policorë dhe rasti është proceduar për hetim të mëtejshëm në Prokurorinë Themelore në Pejë, e cila ka ngritur aktakuzë kundër zyrtarëve policorë të përfshirë në këtë rast.

Rasti Ex officio 850/2025, bëhet fjalë për një rast të publikuar në media, për vdekjen e një qytetari në Lipjan gjatë arrestimit nga policia. Avokati i Popullit ka komunikuar me IPK-në, ku është njoftuar se zyrtarët policorë janë suspenduar nga vendi i punës. Rasti është ende duke u hetuar dhe autoritetet kompetente janë në pritje të raportit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Rasti Ex officio 840/2025, i hapur në bazë të lajmit të publikuar në media, për vdekjen e një të ndaluarit në Stacionin Policor në Suharekë. Nga informatat e siguruar gjatë vizitës në këtë stacion, personi N.K. kishte kryer vetëvrasje në qeli. Gjithashtu u vërejt se sistemi i monitorimit të kamerave nuk ishte i përshtatshëm dhe funksional, kishte mungesë të stafit në këtë qendër ndalimi. Për këto dhe të gjeturat e tjera, Avokati i Popullit do të dalë me raport. IPK-ja ka njoftuar se zyrtarët policorë kujdestarë kishin kryer shkelje të rëndë disiplinore, ndaj të cilëve janë ndërmarrë masa nga Policia e Kosovës.

Nga vizitat e realizuara gjatë vitit 2025 në stacionet policore dhe në qendrat e ndalimit, Avokati i Popullit konstatoi se mangësitë infrastrukturore mbeten të dukshme në një numër të konsiderueshëm institucioneve, për shkak të objekteve të vjetra, mungesës së renovimeve ose punimeve të papërfunduara. Në disa stacione policore, qendrat e ndalimit janë pjesërisht ose plotësisht jashtë funksionit, gjë që ka detyruar transferimin e shpesh të personave të ndaluar për në qendra të tjera të mbajtjes, duke rritur ngarkesën e punës për stafin policor të disa stacioneve dhe duke shkaktuar vështirësi operative dhe logjistike.

Në qendrat dhe stacionet ku renovimet kanë përfunduar ose janë në fazën përmbyllëse, janë vërejtur përmirësime të dukshme në kushtet e qëndrimit të personave të ndaluar, përfshirë ndriçimin natyral dhe artificial, ventilimin e mjaftueshëm, pajisjen me dyshekë dhe batanije të reja, si dhe funksionalizimin e sistemeve të kamerave, duke respektuar privatësinë e personave të ndaluar. Megjithatë, në asnjërën nga qendrat e ndalimit të vizituara nuk ishte i instaluar sistemi i thirrjes emergjente

(zilja), çka përbën mangësi serioze në aspektin e sigurisë dhe reagimit të shpejtë në raste nevoje.

Nga shqyrtimi i dosjeve dhe intervistat e zhvilluara me personat e ndaluar, u konstatua se ata informohen për të drejtat e tyre ligjore dhe kanë qasje në shërbime mjekësore, përfshirë ndihmën e shpejtë dhe transportin në institucionet shëndetësore në raste urgjente. Nuk janë evidentuar ankesa për keqtrajtim fizik nga personat e intervistuar, ndërsa është vlerësuar si praktikë pozitive dërgimi i të miturve dhe i personave madhorë për kontroll mjekësor para vendosjes në ndalim.

Avokati i Popullit konstatoi se mungesa e materialeve higjienike paraqet një problem të vazhdueshëm në disa stacione policore dhe qendra ndalimi, ndërsa furnizimi me uniforma dhe pajisje personale për zyrtarët policorë mbetet i pamjaftueshëm. Po ashtu, u evidentuan probleme të theksuara me pajisjet për fotokopim dhe printim, të cilat shpesh janë jofunksionale ose mungojnë, duke ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e punës administrative dhe operative. Në shumicën e stacioneve të vizituara, u vërejt mungesa e mjeteve transportuese dhe gjendja e rënduar teknike e automjeteve ekzistuese, çka vështirëson kryerjen e detyrave policore, veçanërisht në stacionet me shtrirje të madhe territoriale. Kushtet e punës për stafin policor rezultuan të vështira për shkak të mungesës së hapësirave adekuate, mbingarkesës së zyrave me numër të madh zyrtarësh dhe mungesës së pajisjeve bazë të punës, ndërsa zyrtarët ngritën shqetësime lidhur edhe me të drejtat e tyre në raport me kompensimin për punën gjatë fundjavave, orëve të natës dhe mungesën e pagës së 13-të.

Gjatë vizitave u konstatua se trajnimet e brendshme zhvillohen rregullisht dhe përbëjnë praktikë pozitive, megjithatë stafi policor mbetet i pa trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor dhe përdoruesve të substancave narkotike, të cilët shpesh paraqesin rrezik për vetëlëndim dhe për sigurinë e vetë stafit.

Ushqimi për personat e ndaluar ofrohet në përputhje me obligimet ligjore, megjithatë janë raportuar shqetësime të vazhdueshme lidhur me cilësinë dhe sasinë e tij, të siguruar përmes kompanive kontraktuese.

Për sa i përket parashtrimit të ankesave, Avokati i Popullit konstatoi se në stacionet policore ku ekzistojnë qendra ndalimi janë vendosur kuti ankimesh nga Avokati i Popullit, të cilat garantojnë mundësinë e parashtrimit

konfidencial të ankesave nga personat e ndaluar; megjithatë, gjatë periudhës së raportimit nuk është evidentuar asnjë ankesë e depozituar në këto kuti.

### **Monitorimi i Qendrave Korrektuese dhe të Paraburgimit**

Situata në sistemin e burgjeve ka shënuar përparime të dukshme, si në infrastrukturë, ashtu edhe në ngritjen e nivelit të cilësisë së punës. Shërbimi Korrektuese i Kosovës (ShKK) numëron në radhët e veta 1386 staf të uniformuar dhe 283 staf civil, profesional dhe mbështetës, të trajnuar dhe të përkushtuar për përmbushjen e misionit të ShKK-së, në 11 qendra korrektuese dhe të paraburgimit. Për të gjeturat nga monitorimet, autoritetet përgjegjëse janë njoftuar menjëherë dhe kanë reaguar duke ndërmarrë veprimet e nevojshme.

Në kuadër të ShKK-së ofrohen programe për rehabilitim dhe riintegrim të personave të privuar nga liria, të cilat kanë ndikuar në uljen e recidivizmit, janë krijuar kushte për arsimim të obligueshëm fillor dhe profesional për të burgosur, si dhe për ofrimin e programeve adekuate për aftësi profesionale të ndryshme. Një rol të rëndësishëm luan Njësia Ekonomike, e cila zhvillon aktivitetin e saj ekonomik në katër qendra korrektuese: Dubravë, Smrekonicë, Lipjan dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë. Lejimi i të burgosurve për të punuar jashtë institucionit korrektues është një aktivitet i nevojshëm drejt risocializimit të suksesshëm dhe përgatitjes së tyre për t'u rikthyer në shoqëri si individë të përgjegjshëm dhe të dobishëm.

Duke vepruar në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Ligji për Avokatin e Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), janë realizuar gjithsej 27 vizita në qendrat korrektuese dhe në qendrat e paraburgimit, kryesisht vizita përcjellëse ose ad-hoc. Gjatë këtij procesi janë pranuar 420 telefonata në numrin pa pagesë të Avokatit të Popullit dhe në numrat mobil, si dhe janë zhvilluar 472 intervista individuale dhe grupe. Kërkesat dhe ankesat e pranuar janë adresuar te drejtori i qendrës së vizituar, drejtorja e përgjithshme dhe drejtori i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, të cilët kanë reaguar duke i trajtuar ato brenda një afati shumë të shkurtër. Në Qendrën e

Paraburgimit në Mitrovicë është realizuar një vizitë e përgjithshme dhe është publikuar Raport me Rekomandime.<sup>186</sup>

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 119 ankesa nga të dënuarit dhe të paraburgosurit, prej të cilave 17 janë proceduar për hetim, ndërsa 102 janë shpallur të papranueshme. Ankesat dhe kërkesat janë pranuar në forma të ndryshme, si: përmes telefonit, intervistave, adresës elektronike, adresës postare, kutive të ankesave, nga familjarët, avokatët, si dhe në disa raste nga vetë zyrtarët e qendrave, të cilët kanë përcjellë kërkesat e të dënuarve ose të paraburgosurve për t'u takuar me zyrtarët e MKP-së.

Ankesat e pranuar në qendrat korrektuese dhe paraburgimit kryesisht kanë pasur të bëjnë me: paraburgim të paligjshëm, refuzim të kërkesës për shfrytëzim të vikendeve, transferime nga një qendër në një tjetër për shkaqe familjare, përdorimin e forcës, trajtim jo të duhur mjekësor, kushte të papërshtatshme të akomodimit, monitorimin e seancave, cilësinë dhe sasinë e ushqimit, angazhimin në punë brenda dhe jashtë institucioneve, kërkesa për ndihmë në sigurimin e letërnjoftimit, kartelës bankare, asistencës sociale, lirimim me kusht, daljen më të shpeshtë në ajër të pastër etj.

Në të gjitha këto raste, palët janë këshilluar për veprimet që duhet t'i ndërmarrin dhe autoritetet kompetente janë vënë në dijeni, duke ndërmarrë veprime sipas përgjegjësisë së tyre dhe në përputhje me qëndrueshmërinë e ankesave.

Gjatë vizitave në institucionet korrektuese, MKP-ja, në përgjithësi, ka vërejtur një komunikim të mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Megjithatë, kemi pranuar pohime për sa i përket përdorimit të forcës nga zyrtarët korrektues, të cilat raste janë hapur për hetim: dy pohime për keqtrajtim në BSL,<sup>187</sup> një në QK Dubravë,<sup>188</sup> një në QP Prishtinë,<sup>189</sup> një në QP Pejë,<sup>190</sup> një në QKM Lipjan,<sup>191</sup> dhe një në QEK Lipjan.<sup>192</sup> Lidhur me këto raste, jemi në komunikim të vazhdueshëm me autoritetet relevante dhe ende janë në fazën e hetimeve.

MKP-ja ndër vite ka konstatuar se Qendra e Paraburgimit në Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, si dhe Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan nuk i plotësojnë kushtet e akomodimit

186 [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/08/Avokati-i-Popullit\\_Raport\\_MKPT-vizita-ne-QP\\_Mitrovice\\_compressed.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2025/08/Avokati-i-Popullit_Raport_MKPT-vizita-ne-QP_Mitrovice_compressed.pdf)

187 535/2025 dhe 827/2025.

188 421/2025.

189 1437/2025.

190 663/2025.

191 673/2025.

192 1726/2025.

sipas ligjeve vendore dhe standardeve ndërkombëtare. Edhe pse kanë filluar procedurat për rindërtimin e këtyre qendrave, janë ndarë mjetet dhe janë finalizuar projektet, por ende nuk kanë filluar ndërtimet. Ndërsa në qendrat e tjera rinovimet janë në vazhdimësi dhe kushtet mund të vlerësohen si të kënaqshme.

Gjatë këtij viti, numri i ankesave për trajtim shëndetësor ka qenë më i vogël dhe në të gjitha rastet, kërkesat ose ankesat janë drejtuar tek autoritetet kompetente, të cilët kanë reaguar menjëherë. Po ashtu, këtë vit ka filluar trajtimi i tërë stafit shëndetësor dhe korrektues lidhur me Protokollin e Stambollit, gjë që ka ngritur cilësinë e shërbimit në përgjithësi.

Sipas informatave të siguruara nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB), nga 214 raste të identifikuara me rrezik për vetëvrasje gjatë pranimit, 15 persona kanë tentuar dhe një ka kryer vetëvrasje. Gjatë kësaj periudhe, Pavijoni D në Qendrën Korrektuese Dubravë ka funksionuar mirë, duke pritur personat me nevoja të veçanta dhe trajtimin e rasteve vështirë të menaxhueshme. Në këtë pavijon janë hospitalizuar rreth 133 të burgosur dhe janë liruar 104 pas marrjes së trajtimit, ndërsa në kohën e raportimit, në trajtim janë edhe 53 persona.

Megjithatë, shëndeti mendor vazhdon të mbetet sfidë kryesore në vendet e privimit të lirisë. Edhe pse ka staf adekuat, përfshirë psikologë klinikë, psikiatër dhe staf tjetër mjekësor, numri i rasteve me probleme të shëndetit mendor është në rritje. Përveç kësaj, DShB-ja ka hasur në vështirësi për kryerjen e punëve për shkak të lëvizjeve të stafit, të cilat janë pasojë e mosstimulimit shtesë për punën në burgje, mospagesës së rrezikshmërisë dhe mungesës së shtesave të tjera për specifikat e punës.

Bazuar në Marrëveshjen me Danimarkën për dhënien me qira të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, kanë filluar përgatitjet dhe janë trajnuar 15 zyrtarë, të cilët kanë qëndruar në Danimarkë për 6 muaj, ndërsa aktualisht është në fazën e përzgjedhjes edhe të 25 zyrtarëve të tjerë. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata për ndërtimin e punëtorive, ndërsa pritet nënshkrimi i kontratës për fillimin e punës në këtë qendër.

Institucionet përgjegjëse nuk kanë dhënë informacione të mjaftueshme lidhur me këtë proces, përkundër faktit se Avokati i Popullit

i ka bërë të njohura shqetësimet lidhur me përgjegjësinë që shteti i Kosovës do të mbajë në rast të pamundësisë për t'i plotësuar standardet ose në rast të cenimit të këtyre standardeve, që lidhen me të drejtat e të burgosurve. Avokati i Popullit vlerëson se ky proces duhet të zhvillohet me më shumë transparencë.

Avokati i Popullit ka monitoruar edhe proceset e zgjedhjeve që janë mbajtur këtë vit<sup>193</sup> duke monitoruar të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, si dhe i ka njoftuar për të gjeturat pas procesit.

MKP-ja ka mbajtur prezantime për gjeneratat e reja të oficerëve korrektues, të cilat sqarojnë mandatin dhe rëndësinë e trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, si dhe respektimin e dinjitetit të tyre. Në këto prezantime theksohej se roli i oficerëve nuk është vetëm hapja dhe mbyllja e derës, por qasja e tyre është thelbësore për funksionimin e drejtë dhe human të tërë sistemit.

Sipas të dhënave nga Paneli për Lirim me Kusht (PLK), gjatë këtij viti janë parashtruar 843 kërkesa për lirim me kusht. Nga këto, janë shqyrtuar 689 kërkesa, ndërsa 154 kanë mbetur të pashqyrtuara. Prej kërkesave të shqyrtuara, 369 janë aprovuar, 270 janë refuzuar, për 54 raste është pushuar procedura dhe 12 kërkesa janë hedhur poshtë.

MKP-ja ka pranuar një ankesë nga një grup i të dënuarve me dënime afatgjata, të cilët pohojnë se i kanë plotësuar kushtet për aplikim për lirim me kusht, megjithatë lirimi me kusht u refuzohet. Këto shqetësime MKP-ja i ka adresuar te PLK-ja.

Bashkëpunimi i mirë ka vazhduar edhe me Shërbimin Sprovues, nga i cili jemi njoftuar se gjatë vitit që po raportohet, kanë pranuar gjithsej 1307 kërkesa për masa dhe dënime alternative, si dhe për persona të mitur të liruar në programin e përkujdesjes pas liritimit. Prej këtyre, 458 janë persona të rritur, ndërsa 849 janë të mitur.

### **Monitorimi i Institucioneve të Shëndetit Mendor dhe të Kujdesit Social**

Avokati i Popullit vlerëson se ka pasur zhvillime pozitive në fushën e shëndetit mendor, kryesisht në hartimin e dokumenteve, shtimin e hapësirave në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë, riorganizimin e shfrytëzimit të kapaciteteve

193 Avokati i Popullit ka monitoruar Zgjedhjet e Përgjithshme, të mbajtura më 9 shkurt; Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më 12 tetor; Rundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më 9 nëntor, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor.

ekzistuese bazuar në nevojat aktuale, si dhe planifikimin për renovimin e tërësishëm të Repartit të Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP). Po ashtu, është ofruar shërbim me shtretër në Repartin e Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshent, si dhe kanë filluar punimet për rritjen e kapaciteteve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Zhvillime pozitive janë shënuar edhe në sistemin shëndetësor të burgjeve, përfshirë adaptimin e Pavijonit D në QK Dubravë për trajtimin e personave me nevoja të veçanta.

Gjatë periudhës raportuese janë vizituar gjithsej 19 institucione të shëndetit mendor dhe të kujdesit social, duke përfshirë Qendrat e Shëndetit Mendor (QShM) në Gjilan, Prizren, Podujevë, Gjakovë dhe Ferizaj, Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB) në Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj, Urgjencën dhe Kujdesin Intensiv Psikiatrik të Klinikës Psikiatrike, Repartin e Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshent, Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK), departamentet psikiatrike në spitalet rajonale në Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Gjilan, si dhe institucionet e kujdesit social Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK) nën menaxhimin e komunave në Kamenicë, Ferizaj dhe Prizren.

Gjatë këtij viti, MKP-ja ka realizuar tri vizita ad-hoc: një vizitë në Repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) dhe dy vizita në Klinikën për Fëmijë dhe Adoleshent, që janë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë.<sup>194</sup>

Në UKIP, një çështje shqetësuese që vazhdon të mbetet problem, është pranimi i personave për trajtim pavullnetshëm pa vendim gjykate. Gjatë vizitave u vërejt se UKIP-i nuk ka evidencë që tregojnë se personave të trajtuar pa vullnet u ofrohet shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit, siç kërkohet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili përcakton qartë që pacientit duhet t'i shpjegohen me shkrim brenda 48 orëve arsyet e trajtimit pavullnet.

Po ashtu, në UKIP dhe në departamentet psikiatrike (në kuadër të spitaleve të përgjithshme regjionale në nivel vendi), në të shumtën e rasteve personave të hospitalizuar me probleme të shëndetit mendor nuk u jepet

mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit. E njëjta situatë ishte konstatuar edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015<sup>195</sup> dhe 2020.<sup>196</sup>

Klinika Psikiatrike vazhdon të funksionojë pa Procedura Standarde të Operimit dhe pa zhvillimin e plotë të Terapisë Okupacionale.

Lidhur me trajtimin e pavullnetshëm, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë<sup>197</sup> nga L.G., me pretendimin se u mbajt në UKIP në trajtim psikiatrik pa vullnetin e vet, rast ky i cili është ende nën hetim.

Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshent është i vetmi repart i nivelit terciar në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë, me shtretër për hospitalizimin e 7 fëmijëve dhe ofron shërbime ambulatorie ditore për moshat nën 18 vjeç. Në kuadër të këtij reparti janë të angazhuar 8 psikiatër për fëmijë, 3 psikologë klinikë, 3 logopedë, 7 infermierë, 1 pedagog dhe 1 punëtor social. Gjatë vizitave, Avokati i Popullit ka vlerësuar se mungesa e qendrave të shëndetit mendor për fëmijë në regjione të ndryshme të Kosovës, numri i ulët i personelit shëndetësor në Psikiatrinë për Fëmijë dhe Adoleshent, mbingarkesa e stafit, mungesa e mbështetjes për mjete të punës dhe trajnime të specializuara, si dhe kushtet fizike për ofrimin e shërbimeve spitalore pengojnë ofrimin e shërbimeve cilësore për këtë kategori të pacientëve. Për shkak të këtyre sfidave, më 10 tetor, në Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, Avokati i Popullit është prononcuar nëpërmjet mediave duke kërkuar nga autoritetet relevante ndërmarrjen e masave për përmirësimin e kushteve në Klinikën e Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshent.

Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK), MKP-ja ka realizuar vizitë të përgjithshme, kurse gjetjet nga kjo vizitë do të publikohen në raportin me rekomandime për vitin 2026. Çështja e statutit ligjor të IPFK-së vazhdon të mbetet e pazgjidhur, edhe pse Avokati i Popullit e ka rikujtuar rekomandimin e njëjtë ndër vite. Kapaciteti i institucionit mbetet problematik për shkak të numrit të lartë të personave që kanë nevojë për hospitalizim. Në Repartin B të IPFK-së nuk ekziston protokoll specifik për evidencën e mjeteve të kufizimit, siç kërkohet

194 Klinika e Psikiatrisë është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas Ligjit Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendorë, Klinika Psikiatrike ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), e cila, në mungesë të një spitali të përgjithshëm regjional, është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës. Të gjitha repartet (përveç UKIP-it) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe, në raste të caktuara, edhe pa vullnetin e tyre, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

195 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

196 Shih Raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

197 R 1464/2025.

sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, standardeve të KPT-së dhe Procedurave Standarde të Veprimit të IPFK-së.

Stafi shëndetësor ka marrë vetëm trajnim bazik fillestar për menaxhimin e rasteve të vështira dhe nuk janë realizuar trajnime të mëtejshme për këtë staf. Kamerat e sigurisë nuk funksionojnë, ndërsa mungojnë materialet didaktike, si: letra, ngjyra për vizatime dhe mjete të tjera për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale. Aplikimi i vikendeve terapeutike, i cili ka munguar ndër vite, nuk është përfshirë në Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së. Në shumicën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim ose e drejta për refuzim të trajtimit, gjendje që vazhdon të mbetet e njëjtë. Ka filluar një bashkëpunim më i mirë me gjykatat, dhe pacientët forenzikë marrin pjesë në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideron të nevojshme.

Një problem shtesë paraqet ndërrimi i shpeshtë i stafit të sigurimit nga kompanitë private, të cilët nuk kanë trajnim adekuat për ta menaxhuar këtë kategori të pacientëve.

### **Monitorimi i Departamenteve Psikiatrike në kuadër të Spitaleve të Përgjithshme në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan**

Qëllimi i vizitave monitoruese në këto departamente ishte mbledhja e informatave, vlerësimi i kushteve, trajtimi i pacientëve, furnizimi me barna dhe identifikimi i sfidave të tjera me të cilat ballafaqohet stafi. Nga vizitat u vërejt se, në përgjithësi, trajtimi konsiston kryesisht në farmakoterapi dhe mungon qasja multidisiplinore; shumica e institucioneve nuk ofrojnë gjithmonë të gjitha shërbimet e nevojshme për trajtim, të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkohen për ofrimin e shërbimeve bashkëkohore të psikiatrisë spitalore. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Pejë dhe Gjakovë nuk është i punësuar psikologu klinik, përveç në Departamentin e Psikiatrisë në Gjilan. Për shkak të mungesës së dhomave për aktivitete dhe kufizimeve të tjera, terapitë okupacionale dhe shërbime të tjera terapeutike nuk mund të ofrohen. Departamentet psikiatrike nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve terapeutike të dobishme, të cilat do të mundësonin rikthimin e pacientëve në jetën normale në shoqëri. Shumica e pacientëve kthehen përsëri pas lirimimit nga spitali, dhe shkalla e risocializimit mbetet shumë e ulët. Për sa i përket pëlqimit për trajtim, Avokati i Popullit

konstaton se, në përgjithësi, departamentet psikiatrike në katër regjione nuk kanë formë specifike të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim për pacientët psikiatrikë. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Gjakovë dhe Pejë nuk është vendosur Karta e të Drejtave të Pacientit dhe Karta e Përgjegjësive të Pacientit, përveç në Gjilan. Sipas deklarimeve të stafit të mesëm, nuk ka trajnime adekuate për menaxhimin e rasteve të vështira për t'u menaxhuar. Kutia e ankesave në Prizren është jashtë funksionit. Në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit të Pejës dhe Prizrenit, dhomat që funksionojnë në kuadër të Njësisë Shëndetësore të Burgjeve nuk janë të përshtatshme për qëndrim afatgjatë të rasteve psikiatrike, pasi nuk ka mundësi për dalje në shëtitje dhe dhomat ngjajnë me qeli të burgut. Në departamentet e psikiatrisë në Prizren dhe Gjakovë, dhomat e kujdesit intensiv psikiatrik janë jofunksionale, për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate, pasi janë të vjetruara dhe nuk i përmbushin standardet. Objektet nuk ofrojnë gjithmonë dhoma me një ose dy shtretër, por shpesh me tre dhe ndonjëherë edhe me katër shtretër. Në departamentet psikiatrike aktualisht nuk ekzistojnë kushte për pastrimin e pacientëve të hospitalizuar. Shërbimet psikiatrike nuk ofrohen në spitalet rajonale në Mitrovicë dhe Ferizaj; rastet akute me sëmundje mendore nga këto zona referohen në nivelin terciar në Prishtinë.

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë lidhur me Statutin (QRK) Nr. 01/2023 nga psikiatrit e spitaleve regjionale të komunave Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Pejë, si dhe nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me miratimin e Statutit (QRK) nr. 01/2023 për ShSKUK-në, i cili kishte hequr shërbimet psikiatrike brenda spitaleve regjionale. Avokati i Popullit kishte analizuar Statutin e përmendur dhe, më 3 korrik 2024, kishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 11 të Statutit (QRK) nr. 01/2023 për ShSKUK-në dhe kishte kërkuar nga gjykata që të vlerësonte nëse paragrafi 1 i nenit 11 është në pajtim me nenin 7, nenin 24, nenin 51, paragrafi 1, dhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë aktgjykimin,<sup>198</sup> ku ka konstatuar se paragrafi 1 i nenit 11 të aktit të kontestuar

198 KO 141/24.

është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 51 (Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale), në lidhje me paragrafin 1 të nenit 7 (Vlerat) dhe paragrafin 4 të nenit 92 (Parimet e Përgjithshme) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas aktgjykimit, Statuti i ShSKUK-së është plotësuar/ndryshuar duke shtuar departamentet psikiatrike në spitalet e përgjithshme, ashtu siç parasheh edhe Ligji për Shëndetin Mendor.

### **Monitorimi i Qendrave të Shëndetit Mendor dhe Shtëpive Integruese në Bashkësi**

Gjatë vitit 2025, ekipi i MKP-së vizitoi 5 Qendra të Shëndetit Mendor (QShM): në Podujevë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan; si dhe 4 ShIB: në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan.

QShM-të e vizituara (përpos QShM-së në Podujevë) ofrojnë shërbime ditore, trajtim me medikamente dhe aktivitete psiko-sociale. Puna organizohet në dy forma: në formën e brendshme, ku zhvillohen aktivitete psiko-sociale brenda qendrës dhe pacientëve u ofrohet terapi me medikamente falas; si dhe në formën e punës në terren nga ekipi mobil i qendrës, i cili mbulon në regjionin përkatës ku ndodhet QShM-ja. Këto vizita të ekipit mobil realizohen me qëllim të ofrimit të mbështetjes psiko-sociale, sigurimit të terapisë së rregullt dhe njëkohësisht ofrojnë mbështetje edhe për familjen. QShM-të në staf kanë një psikiatër, psikolog dhe disa infermierë.

Gjatë vizitave në QShM, përveç trajtimit dhe kushteve, ekipi i MKP-së i kushtoi rëndësi edhe ekzekutimit të Masës së Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri, të cilën masë gjykatat e caktojnë kryesisht në QShM. U vlerësua se në QShM-të në Gjakovë, Podujevë dhe Ferizaj, të gjitha rastet me Masë të Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri, që marrin shërbime të rregullta, evidentohen në protokoll të veçantë, ndërsa në QShM-të në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan nuk praktikohet një gjë e tillë.

Për sa i përket furnizimit me barna dhe ushqimit për qëndrim ditor të pacientëve, stafi dhe pacientët QShM-se të vizituara nuk patën ankesa.

Avokati i Popullit ka realizuar vizitë të përgjithshme në QShM në Podujevë dhe, nëpërmjet raportit me rekomandime, ka

konstatuar se kjo qendër nuk ka kushte minimale për ofrimin e shërbimeve për personat me probleme të shëndetit mendor. Për shkak të kushteve të papërshtatshme, qëndrimi ditor dhe trajtimi psiko-social nuk realizohen, si dhe rrezikohet konfidencialiteti i shërbimeve. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e ShSKUK-së dhe as nga Komuna e Podujevës, bazuar në marrëveshjen e tyre për zhvendosjen e QShM-së në Podujevë në një objekt të përshtatshëm, si dhe nga QShM-ja në Prishtinë, e cila e menaxhon edhe Qendrën në Podujevë. Ndërkohë, kjo qendër është e furnizuar mjaftueshëm me barna dhe mjete higjienike.

**Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB)** - ofrojnë kujdes shëndetësor 24 orë në funksion të rehabilitimit dhe riintegritimit social të klientëve me çrregullime kronike psikotike në remision.<sup>199</sup> Në ShIB nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, as me demenca të të gjitha llojeve, as me sëmundje të varësisë dhe as rastet sociale. Vendosja e rezidentëve në këto shtëpi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (në Shëndetësi) nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës, i cili është shfuqizuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/50, të datës 23.12.2021.

Gjatë këtij viti janë vizituar ShIB-të në Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Bazuar në dosjet e rezidentëve, të gjithë ishin me diagnoza kronike psikiatrike dhe në asnjërën nga këto shtëpi nuk kishte mbipopullim.

Gjatë vizitës është vërejtur një qasje e afërt e personelit ndaj rezidentëve dhe, në përgjithësi, një klimë pozitive brenda shtëpive të vizituara. Rezidentët dukeshin mirë për nga veshja dhe higjiena. Nuk janë hasur shenja të lëndimeve trupore te rezidentët. Ekipi monitorues ka intervistuar rezidentët dhe nuk patën ankesa për ndonjë formë të keqtrajtimit. Në përgjithësi realizohen aktivitete, si: loja me pingpong, dëgjimi i muzikës dhe angazhimi në punë shtëpie, si pastrim, kuzhinë dhe mirëmbajtje të oborrit, për aq sa munden.

Standardet e KPT-së theksojnë se trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient. Ky plan duhet

<sup>199</sup> Remision është term mjekësor që përdoret për të përshkruar një periudhë, gjatë së cilës simptomat e një sëmundjeje zvogëlohen apo zhduken plotësisht. Gjendja në remision për rastet me sëmundje mendore nënkupton një përmirësim të ndjeshëm ose mungesë të dukshme të simptomave.

të përfshijë një gamë të gjerë aktivitetesh rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë qasje në terapi okupacionale, terapi në grup, psikoterapi individuale, art, teatër, muzikë dhe sporte.<sup>200</sup> Gjatë vizitës u vërejt se ShIB-të e vizituara nuk kishin Plan Individual të Trajtimit, përpos disa aktiviteteve të cekura më lart. Shtëpitë e vizituara, në përgjithësi, ishin në gjendje të mirë, përveç ShIB-it në Gjilan, ku banjat ishin shumë të dëmtuara dhe të papastra, ndërsa dhomat ishin të mira dhe me ndriçim të mjaftueshëm. Për sa i përket furnizimit me barna, ushqim dhe veshmbathje, nuk kishte probleme dhe nuk patën ankesa lidhur me trajtimin apo ushqimin. Gjatë vizitave, ekipi ka vërejtur se të gjitha ShIB-të e vizituara posedonin vetëm një fletore ditore ku evidentohen aktivitetet me rezidentët, si: ndërrimi i stafit, gjendja e pacientëve, incidentet dhe shqetësimet e rezidentëve, pra nuk kishin protokolle të veçanta për evidentimin e incidenteve apo lëndimeve trupore. Bazuar në fletoren ditore të ShIB-ve të vizituara, nuk ishte evidentuar asnjë incident. Klientëve të vendosur në ShIB, në përgjithësi, u kryhen analizat laboratorike një herë në vit, ndërsa klientëve që kanë edhe sëmundje të tjera përveç çrregullimeve mendore, analizat u bëhen sa herë që është e nevojshme.

### **Institucionet e vizituara të kujdesit social**

ShBK-të funksionojnë bazuar në Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku në nenin 20 theksohen shërbimet dhe format e mbrojtjes, duke përfshirë edhe shtëpitë e komunitetit apo strehimin rezidencial.

Komunat që kanë ShBK janë: Kamenicë, Deçan, Ferizaj, Vushtrri, Lipjan, Graçanicë, Shtime dhe Prizren. Këto shtëpi aktualisht kanë kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShBK-it në Shtime, me kapacitet prej 12 shtretërish.

Gjatë vitit 2025 janë vizituar ShBK-të në Kamenicë, Ferizaj dhe Prizren dhe është konstatuar se në këto shtëpi nuk ka mbipopullim. Në ShBK-të në Ferizaj, Kamenicë dhe Prizren është evidentuar se asnjëra prej tyre nuk ka Plan Individual të Kujdesit për rezidentët, ashtu siç parashihet në nenin 25 të UA MD-Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial.

Në ShBK-në në Ferizaj, kushtet e akomodimit në përgjithësi nuk janë të mira; në kuzhinë dritaret ishin të dëmtuara dhe nuk mbylleshin, ndërsa depoja ku mbahet ushqimi kishte

lagështi dhe myk, çka nuk i plotëson standardet minimale për jetesë për këtë kategori. Në Prizren nuk ka pasur renovime dhe ka nevojë për ndërhyrje në disa pjesë të objektit (dyert dhe sanitaria), ndërsa kushtet në Kamenicë janë të kënaqshme.

Në ShBK në Prizren u vërejt dhe u konfirmua nga stafi se prej disa vitesh nuk ka pasur renovime; sanitaria ishin e dëmtuar, ndërsa dyert nuk mbylleshin mirë dhe ishin të prishura.

Në ShBK nuk ka dhoma izolimi dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik.

Shërbimet shëndetësore për ShBK-të e vizituara realizohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare të komunave përkatëse, ndërsa shërbimet psikiatrike realizohen në Qendrat e Shëndetit Mendor.

Për sa i përket furnizimit me veshmbathje, ushqim, barna dhe ngrohje, ekipi nuk ka vërejtur mangësi në shtëpitë e vizituara.

ShBK-ja në Kamenicë posedon regjistra të veçantë, si p.sh. regjistra të incidenteve, shqetësimeve, terapisë, aktiviteteve dhe vizitave mjekësore, ndërsa në ShBK-të në Ferizaj dhe Prizren nuk kanë regjistra të tillë. Për këtë arsye, Avokati i Popullit inkurajon udhëheqësit e ShBK-ve të tjera të marrin shembull nga ShBK-ja në Kamenicë dhe t'i unifikojnë procedurat në të gjitha shtëpitë.

### **Të drejtat e të huajve**

Të huajt gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, njësoj si shtetasit e vendit, përveç kur ligji parasheh kufizime të veçanta (sidomos për të drejtat politike). Kushtetuta e Republikës së Kosovës përfshin drejtpërdrejt instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (si KEDNj-në), të cilat zbatohen edhe për të huajt, si dhe parasheh respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Të huajve u garantohet e drejta për jetë, siguri personale, ndalimi i torturës dhe mbrojtja nga ndalimi arbitrar, si dhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Po ashtu, ata kanë të drejtë për punë, arsim, kujdes shëndetësor dhe pronë (sipas kufizimeve ligjore), por nuk kanë të drejtë vote, as të drejtën për të ushtruar funksione publike.

200 Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12].

Hyrja, qëndrimi dhe dëbimi i tyre është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huaj<sup>201</sup> dhe shtetet duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe të mos kthimit (non-refoulement). Asnjë i huaj nuk guxon të kthehet/dëbohet në një shtet ku rrezikohet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor apo persekutimit. Ata kanë të drejtë të kërkojnë azil, status refugjati ose mbrojtje subsidiare (mbrojtje ndërkombëtare).

Mbrojtja e të drejtave të të huajve synon të garantojë barazi në dinjitet dhe mbrojtje ligjore duke respektuar njëkohësisht sovranitetin e shtetit.

Avokati i Popullit ka pranuar 19 ankesa, prej të cilave 4 janë për hetim, 1 është mbyll dhe 14 janë shpallë të papranueshme.

Hyrja, qëndrimi dhe dëbimi i tyre është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe shtetet duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe të moskthimit (non-refoulement). Asnjë i huaj nuk guxon të kthehet/dëbohet në një shtet ku rrezikohet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor apo persekutimit. Ata kanë të drejtë të kërkojnë azil, status refugjati ose mbrojtje subsidiare (mbrojtje ndërkombëtare).

Mbrojtja e të drejtave të të huajve synon të garantojë barazi në dinjitet dhe mbrojtje ligjore, duke respektuar njëkohësisht sovranitetin e shtetit.

Avokati i Popullit ka pranuar 19 ankesa, prej të cilave 4 janë në hetim, 1 është mbyllur dhe 14 janë shpallur të papranueshme.

Rastet që ende janë duke u proceduar, kanë të bëjnë me:

- Ankesë kundër Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë (QPP). Pala ankohet se gjatë bastisjes ndaj tij është përdorur forcë e tepruar nga njësi intervenues i Shërbimit Korrektues, për çka i njëjti është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore. Pas pranimit të ankesës, MKP-ja ka realizuar vizitë në QPP, ka shqyrtuar dosjet mjekësore, si dhe ka intervistuar palën. Lidhur me rastin kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet, nga të cilat kemi pranuar raportin e komisionit

të brendshëm hetimor, ku jemi njoftuar se janë shqiptuar masa disiplinore ndaj zyrtarëve të përfshirë në këtë rast.<sup>202</sup>

- Ankesë ku pala, e cila jeton për një kohë të gjatë në Kosovë dhe është e nacionalitetit kroat, ankohet për refuzimin e së drejtës për fitim të shtetësisë. Rasti është ende duke u proceduar.<sup>203</sup>
- Ankesë ku pala, e cila jeton në Kosovë dhe ka lindur këtu, ka jetuar deri në moshën 7-vjeçare, më pas është zhvendosur për të jetuar në Gjermani me familjen, është kthyer pas viteve të '90-ta në Kosovë, ku është martuar dhe pas një periudhe është shkurorëzuar, ka shkuar të jetojë përsëri në Gjermani, ku është martuar me një shtetas grek. Aktualisht ajo figuron në sistem me tre mbiemra: mbiemrin e lindjes, të bashkëshortit të parë dhe të bashkëshortit të dytë. Kërkesa për marrjen e pasaportës i është refuzuar me arsyetimin se nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për fitimin e shtetësisë, por vendimi nuk përmban udhëzim të qartë se cilat prova i kanë munguar. Rasti është ende duke u proceduar.<sup>204</sup>
- Ankesë ku pala është ankuar për refuzimin e shtetësisë, edhe pse ka jetuar në Kosovë për 20 vjet, ka punuar, ka banesë dhe është duke studiuar, por kërkesa për njohjen e shtetësisë i është refuzuar. Pala është dërguar në mbajtje në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll, ku ka qëndruar për 1 vjet. MKP-ja e ka vizituar disa herë palën, ka kontaktuar me avokatin e saj, i cili ka njoftuar se ka parashtruar padi në gjykatë; kemi kontaktuar edhe gjykatën për të marrë informacione se ku ndodhet lënda dhe nëse ka një vendim lidhur me të; jemi takuar me Policinë Kufitare dhe Departamentin për Shtetësi, të cilët na kanë njoftuar se pa një vendim gjykate nuk mund të veprojnë ndryshe, pasi janë në komunikim me autoritetet e sigurisë dhe e njëjta duhet të presë vendimin e gjykatës. Në kohën e paraparë sipas afateve ligjore (1 vit), pala është dërguar në Qendrën e Azilit dhe kërkesa e saj për banim privat i është aprovuar.

201 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

202 1438/2025.

203 1216/2025.

204 1171/2025.

Ndërsa ankesat e shpallura të papranueshme kryesisht kishin të bënin me: vendimin për largim vullnetar nga Kosova, mosdhënien e përgjigjes në kërkesën për marrjen e shtetësisë, kundër vendimit për ndalim, zvarritje të procedurës, për shkak të bastisjeve të shpeshta në burg, për shkak të largimit nga kolegji privat IGL etj.

Gjatë këtij viti, MKP-ja, në vendet ku mbahen azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt, ka vizituar: Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë (QPPM); Qendrën për Azil (QA); Qendrën për Mbajtjen e të Huajve (QMH); si dhe ka monitoruar kthimin me forcë nga Zvicra në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit mes Komisionit Kombëtar Zviceran për Parandalim të Torturës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, të nënshkruar më 24 prill 2019.

Nga të gjeturat gjatë vizitës në QPPM, rezultoi se nuk ka staf të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të migrantëve të akomoduar. Qendra nuk posedon udhëzues për funksionimin, të përcaktuar sipas Vendimit Nr. 0490/2022 të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të datës 24 qershor 2022. QPPM-ja tash për tash përbëhet vetëm nga udhëheqësi i Qendrës, i cili kryen të gjitha shërbimet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës, ndërsa qendra ka nevojë për angazhimin e së paku një infermieri për dhënien e shërbimeve mjekësore për migrantët e akomoduar.

Gjatë vizitës në Qendrën e Azilit kemi vërejtur se kushtet e akomodimit janë në përgjithësi të një standardi shumë të mirë në kuptim të hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Megjithatë, tri dhoma ishin jashtë funksionit, për shkak të lagështisë dhe rrjedhjes së ujit nga kulmi, për çka u njoftuam në fillim të takimit edhe nga drejtori.

Pavarësisht se Qendra e Azilit ofron kushte të pranueshme për familjet dhe fëmijët, kishte shqetësime se ambienti nuk është shumë i përshtatshëm për familjet, pasi ato janë të vendosura në katin e dytë të Qendrës, përderisa në katin e parë janë të vendosur meshkujt beqarë. Kjo vendosje po e kufizon lirinë e lëvizjes për fëmijët dhe nënat, ku shumicën e kohës e kalojnë në dhomë, edhe pse nuk kanë pasur shqetësime nga banorët e tjerë. Andaj, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve dhe nevojat e tyre për liri, siguri dhe zhvillim të shëndetshëm, Qendra ka nevojë për një ambient të veçantë dhe të

përshtatshëm për familjet dhe fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe kujdesit për fëmijët në situata azili.

Pas vizitave të realizuara në këto qendra, janë publikuar raporte me rekomandime për QPPM-në<sup>205</sup> dhe QA-në.<sup>206</sup> Ndërsa në QMH<sup>207</sup> është realizuar aktivitet i përbashkët me UNHCR-në dhe CRPK-në, ku janë diskutuar rekomandimet e dhëna e më herët, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të kësaj qendre.

205 <https://oik-rks.org/2025/04/17/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-perkohshme-te-pritjes-per-migrante/>

206 <https://oik-rks.org/2025/10/28/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-azilit-ne-magure-lipjan/>

207 <https://oik-rks.org/2025/03/25/vizite-ne-qendren-per-mbajtje-te-te-huajve/>

## Të drejtat e personave në kuptim të “drejtësisë tranzicionale”

Drejtësia tranzicionale është fushë e drejtësisë, e cila ka të bëjë me të gjitha masat që çdo shoqëri në tranzicion ka obligim t'i ndërmarrë në periudhën e stabilizimit pas konfliktit, për të kërkuar llogaridhënie dhe për t'i adresuar pasojat e shkaktuara nga lufta dhe shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Drejtësia tranzicionale, përmes katër mekanizmave kryesorë të saj, siç janë: e drejta në drejtësi, e drejta për të ditur, e drejta në reparacion dhe garantimi i mospërsëritjes, synon të ndihmojë një shoqëri pas konfliktit që të sigurojë drejtësi për viktimat dhe njohjen e tyre, ta rrisë besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit, ta sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut, ta promovojë sundimin e ligjit dhe, përmes këtyre masave, t'i parandalojë shkeljet masive të të drejtave të njeriut në të ardhmen dhe ta nxisë pajtimin.

E drejta për drejtësi përfshin të drejtën e viktimave për të marrë drejtësi përmes një mjeti juridik të drejtë dhe efektiv, si dhe i detyron shtetet të hetojnë shkeljet dhe të ndjekin penalisht personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. E drejta për të ditur përfshin të drejtën e viktimave dhe familjeve të tyre për të mësuar të vërtetën mbi atë çfarë u ka ndodhur atyre personalisht apo familjarëve dhe njerëzve të tyre të dashur, si dhe paraqet detyrim të shtetit për të ndërmarrë masa, si sigurimi i arkivave dhe dëshmime të tjera, duke ruajtur dhe mirëmbajtur kujtesën kolektive. E drejta për dëmshpërblim përfshin masat që shteti obligohet t'i aplikojë për viktimat, familjet e tyre dhe komunitetet, në mënyrë që t'i kontribuojë një forme të njohjes simbolike të ndjenjës së humbjes së tyre. Ndërsa e drejta për garanci për mospërsëritje nënkupton obligimin e shtetit për të siguruar qeverisje të mirë, sundim të ligjit dhe reforma institucionale, në mënyrë që të sigurojë se krimet që kanë ndodhur në të kaluarën të mos përsëriten.

Në Republikën e Kosovës, si pasojë e luftës, janë shkaktuar shumë viktima dhe dëme materiale. Prandaj, mekanizmat e drejtësisë tranzicionale janë të domosdoshëm në mënyrë që të adresohen nevojat e viktimave për drejtësi, njohje dhe pranim, zhdëmtim për humbjet e tyre jomateriale dhe materiale, si dhe ndërmarrje të veprimeve ligjore dhe të

natyrave të tjera, me qëllim që të garantohet mospërsëritja.

Avokati i Popullit, në Raportin ex officio nr. 422/2021 lidhur me drejtësinë tranzicionale dhe zbatimin e mekanizmave të saj,<sup>208</sup> të publikuar në vitin 2023, ka konstatuar se institucionet nuk i kanë përmbushur obligimet e veta karshi viktimave në ofrimin e drejtësisë për krimet e luftës kundër njerëzimit, me përmasa të gjenocidit, që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se shteti nuk i ka përmbushur obligimet e veta ndaj viktimave për sa i përket mbledhjes dhe dokumentimit të fakteve mbi krimet e luftës. Në anën tjetër, është vlerësuar se janë përmbushur disa detyrime në ofrimin e reparacioneve materiale ndaj viktimave dhe në ndërmarrjen e reformave institucionale, me qëllim të garantimit të mospërsëritjes. Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime konkrete autoriteteve përgjegjëse për politika dhe nisma të reja, si dhe rekomandime për përmirësimin e funksionimit të nismave ekzistuese në fushën e drejtësisë tranzicionale, në përmirësimin e gjendjes lidhur me realizimin e të drejtave të viktimave për drejtësi dhe reparacion, si dhe të së drejtës për të ditur dhe garantimit të mospërsëritjes.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2024, kishte organizuar tryezë diskutimi me qëllim të shënimit të Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur dhe diskutimit me aktorët relevantë lidhur me fatin e personave të pagjetur dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit në Raportin për drejtësinë tranzicionale. Gjatë tryezës u diskutua me aktorët relevantë lidhur me fatin e personave të pagjetur, si dhe me masat që shteti ka ndërmarrë dhe duhet të ndërmarrë për sa u përket krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe adresimit të fatit të personave të pagjetur, duke shtruar për diskutim dhe adresim edhe sfidat aktuale të këtij procesi.

Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2024, kishte miratuar Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale<sup>209</sup> 2024–2034, e cila përmban qëllimet për adresimin e krimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe synon të mundësojë dialogun shoqëror për të kaluarën, të sigurojë kushtet e nevojshme për arritjen e drejtësisë për të gjitha viktimat, si dhe të sigurojë zbatimin e një procesi gjithëpërfshirës e transparent të mbështetjes materiale, simbolike dhe psiko-sociale për të gjitha viktimat etj.

208 <https://oik-rks.org/2023/06/05/rraporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4222021-drejtësia-tranzicionale-dhe-zbatimi-i-mekanizmave-te-saj/>

209 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-PER-DREJTESI-TRANZICIONALE-E-REPUBLIKES-SE-KOSOVES-2024-2034.pdf>

Me qëllim të funksionalizimit të Komisionit Presidencial për Drejtësi Tranzicionale, gjatë vitit 2025, Presidentja e Republikës së Kosovës zhvilloi takim me përfaqësues të misioneve diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare për të diskutuar përgatitjet për themelimin e këtij komisioni. Gjithashtu, u zhvillua takim i Presidentes edhe me organizata të shoqërisë civile për të diskutuar rolin e tyre dhe bashkëpunimin në themelimin e Komisionit Presidencial për Drejtësi Tranzicionale ndërmjet institucioneve shtetërore, viktimave dhe shoqërisë civile.

Pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, që tani e lejon qartë zhvillimin e gjykimeve në mungesë, Prokuroria Speciale ka nisur ta përdorë këtë mekanizëm më shpesh dhe ka një rritje të ndjeshme në numrin e ngritjes së aktakuzave në mungesë dhe në zhvillimin e seancave gjyqësore për rastet e krimeve të luftës. Megjithatë, trajtimi i gjykimeve në mungesë, përveçse ngre debate për drejtësinë e arritur për faktin se të akuzuarit nuk janë të pranishëm në procesin gjyqësor dhe mbesin të lirë, sfidon edhe sistemin gjyqësor dhe prokurorial në aspektin e kapaciteteve të tyre për të menaxhuar një numër në rritje të këtyre rasteve komplekse.

Lidhur me çështjet e drejtësisë tranzicionale, gjatë vitit 2025 është vendosur që këto çështje të përfshihen në programin e trajnimit në Akademinë e Drejtësisë për vitin 2026, për profesionistët e drejtësisë, gjykatësit, prokurorët etj.

Avokati i Popullit vlerëson se, përkundër disa zhvillimeve në fushën e drejtësisë tranzicionale, rruga mbetet e gjatë për përfundimin efektiv të çështjeve të së kaluarës dhe përmbushjen e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, sidomos për sa i përket sigurimit të llogaridhënies, të së drejtës për të vendosur drejtësi dhe të së drejtës së viktimave dhe familjeve të tyre për të mësuar të vërtetën.

## Të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

Duke pasur parasysh shqetësimet e vazhdueshme të ngritura për çështje që ndërlidhen me procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe pengesat në realizimin e beneficioneve që u takojnë viktimave mbi bazën e ligjit, Avokati i Popullit, më 24 tetor 2024, publikoi Raportin mbi respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, si dhe pengesat në realizimin e beneficioneve të garantuara me ligj.<sup>210</sup>

Lidhur me veprimet e autoriteteve në vitin 2025, lidhur me rekomandimet e Raportit të Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit nuk ka arritur të merrte informata të qarta.

Trajtimi i çështjes nga Avokati i Popullit, nga perspektiva e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, fokusohet në: respektimin e afateve ligjore nga ana e komisionit në procesin e trajtimit të aplikacioneve për verifikim dhe njohje të statusit të viktimës; individualizimin e arsytimit të vendimeve për secilin rast veç e veç, duke iu shmangur arsytimeve shabllone apo të njëjta për raste të ndryshme; kufizimin e afatit kohor për dorëzimin e aplikacioneve; organizimin dhe realizimin e procesit të intervistimit të viktimave, si edhe qasjen e viktimave në hapësirat ku realizohet intervistimi; si dhe ngritjen e vetëdijesimit dhe sensibilizimit të opinionit publik për aplikimin për njohje dhe verifikim të statusit të viktimës.

210 <https://oik-rks.org/2024/10/31/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-436-2023-lidhur-me-respektimin-e-te-drejtave-te-njeriut-gjate-zhvillimit-te-procesit-te-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-viktimave-se-dhunes-seksuale/>

# Shërbimet digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe Të Drejtat e Njeriut

## Shërbimet digjitale

Zhvillimet në fushën e shërbimeve digjitale dhe teknologjive të avancuara kanë vazhduar të ndikojnë ndjeshëm në proceset shoqërore, ekonomike dhe institucionale në vend edhe gjatë vitit 2025. Proceset e digjitalizimit, të orientuara drejt rritjes së efikasitetit të administratës dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike, kanë krijuar mundësi të reja për zhvillim social dhe ekonomik, si dhe për rritjen e transparencës institucionale. Megjithatë, këto zhvillime janë shoqëruar edhe me shqetësime në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për shkak të rreziqeve potenciale që shërbimet digjitale mund të paraqesin në raport me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht në relacion me të drejtën e privatësisë, lirinë e shprehjes dhe qasjen e barabartë të qytetarëve.

Miratimi i Agjendës Digjitale të Kosovës 2030 dhe Strategjisë së Kosovës për Teknologjinë Informativë, si dokumente strategjike që synojnë orientimin e vendit drejt një shoqërie të zhvilluar digjitale, konsiderohen zhvillime tejet pozitive në këtë fushë, për të cilat Avokati i Popullit ka raportuar edhe në Raportin e tij Vjetor për vitin 2024. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rithekson se qasja e bazuar në të drejtat e njeriut është thelbësore dhe kjo kërkon një balancë të kujdesshme ndërmjet mundësive dhe rreziqeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo qasje nuk është përfshirë në Agjendën Digjitale të Kosovës 2030. Prandaj, duke e vënë në pah rëndësinë e saj, është e nevojshme të theksohet se qasja e bazuar në të drejtat e njeriut duhet të jetë e integruar në dokumentet strategjike për zhvillimin e digjitalizimit në vend.

Një ndër zhvillimet me ndikim pozitiv në lehtësimin e shërbimeve administrative dhe qasjes së qytetarëve në shërbimet publike është funksionimi i platformës shtetërore “e-Kosova”, e cila ka vazhduar zgjerimin e shërbimeve dhe

informatave publike të ofruara online. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se është e rëndësishme që platforma të avancohet edhe më tej në aspektin e integritit të standardeve të të drejtave të njeriut në funksionimin e saj. Në veçanti, është e nevojshme që informatat lidhur me mjetet juridike në dispozicion të qytetarëve të jenë më të strukturuar dhe më transparente, duke ofruar udhëzime të qarta për procedurat ankimore, afatet ligjore dhe institucionet kompetente. Po ashtu, është e rëndësishme të avancohet më tej mundësia e komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve përgjegjëse përmes platformës, duke mundësuar adresimin e pyetjeve dhe kërkesave për sqarime shtesë, të cilat qytetarët apo përdoruesit i konsiderojnë të nevojshme.

Në nivel evropian, miratimi i Aktit të Shërbimeve Digjitale (Digital Services Act – DSA) nga Bashkimi Evropian ka vendosur standarde të reja për sigurinë, përgjegjshmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore në hapësirën digjitale. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit konsideron se autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrin masa konkrete për harmonizimin gradual të kornizës ligjore dhe institucionale me këto standarde, me qëllim të parandalimit të rreziqeve që mund të cenojnë të drejtat e njeriut në procesin e transformimit digjital.

Lidhur me avancimin e shërbimeve publike digjitale, më 14 mars 2025, Avokati i Popullit mori pjesë në tryezën konsultative mbi rekomandimet e paraqitura në Rezolutën për Digjitalizimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K) në bashkëpunim me aktorët kyç. Në këtë tryezë u diskutuan prioritetet për avancimin e shërbimeve publike digjitale, përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në përputhje me standardet evropiane. Avokati i Popullit kontribuoi në diskutimet lidhur me sfidat ekzistuese dhe nevojën për garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave personale në proceset e transformimit digjital.

## Inteligjenca Artificiale

Për sa i përket zhvillimit të Inteligjencës Artificiale, gjatë vitit 2025 ka vazhduar rritja dhe zhvillimi i hovshëm me shpejtësi të theksuar. Për përdorimin e sigurt dhe etik të shërbimeve digjitale dhe të IA-së, BE-ja është fokusuar në krijimin e një kuadri ligjor dhe rregullator, siç është miratimi i Aktit të BE-së për Inteligjencën

Artificiale, qëllimi i të cilit është të sigurohet që IA-ja të përdoret në mënyrë të sigurt, transparente dhe të përgjegjshme, duke i mbrojtur të drejtat e njeriut. Po ashtu, Këshilli i Evropës ka miratuar Konventën Kornizë për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, nëpërmjet së cilës kërkohet respektimi: i dinjitetit njerëzor dhe autonomisë individuale; barazisë dhe mosdiskriminimit; respektimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; transparencës dhe mbikëqyrjes etj.

Avokati i Popullit, në raportin vjetor të vitit paraprak, ka potencuar se standardet ndërkombëtare të krijuara për mbrojtjen e qytetarëve nga rreziqet e IA-së, nga aspekti i të drejtave themelore, duhet të integrohen në rendin juridik të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka vërejtur se, pavarësisht zhvillimeve të shpejta në fushën e IA-së dhe rëndësisë së saj në proceset e digjitalizimit, autoritetet përgjegjëse, përfshirë Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet relevante, nuk kanë publikuar informata të qarta dhe të strukturuar lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete, masave specifike apo rezultateve të arritura në këtë fushë. Mungesa e transparencës institucionale e vështirëson vlerësimin e nivelit të përgatitjes së vendit për adresimin e sfidave dhe rreziqeve që lidhen me përdorimin e teknologjive të IA-së, veçanërisht nga këndvështrimi i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe nënvizon nevojën për informim publik dhe koordinim më të qartë ndërinstitucional.

Në kuadër të rolit të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj), siç është IAP-ja, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ndikimet negative të IA-së, i përcaktuar me nenin 77, paragrafi 1, të Aktit të BE-së për Inteligjencën Artificiale, IAP-ja gjatë vitit raportues ka ndërmarrë veprime konkrete për hartimin e një raporti me rekomandime lidhur me ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të Drejtat Themelore të Njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky raport është vlerësuar si i nevojshëm, si rezultat i vlerësimit të nevojës për adresimin në kohë të sfidave që paraqet zhvillimi dhe përdorimi në rritje i teknologjive të Inteligjencës Artificiale dhe pritet t'u adresohet autoriteteve relevante gjatë vitit 2026.

Edhe gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje të shtuar zhvillimet periodike në fushën e Inteligjencës Artificiale, si dhe debatet dhe iniciativat në nivel ndërkombëtar lidhur me rolin e IKDNj-ve dhe organeve të barazisë në mbrojtjen dhe promovimin e të

drejtave të njeriut nga ndikimet potencialisht negative të IA-së. Stafi i IAP-së, i angazhuar në këtë fushë, në cilësinë e anëtarëve të grupeve punuese të ENNHRI-së dhe EQUINET-it, ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet relevante, standardet e reja dhe praktikrat e mira evropiane, me qëllim të forcimit të qasjes institucionale dhe avancimit të kapaciteteve për adresimin efektiv të sfidave që ndërlidhen me përdorimin e sistemeve të IA-së.

Me qëllim të fuqizimit për ushtrimin e mandatit dhe rolit të IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ndikimet negative të teknologjive të IA-së, IAP-ja ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë në IA dhe ndikimin e saj në të drejtat e njeriut. Në këtë kuadër, më 2 dhe 3 korrik 2025, stafi i IAP-së ka ndjekur një trajnim dyditor me temën “Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në të Drejtat e Njeriut”, i cili ka trajtuar aspekte thelbësore të IA-së, duke përfshirë analizën e kuadrit të ri rregullator evropian, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale dhe Aktin e BE-së për IA-në, me theks në vlerësimin e ndikimit në të drejtat themelore. Trajnimi është ofruar nga ekspertja e Këshillit të Evropës në Strasburg dhe është mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

# Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është i autorizuar që të ngrejë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën, si dhe përputhshmërisë së Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Në këtë drejtim, gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka analizuar Ligjin nr. 08/L-262 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e Tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – Faza e Dytë, dhe ka vërejtur se në Kapitullin XXIV [Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore], në nenin 77 deri në 84, janë ndryshuar dhe plotësuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, në bazë të autorizimeve kushtetuese të përcaktuara në nenin 113, më 24 shkurt 2025 ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të neneve 77 deri në 84 të Ligjit nr. 08/L-262 për

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e Tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – Faza e Dytë.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka konsideruar se përcaktimet e aktit të kontestuar kanë krijuar paqartësi rreth procedurave të ekzekutimit të akteve administrative, rrjedhimisht u kanë mohuar personave të drejtën që aktet administrative të ekzekutohen nëpërmjet dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përkatësisht që realizimi i të drejtave të bëhet në procedurën përmbartimore.

Në këtë rast, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë nëse nenin 77 deri në 84 të Ligjit të kontestuar janë në pajtim me nenin 7 dhe nenin 32 të Kushtetutës

së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, më 8 janar 2025, ka pranuar nga Gjykata Kushtetuese Njoftim për regjistrimin e Kërkesës KO 261/24. Nëpërmjet këtij njoftimi u është mundësuar palëve të interesuara t'i jepnin komentet e tyre lidhur me Ligjin nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, pas analizimit të ligjit të theksuar më sipër, më 15 janar 2025 ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese komente lidhur me Ligjin nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, sipas Njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e Kërkesës KO 261/24, të datës 8 janar 2025.

Nëpërmjet këtyre komenteve, Avokati i Popullit e ka konsideruar të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese:

- Të vlerësojë nëse dispozitat e Ligjit nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme cenojnë të drejtën e pronës, sigurinë juridike, të drejtën për mjete juridike, si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
- Të vlerësojë nëse përmbajtja e nenit 19, paragrafi 2, cenon sigurinë juridike dhe të drejtën e pronës të përcaktuara në Kushtetutë.
- Të vlerësojë nëse kompetenca e Komisionit të Kuvendit, që pas dështimit të Kuvendit për ta zgjedhur drejtorin e përgjithshëm pas dy rundeve t'i zhvillojë procedurat sipas nenit 16 dhe, në fund të procesit, ta zgjedhë si drejtor të përgjithshëm kandidatin me më së shumti pikë, bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që përcaktojnë kompetencat e Kuvendit.

**Promovimi i drejtave  
dhe lirive themelore  
të njeriut**

# Promovimi i drejtave dhe lirive themelore të njeriut

## Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë

Në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor, si dhe me standardet ndërkombëtare që rregullojnë funksionimin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit ushtron një rol thelbësor në promovimin dhe ndërtimin e një kulture të respektimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Mandati i promovimit përbën një komponent të pandashëm dhe komplementar me funksionin e mbrojtës dhe atë të parandalimit të cenimit apo shkeljes së të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit e realizon këtë mandat përmes zhvillimit të aktiviteteve sistematike për ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të institucioneve publike mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, me qëllim parandalimin e shkeljeve, forcimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes së mirë. Këto aktivitete bazohen në një qasje të strukturuar, të orientuar drejt standardeve ndërkombëtare dhe nevojave konkrete të qytetarëve.

Promovimi i të drejtave të njeriut realizohet gjithashtu nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet publike, shoqërinë civile, institucionet arsimore, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në rrjete të ndryshme, duke siguruar qasje më të afërt dhe më të drejtpërdrejtë me publikun.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka vijuar me intensitet të shtuar realizimin e mandatit të tij për promovimin e të drejtave të njeriut, përmes një game të gjerë aktiviteteve edukative, informuese, sensibilizuese dhe vetëdijësuese, të orientuara drejt forcimit të kulturës së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore në vend.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka

organizuar një numër të konsiderueshëm tryezash promovuese dhe tematike, fushata vetëdijësuese, aktivitete bashkëpunimi dhe bashkërendimi me partnerë socialë, publikime të ndryshme, konferenca dhe aktivitete të tjera, në kuadër të të cilave janë trajtuar çështje me rëndësi të veçantë për të drejtat e njeriut, përfshirë luftimin e diskriminimit, mbrojtjen e komuniteteve joshumicë, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin mendor etj.

Avokati i Popullit ka zhvilluar një bashkëpunim të strukturuar dhe të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile, përfshirë përmes Forumit për Dialog ndërmjet IAP-së dhe OShC-ve, duke synuar avokim të përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme, si dhe për fuqizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vend. Në këtë kuadër janë përcaktuar edhe prioritetet e përbashkëta për veprim për vitin 2025/2026.

Promovimi i të drejtave të njeriut është realizuar gjithashtu përmes komunikimit publik dhe deklaratave tematike të Avokatit të Popullit lidhur me çështje të ndjeshme dhe me interes të lartë publik, përkritazi me ngritjen e vetëdijësimit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e punës, mbrojtjen e mjedisit, të drejtat sociale dhe ekonomike, luftimin e dhunës dhe diskriminimit, të drejtat e fëmijëve, proceset zgjedhore, si dhe të drejtat e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Këto reagime kanë synuar të adresonin shqetësimet e ngritura në shoqëri dhe të nxisin institucionet përgjegjëse për veprim në përputhje me obligimet e tyre ligjore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të ngritjes së vetëdijës publike dhe edukimit për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit ka realizuar takime dhe ligjërata me studentë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë studentë të programeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe studentë nga universitete të huaja, duke i informuar ata për mandatin, kompetencat dhe rolin e institucionit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për gjendjen e përgjithshme të të drejtave të njeriut në vend.

Në kuadër të mandatit të MKP-së, Avokati i Popullit ka zhvilluar aktivitete promovuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me mbrojtjen e personave të privuar nga liria, si dhe ka marrë pjesë në aktivitete monitoruese dhe dialoguese me institucionet përkatëse, me theks të veçantë në shëndetin mendor dhe trajtimin me dinjitet.

Në tërësi, me aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2025 është synuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive e Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut, duke kontribuar në ngritjen e vetëdijes publike, forcimin e dialogut institucional dhe shoqëror, si dhe në avancimin e standardeve të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore në Republikën e Kosovës.

Në vijim paraqitja tabelore e aktiviteteve të organizuara nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2025:

Lloji i aktivitetit	Qëllimi	Numri
Tryeza tematike të organizuara nga IAP-ja dhe në bashkëpunim me partnerë	Diskutimi mbi të drejtat e njeriut, promovimi i të drejtave të njeriut, prezantimi i të gjeturave në raportet e publikuara me rekomandime	7
Tryeza tematike në kuadër të fushatës informuese për të drejtat e komuniteteve joshumicë	Fushatë informuese për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë, me qëllim të adresimit të çështjeve të ngritura dhe rritjen e besimit të komuniteteve në mekanizmat mbrojtës	7
Tryeza të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar		4
Ligjërata dhe takime me të rinj	Edukimi dhe informimi mbi të drejtat e njeriut	5
Trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë	Edukimi dhe informimi i profesionistëve ligjorë mbi të drejtat e njeriut, praktikën e GjEDNJ-së dhe mandatin e IAP-së	2
Takime me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në kuadër të fushatës "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit"	Edukimi mbi të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e vetëdijesimit	29
Takime në kuadër të Forumit për Dialog të IAP-së me OShC-në	Fuqizimi i bashkëpunimit dhe avancimi i promovimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut	4

# Tryezat tematike të organizuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, IAP-ja ka organizuar një numër të konsiderueshëm tryezash tematike, të cilat kanë shërbyer si platforma të rëndësishme për diskutim, dialog ndërinstitucional dhe adresim të çështjeve prioritare në fushën e të drejtave të njeriut. Këto tryeza kanë kontribuar në promovimin e barazisë, luftimin e diskriminimit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe forcimin e mekanizmave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## Tryezë tematike “Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi - Raporti Vjetor 2023”

Më 28 janar 2025, Avokati i Popullit organizoi një tryezë tematike në Prishtinë, ku u prezantuan të gjeturat e Raportit Vjetor 2023 për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Në tryezë morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike, gjyqësorit, shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë.

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi mbi nivelin e zbatimit në praktikë të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe identifikimi i sfidave kryesore institucionale. Gjatë diskutimeve u vlerësua se bashkëpunimi institucional është vendimtar, jo vetëm si obligim kushtetues, por edhe si parakusht themelor për luftimin efektiv të diskriminimit dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. U theksua gjithashtu se raporti ka identifikuar zbrazëtira dhe aspekte kritike që duhen adresuar për të mundësuar mbikëqyrje më efektive. Përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë rithekësuan rëndësinë e funksionalizimit të mekanizmave për mbrojtjen kundër diskriminimit në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Tryeza vuri në pah nevojën për zbatimin e gjashtë rekomandimeve konkrete të raportit, me qëllim përmirësimin e implementimit të ligjit dhe garantimin e një mbrojtjeje më efektive ndaj diskriminimit. U theksua gjithashtu se raporti është mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

## Tryezë diskutimi mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT)

Më 8 prill 2025, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, me qëllim diskutimin e zotimeve dhe progresit në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Evropës, pas vizitës së këtij mekanizmi në Kosovë. Në fokus të diskutimeve ishin kushtet në institucionet e privimit të lirisë, trajtimi i personave të ndaluar dhe roli i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në kuadër të IAP-së në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut.



U theksua se zbatimi i rekomandimeve të CPT-së ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e trajtimit të personave të privuar nga liria dhe në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, duke kontribuar njëkohësisht në proceset integruese evropiane të Kosovës. Takimi nxori si synim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet MKP-së, institucioneve relevante dhe shoqërisë civile, për të siguruar monitorim efektiv dhe respektim të të drejtave të njeriut në institucionet korrektuese, qendrat e ndalimit dhe institucionet psikiatrike.



## Tryezë tematike në Stanishor “Mjedisi, e drejtë e njeriut”

Më 19 qershor 2025, Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, organizoi një tryezë tematike në fshatin Stanishor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komunës së Novobërdës, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, si dhe banorëve të kësaj komune, fshatit Stanishor dhe Komunës së Gjilanit.



Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i çështjeve mjedisore në terren dhe trajtimi i mjedisit, si komponent i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

Gjatë tryezës, Avokati i Popullit i informoi të pranishmit mbi mandatin dhe kompetencat e institucionit, duke përfshirë edhe rolin në mbrojtjen e mjedisit, dhe theksoi se takime të tilla ndihmojnë institucionin të kuptojë më mirë sfidat dhe problemet e qytetarëve. Pjesëmarrësit evidentuan se zona vazhdon të përballet me ndotje nga gurthyesit, si dhe shprehën shqetësim për prishjen e rrugës, duke sugjeruar ndërtimin e një rruge alternative për banorët.

Tryeza synoi adresimin e shqetësimeve të qytetarëve nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe koordinimit institucional, ndërsa u theksua se kjo tryezë është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

## Tryezë tematike “Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve” në Prishtinë

Më 1 korrik 2025, Avokati i Popullit organizoi tryezë me temën “Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve”, me pjesëmarrjen e gazetarëve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i gjendjes së lirisë së mediave në Kosovë, sfidave me të cilat përballet gazetarët dhe nevojës për mbrojtje më të fortë ligjore.



Gjatë diskutimeve u theksua renditja negative e Kosovës në indeksin e Reporterëve pa Kufij, mungesa e transparencës institucionale dhe nevoja për dialog të strukturuar me institucionet shtetërore. Tryeza riafirmoi rëndësinë e lirisë së shprehjes si shtyllë themelore e demokracisë dhe nevojën për garantimin e sigurisë së gazetarëve.

## Tryezë tematike mbi sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi në nivel qendror dhe lokal

Më 17 korrik 2025, Avokati i Popullit organizoi një tryezë me zyrtarë të institucioneve publike, ku u diskutuan sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nga ana e institucioneve qendrore dhe lokale. Qëllimi i tryezës ishte vlerësimi i funksionimit të mekanizmave institucionalë të krijuar nga ministritë dhe komunat për monitorimin e zbatimit të ligjit, si dhe shqyrtimi i gjetjeve të Raportit të vitit 2023 në këtë fushë.

Gjatë diskutimeve u theksua se disa nga mekanizmat e paraparë me ligj, përfshirë njësitë për mbrojtje nga diskriminimi, janë shuar ose nuk funksionojnë, ndërsa disa institucione nuk kanë emëruar ende zyrtarët përkatës. Tryeza nxori si konkluzion nevojën për përmbushjen e obligimeve ligjore nga institucionet publike dhe forcimin e mekanizmave monitorues për një zbatim më efektiv të ligjit.

Gjithashtu, u trajtua procesi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili pritet të adresojë fusha kyçe, përfshirë krijimin e njësitë për mbrojtje nga diskriminimi, standardizimin e detyrave të punës dhe ndërtimin e një kornize monitoruese

dhe zbatuese më të qartë. Tryeza synoi rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e zbatimit praktik të ligjit.

## Tryezë tematike “Të komunikojmë përmes artit” me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar



Më 6 dhjetor 2025, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me OJQ-në “Sytë kërkojnë dritë”, organizoi një tryezë në Suharekë me temë “Të komunikojmë përmes artit”, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar. Qëllimi i kësaj tryeze ishte të rritej ndërgjegjësimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe të promovohet përfshirja dhe barazia e tyre në shoqëri, duke përdorur artin si mjet komunikimi dhe sensibilizimi.

Në këtë takim, Avokati i Popullit theksoi se kjo ditë rikujton detyrat dhe obligimet e institucioneve dhe të shoqërisë për të përmbushur përgjegjësitë ndaj qytetarëve që kanë nevojë, ndërsa ritheksoi përkushtimin e institucionit për të vazhduar punën dhe t’ua rikujtojë autoritetet publike që të veprojnë në përputhje me ligjin dhe standardet për të përmbushur obligimet ndaj personave me aftësi të kufizuar. Tryeza u shoqërua edhe me hapjen e ekspozitës së pikturave të krijuara nga personat me aftësi të kufizuar, duke e vendosur theksin te fuqizimi, dukshmëria dhe pjesëmarrja aktive e tyre në jetën shoqërore.

## Tryezë tematike në Prishtinë: “Shëndeti mendor i personave të moshuar: Detyrimi i shtetit për përkujdesje, mbrojtje dhe dinjitet dhe roli i Avokatit të Popullit”

Më 10 dhjetor 2025, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Forumin për Dialog ndërmjet IAP-së dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, organizoi një tryezë tematike në Prishtinë me temën “Shëndeti mendor i personave të moshuar: Detyrimi i shtetit për përkujdesje, mbrojtje dhe dinjitet dhe roli i Avokatit të Popullit”.



Qëllimi i kësaj tryeze ishte të theksohej rëndësia e kësaj dite në kujtesën institucionale dhe publike dhe të trajtohej një çështje me ndjeshmëri të lartë shoqërore, siç është shëndeti mendor i personave të moshës së tretë.



Në tryezë u prezantua raporti tematik për shëndetin mendor të personave të moshuar,

ku u diskutua se shoqëria jonë vazhdon të përballet me sfida serioze në këtë fushë, ndërsa problemet e shëndetit mendor që prekin të moshuarit kërkojnë një fokus më të madh institucional. U theksua se pengesat kryesore nuk lidhen domosdoshmërisht me neglizhencën, por me mungesën e politikave dhe programeve të përshtatshme për trajtimin e këtyre problemeve.

Po ashtu, u theksua se mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor vështirëson zbatimin e ligjit dhe krijon hapësirë për praktika diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat mbi 65 vjeç. Tryeza synoi rritjen e vëmendjes institucionale, forcimin e kornizës rregullative dhe garantimin e trajtimit dinjitoz për këtë kategori, me pjesëmarrjen e institucioneve vendore e ndërkombëtare, udhëheqësve të shërbimeve shëndetësore dhe shoqërisë civile.

## Tryezat e organizuara në kuadër të fushatës për të drejtat e komuniteteve joshumicë

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit realizoi një fushatë të dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë, nëpërmjet organizimit të një sërë tryezash diskutimi në komuna të ndryshme, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Kjo fushatë u konceptua si një qasje e drejtpërdrejtë në terren, me qëllim dëgjimin e shqetësimeve reale të komuniteteve, identifikimin e barrierave në realizimin e të drejtave të tyre dhe forcimin e komunikimit ndërmjet qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

Nëpërmjet këtyre takimeve, IAP-ja synoi mbledhjen e informatave të strukturuar mbi çështjet që preokupojnë komunitetet joshumicë, si dhe të nxisë bashkëpunim të qëndrueshëm ndërinstinucional për adresimin e problemeve të ngritura, duke rritur besimin e komuniteteve në mekanizmat mbrojtës.

Tryezat e realizuara janë si vijon:

## Tryezë në kuadër të fushatës për të drejtat e komuniteteve joshumicë në Pejë

Më 19 shkurt 2025, Avokati i Popullit organizoi në Pejë një tryezë diskutimi me organizatat e shoqërisë civile të këtij rajoni, ku u trajtuan sfidat dhe problemet e komuniteteve në lidhje me të drejtat e njeriut.

Qëllimi i tryezës ishte të rritej vetëdija dhe të thellohej kuptimi i çështjeve të të drejtave të njeriut nga perspektiva e komuniteteve të prekura, si dhe të lehtësohej bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet IAP-së dhe organizatave të shoqërisë civile në rajon



Në tryezë morën pjesë organizata nga komunitetet serbe, boshnjake dhe shqiptare, të cilat ngritën shqetësime konkrete, duke përfshirë: proceset e ngadalshme gjyqësore për kthimin e pronave të uzurpuara, çështje mjedisore, nevojën për përkujdesje më të madhe sociale dhe shëndetësore, mungesën e dokumenteve personale (sidomos në mesin e qytetarëve të komunitetit serb), si dhe problematika të tjera sociale.

Tryeza u organizua në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “ACDC” dhe synoi që shqetësimet e ngritura të shërbejnë si bazë për adresim institucional dhe për forcimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm në terren.

## Tryezë diskutimi me qytetarë për problemet sociale dhe ligjore në Komunën e Mitrovicës së Veriut

Më 26 shkurt 2025, në Mitrovicën e Veriut, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me organizatën “ACDC”, organizoi një tryezë diskutimi me qytetarë për problemet sociale dhe ligjore në këtë komunë. Qëllimi i takimit ishte të dëgjoheshin drejtpërdrejt shqetësimet e qytetarëve dhe të identifikoheshin barrierat që ndikonin në realizimin e të drejtave të tyre, si në aspektin social, ashtu edhe në atë ligjor.

Tryeza synoi të shërbente si platformë komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj mekanizmave mbrojtës dhe në orientimin e tyre për përdorimin e mjeteve ligjore në dispozicion. Po ashtu, diskutimet u parashikuan të shërbenin si bazë për adresim të çështjeve konkrete nëpërmjet trajtimit të ankesave dhe veprimeve institucionale të mëtejshme.

## Tryezë diskutimi për të drejtat e njeriut me organizatat e shoqërisë civile në Prizren

Më 11 prill 2025, Avokati i Popullit, organizoi tryezë diskutimi në regjionin e Prizrenit me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të institucioneve publike, me qëllim diskutimin e gjendjes së të drejtave të njeriut dhe sfidave me të cilat përballen qytetarët e komuniteteve joshumicë në këtë rajon. Tryeza kishte për qëllim të dëgjoheshin drejtpërdrejt problemet e komuniteteve, marrjen e informatave nga organizatat që punojnë për të drejtat e njeriut dhe të vendosë bashkëpunim të qëndrueshëm për adresimin e çështjeve në terren.

Gjatë tryezës u trajtuan çështje që lidheshin me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, problematika sociale, nënpërfaqësimin e komuniteteve në jetën publike, pensionet dhe tema të tjera me rëndësi për komunitetet. Pjesëmarrësit theksuan probleme në realizimin e të drejtave për pensione, mungesën e punësimit, çështje të sigurisë, nostrifikimin e diplomave të shkollës së mesme, vështirësitë e OJQ-ve për të përfituar subvencione nga autoritetet lokale, si dhe të drejtën në përdorimin e gjuhëve. U ngritën gjithashtu shqetësime për braktisjen e shkollës nga fëmijët, pozitën e tyre

në situatë rruge, gjendjen e rëndë të mirëqenies së familjeve të komuniteteve dhe ankesat për refuzimin e marrjes së pensioneve të dyfishta. Tryeza u organizua në bashkëpunim me OJQ-në “ACDC”, në kuadër të projektit “Avancimi i të drejtave të njeriut përmes aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komunitetit”.

## Tryezë diskutimi me komunitetin serb për të drejtat e njeriut në Leposaviq

Më 10 korrik 2025, Avokati i Popullit vizitoi fshatin Leshak të Leposaviqit, takoi banorët lokalë dhe dëgjoji shqetësimet e tyre lidhur me çështjet pronësore. Po ashtu, Avokati i Popullit organizoi një tryezë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarë të Leposaviqit, ku u diskutua për qëllimin e vizitës dhe u dëgjuan ankesa të tjera nga komuniteti serb. Pjesëmarrësit ngritën probleme të lidhura me pajisjen me dokumente personale, çështjen e personave të zhvendosur dhe sfidat në furnizimin me energji elektrike. Avokati i Popullit takoi edhe kryetarin e Komunës së Leposaviqit, me të cilin diskutoi për takimet me qytetarët dhe për ankesat e parashtruara, me synim orientimin e veprimeve institucionale në adresimin e çështjeve të ngritura.

## Tryezë diskutimi në Prishtinë: “Gjendja e të drejtave të komuniteteve në vend”

Më 31 tetor 2025, Avokati i Popullit, me mbështetje të OSBE-së, organizoi në Prishtinë një tryezë diskutimi me temën “Gjendja e të drejtave të komuniteteve në vend”, me qëllim diskutimin e përbashkët mbi gjendjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të drejta të garantuara në Kapitullin III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



Avokati i Popullit theksoi rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe prezantoi gjetjet e nxjerra nga takimet e realizuara në vendbanimet e banuara me komunitete gjatë dy viteve të fundit. Në tryezë u vlerësua se ankesat nga komunitetet joshumicë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit janë rritur ndër vite, duke reflektuar rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve vendore për të drejtat e komuniteteve, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Diskutimet trajtuan sfida në arsim, punësim, të drejta gjuhësore, përfaqësim institucional, qasje në fonde dhe subvencione, si dhe nevojën për dialog dhe mirëbesim ndërkombëtar.

### **Tryezë me pjesëtarët e komunitetit boshnjak në Reçan**

Më 24 nëntor 2025, në Reçan, Avokati i Popullit, me mbështetje të OSBE-së, organizoi një tryezë me pjesëtarë të komunitetit boshnjak.



Gjatë takimit, Avokati i Popullit i njoftoi të pranishmit për rolin e veçantë të IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe theksoi se ky takim ofron një mundësi të mirë për të diskutuar sfidat dhe problemet që prekin këtë komunitet. Pjesëmarrësit ngritën shqetësime lidhur me përdorimin e gjuhës boshnjake në komunat ku ajo është gjuhë zyrtare, duke theksuar mungesën e publikimeve të mjaftueshme dhe të përditësuara në gjuhën boshnjake në ueb-faqet zyrtare. Po ashtu, u vlerësua mungesa e librave shkollorë në këtë gjuhë, çështja e mosnstrifikimit të diplomave pas arsimit të lartë dhe zvarritjet e procedurave gjyqësore.

## **Tryeza të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar**

### **Konferencë rajonale mbi forcimin e partneritetit ndërmjet institucioneve të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile**

Më 3 prill 2025, në Prishtinë, IAP-ja, në bashkëpunim me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR/KS), organizoi

Konferencën Rajonale me temë “Rritja e partneritetit ndërmjet institucioneve të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut”. Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve homologe të Avokatit të Popullit nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, organizata të shoqërisë civile, aktivistë dhe ekspertë, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e formave të bashkëpunimit të strukturuar dhe strategjik në përputhje me Parimet e Parisit.



Diskutimet u fokusuan në nevojën për veprime të përbashkëta në mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, fuqizimin e mekanizmave të monitorimit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për veprimin e shoqërisë civile. Konferenca shërbeu si platformë për thellimin e dialogut rajonal dhe rikonfirmoi përkushtimin e përbashkët për forcimin e partneritetit ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

### **Konferencë ndërkombëtare e MKP-së mbi shëndetin mendor në institucionet e privimit të lirisë**

Më 26 qershor 2025, Avokati i Popullit, në kuadër të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), organizoi Konferencën Ndërkombëtare me temën “Shëndeti Mendor në Institucionet e Privimit të Lirisë: Roli i MKP-ve në mbrojtjen e të drejtave dhe sigurimin e mbikëqyrjes efektive”. Konferenca u zhvillua me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Torturës dhe kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi standardet evropiane të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në institucionet e privimit të lirisë, si dhe forcimin e rolit të MKP-ve në monitorimin e këtyre institucioneve.

Ky aktivitet mbledhi përfaqësues të MKP-ve

nga vendet e rajonit, institucione shtetërore relevante, organizata ndërkombëtare dhe shoqëri civile, duke shërbyer si platformë për shkëmbim përvojash, diskutim të sfidave praktike dhe identifikim të nevojave për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave, trajtimit me dinjitet dhe mbikëqyrjes efektive të personave me çrregullime mendore në sistemin penitenciar dhe institucionet e shëndetit mendor.

## Tryezë me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në vend



Më 1 tetor 2025, Avokati i Popullit organizoi një tryezë me ambasadorë dhe përfaqësues të agjencive dhe organizatave ndërkombëtare, me qëllim informimin për shënimin e 25-vjetorit të themelimit të IAP-së dhe reflektimin mbi bashkëpunimin e ndërtuar ndër vite.

Tryeza shërbeu si platformë për shkëmbim vlerësimesh mbi rolin e Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, sfidat aktuale të institucioneve të pavarura dhe rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë institucionale. Diskutimet theksuan nevojën për vazhdimin dhe forcimin e partneritetit me aktorët ndërkombëtarë, për rritjen e respektimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike dhe për krijimin e një mjedisi të favorshëm që mundëson funksionimin efektiv të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Tryeza rikonfirmoi përkushtimin e ndërsjellë për bashkëpunim të mëtejshëm në avancimin e standardeve demokratike dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.

# Edukimi mbi të drejtat e njeriut

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka zhvilluar një sërë aktivitete edukative me grupe të ndryshme, me qëllim forcimin e njohurive, ndërgjegjësimin dhe kulturës së respektimit të të drejtave të njeriut. Nëpërmjet takimeve me studentë vendorë dhe ndërkombëtarë, fëmijë dhe të mitur, si dhe me përfaqësues të grupeve që avokojnë për të drejtat e fëmijëve, IAP-ja ka synuar promovimin e standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, forcimin e kuptimit mbi rolin e institucioneve publike dhe kontribuimin në ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj mbrojtjes së të drejtave themelore.

Këto aktivitete kanë shërbyer si platforma edukimi, dialogu dhe shkëmbimi përvojash, duke rritur vetëdijen dhe përgjegjësinë institucionale në fusha të ndryshme të shoqërisë.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka realizuar trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, me qëllim t'i njoftojë më afër për rolin dhe kompetencat e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut.

Aktivitetet lidhur me edukimin për të drejtat e njeriut pasqyrohen në vijim:

## Takim edukativ me studentët e programit ndërkombëtar EMA

Më 23 janar 2025, Avokati i Popullit priti në takim studentë të programit ndërkombëtar “The European Master’s Degree in Human Rights and Democratization (EMA)”, me seli në Vjenë dhe Venedik, të cilët çdo vit vizitojnë Kosovën në kuadër të vizitës së tyre studimore.



Gjatë takimit, Avokati i Popullit i informoi studentët për krijimin e institucionit, mandatin dhe kompetencat, procedurat e pranimit të

ankesave, si dhe rolin e IAP-së në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Studentët u njoftuan gjithashtu për gjendjen e përgjithshme të të drejtave të njeriut në vend. U theksua se ky bashkëpunim shënon 21 vjet dhe se mbi 2500 studentë nga e gjithë bota kanë vizituar Kosovën dhe janë takuar me Avokatin e Popullit, duke e bërë këtë aktivitet një kontribut të rëndësishëm në edukimin dhe ndërgjegjësimin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut në Kosovë.

### **Takim edukativ me përfaqësues të grupeve të fëmijëve që avokojnë për të drejtat e fëmijëve**

Më 15 prill 2025, Avokati i Popullit organizoi një takim edukativ me përfaqësues të grupeve të ndryshme të fëmijëve që avokojnë për të drejtat e fëmijëve, përfshirë Asamblenë e Fëmijëve të Prishtinës dhe të Mitrovicës, grupin Respect Our Rights (ROR), SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë dhe HANDIKOS-in (grupi Hëna).

Qëllimi i takimit ishte dëgjimi i perspektivës së fëmijëve lidhur me çështjet që i prekin drejtpërdrejt në shkolla dhe në komunitet, si dhe përfshirja e tyre në diskutimet mbi përgjegjësitë institucionale për parandalimin dhe adresimin e dhunës në shkolla. Ky aktivitet kontribuoi në mbledhjen e informatave nga vetë fëmijët dhe pasurimin e procesit të hartimit të rekomandimeve institucionale në këtë fushë.

### **Takim edukativ me të miturit nga Qendra Korrektuese-Edukuese në Lipjan**

Më 6 maj 2025, Avokati i Popullit zhvilloi një takim edukativ me të miturit nga Qendra Korrektuese-Edukuese në Lipjan. Qëllimi i këtij takimi ishte informimi i të miturve për rolin dhe kompetencat e IAP-së, si dhe rritja e njohurive të tyre mbi të drejtat e njeriut dhe funksionimin e institucioneve publike. Takimi synoi mbështetjen në procesin e rehabilitimit dhe risocializimit të të miturve, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të tyre për integrim të suksesshëm në shoqëri.

### **Takim edukativ me studentët e Universitetit Shtetëror të Floridas (ShBA)**

Më 21 maj 2025, Avokati i Popullit organizoi një takim edukativ me studentë të Universitetit Shtetëror të Floridas (ShBA), me qëllim informimin e tyre për sistemin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe rolin e Avokatit të Popullit. Gjatë takimit u trajtuan parimet themelore të të drejtave të njeriut, standardet ndërkombëtare dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve publike. Takimi

kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e të drejtave të njeriut në një kontekst ndërkombëtar.

### **Punëtori për forcimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në epokën digjitale**

Më 27 nëntor 2025, Save the Children Kosova, në bashkëpunim me IAP-në, organizuan një punëtori me fokus forcimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në hapësirën fizike dhe digjitale.

Punëtorja trajtoi përvojat e fëmijëve në epokën digjitale, mundësitë që ofron teknologjia dhe sfidat online që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Aktiviteti synoi përmirësimin e kapaciteteve institucionale për adresimin e këtyre çështjeve dhe kontribuimin në ndërtimin e mekanizmave gjithëpërfshirës që promovojnë pjesëmarrjen dhe mbrojtjen efektive të fëmijëve.



### **Aktivitetet për shënimin e Ditës Botërore të Fëmijëve**

Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Fëmijëve, më 20 nëntor 2025, Avokati i Popullit zhvilloi një sërë takimesh dhe aktivitetsesh me fëmijë, duke riafirmuar angazhimin e IAP-së për mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të çdo fëmije, pa dallim.



Në Zyrën Qendrore, Avokati i Popullit priti fëmijët nga "SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë" dhe nga Shkolla Filllore "European School of Kosova", ndërsa u organizua edhe një debat me nxënësit e "American School of Kosova",

ku u diskutua për të drejtat e fëmijëve, sigurinë, arsimin cilësor dhe rëndësinë e dëgjimit të zërit të tyre në vendimmarrje. Aktivitetet u zhvilluan edhe në zyrat rajonale, me takime me fëmijë dhe nxënës në Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, duke theksuar përgjegjësinë e përbashkët të institucioneve, familjeve dhe shoqërisë për krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbrojtës për fëmijët.



Këto takime shërbyen për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përforsimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës në çdo politikë dhe veprim institucional, duke ritheksuar se të drejtat e fëmijëve janë një detyrim konkret dhe një investim thelbësor për të ardhmen e vendit.

### **Fushata informuese për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në institucionet arsimore**

Për sa i përket promovimit të të drejtave të fëmijëve, Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në IAP, gjatë vitit 2025, organizoi fushata informuese për nxënësit dhe mësimmshënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në 29 shkolla në 16 komuna: Ferizaj, Shtërpçë, Shtime, Gjilan, Viti, Kamenicë, Malishevë, Rahovec, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, Prishtinë dhe Podujevë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte njohja e nxënësve dhe mësimmshënësve me rolin, mandatin dhe kompetencat e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend.

Synimi kryesor i fushatës ishte theksimi i domosdoshmërisë së parandalimit të ndëshkimit trupor në institucionet arsimore, si dhe informimi i nxënësve dhe mësimmshënësve mbi mundësitë për t'iu drejtuar IAP-së në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjatë realizimit të fushatës, nxënësve dhe mësimmshënësve iu bë e ditur mundësia të dëgjoheshin drejtpërdrejt nga përfaqësuesit e

IAP-së, duke shprehur mendimet, qëndrimet dhe shqetësimet e tyre lidhur me problematika të ndryshme me të cilat përballen në jetën e përditshme, jo vetëm në ambientet shkollore, por edhe jashtë tyre.

### **Publikimi i videove informuese**

Gjatë vitit 2025 janë publikuar dy video promovuese. Më 14 mars 2025, u realizua dhe u publikua një video informuese për punën dhe mandatin e IAP-së, e përshtatur posaçërisht për komunitetin e të shurdhërve, me synim rritjen e qasjes në informim dhe përfshirjen e barabartë në ushtrimin e të drejtave.<sup>211</sup> Po ashtu, më 25 shtator 2025, u publikua mesazhi i Avokatit të Popullit në kuadër të muajit ndërkombëtar të parandalimit të vetëvrasjes, me qëllim ndërgjegjësimin publik, nxitjen e kërimit të ndihmës në kohë dhe promovimin e kujdesit për shëndetin mendor.<sup>212</sup>

### **Takimet me gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar**

Më 16 maj 2025, Avokati i Popullit, së bashku me bashkëpunëtorë, priti në takim gjyqtarët e sapoemëruar dhe bashkëbisedoi me ta për të drejtat e njeriut, sistemin e drejtësisë dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore. Avokati i Popullit i njoftoi të pranishmit për mandatin dhe kompetencat e institucionit, si dhe për aktivitetet e tij në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

Po ashtu, më 27 nëntor 2025, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët priti në takim gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, me të cilët diskutoi për të drejtat e njeriut, sistemin e drejtësisë dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

### **Bashkëpunimi me shoqërinë civile**

Gjatë vitit raportues, IAP-ja ka vijuar dhe forcuar bashkëpunimin e strukturuar dhe të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si një element të rëndësishëm për realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor në promovimin dhe avancimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shoqëria civile ka shërbyer si partner i rëndësishëm në identifikimin e problematikave në terren, adresimin e shqetësimeve të grupeve të cënueshme dhe avancimin e dialogut ndër-institucional për çështje me interes publik.

Bashkëpunimi është zhvilluar përmes organizimit të tryezave tematike, konferencave, punëtorive, fushatave informuese dhe

211 <https://oik-rks.org/2025/03/14/video-promovuese-per-punen-e-institucionit-te-avokatit-te-popullit-drejtuar-komunitetit-te-te-shurdherve/>

212 <https://oik-rks.org/2025/09/25/mesazhi-i-avokatit-te-popullit-z-naim-qelaj-per-nder-te-muajit-nderkombetar-te-parandalimit-te-vetevrasjes/>

aktiviteteve të përbashkëta, si dhe përmes pjesëmarrjes aktive të IAP-së në iniciativa të organizuara nga partnerët. Këto aktivitete kanë krijuar hapësira të rëndësishme për shkëmbim informacionesh, diskutim të gjetjeve, avokim të përbashkët dhe adresim të rekomandimeve konkrete për autoritetet publike.

Një mekanizëm kyç i këtij bashkëpunimi ka qenë Forumi për Dialog ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, i cili gjatë vitit 2025 shërbeu si platformë e qëndrueshme për koordinim, konsultim dhe veprim të përbashkët. Përmes aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të Forumit, janë përcaktuar prioritetet strategjike të përbashkëta, të fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cënueshme dhe jo vetëm.

Bashkëpunimi u reflektua edhe në organizimin e një numri të konsiderueshëm tryezash tematike në nivel lokal, rajonal dhe qendror, veçanërisht në kuadër të fushatës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë. Këto tryeza mundësuan dëgjimin e drejtpërdrejtë të shqetësimeve të qytetarëve, mbledhjen e informatave nga organizatat që veprojnë në terren dhe forcimin e besimit të komuniteteve ndaj mekanizmave mbrojtës. Organizatat e shoqërisë civile luajtën një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike, si dhe në orientimin e çështjeve të ngritura drejt trajtimit institucional.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit bashkëpunoi ngushtë me organizatat e shoqërisë civile në organizimin e konferencave rajonale, duke kontribuar në shkëmbimin e praktikave të mira, fuqizimin e partneritetit ndërinstucional dhe harmonizimin e veprimeve me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në përgjithësi, ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e qasjes gjithëpërfshirëse të IAP-së, në rritjen e ndërgjegjësimin publik, në adresimin më efektiv të problematikave të identifikuara dhe në avancimin e standardeve të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.

### **Forum për Dialog mes IAP-së dhe OShC-së**

Gjatë vitit 2025, IAP-ja ka vijuar bashkëpunimin e strukturuar dhe të qëndrueshëm me organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet Forumit për Dialog, i cili ka shërbyer si platformë e rëndësishme për koordinim, konsultim dhe veprim të përbashkët në fushën e të drejtave të njeriut. Në kuadër të Forumit, gjatë vitit raportues janë realizuar një punëtori treditore, një tryezë dhe dy takime, si vijon:

## **Punëtori për hartimin e Planit të Veprimit 2025/2026 të Forumit për Dialog**

Më 25, 26 dhe 27 prill 2025, në kuadër të Forumit për Dialog ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, u mbajt një punëtori treditore me mbështetje të OJQ-së “ACDC”. Gjatë punëtorisë u hartua Plani i Veprimit i Forumit për vitet 2025–2026 dhe u përcaktuan prioritetet strategjike për veprim të përbashkët. Fokusi i planit përfshiu avokimin për fuqizimin e rolit dhe mbështetjes institucionale të shoqërisë civile, si dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve joshumicë, komunitetit LGBTIQ+, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin mendor dhe luftimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

### **Takimi i parë vjetor i Forumit për Dialog për vitin 2025**

Më 6 maj 2025, u mbajt takimi i parë i punës për vitin 2025 i Forumit për Dialog ndërmjet IAP-së dhe OShC-së. Gjatë takimit u prezantuan aktivitetet dhe objektivat e Planit të Veprimit 2025–2026, si dhe u propozuan aktivitete të ndryshme për zbatimin e tyre. Përfaqësuesit e shoqërisë civile ngritën shqetësime lidhur me mungesën e financimit të qëndrueshëm dhe mbështetjes institucionale, duke theksuar nevojën për krijimin e një ambienti më të favorshëm për funksionimin e OJQ-ve në fushën e të drejtave të njeriut.

## **Tryezë diskutimi mbi mbështetjen e shoqërisë civile dhe politikave të financimit**

Më 9 qershor 2025, IAP-ja organizoi një tryezë diskutimi në kuadër të Forumit për Dialog me organizatat e shoqërisë civile. Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i ndikimit të ndryshimeve të politikave të Bashkimit Evropian dhe orientimin e fondeve, si dhe të shqyrtimi i mundësive për rritjen e mbështetjes shtetërore për shoqërinë civile, veçanërisht për shërbimet profesionale që OShC-të ofrojnë për qytetarët dhe institucionet publike. Takimi kontribuoi në forcimin e dialogut institucional dhe në rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

### **Takimi i tretë vjetor i Forumit për Dialog me shoqërinë civile**

Më 7 tetor 2025, u mbajt takimi i tretë vjetor

i Forumit për Dialog me përfaqësuesit e organizatave anëtare. Gjatë takimit u diskutuan aktivitetet e realizuara nga IAP-ja gjatë periudhës prill–tetor 2025 në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, si dhe çështjet me interes të veçantë, përfshirë problematikat mjedisore, shëndetin mendor, të drejtat e fëmijëve, lirinë e mediave, të drejtat sociale dhe ekonomike, dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore, si dhe çështjet pronësore të komuniteteve. Takimi shërbeu si platformë për shkëmbim informacionesh, koordinim veprimesh dhe dakordim për aktivitete të përbashkëta në vijim.



## Pjesëmarrja e Avokatit të Popullit në aktivitetet e organizuara nga institucionet bashkëpunuese dhe vizitat në terren

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka realizuar një numër të konsiderueshëm vizitash dhe pjesëmarrjesh në terren, me qëllim monitorimin e drejtpërdrejtë të respektimit të të drejtave të njeriut, forcimin e bashkëpunimit ndërinstucional dhe ndërkombëtar, si dhe adresimin e çështjeve konkrete të ngritura nga qytetarët dhe grupet e cënueshme.

Vizitat kanë përfshirë institucione shëndetësore, korrektuese dhe të privimit të lirisë, pika kufitare, qendra të shoqërisë civile, aktivitete monitoruese të grevave dhe tubimeve, si dhe pjesëmarrje në forume kombëtare dhe ndërkombëtare mbi drejtësinë, shëndetin mendor, të drejtat e punëtorëve, personave me aftësi të kufizuara, refugjatëve, grave, fëmijëve dhe komuniteteve joshumicë.

Përmes këtyre vizitave është mundësuar identifikimi i mangësive strukturore dhe ligjore, mbledhja e informatave të dorës së parë, dhënia e rekomandimeve për autoritetet publike, si dhe avancimi i dialogut me institucionet

shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Këto angazhime kanë kontribuar në rritjen e mbikëqyrjes efektive, forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit.

## Promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet deklaratave të publikuara

Me qëllim të informimit të qytetarëve dhe vetëdijësimit të publikut mbi standardet e të drejtave të njeriut dhe mbi detyrimet e institucioneve publike, Avokati i Popullit, në kuadër të promovimit të të drejtave të njeriut, nëpërmjet komunikatave për media, ka publikuar disa deklarata me rastin e ditëve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si: Dita e Kushtetutës (9 prill 2025), Dita Memoriale të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës (14 prill 2025), Dita Ndërkombëtare të Punëtorëve (1 maj 2025), Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor 2025) dhe Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor 2025).

Këto komunikata kanë shërbyer për rritjen e ndërgjegjësimit publik, forcimin e kulturës së përgjegjësive institucionale dhe orientimin e debateve publike drejt standardeve të të drejtave të njeriut, me synimin që respektimi i të drejtave të mos mbetet deklarative, por të përkthehet në politika dhe veprime konkrete në dobi të qytetarëve.

## Arritjet në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë

Gjatë vitit raportues, IAP-ja ka shënuar arritje të konsiderueshme në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë, përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, proaktive dhe të orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve dhe grupeve të cënueshme. Megjithatë, mbeten ende sfida për t'u adresuar. Aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në forcimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe avancimin e zbatimit të standardeve vendore në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Organizimi dhe realizimi i një numri të konsiderueshëm tryezash tematike dhe promovuese kanë shërbyer si platforma të rëndësishme për dialog ndërinstucional dhe

shoqëror mbi çështje kyçe, si luftimi i diskriminimit, barazia dhe mosdiskriminimi, të drejtat e komuniteteve joshumicë, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, shëndeti mendor, mbrojtja e mjedisit, liria e mediave dhe siguria e gazetarëve.

Një arritje e veçantë gjatë vitit raportues ka qenë zbatimi i fushatave për promovimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë, përmes organizimit të tryezave në nivel lokal dhe qendror me pjesëmarrjen e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Këto aktivitete kanë kontribuar në identifikimin e barrierave në realizimin e të drejtave, rritjen e besimit të komuniteteve ndaj IAP-së dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për adresimin e çështjeve të ngritura, veçanërisht në fushat e arsimit, punësimit, të të drejtave gjuhësore, shërbimeve sociale dhe të të drejtave pronësore.

Në kuadër të promovimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, IAP-ja ka arritur progres të rëndësishëm nëpërmjet organizimit të tryezave dhe aktiviteteve që trajtojnë zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke theksuar nevojën për funksionalizimin e mekanizmave institucionale dhe përmirësimin e zbatimit praktik të legjislacionit. Këto aktivitete kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe akterëve relevantë për obligimet ligjore dhe standardet evropiane në fushën e barazisë.

Një tjetër arritje e rëndësishme ka qenë fuqizimi i edukimit dhe vetëdijesimit mbi të drejtat e njeriut nëpërmjet takimeve me fëmijë, të mitur, nxënës, studentë dhe të rinj. Këto aktivitete kanë kontribuar në ngritjen e njohurive mbi të drejtat e njeriut, rolin e institucioneve mbrojtëse dhe rëndësinë e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke ndikuar në ndërtimin e një kulture demokratike dhe respektuese ndaj të drejtave të çdo individi.

Në përgjithësi, aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 përbëjnë një arritje të konsiderueshme të IAP-së në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë, duke fuqizuar njohuritë dhe vetëdijesimin publik mbi të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin.

# Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj) vazhdoi të ketë rëndësi thelbësore në konsolidimin e sistemit global të të drejtave të njeriut dhe në garantimin e mbrojtjes efektive të këtyre të drejtave në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave të mira, IKDNj-të ishin në gjendje të adresonin sfidat e përbashkëta, të forconin kapacitetet institucionale dhe të kontribuonin në avancimin e standardeve universale që promovojnë respektimin e dinjitetit njerëzor. Ky bashkëpunim, i cili u shtri përtej konteksteve kombëtare dhe përfshiu mekanizmat e Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës, të Bashkimit Evropian dhe organizatat e rrjetet e tjera rajonale, paraqiti një mjet thelbësor për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të këtyre institucioneve.

Në themel të funksionimit të IKDNj-ve mbeti pavarësia e tyre, e cila përbëri garanci të paanshmërisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë publike. Pavarësia institucionale dhe operacionale ishte kusht thelbësor për ushtrimin e mandatit në mënyrë të paanshme dhe të pavarur nga çdo ndikim i jashtëm, veçanërisht nga politika. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Parimet e Parisit, ndërsa Këshilli i Evropës miratoi Parimet e Venecias, të cilat përbëjnë bazën normative ndërkombëtare që garanton pavarësinë, mandatin dhe funksionimin efektiv të IKDNj-ve. Këto standarde përcaktuan qartë se IKDNj-të duhet të themelohen me kushtetutë apo ligj, të gëzojnë autonomi të plotë financiare dhe administrative dhe të ushtrojnë mandatin e tyre pa ndërhyrje politike, duke siguruar integritet institucional dhe kompetencë për të kërkuar llogaridhënie nga autoritetet publike.

Në këtë kuadër, besueshmëria dhe autoriteti institucional i Institucionit të Avokatit të Popullit u konfirmuan edhe nga vlerësime të pavarura rajonale. Sipas Barometrit të Ballkanit, anketës së perceptimit publik të realizuar këtë vit nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës u rendit më i larti në rajonin e Ballkanit Perëndimor për sa i përket besimit të qytetarëve në pavarësinë e tij dhe aftësinë për të vepruar pa ndikim politik. Ky rezultat përforcoi më tej vlerësimet pozitive të dhëna nga rrjetet dhe partnerët ndërkombëtarë dhe dëshmoi

se puna e Institucionit u perceptua gjerësisht nga publiku si profesionale, e paanshme dhe e përkushtuar ndaj mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Gjatë vitit 2025, zhvillimet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut theksuan edhe më shumë rëndësinë e zbatimit të këtyre standardeve. Në veçanti, vendet evropiane u përballën me sfida të reja që dolën nga transformimi i shpejtë teknologjik dhe digjital, shtimi i rreziqeve të dezinformimit, presionet mbi pavarësinë e institucioneve demokratike dhe barrierat e vazhdueshme në qasjen në drejtësi për grupet e cenueshme. Përgjigjja e mekanizmave ndërkombëtarë u orientua drejt forcimit të standardeve ekzistuese dhe krijimit të instrumenteve të reja që ndihmuan vendet të harmonizonin politikat dhe praktikat e tyre me parimet e të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian avancuan standarde të rëndësishme, duke përfshirë dispozita për mbrojtjen e të dhënave personale, mosdiskriminimin dhe transparencën në përdorimin e teknologjive të reja, me theks të veçantë në inteligjencën artificiale. Miratimi dhe operacionalizimi i Direktivave të BE-së 2024/1499 dhe 2024/1500 për pavarësinë dhe funksionimin e mekanizmave të barazisë gjatë vitit 2025 përbënin një zhvillim kyç, duke kërkuar nga shtetet anëtare dhe ato në proces integrimi të siguronin funksionim të pavarur, profesional dhe të paanshëm të këtyre mekanizmave, pa ndikime të jashtme në ushtrimin e mandateve të tyre.

Në këtë drejtim, Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës (IAP) vijoi të kontribuonte aktivisht në platformat ndërkombëtare, duke ndjekur nga afër zhvillimet globale dhe rajonale në fushën e të drejtave të njeriut dhe duke i reflektuar ato në punën e tij të përditshme. Nëpërmjet bashkëpunimit me rrjetet ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat ishte anëtarësuar, IAP-ja siguroi qasje në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe fuqizoi kapacitetin për të adresuar sfidat që dolën nga dinamika shoqërore, institucionale dhe teknologjike.

Gjatë vitit raportues, IAP-ja vazhdoi të thellonte angazhimin e vet në proceset ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takime, konsultime, programe trajnimi dhe kontributit në dokumente themelore në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Ky angazhim ishte thelbësor për të siguruar që zëri i qytetarëve të Kosovës të përfaqësohej në platformat relevante dhe që standardet ndërkombëtare të përktheheshin në masa konkrete në nivel kombëtar.

## Konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare të organizuara nga IAP-ja gjatë vitit 2025

Më 3 prill 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR/KS), organizoi Konferencën Rajonale “Forcimi i Partneriteteve ndërmjet Institucioneve të Avokatit të Popullit dhe Shoqërisë Civile për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut”. Qëllimi kryesor i konferencës ishte krijimi i një platforme rajonale për institucionet e Avokatit të Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira, si dhe zhvillimin e qasjeve të përbashkëta strategjike për avancimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.



Në këtë kuadër, konferenca i kushtoi vëmendje të veçantë mbështetjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe rëndësisë së garantimit të një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të favorshëm për veprimtarinë e shoqërisë civile. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin Avokatja e Popullit e Shqipërisë, Avokati i Popullit i Malit të Zi, Avokati i Popullit i Kroacisë, përfaqësues nga Avokati i Popullit i Maqedonisë së Veriut, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Nëpërmjet kësaj konference rajonale u rikonfirmua përkushtimi i përbashkët për fuqizimin e

mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e urave më të forta të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të drejtat e njeriut dhe shoqërisë civile.

Më 26 qershor 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), organizoi Konferencën Ndërkombëtare “Shëndeti Mendor në Institucionet e Privimit të Lirisë:

Roli i MKP-ve në mbrojtjen e të drejtave si dhe sigurimin e mbikëqyrjes efektive”. Konferenca u organizua për të shënuar 26 Qershorin – Ditën Ndërkombëtare për Mbështetjen e Viktimave të Torturës – dhe për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm të publikut, në veçanti të autoriteteve përgjegjëse, lidhur me standardet evropiane të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor, ndjeshmërinë që mbart kjo çështje dhe nevojën për trajtim me dinjitet.



Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës të shteteve si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Sllovenia, si dhe përfaqësues nga institucione shtetërore, përfshirë Zyrën për Qeverisje të Mirë, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Policinë e Kosovës, Departamentin Shëndetësor të Burgjeve dhe Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Po ashtu, të pranishëm ishin përfaqësues nga organizata ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, EULEX-i, OSBE-ja dhe UNMIK-u, ekspertë të Këshillit të Evropës, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

## Shënimi i 25-vjetorit të Institucionit të Avokatit të Popullit

Më 1-2 dhjetor 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit shënoi 25-vjetorin e themelimit të tij, një moment i rëndësishëm që simbolizon një çerekshekulli shërbim të përkushtuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë dhe qeverisjes së mirë. I themeluar në periudhën pas konfliktit, në një kohë kur institucionet demokratike të Kosovës ishin në ndërtim e sipër, Institucioni ka mbetur i palëkundur në mbrojtjen e sundimit të ligjit, forcimin e llogaridhënies institucionale dhe garantimin e dinjitetit dhe lirive themelore për çdo individ. Gjatë këtyre 25 viteve, ai është shndërruar në një shtyllë qendrore të rendit demokratik dhe juridik të vendit.

Shënimi i këtij jubileu, nisi me një Ceremoni Festive, e mbajtur më 1 dhjetor, në të cilin na nderoi me pjesëmarrjen e saj, Presidentja e Republikës së Kosovës, Sh.S. Dr. Vjosa Osmani Sadriu, dhe e pasuruar me një video-mesazh nga Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, z. Michael O'Flaherty dhe më një fjalë rasti nga Ambasadori i Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Gerard McGurk.

Më 2 dhjetor, aktivitetet vijuan me mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë me temën “E Ardhmja e të Drejtave të Njeriut në mes të Transformimeve Globale: Sfidat Kombëtare dhe Detyrimet Ndërkombëtare”, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Dimal Basha, dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Nexhmi Rexhepi, e më pas e pasuar me një video-mesazh nga znj. Sirpa Rautio, drejtoreshë e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), duke theksuar edhe një herë rolin jetik të institucioneve të forta dhe të pavarura të të drejtave të njeriut.

Në një botë të ndikuar nga inovacioni teknologjik, ndryshimet mjedisore, zhvillimet gjeopolitike dhe polarizimi shoqëror, roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut është më i rëndësishëm se kurrë. Diskutimet e konferencës u përqendruan në mënyrën se si institucionet e pavarura mund të mbeten të qëndrueshme, reaguese dhe efektive në mbrojtjen e universalitetit dhe pandashmërisë së të drejtave të njeriut.

Konferenca u nda në dy sesione, ku sesioni i parë pati për temë “Ndryshimi i Prioriteteve: Të Drejtat e Njeriut në një Botë në Ndryshim – Perspektivat nga Rrjetet e të Drejtave të Njeriut” dhe në këtë panel morën pjesë: Dr. Joseph Zammit McKeon, zëvendës-president,

Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI); znj. Erinda Ballanca, presidente, Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), znj. Simona Drenik Bavdek, anëtare e Bordit, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI); dhe z. Patrick Charlier, kryesues, Rrjeti Evropian i Trupave të Barazisë (EQUINET).



Ndërsa në sesionin e dytë u diskutua tema “Përgjigjet Kombëtare ndaj Sfidave Globale: Praktikë më të Mira për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut”. Në këtë panel morën pjesë: z. Mehmet Akarca, Ombudsman i Turqisë, Dr. Robert Gajda, Komisionar për Mbrojtje nga Diskriminimi i Shqipërisë; Dr. Andrew Forde, Komisionar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi të Irlandës; Dr. Jolita Miliuvienė, Ombudspersonë Parlamentare e Lituaniës dhe znj. Feride Rushiti, drejtoreshë ekzekutive nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.

Në shënimin e këtij përvjetori kishim nderin të mirëprisnim përfaqësues nga rrjete të rëndësishme ndërkombëtare, si: IOI, ENNHRI, AOM, EQUINET, si dhe institucione homologe nga Malta, Shqipëria, Turqia, Sllovenia, Zvicra, Danimarka, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Lituania dhe Irlanda. Pjesëmarrja e tyre reflekton respektin e thellë dhe besimin që institucioni ynë gëzon ndërkombëtarisht, si dhe angazhimin e përbashkët për avancimin e të drejtave të njeriut.



Në këtë kontekst, vlerësimet dhe mbështetja e shprehur nga figura të larta të ombudmanëve evropianë dhe ndërkombëtarë dëshmojnë më tej rolin kyç dhe kredibilitetin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në artikullin e tij të publikuar më 13 dhjetor 2025, më titull “Avokati i Popullit i Kosovës: një institucion që meriton njohje dhe mbështetje të vazhdueshme ndërkombëtare”,<sup>213</sup> Avokati Parlamentar i Maltës dhe Zëvendëspresidenti i Bordit të Rajonit Evropian të IOI-së, z. Joseph Zammit McKeon, e cilëson IAP-në si një institucion kushtetues të pavarur, me mandat të fortë ligjor, vizion të qartë dhe ndikim të prekshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të grupeve të cenueshme dhe komuniteteve pakicë. Ai nënvizoi se mbështetja e vazhdueshme ndërkombëtare ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit ka rëndësi thelbësore për forcimin e sundimit të ligjit, konsolidimin demokratik dhe avancimin e Kosovës në rrugën e integritimit evropian, duke e konsideruar këtë institucion si një zë të besueshëm, të respektuar dhe të domosdoshëm në arkitekturën evropiane të të drejtave të njeriut.

## Angazhimet ndërkombëtare jashtë vendit

Më 16 tetor 2025, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Naim Qelaj, u zgjodh anëtar i Bordit Drejtues të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM),<sup>214</sup> gjatë Asamblesë së Përgjithshme të mbajtur në Maltë.

Në këtë rol, ai do të kontribuojë në zhvillimin e strategjive dhe politikave të AOM-it, duke përfaqësuar zërin dhe përvojën e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.



© Foto nga Ombudsmani Parlamentar i Maltës

Kjo zgjedhje është një dëshmi e besimit dhe respektit që gëzon institucioni ynë në arenën ndërkombëtare, si dhe një nxitje për vazhdimin e punës së palodhshme në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Më 8 tetor 2025, me nominim të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe me votim të fshehtë, Zëvendësi i Avokatit të Popullit, z. Niman Hajdari është zgjedhur anëtar i Bordit Ekzekutiv të Rrjetit Evropian të Trupave të Barazisë (EQUINET).<sup>215</sup>

213 Artikulli “Avokati i Popullit i Kosovës: një institucion që meriton njohje dhe mbështetje të vazhdueshme ndërkombëtare”, shkruar nga z. Joseph Zammit McKeon, Avokat Parlamentar i Maltës dhe Zëvendëspresidenti i Bordit të Rajonit Evropian të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), i qasshëm në: <https://ombudsman.org.mk/news-and-events/the-ombudsperson-of-kosovo-an-institution-worthy-of-consistent-international-recognition-and-support/>

214 Avokati i Popullit është anëtar institucional i Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) që prej viti 2016.

215 EQUINET është rrjeti udhëheqës evropian që bashkon 47 trupa të barazisë nga 39 shtete evropiane, të cilat punojnë për të promovuar barazinë, për të luftuar diskriminimin në të gjitha format e tij dhe për të forcuar zbatimin efektiv të të drejtave themelore të njeriut në Evropë. Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës është anëtar i këtij rrjeti që prej vitit 2019.



© Foto nga EQUINET

Kjo përzgjedhje është bërë gjatë Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të EQUINET-it, të mbajtur në Bruksel, ku përfaqësuesit e institucioneve anëtare votuan për përbërjen e re të Bordit Ekzekutiv, i cili do të udhëheqë punën strategjike të rrjetit gjatë dy viteve të ardhshme, 2025-2027. Ky emërim përbëri një njohje të rëndësishme të rolit aktiv, profesionalizmit dhe bashkëpunimit të avancuar ndërkombëtar të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili në mënyrë të vazhdueshme kontribuoi në punën e rrjeteve evropiane dhe në promovimin e standardeve të barazisë dhe të të drejtave të njeriut në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

### **Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare**

Pjesëmarrja aktive e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) në takime dhe forume ndërkombëtare përbëri një komponent thelbësor të veprimtarisë së tij vjetore, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Këto angazhime shërbyen si platformë për shkëmbimin e përvojave, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjatë periudhës raportuese, IAP-ja mori pjesë në takime, konferenca dhe forume të organizuara nga institucione homologe, rrjete rajonale dhe ndërkombëtare të ombudsmanëve, si dhe nga organizata relevante ndërkombëtare. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, IAP-ja kontribuoi në diskutime tematike mbi çështje aktuale, ndau praktika të mira dhe forcoi rolin e tij si një aktor i besueshëm dhe konstruktiv në arenën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Angazhimi ndërkombëtar ndikoi drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve profesionale të IAP-së, në avancimin e qasjeve bashkëkohore në trajtimin e ankesave dhe

në fuqizimin e avokimit për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave vendore me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Njëkohësisht, këto angazhime kontribuuan në afirmimin e Republikës së Kosovës dhe të IAP-së si partnerë aktivë në dialogun rajonal dhe global për të drejtat e njeriut.

Më 30 prill 2025, në kuadër të takimeve bilaterale, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Naim Qelaj, zhvilloi një takim zyrtar me znj. Sirpa Rautio, drejtoreshë e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe avancimin e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut. Gjatë takimit u diskutua rëndësia e përfshirjes së Kosovës në rrjetet dhe platformat tematike të FRA-së, me fokus në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, luftimin e diskriminimit, digjitalizimin, inteligjencën artificiale, garantimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të drejtat e pakicave, si dhe mundësia e përfshirjes së Kosovës si anëtare vëzhguese në punën e FRA-së.

Znj. Rautio shprehu gatishmërinë e FRA-së për të mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës nëpërmjet vizitave studimore, shkëmbimit të metodologjive të punës dhe pjesëmarrjes në ngjarje të ndryshme, duke theksuar rolin jetik të institucioneve të pavarura në promovimin e të drejtave themelore dhe standardeve të BE-së. Takimi shënoi një hap të rëndësishëm drejt thellimit të marrëdhënieve ndërmjet IAP-së dhe FRA-së dhe kontribuon në avancimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë.



© Foto nga FRA

Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet homologe dhe me rrjetet ndërkombëtare, si dhe këtyre takimeve, IAP-ja ka arritur që gjatë vitit 2025 të sigurojë qasje në burime dhe ekspertizë që e forcojnë mandatin e tij dhe e ndihmojnë të adresojë sfida gjithnjë e më komplekse, duke reflektuar ndryshimet e shpejta në fushën e të drejtave të njeriut. Këto përpjekje përmirësojnë jo vetëm reagimin ndaj sfidave kombëtare, por edhe kontribuojnë në forcimin e zbatimit të obligimeve ndërkombëtare në nivel vendor dhe në përfshirjen e rolit të Kosovës në dialogun global për të drejtat e njeriut.

Në total, gjatë vitit 2025, IAP-ja ka marrë pjesë në 49 ngjarje ndërkombëtare, prej të cilave 32 me pjesëmarrje fizike dhe 17 me pjesëmarrje online, të paraqitura në tabelën përkatëse më poshtë.

**Tabela 1:** Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Nr.	Aktiviteti / Tema	Vendi	Data	Organizatori
1.	Uebinari me temën: “Mbrojtja e grupeve në situatë vulnerabiliteti: sfidat dhe strategjitë për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ)”	Online	30 janar 2025	GANHRI
2.	Forumi i MKP-ve Evropiane, me temën: “Trajtimi i mbipopullimit në burgjet evropiane: Fuqizimi i rolit të MKP-ve në mbrojtjen e të drejtave dhe sigurimin e mbikëqyrjes efektive”	Strasbourg, Francë	5-6 shkurt 2025	Këshilli i Evropës
3.	Trajnimi online lidhur me angazhimin me Komitetin Evropian për të Drejtat Sociale sipas procedurave raportuese të Kartës Sociale Evropiane	Online	14 shkurt 2025	Këshilli i Evropës & Equinet
4.	Takimi në temën: “Të drejtat e punës si të drejta të njeriut”	Online	25 shkurt 2025	GANHRI & ILO
5.	Trajnimi “Qasja në të drejta dhe mbrojtja ligjore e të huajve në Republikën e Kosovës”	Tiranë, Shqipëri	24-27 shkurt 2025	CRPK
6.	Trajnimi online lidhur me Pjesëmarrjen e Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve	Online	4 mars 2025	ENOC
7.	Takimi vjetor i Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	Gjenevë, Zvicër	10-12 mars 2025	GANHRI
8.	Konferenca rajonale “Rritja e Partneritetit ndërmjet Institucioneve të Ombudsmanëve dhe Shoqërisë Civile për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut”	Prishtinë, Kosovë	2-3 prill 2025	IAP& YIHR
9.	Vizitë zyrtare “Shkëmbimi i eksperiencës në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut nga institucionet e të drejtave të njeriut”	Tiranë, Shqipëri	7-8 prill 2025	Avokati i Popullit-Shqipëri
10.	Trajnimi për Trajner (ToT) lidhur me Luftimin e Racizmit dhe Diskriminimit Racor	Online	9 prill-27 tetor 2025	Këshilli i Evropës

11.	Forumi i MKP-ve Evropiane, me temën: “Monitorimi i MKP-ve në kontekst të migracionit”	Strasburg, Francë	9-10 prill 2025	Këshilli i Evropës
12.	Uebinari lidhur me Vlerësimin e Ndikimit të të Drejtave Themelore për Inteligjencën Artificiale	Online	10 prill 2025	ENNHRI
13.	Takimi ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA)	Vjenë, Austri	29 prill 2025	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
14.	Uebinari “Zbatimi i barazisë përmes standarteve teknike: mundësitë për organizatat e shoqërisë civile dhe organet e barazisë”	Online	29 prill 2025	EQUINET
15.	Takimi për udhëheqësit e institucioneve: Liderhipi për barazi	Palermo, Itali	8-9 maj 2025	EQUINET
16.	Takimi i parë i Rrjetit të NPM-ve të Evropës Juglindore	Lubjanë, Slloveni	13-14 maj 2025	MKP Slloveni
17.	Takimi i Grupit Punues të EQUINET “Standardet për Organet e Barazisë”	Online	28 maj 2025	EQUINET
18.	Uebinari lidhur me Migrimin e Punës dhe Biznesi dhe të drejtat e njeriut	Online	28 maj 2025	GANHRI
19.	Konferencën Vjetore të Forumit Evropian të MKP-ve	Strasburg, Francë	5-6 qershor 2025	Këshilli i Evropës
20.	Punëtorja e Rrjetit Evropian të Planifikimit të Planeve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut	Liverpul, Britani e Madhe	4-6 qershor 2025	Universiteti i Liverpulit
21.	Tryeza e diskutimit lidhur situatën e grave të pakicave kombëtare dhe mundësinë e tyre për pjesëmarrje në jetën publike dhe parandalimin e konfliktit	Hagë, Holandë	13 qershor 2025	Komisionari i Lartë për Pakica Kombëtare i OSBE-së
22.	Takimi dhe Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e EQUINET	Online	17 qershor 2025	EQUINET
23.	Tryeza e diskutimit: “Organet e Barazisë në mundësimin e qasjes së barabartë të romëve në edukim”	Online	19 qershor 2025	EQUINET
24.	Ngjarja për shënimin e 25-vjetorit të themelimit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe Konferenca ndërkombëtare me temën: “Strukturat vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: Praktikat e mira dhe mësimet e mësuara”	Tiranë, Shqipëri	24-25 qershor 2025	Avokati i Popullit i Shqipërisë

25.	Konferenca Ndërkombëtare "Shëndeti Mendor në Vendet e Privimit të Lirisë: Roli i MKP-ve në mbrojtjen e të drejtave dhe sigurimin e një mbikëqyrjeje efektive"	Prishtinë, Kosovë	26-27 qershor 2025	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
26.	Uebinarin e me temën: "Fuqizimi i implementimit-Sigurimi i Ekzekutimit Efektiv të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit"	Online	15 korrik 2025	AOMA&IOI
27.	Konferenca e 29-të vjetore mbi të Drejtën e Fëmijëve për Shëndet Fizik dhe Takimi i 29-të i Asamblesë së Përgjithshme të ENOC	Bukuresht, Rumani	17-19 shtator 2025	ENOC
28.	Konferenca e 9-të Rajonale e Organeve të Barazisë të Evropës Juglindore	Split, Kroaci	22-23 shtator 2025	Ombudsmanja e Kroacisë
29.	Trajnimi dhe Takimi i Grupit Punues të EQUINET, me temën: "Nga Polarizimi tek Mbrojtja: Komunikimi, Politikat dhe Strategjitë Ligjore për Trajtimin e Gjuhës së Urrjetjes dhe keqinformimit"	Icalá de Henares, Spanjë	22-24 shtator 2025	ENNHRI
30.	Vizitë studimore e Grupit Teknik për koordinimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare	Strasburg, Francë	22-25 shtator 2025	Këshilli i Evropës
31.	Programi trajnues "Aplikimi i Ligjit kundër Diskriminimit"	Talin, Estoni	25-26 shtator 2025	ERA
32.	Ngjarja e angazhimit për Zgjerimin e BE-së	Bruksel, Belgjikë	24 shtator 2025	ENNHRI
33.	Forumi i ENNHRI për Leadership	Bruksel, Belgjikë	25-26 shtator 2025	ENNHRI
34.	Takimi vjetor i Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET)	Bruksel, Belgjikë	7 tetor 2025	EQUINET
35.	Takimi i Grupit Punues për Standardet për Organet e Barazisë	Bruksel, Belgjikë	8 tetor 2025	EQUINET
36.	Takimi lidhur me Raportin e ENNHRI-së për Sundimin e Ligjit	Online	8 tetor 2025	ENNHRI
37.	Takimi Rajonal lidhur me Alternativat e Mbatjes së Imigrantëve (ATD) në Ballkanin Perëndimor	Podgoricë, Mal i Zi	21-22 tetor 2025	IOM
38.	Seminari regjional "Fuqizimi i Veprimit të Trupave të Barazisë kundër Diskriminimit dhe Urrjetjes"	Strasburg, Francë	27 -28 tetor 2025	Këshilli i Evropës

39.	Trajnimi rajonal lidhur me Diskriminimin Racor dhe Anti-Racizmin	Strasbourg, Francë	28-29 tetor 2025	Këshilli i Evropës
40.	Takimi i Grupit Punues "Ligji për Barazinë në Praktikë"	Online	28 tetor 2025	EQUINET
41.	Takimi i Rrjetit të NPM-ve të Evropës Juglindore, me temën: "Hospitalizimi i pavullnetshëm në procedurat paragyqësore dhe civile"	Podgoricë, Mali i Zi	4-6 nëntor 2025	Ombudmani i Malit të Zi
42.	Punëtorja me temën: "Nga Evidenca tek Veprimi: Ndërtimi i rasteve ligjore lidhur me diskriminimin algoritmik"	Online	6-7 nëntor 2025	EQUINET
43.	Takimi online "Inteligjenca Artificiale, Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut"	Online	6 nëntor 2025	ENNHRI
44.	Takimi i Grupit Punues për Azilin dhe Migracionin	Online	13 nëntor 2025	ENNHRI
45.	Panairi për Pjesëmarrje të Fëmijëve	Bruksel, Belgjikë	17-18 nëntor 2025	Rrjeti Ndërkombëtar për Pjesëmarrjen e Fëmijëve (ICPN), mbështetur nga Save the Children Kosova
46.	Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	Bruksel, Belgjikë	19-20 nëntor 2025	ENNHRI
47.	Vizitë Studimore lidhur me Qasjen në Drejtësi	Stokholm, Suedi	20-21 nëntor 2025	Ombudsmeni për Barazi të Suedisë dhe Equinet
48.	Takimi i ENNHRI-FRONTEX- FRA lidhur me temën "Monitorimi i Pavarur në kuadër të Paktit të ri për Migracionin – Vlerësim dhe planifikim i mëtejshëm-Takim me Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe aktorët e BE-së për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme"	Varshavë, Poloni	24-25 nëntor 2025	FRONTEX
49.	Ceremonia festive për shënimin e 25 vjetorit të themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës & Konferenca e Nivelit të Lartë "E Ardhmja e të Drejtave të Njeriut në mes të Transformimeve Globale: Sfidat Kombëtare dhe Detyrimet Ndërkombëtare"	Prishtinë, Kosovë	1-2 dhjetor 2025	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës

## Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (IKDNj) në mekanizma dhe rrjete ndërkombëtare shërben për të avancuar marrëdhëniet dinamike që duhet të ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Meqë IAP-ja tashmë është anëtarësuar në rrjetet dhe organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, edhe në këtë vit është kujdesur që të ndërvepronte me to, duke mbajtur takime të përbashkëta, shkëmbim të informatave e praktikave të mira, që ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Më poshtë paraqesim mekanizmat ndërkombëtarë ku IAP-ja është e anëtarësuar:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009
3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)	2015
6.	Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura (ICOAF)	2015
7.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
8.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut	2017
9.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)	2019
10.	Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC)	2022

*Tabela: Lista e anëtarësimeve të IAP-së në rrjete ndërkombëtare*

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat, për shkak të barrierave politike, është vetëm anëtare vëzhgues, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (ku bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit);<sup>216</sup>
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore - SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).<sup>217</sup>

<sup>216</sup> Kusht për anëtarësimin në këtë organizatë është anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara.

<sup>217</sup> Kusht për anëtarësimin në këtë rrjet rajonal është aderimi i Kosovës në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës.

# Komunikimi me publikun dhe mediat

Në përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor, si dhe në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka komunikuar me publikun duke ngritur bashkëpunimin me mediat. Kjo është bërë përmes publikimit të materialeve që paraqesin punën dhe aktivitetet e institucionit, qoftë përmes përgjigjeve në pyetjet e mediave për të marrë opinionet, qëndrimet ose edhe për të marrë të dhëna lidhur me raste apo fusha të caktuara të të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjatë vitit raportues, mediat kanë mbuluar dhe i kanë dhënë hapësirë ngjarjeve dhe kanë raportuar për raportet me rekomandime dhe opinionet e Avokatit të Popullit.

Në varësi të situatave, mediat kanë kërkuar edhe qëndrim apo mendim të Avokatit të Popullit për temat të cilat ato i kanë trajtuar. Një numër i tyre janë paraqitur edhe nga mediat e komuniteteve, e në veçanti nga komuniteti serb. Duke u bazuar në raportimet e mediave, Avokati i Popullit ka filluar 15 raste të hetimeve sipas detyrës zyrtare. Ky fakt nënvizon rëndësinë e raportimit të saktë dhe profesional të mediave për publikun, përmes gazetarisë hulumtuese që identifikon dhe raporton rastet e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Për Avokatin e Popullit, këto paraqesin informata të rëndësishme dhe një burim për nisjen e hetimeve në rastet kur mund të konstatohet se ka shkelje sistematike të të drejtave të njeriut. Prandaj, duhet të inkurajohet angazhimi i mediave në prezantimin dhe raportimin e rasteve kur ekzistojnë informata për shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut, pasi puna e tyre tërheq vëmendjen e autoriteteve dhe institucioneve ndaj çështjeve jetike për jetën e qytetarëve.

Ueb faqja, si një mjet për shpërndarjen e lajmeve dhe informatave (mbi 110 lajme gjatë vitit 2025), si dhe rrjetet sociale (Facebook, Instagram dhe X), kanë shërbyer si hapësira ku qytetarët janë informuar për punën dhe aktivitetet e IAP-së, si dhe për angazhimin e Avokatit të Popullit në veçanti. Mediat po ashtu kanë mbuluar tryezat e rrumbullakëta ku Avokati i Popullit është takuar me qytetarë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve lokale.

Zyra për komunikim me media dhe publikun ka nisur në dhjetor hartimin e strategjisë për marrëdhëniet me publikun dhe mediat (2026-2030). Zyra për Komunikim me Publikun trajton gjithashtu kërkesat për qasje në dokumente publike. IAP-ja ka trajtuar 41 kërkesa të paraqitura nga ankues, qytetarë, media dhe organizata joqeveritare lidhur me qasjen në dokumente publike, statistika, vendime dhe materiale të tjera. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave, 33 janë aprovuar për qasje të plotë, 1 kërkesë e aprovuar pjesërisht, dhe 33 kërkesa janë refuzuar. Të gjitha kërkesat janë paraqitur nëpërmjet postës elektronike dhe, po ashtu, përgjigjet janë dërguar në mënyrë elektronike.

# Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme angazhimin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në harmoni me standardet dhe obligimet ndërkombëtare të Republika e Kosovës. Në këtë kontekst, Institucioni ka kontribuar në forcimin e rolit të tij në ndërlidhjen e të drejtave të njeriut me proceset e zbatimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), duke reflektuar funksionin e Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (IKDNj).

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, përfaqëson një kornizë globale gjithëpërfshirëse me 17 objektiva dhe 169 caqe, të shoqëruara me tregues matës për monitorimin e progresit. Në këtë drejtim, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shprehur përkushtimin institucional për zbatimin e kësaj agjende nëpërmjet miratimit të rezolutës përkatëse dhe krijimit të mekanizmave koordinues ndërinstitucionalë, përfshirë Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, si platformë për orientimin dhe harmonizimin e politikave publike me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ).

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm mbështetet në një vizion universal të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili vendos në qendër njeriun, prosperitetin, mbrojtjen e mjedisit, paqen dhe partneritetin. Ajo është thellësisht e ndërlidhur me parimet e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, duke synuar çrrënjosjen e varfërisë dhe pabarazive, garantimin e dinjitetit njerëzor dhe zbatimin e parimit thelbësor “të mos mbetet askush pas”, me fokus të veçantë në grupet më të marginalizuara.

Roli i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në zbatimin e Agjendës 2030 është theksuar edhe në *Deklaratën e Meridas*,<sup>218</sup> e cila nënvizon se Agjenda është e ndërtuar mbi *Kartën e Kombeve të Bashkuara*,<sup>219</sup> *Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut*<sup>220</sup> dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit vazhdon të kontribuojë në promovimin, monitorimin dhe adresimin e çështjeve që lidhen me OZhQ-të, përmes mandatit të tij kushtetues dhe ligjor.

Institucionet e këtij profili, në ushtrimin e mandatit të tyre, aplikojnë *qasje të bazuar në të drejta të njeriut*<sup>221</sup>, si parim udhëheqës të veprimtarisë institucionale. Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2025, IAP-ja ka vijuar integrimin e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) në veprimtarinë e përditshme të Institucionit, nëpërmjet ndërlidhjes së objektivat dhe caqeve përkatëse me të dhënat që burojnë nga ankesat individuale dhe rastet sistematike të trajtuara në IAP.

Duke u mbështetur në funksionalizimin e bazës së re të të dhënave, e cila është në përdorim që nga 1 janari 2024, gjatë vitit raportues 2025 është vazhduar në mënyrë të qëndrueshme procesi i ndërlidhjes së çdo ankese të regjistruar me objektivat përkatëse të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Ky mekanizëm ka shërbyer si një mjet i konsoliduar për analizë, monitorim dhe vlerësim të politikave dhe masave të ndërmarra nga institucionet publike, në funksion të

218 <https://ennhri.org/our-work/topics/sustainable-development-goals/#:~:text=The%20M%C3%A9rida%20Declaration%2C%20adopted%20by,human%20rights%20and%20sustainable%20development.>

219 <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>

220 <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

221 <https://ennhri.org/about-nhris/human-rights-based-approach/>

përbushjes së angazhimeve ndërkombëtare dhe avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Vijimi i këtij procesi ka mundësuar që edhe gjatë vitit 2025 të gjenerohen statistika të ankesave dhe rasteve të hapura në IAP, të ndërlidhura me të gjitha 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Këto statistika pasqyrojnë në mënyrë të strukturuar fushat ku paraqiten shkelle të të drejtave të njeriut, me qëllim të kontribuimit në identifikimin e mangësive sistemike, si dhe në evidentimin e fushave ku nevojiten ndërhyrje të mëtejme institucionale dhe përmirësime të politikave publike.

<b>Numri i ankesave të paraqitura, sipas Objektiveve për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) - një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ</b>	
16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	1471
03. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	148
10. Pabarazitë e Reduktuara	53
08. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	35
17. Partneritetet për Qëllimet	24
04. Arsim Cilësor	19
06. Uji i Pastër dhe Kanalizimi	9
09. Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura	9
07. Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	8
05. Barazia Gjinore	4
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	4
12. Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm	3
13. Veprimi Klimatik	1

<b>Numri i ankesave të hetuara, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)</b>	
16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	551
03. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	44
10. Pabarazitë e Reduktuara	25
08. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	15
04. Arsim Cilësor	11
17. Partneritetet për Qëllimet	10
09. Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura	5
07. Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	4
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	2
05. Barazia Gjinore	1

Analiza e ankesave të hetuara gjatë vitit 2025, të ndërlidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, tregon se shumica dërrmuese e tyre lidhen me OZhQ 16 [Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta], duke pasqyruar shqetësime të vazhdueshme lidhur me funksionimin e institucioneve publike, sundimin e ligjit dhe qasjen në drejtësi. Një numër më i kufizuar ankesash është evidentuar në fushat e shëndetësisë, reduktimit të pabarazive, punësisimit dhe arsimit, duke reflektuar sfida sociale dhe ekonomike që prekin drejtpërdrejt të drejtat e qytetarëve. Ankesat e pakta në fushat e tjera të OZhQ-ve nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht mungesë problemesh, por mund të tregojnë nivel më të ulët raportimi ose vetëdijesimi. Në tërësi, këto të dhëna shërbejnë si bazë për identifikimin e prioriteteve dhe orientimin e veprimeve të Avokatit të Popullit në funksion të avancimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se vazhdimësia e gjenerimit dhe analizimit të këtyre statistikave përbën një instrument të rëndësishëm për monitorimin e progresit të Republikës së Kosovës në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) në nivel nacional, nga perspektiva e IAP-së. Njëkohësisht, ky proces forcon qasjen e koordinuar ndërmjet të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar që parimi i përfitimeve afatgjata për qytetarët dhe parimi *“të mos mbetet askush pas”* të reflektohen në mënyrë të matshme në punën e institucioneve publike.

# Buxheti i IAP-së

# Buxheti i IAP-së

IAP-ja është institucion i pavarur kushtetues, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Kurse kërkesën e vet buxhetore për vitin kalendarik një dhe trevjeçar e paraqet në Kuvendin e Republikës të Kosovës, mbi bazën e prioriteteve dhe nevojave të punës sipas kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore për ushtrimin e mandatit kryesor: mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: "IAP-ja e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës."<sup>222</sup> Po sipas kësaj dispozite ligjore, për IAP-në mund të ndahet buxhet i nevojshëm shtesë për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe ligjet e tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.<sup>223</sup>

## Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

Bazuar në procedurat ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, IAP-ja brenda afatit të paraparë ligjor e ka paraqitur kërkesën e vet buxhetore për vitin 2025 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kërkesa buxhetore për vitin 2025 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur mbi bazën e planifikimit të nevojave dhe aktiviteteve të punës të IAP për vitin kalendarik 2025 bazuar në mandatin ligjor dhe strategjisë zhvillimore të IAP-së.

Buxheti i IAP-së për vitin 2025, sipas Ligjit të Buxhetit, është ndarë në shumën prej 1.451.622.00 €, i destinuar për këto kategori ekonomike buxhetore:

- Paga dhe mëditje, në shumën prej 1.038.622.00 €;
- Mallra dhe shërbime, në shumën prej 356.000.00 €;
- Shpenzime komunale, në shumën prej 7.000.00 €.
- Shpenzime kapitale, në shumën prej 50.000.00 €

Pasqyrimin e gjendjes dhe të rrjedhës së shpenzimeve të buxhetit të Avokati i Popullit për vitin 2025 do ta paraqesim sipas kërkesës buxhetore të IAP-së dhe në raport me buxhetin e ndarë sipas Ligjit për Buxhetin për vitin 2025, duke përfshirë shpenzimet buxhetore në fund të vitit fiskal, si dhe raportimin e kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe shkurtimeve të tjera buxhetore të vendosura me vendim të Qeveria e Republikës së Kosovës. Të dhënat do të paraqiten në formë tabelore dhe sipas kategorive ekonomike buxhetore.

Njëherësh, Avokati i Popullit duhet ta paraqesë edhe raportin financiar të veçantë dhe të detajuar për vitin buxhetor 2025 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbi bazën e raportimit të rregullt vjetor sipas formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, siç kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>224</sup>

Më konkretisht, në paraqitjen tabelore në vijim do të pasqyrohet buxheti i Avokati i Popullit për vitin 2025, duke filluar me kërkesën fillestare buxhetore, buxhetin e ndarë sipas Ligjit Vjetor për Buxhetin 2025, deklarimin e kursimeve buxhetore nga IAP-ja, si dhe të shkurtimeve të buxhetit në fund të vitit fiskal sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kursime të mjeteve financiare.

<sup>222</sup> Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 3.

<sup>223</sup> Po aty.

<sup>224</sup> Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

**Tabela 1:** Buxheti i IAP për vitin 2025, sipas të dhënave në vijim:

Kategoria ekonomike	Kërkesa buxhetore e IAP-së për vitin 2025	Buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2025	Deklarimi i kursimeve nga IAP-ja 2025	Shkurtimet me Vendim të Qeverisë	Gjithsej ndryshimet buxhetore 2025	Buxheti final 2025
<b>Paga dhe mëditje</b>	1.182.039.81	1.038.622.00	(70.000.00)	(104.170.60)	(104.170.60)	959.780.55
<b>Mallra dhe shërbime</b>	310.000.00	356.000.00		(36.342.36)	(36.342.36)	319.657.64
<b>Shpenzime komunale</b>	7.000.00	7.000.00	(3.000.00)	0.00	(3.000.00)	4.000.00
<b>Shpenzimet kapitale</b>	56.000.00	50.000.00	(17.006.00)	0.00	(17.006.00)	32.994.00
<b>Gjithsej buxheti</b>	<b>1.555.039.81</b>	<b>1.451.622.00</b>	<b>90.006.00</b>	<b>(140.512.96)</b>	<b>(160.518.96)</b>	<b>1.316.432.19</b>

Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2025 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e aktiviteteve dhe të punës së Avokati i Popullit, të cilat kanë pasur interes për sigurimin e ushtrimit të mandatit, mbarëvajtjes së punës dhe funksionimit sipas planit të punës të IAP-së.

Kurse lidhur me mosshpenzimin e buxhetit për vitin 2025, në raport me planifikimin dhe ndarjen e buxhetit, si dhe me buxhetin final në fund të vitit fiskal, ndikim kanë pasur edhe donacionet dhe projektet ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave Avokati i Popullit ka siguruar nevojat dhe aktivitetet e ndryshme të punës me interes të lartë për ushtrimin e mandatit, si dhe për realizimin e planit të punës për vitin 2025. Njëherësh, në IAP nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm për shfrytëzimin sa më ekonomik dhe efektiv të buxhetit.

Për vitin buxhetor 2025, sipas procedurave ligjore dhe kërkesës së bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore për vitin 2025 në shumën totale prej 90.006.00 €.

Kurse, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me vendimet e Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 01/281, datë 24.12.2025, janë tërhequr 104.170,60 € nga kategoria e pagave dhe shtesave, me Vendimin Nr. 04/282, datë 24.12.2025, është tërhequr shuma prej 36.342,36 € nga kategoria Mallra dhe Shërbime, ndërsa me Vendimin Nr. 03/261, datë 5.6.2025, për zbatimin e nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, është rritur koeficienti me 0.5 njësi, që aplikohet nga muaji korrik 2025.

## Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2025

Buxheti i Avokati i Popullit për vitin 2025 është realizuar në masën monetare 1.288.052,24 €, që përkthehet në 97,84% të buxhetit final në fund të vitit buxhetor. Në tabelën vijuese do të pasqyrohet gjendja e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2025, sipas të dhënave buxhetore të kategorive ekonomike, të shprehura në përqindje, si për totalin e realizuar të buxhetit, ashtu edhe sipas kategorive ekonomike buxhetore.

**Tabela 2:** Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2025

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për 2025	Buxheti i shpenzuar 2025	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	959.780.55	959.780.55	0.00	100.00%
2.	Mallra dhe shërbime	319.657.00	291.830.06	27.827.58	91.29%
3.	Shpenzime komunale	4.000.00	3.447.63	552.37	86.19%
4.	Shpenzime kapitale	32.994.00	32.994.00	0.00	100.00
	<b>Gjithsej</b>	<b>1.316.432.19</b>	<b>1.288.052.24</b>	<b>28.379.95</b>	<b>97.84%</b>



**RAPORTI VJETOR  
2025**

NR. 25



